



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS CIVILE**

DISERTACION

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE
“DOKTOR”**

**“ASPEKTE JURIDIKO-CIVILE DHE RASTE PRAKTIKE TË ZBATIMIT TË
LIGJIT MBI SHOQËRINË TREGTARE”**

**Kandidati:
Gjin Gjoni**

**Udhëheqës shkencor:
Prof.Asoc.Dr. Endirë Bushati**

Tiranë, 2021

© E drejta e autorit: Gjin Gjoni, 2021

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, shpërndarje, fotokopjim, kopjim, përkthim, përshtatje, përdorje dhe çdo formë tjetër qarkullimi tregtar apo çdo veprimtari tjetër, e cila cënon të drejtën e autorit, pa lejen përkatëse të tij.

Falenderime

Shpreh falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën për realizimin e punimit tim të doktoraturës.

Së pari, falënderoj udhëheqësen time shkencore Prof.Asoc. Dr. Endirë Bushati të këtij punimi doktoral, e cila me kontributin e saj, përmes sugjerimeve e rekomandimeve, më ka ndihmuar dhe nxitur gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi.

Falënderimet shkojnë dhe për të gjithë profesorët e tjerë të Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës, të cilët përmes kontributit të tyre, janë pjesë e punës sime disa vjeçare në realizimin e këtij punimi.

Falënderime të veçanta u shkojnë kolegëve të mi të praktikës, gjyqtarë dhe avokatë, që përmes debateve, diskutimeve, analizave, u përfshinë në realizimin e këtij punimi.

Dhe, në fund, falënderoj Familjen time, e cila siç më ka përkrahur e inkurajuar gjatë gjithë veprimtarisë sime profesionale e shkencore, më ka dhënë mbështetjen maksimale, pa të cilën ky punim doktoral do të ishte i pamundur.

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Falenderime</i>	3
<i><u>LISTA E SHKURTIMEVE</u></i>	<i>vi</i>
<i><u>ABSTRAKTI</u></i>	<i>vii</i>
<i><u>PARATHËNIE</u></i>	<i>viii</i>
<i><u>HYRJE</u></i>	<i>x</i>
<i><u>PJESA I- SHOOËRIA SI PERSON JURIDIK</u></i>	
<i><u>KAPITULLI I - KRIJIMI I SHOOËRIVE DHE PERSONALITETI JURIDIK</u></i>	
1. Personaliteti juridik i shoqërive tregtare	
1.1. Teoritë mbi personalitetin juridik	
1.2. Pasojat juridike të personalitetit të veçantë juridik	
1.3. Krijimi i shoqërive sipas legjislacionit Shqiptar	
1.4. Krijimi i degës dhe zyrës së përfaqësimit	
2. Koncepti i pavlefshmërisë së shoqërisë	
2.1. Praktika gjyqësore shqiptare mbi pavlefshmërinë e shoqërive	
2.2. Pavlefshmëria e shoqërive sipas legjislacionit të BE-së	
2.3. Praktika e GJED mbi pavlefshmërinë	
<i><u>KAPITULLI II - BASHKIMI DHE NDARJA E SHOOËRIVE</u></i>	
1. Rregullimi ligjor i bashkimit dhe ndarjes së shoqërive	
1.1. Rregullimi ligjor sipas të drejtës Europiane	
1.2. Bashkimi ndërkufitar i shoqërive brenda Bashkimit Europian	
2. Kontrolli i përqëndrimeve	
2.1. Praktikë gjyqësore	
2.1.1. Pozita dominuese	
2.1.2. Bashkimet konglomerate	
2.1.3. Bashkimet Vertikale	
2.1.4. Njoftimi për Bashkim	
<i><u>KAPITULLI III – E DREJTA E VENDOSJES DHE TRANSFERIMIT TË SHOOËRIVE BRENDA BE</u></i>	
1. E drejta e vendosjes dhe e lëvizjes së lirë	
1.1. Fusha e zbatimit të të drejtës së vendosjes	
1.2. Rregullat e shteteve të origjinës në kuadër të legjislacionit të BE-së	
1.3. Praktikë gjyqësore mbi të drejtën e vendosjes	
1.3.1. Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen	
1.3.2. C-208/00 Überseering [2002] ECR I-9919	

[1.3.3 Sistemi Sevic](#)

[1.3.4 C-210/06 Cartesio](#)

[2. Procesi i harmonizimit dhe impakti në legjislacionin e vendeve anëtare](#)

[2.1. Direktiva 2009/102/EC “Mbi shoqëritë tregtare me një ortak të vetëm”](#)

[2.2. Direktiva 89 / 666 /EEC 21 Dhjetor 1989 “Mbi kërkesat për publikimin e infomacioneve nga degët të disa shoqërive që janë subjekt i ligjeve të një Vendi tjetër Anëtar”](#)

[2.3. Informacioni i nevojshëm për publikim në rastin e krijimit të degëve nga vendet e treta](#)

KAPITULLI IV - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE *lxx*

[1. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve \(Ndërmjetësimi\)](#)

[2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me elementë të huaj](#)

[2.1. Referimi mbi praktikën e GJED](#)

[2.2. Gjykimi ne mungesë i shoqërive, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve](#)

[3. Dëshmipërblimi kolektiv](#)

[4. Vështrim i përgjithshëm i Rregullores 1215/2012](#)

[4.1. Përcaktimet mbi arbitrazhin](#)

PJESA II - KAPITALI SHOOËRIVE

KAPITULLI V ASPEKTE TË KAPITALIT TË SHOOËRIVE

[1. Koncepti i kapitalit dhe llojet e tij](#)

[2. Forma e organizimit të kapitalit](#)

[3. Lëvizja e lirë e kapitalit në BE](#)

[3.1. Kuadri ligjor European](#)

[3.1.1. Ndalimi i masave shtrënguese](#)

[3.1.2. Kufizimi i investimeve direkte](#)

[3.1.3. Autorizimi paraprak për blerjen e aksioneve](#)

[3.1.4. Taksimi i fitimeve nga shitja e aksioneve](#)

[3.1.5. Taksimi i dividendëve](#)

[4. E drejta për themelimin e shoqërive dhe liria e ofrimit të shërbimeve përtej kufijve](#)

[4.1. Lëvizja e lirë e kapitalit](#)

[4.2. E drejta e shoqërive tregtare](#)

[5. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë](#)

[5.1. Pavlefshmëria e zmadhimit të kapitalit](#)

[5.2. Praktika mbi ndryshimin e vlerës së kapitalit](#)

[5.3. Njoftimi për zmadhimin e kapitalit](#)

[6. Shoqëria tregtare si pjesë e pasurisë bashkëshortore](#)

[6.1. Pjesëtimi i shoqërisë](#)

[6.2. Pavlefshmëria e transferimit të kapitalit nga njëri bashkëshort](#)

KAPITULLI VI - MARRËDHËNIET MES ORTAKËVE DHE AKSIONARËVE NË SHOOËRINË TREGTARE

[1. Përgjegjësia personale në shoqëri dhe abuzimi me formën e saj](#)

[1.1. Përgjegjësia e administratorëve/ organeve drejtuese](#)

[1.2. Përgjegjësia në rastin e grupimeve të shoqërive](#)

[1.3. Përgjegjësia personale e administratorit](#)

[1.3.1. Përgjegjësia Civile](#)

[1.3.2. Përgjegjësia Penale](#)

[1.3.3. Detyrimi për të paraqitur gjendjen e falimentit](#)

[2. Marrëdhëniet me ortakëve](#)

[2.1. Përfundimi i ortakut](#)

[2.2. Procedura për përfundimin e ortakut- Kuorumi i nevojshëm](#)

[2.3. Kompesimi i kuotës](#)

[2.4. Problemet ndërkufitare në përgjegjësinë e administratorëve](#)

[3. Qëndrimi i Gjykatave Shqiptare në lidhje me problematikat e administrimit](#)

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

BIBLIOGRAFI

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
TFBE	Traktati i Funksionimit të Bashkimit Evropian
MSA	Marrëveshja Stabiliz-Asociim
GJA	Gjykata e Apelit
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
KC	Kodi Civil
KF	Kodi i Familjes
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
KP	Kodi Penal
Para.	Paragrafi
RSH	Republika e Shqipërisë

ABSTRAKTI

Ky disertacion synon dhënie e një informacioni të kombinuar, doktrinar dhe praktik, me qëllim evidentimin e problematikave më të rëndësishme të hasura në praktikë gjatë zbatimit të kuadrit ligjor shqiptar dhe atij evropian mbi shoqëritë tregtare. Punimi ofron një vështrim mbi aspekte të rëndësishme lidhur me shoqërinë tregtare si person juridik, duke u ndalur veçanërisht në themelimin, bashkimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu reflektohen disa aspekte të rëndësishme të kapitalit si: lëvizja e lirë brenda tregut evropian, zmadhimi i kapitalit, teoritë e ndryshme mbi konceptin e kapitalit, e drejta e transferimit etj.

Në kuadër të aspiratave të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, merr rëndësi analizimi i disa prej çështjeve më të rëndësishme të shqyrtuara nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në kuadër të legjislacionit evropian mbi shoqëritë tregtare, me qëllim evidentimin e problematikave kryesore dhe transpozimin e tyre jo vetëm në legjislacionin shqiptar, por dhe në praktikën tonë gjyqësore. Në kushtet e një tregu dinamik dhe zhvillimit të aktivitetit tregtar përtej kufijve, ky punim analizon mundësinë e bashkëpunimeve brenda Komunitetit Evropian si dhe mundësinë e bashkimeve ndërkufitare në rastin e Shqipërisë.

Fjalët kyçe: shoqëri tregtare, person juridik, kapital, lëvizje e lirë, ortak, kuota

ABSTRACT

This thesis aims to provide a combined information, doctrinal and practical, in order to identify the most important issues encountered in practice during the implementation of the Albanian and European legal framework on commercial companies. The paper provides an overview of important aspects related to the company as a legal entity, focusing in particular on the establishment, merger and settlement of disputes. Also, reflected are some important aspects of capital such as: free movement within the European market, capital increase, various theories on the concept of capital, the right of transfer, etc.

In the context of Albania's aspirations to become part of the European Union, it is important to analyze some of the most important issues reviewed by the Court of Justice of the European Union in the framework of European legislation on companies, in order to identify the main problems and their transposition not only in Albanian legislation, but also in our case law. In the conditions of a dynamic market and the development of trade activity across borders, this paper analyzes the possibility of cooperation within the European Community and the possibility of cross-border mergers in the case of Albania.

Keywords: commercial company, legal entity, capital, free movement, partner, quota

PARATHËNIE

Ky disertacion synon dhënie e një informacioni të kombinuar, doktrinar dhe praktik, me qëllim evidentimin e problematikave më të rëndësishme të hasura në praktikë gjatë implementimit të kuadrit ligjor shqiptar dhe atij evropian mbi shoqëritë tregtare. Punimi ofron një vështrim mbi aspekte të rëndësishme lidhur me shoqërinë si person juridik, duke u ndalur veçanërisht në themelimin, bashkimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe reflektohen disa aspekte të rëndësishme të kapitalit si: lëvizja e lirë brenda tregut evropian, zmadhimi i kapitalit, teoritë e ndryshme mbi konceptin e kapitalit, e drejta e transferimit etj.

Në kuadër të aspiratave të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, gjykoj të vlefshme analizën e disa prej çështjeve më të rëndësishme të shqyrtuara nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në kuadër të legjislacionit evropian mbi shoqëritë tregtare me qëllim evidentimin e problematikave kryesore dhe transpozimin e tyre jo vetëm në legjislacionin shqiptar, por dhe në praktikën tonë gjyqësore. Në kushtet e një tregu dinamik dhe zhvillimit të aktivitetit tregtar përtej kufijve, ky punim analizon mundësinë e bashkëpunimeve brenda Komunitetit Evropian si dhe mundësinë e bashkimeve ndërkufitare në rastin e Shqipërisë.

Në realizimin e këtij punimi, rol të rëndësishëm ka luajtur kërkimi doktrinar, i cili ka konsistuar në evidentimin dhe analizën e literaturës së nevojshme mbi aspektet më kryesore të krijimit të shoqërive, bashkimeve ndërkufitare, aspekteve të krijimit, lëvizjes dhe zmadhimit të kapitalit etj. Evidentimi i literaturës ka përfshirë identifikimin, mbledhjen dhe analizimin e librave, artikujve shkencorë në fushën ligjore dhe me fokus kryesor shoqërinë tregtare. Bibliografia e përzgjedhur është fokusuar veçanërisht në autorët e huaj.

Në kuadër të këtij disertacioni, një nga komponentët më të rëndësishmë të studimit ka qenë evidentimi dhe përpunimi i praktikës gjyqësore shqiptare dhe evropiane mbi çështjet që janë bërë pjesë e punimit. Praktika gjyqësore zë një hapësirë të konsiderueshme të punimit dhe studimi i saj është kryer me qëllim evidentimin e çështjeve më problematike në drejtim të zbatimit të ligjeve tregtare dhe nxjerrjen në pah të elementëve, të cilët kanë nevojë për përmirësim në këtë drejtim.

Me qëllim arritjen e objektivave të studimit, ka qenë e domosdoshme analiza e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar mbi shoqëritë tregtare. Problemet ligjore dhe praktike janë analizuar nëpërmjet krahasimit të praktikës gjyqësore të gjykatave të Republikës së Shqipërisë, GJED apo gjykatave kombëtare të vendeve anëtare të BE-së. Nëpërmjet analizës krahasimore është bërë i mundur evidentimi i problematikave kryesore në varësi të qasjes së legjislacioneve dhe qëndrimeve të gjykatave kombëtare. Metoda e analizës ligjore ka shërbyer gjithashtu në gjetjen e disa propozimeve për zgjidhjen e problemeve praktike të lindura në kuadër të normave tregtare.

Objektivi i këtij disertacioni është paraqitja e problematikave kryesore të evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit tregtar shqiptar dhe evropian me qëllim paraqitjen e disa zgjidhjeve të mundshme të parashtruara nga doktrina dhe praktika vendase apo e huaj, kryesisht duke u fokusuar në aspektet e mëposhtme:

- Analiza e problematikave që paraqet në praktikë procedura e krijimit të shoqërive tregtare, veçanërisht në kuadër të pavlefshmërisë së shoqërisë, ligjit të zbatueshëm dhe fitimin e personalitetit juridik;

- Evidentimi i praktikës gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të ligjeve tregtare me qëllim huazimin e praktikave më të mira;
- Propozimi i ndryshimeve ligjore mbi normat e kuadrit ligjor mbi shoqëritë tregtare, të cilat shfaqen problematike në zbatimin praktik;
- Problematikat e hasura në procedurat e bashkimit të shoqërive tregtare;
- Problematikat lidhur me kryerjen e aktivitetit ndërkuftar të shoqërive;
- Aspekte të lëvizjes së lirë të kapitalit;
- Problematika lidhur me përgjegjësitë personale të administratorëve dhe ortakëve;
- Aspekte të veprimtarisë tregtare në kuadër të se drejtës ndërkombëtare private;
- Aspekte të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare me ndërmjetësim duke u bazuar në praktikën europiane.

Ky disertacion është i organizuar në dy pjesë. Pjesa e parë përmban një analizë të shoqërisë si person juridik dhe aspekte të lidhura me të, ndërkohë që pjesa e dytë trajton aspekte të krijimit, zmadhimit dhe tjetërsimit të kapitalit të shoqërive tregtare.

PJESA I është organizuar në katër kapituj si më poshtë:

Kapitulli i parë, i kushtohet mënyrës së fitimit të personalitetit juridik të shoqërive tregtare, si momenti më i rëndësishëm lidhur me krijimin si dhe pasojat përkatëse të cilat vijnë ipso jure me fitimin e këtij personaliteti. Mundësia e krijimit të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive është gjithashtu objekt studimi i këtij kapitulli. Një aspekt i rëndësishëm i përfshirë në këtë kapitull është dhe trajtimi i konceptit të pavlefshmërisë së shoqërisë dhe praktikës shqiptare e evropiane lidhur me këtë çështje.

Kapitulli i dytë, trajton çështje të lidhura me procesin e bashkimit të shoqërive sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar dhe atij evropian, duke u ndalur në praktikën gjyqësore europiane me qëllim ilustrimin e procedurave të bashkimit të parashikuar në direktivat europiane, njoftimin për bashkim, bashkimet konglomerate, bashkimet vertikale etj. me qëllim identifikimin e problematikave kryesore në kuadër të zbatimit të legjislacionit tregtar në këtë kuadër dhe evidentimin e kriterëve të përdorura për analizën e pasojave të bashkimeve mes shoqërive.

Kapitulli i tretë, trajton mundësinë e shoqërive për të kryer aktivitet tregtar ndërkuftar dhe analizon aspekte në lidhje me të drejtën e vendosjes së tyre brenda Bashkimit Europian, duke parashtruar aspekte ligjore të vendeve të origjinës si dhe dhe rastet praktike të lidhura me çështjen e transferimit të selive të shoqërive. Praktika europiane është e pasur në këtë drejtim dhe veçanërisht çështjet Überseering dhe Cartesio, kanë ndikuar në aspekte të rëndësishme të unifikimit të praktikës mbi shoqëritë, të cilat ushtrojnë aktivitet në disa vende të BE-së. Në këtë kuadër është analizuar dhe procesi i harmonizimit të legjislacionit mes vendeve anëtare duke paraqitur disa elemente thelbësore të direktivave ekzistuese në këtë fushë.

Kapitulli i katërt, i kushtohet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura në shoqëritë tregtare, duke u ndalur në dy momente kryesore: Zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, duke u fokusuar tek ndërmjetësimi dhe zgjidhjen e tyre në rastin e konflikteve me elementë të huaj.

PJESA II është organizuar në dy kapituj si më poshtë:

Kapitulli i pestë, i kushtohet aspekteve më të rëndësishme lidhur me kapitalin e shoqërive tregtare duke u fokusuar në kontributin për krijimin e kapitalit, transferimin e tij, zmadhimin e kapitalit si dhe çështje të tjera lidhur me të. Në këtë drejtim, është bërë një analizë e hollësishme e praktikës gjyqësore shqiptare dhe jo vetëm. Ky kapitull përfshin çështje të rëndësishme të lëvizjes së lirë të kapitalit brenda BE-së, si një nga katër liritë themelore të garantuara brenda Komunitetit, duke nxjerrë në pah dhe masat shtrënguese të miratuara nga Vendet Anëtare të cilat pengojnë ose zvogëlojnë mundësinë e lëvizjes së lirë brenda tregut evropian.

Kapitulli i gjashtë, trajton çështje të lidhura me përgjegjësinë e ortakëve apo administratorëve në lidhje me administrimin e shoqërive, në rastin e grupimeve të shoqërive si dhe në rastin e abuzimit me formën e shoqërisë. Marrëdhëniet mes ortakëve të shoqërisë si zotërues të saj, përbëjnë gjithashtu një aspekt të rëndësishëm të ecurisë së shoqërisë, duke shkaktuar shpesh dhe problematika në zbatimin e ligjit, veçanërisht në rastin e likuidimit të kuotave apo shkeljes së marrëdhënies së besimit mes ortakëve.

Ky disertacion, mendoj se do të lehtësojë në mënyrë modeste jo vetëm shoqëritë tregtare të cilat mund të informohen mbi mundësitë ligjore të ofruara në Shqipëri dhe jashtë saj, por dhe studiuesit e së drejtës, gjyqtarët dhe avokatët, të cilët dëshirojnë të eksplorojnë problematikat e zbatimit të ligjeve tregtare në kuadër të praktikës gjyqësore shqiptare dhe evropiane.

HYRJE

Që prej vitit 2008, kur u miratua Ligji nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, institucionet shqiptare kanë marrë një sërë masash, legjislativë dhe jo vetëm për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar mbi biznesin me *acquis communautaire*.

Në vitin 2011 u miratua Ligji nr.10475, datë 27.10.2011, “Për një ndryshim në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ky ndryshim kishte për qëllim të realizonte kërkesat e Direktivës së Dytë të BE-së për përshtatjen e nivelit të kapitalit minimal sipas direktivës.¹

Një nga ligjet e miratuara në këtë drejtim, është dhe Ligji nr.110/2012, “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, një ligj ky tërësisht i përafuar me Direktivën 2005/56/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar"².

Ky ligj zbatohet për bashkimet ndërkufitare³, nëse, të paktën, njëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim është shoqëri shqiptare.

Më tej, gjithmonë në kuadër të harmonizimit me *acquis communautaire*, përmes Ligjit nr.129/2014, u ndryshua përsëri Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Së bashku dhe me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe një sërë ligjesh të tjera specifike për biznesin, vlerësohet se Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë në këtë fushë,⁴ të thjeshtë e të harmonizuar me legjislacionin evropian dhe që lehtëson investimet e huaja në vend.

Punimi trajton aspekte të veçanta juridiko-civile dhe raste praktike të zbatimit të ligjit për shoqëritë tregtare, pikërisht duke dhënë panoramën e të drejtës së BE-së për këto aspekte, dhe njëkohësisht duke interpretuar dispozitat e legjislacionit shqiptar në bazë të standardeve ligjore evropiane, duke synuar në të njëjtën kohë që standardet e zbatimit të së drejtës tregtare shqiptare në gjykatat shqiptare, të ndryshohen konform standardeve evropiane.

Një aspekt i rëndësishëm i të drejtës tregtare është themelimi i shoqërisë tregtare. Legjislacioni shqiptar në këtë kuadër është në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe krijon lehtësi maksimale mbi themelimin e shoqërive dhe fitimin e personalitetit juridik. Me ndryshimet e bëra në vitin 2014, Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ka prezantuar për herë të parë konceptin e pavlefshmërisë së krijimit të një shoqërie tregtare duke ecur në drejtim të përshtatjes së legjislacionit me *Acquis Communautaire*, veçanërisht Direktivën e Këshillit 68/151/ KEE të 9 Marsit 1968. Ligji përcakton dy regjime të ndryshme: pavlefshmërinë absolute dhe atë relative. Gjykimi mbi ekzistencën e njëjës prej këtyre lloj pavlefshmërisë, do

¹ Direktiva e Dytë e Këshillit 77/91 KEE, datë 13 dhjetor 1976, “Për bashkërendimin e elementëve mbrojtës që u kërkojnë shoqërive tregtare shtetet anëtare për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve, në kuadër të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, lidhur me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar publike dhe ruajtjen dhe ndryshimin e kapitalit për vendosjen në një nivel të këtyre elementëve mbrojtës”.

² Numri CELEX: 32005L0056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 310, datë 25.11.2005, faqe 1 - 9.

³ Shih nenin 3 të Ligjit.

⁴ J.Dine, M.Blecher, Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Teksti me shpjegime, version I rishikuar, 2016, f.6-7.

të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasojat që do të vijnë kundrejt personit juridik të krijuar (shoqërisë tregtare). Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka elaboruar ndryshimet mes pavlefshmërisë së krijimit të shoqërisë tregtare dhe pavlefshmërisë së veprimeve juridike, duke plotësuar kuptimin e dispozitave të parashikuara në ligjin e shoqërive tregtare. Në përfundim të punimit do të analizohet nëse ky interpretim është i mjaftueshëm apo nevojitet një ndërhyrje në ligj.

Përsa i përket ndarjes apo bashkimit të shoqërive tregtare, duhet analizuar jo vetëm teksti i ligjit shqiptar, i cili është në përputhje me direktivat evropiane, por në kushtet kur vetë praktika e GJED e paraqet këtë çështje me ndjeshmëri të lartë dhe impakt publik, duhet që kjo praktikë të njihet dhe përqafohet nga gjykatat shqiptare.

Në kuadër të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, si dhe në kuadër të një procesi që po shkon drejt unifikimit të legjislacionit të shoqërive tregtare brenda vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, një set Direktivash janë krijuar me qëllim lehtësimin e tregut të përbashkët dhe krijimin e një seti minimum rregullash të përbashkëta në të gjithë bashkimin.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është çështja e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elementë të huaj. Lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve është një nga hapat më domethënës që Rregullorja Bruksel I e rishikuar ka ndërmarrë. Tashmë nuk do të jetë më e nevojshme deklarimi i një vendimi si “i ekzekutueshëm”, por mjafton që ky vendim të jetë dhënë në një shtet anëtar dhe të jetë i ekzekutueshëm në shtetin anëtar ku është dhënë. Nëse këto dy kushte plotësohen, atëherë vendimi është i ekzekutueshëm në çdo shtet tjetër anëtar.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i shoqërive tregtare është kapitali. Koncepti i kapitalit të shoqërisë është i gjithëpranuar si shuma e përgjithshme e deklaruar në bilanc si aktiv dhe korrespondon me vlerën e kontributeve fillestare të bërë nga ortakët e shoqërisë në momentin e krijimit të saj, si dhe me asetet neto të shoqërisë të cilat janë të destinuara të përdoren për zhvillimin e aktivitetit tregtar. Kapitali përbën një nga garancitë kryesore të kreditorëve në marrëdhëniet kontraktore me shoqëritë dhe ideja e vendosjes së kapitalit minimal kulmoi me miratimin e Direktivës së dytë mbi kapitalin⁵. Ekzistenca e rregullave për mbrojtjen e interesave ekonomike të kreditorëve është një zgjidhje e domosdoshme për shkak të mungesës së tregjeve ideale në të cilat transparenca është maksimale dhe ku sjelljet oportuniste nuk janë prezente. Në kushtet e tregjeve ku ekziston mundësia e asimetrisë së informacionit, doktrina e kapitalit ligjor duhet të shikohet e ndërthurur me mekanizmat e mbrojtjes së kreditorëve. Niveli i mbrojtjes së ofruar kundrejt kreditorëve, varion nga një shtet në tjetrin, megjithatë në një vështrim të përgjithshëm, shtete e BE-së janë të orientuara më tepër drejt mbrojtjes së interesave të kreditorëve, ndërkohë që në SHBA vihet re një qasje, e cila ofron më tepër fleksibilitet për ortakët dhe aksionerët e shoqërive në krahasim me kreditorët.

GJED, në praktikën e saj ka analizuar dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga Shtetet Anëtare me qëllim nxitjen e investimeve në tregun e brendshëm dhe kufizimin e investimeve në shoqëri të krijuara në një Shtet tjetër Anëtar. Një nga llojet më të ndeshura të këtij kufizimi, mund të konsiderohet dhe vendosja e disa procedurave të miratimit paraprak, sipas të cilave shoqëria duhet të autorizohet nga shteti para marrjes së vendimeve lidhur me disa aspekte të rëndësishme të menaxhimit të shoqërisë dhe ushtrimit të të drejtave që lindin nga zotërimi i kuotave dhe aksioneve.

Brenda vendeve të Bashkimit Evropian, ka ndryshime të konsiderueshme mbi mekanizmat ligjorë të aplikueshëm për administratorët në përgjithësi dhe llojet e përgjegjësisë së tyre.

⁵ Escher – Weingart, Reform durch Deregulierung im Kapitalgesellschaftsrecht (2001) 59

Analiza e vendimeve gjyqësore shqiptare në këtë drejtim, nxjerr në pah dhe vështirësitë që hasin gjykatat në interpretimin e duhur të dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare. Si qëndron përgjegjësia civile e tyre dhe si duhet aplikuar Kodi i Punës në rastin e administratorëve është një aspekt tjetër i punimit. Po kështu dhe marrëdhëniet mes ortakëve, largimi i ortakut dhe kuorumi i nevojshëm, janë aspekte të rëndësishme të organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare, për të cilat duhet pasur në vëmendje jurisprudenca evropiane.

Aktualisht në Shqipëri ende nuk ka një praktikë gjyqësore të konsoliduar në drejtim të përcaktimit të mënyrës sesi do të vepohet në rastin e një aktiviteti tregtar të bashkëshortëve kur ata vendosin të zgjidhin martesën. Pas zgjidhjes së martesës, kur palët i drejtohen gjykatës për pjesëtimin e pasurisë, shfaqen problemet lidhur me mirë administrimin ose jo të veprimtarisë tregtare. Në praktikën shqiptare gjatë administrimit të shoqërive tregtare shtrohen pyetjet: A kërkohet pëlqimi i bashkëshortit në tjetërsimin e kuotave të një shoqërie tregtare? Nëse bashkëshortët ndërmjet tyre kanë bërë marrëveshje mes tyre për transferim kuotash, a është kjo marrëveshje e vlefshme, nëse nuk është bërë me akt noterial për shkak se ortakët në këtë rast janë njëkohësisht dhe bashkëshortë?

Gjyqtari shqiptar gjatë interpretimit të dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare, nuk duhet mjaftuar vetëm me interpretimin strikt të normës, por në rrugën e integritit të Shqipërisë në BE, duhet të “mësohet” të interpretojë si një “gjyqtar evropian” nën dritën e vendimeve të GJED.



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS CIVILE**

DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR”

**“ASPEKTE JURIDIKO-CIVILE DHE RASTE PRAKTIKE TË ZBATIMIT TË
LIGJIT MBI SHOQËRINË TREGTARE”**

Kandidati:

Gjin Gjoni

Udhëheqës shkencor:

Prof.Asoc.Dr. Endirë Bushati

Tiranë, 2021

© E drejta e autorit: Gjin Gjoni, 2021

Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, shpërndarje, fotokopjim, kopjim, përkthim, përshtatje, përdorje dhe çdo formë tjetër çarkullimi tregtar apo çdo veprimtari tjetër, e cila cënon të drejtën e autorit, pa lejen përkatëse të tij.

Falenderime

Shpreh falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën për realizimin e punimit tim të doktoraturës.

Së pari, falënderoj udhëheqësen time shkencore Prof.Asoc. Dr. Endirë Bushati të këtij punimi doktoral, e cila me kontributin e saj, përmes sugjerimeve e rekomandimeve, më ka ndihmuar dhe nxitur gjatë gjithë periudhës së punës për realizimin e këtij punimi.

Falënderimet shkojnë dhe për të gjithë profesorët e tjerë të Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Tiranës, të cilët përmes kontributit të tyre, janë pjesë e punës sime disa vjeçare në realizimin e këtij punimi.

Falënderime të veçanta u shkojnë kolegëve të mi të praktikës, gjyqtarë dhe avokatë, që përmes debateve, diskutimeve, analizave, u përfshinë në realizimin e këtij punimi.

Dhe, në fund, falënderoj Familjen time, e cila siç më ka përkrahur e inkurajuar gjatë gjithë veprimtarisë sime profesionale e shkencore, më ka dhënë mbështetjen maksimale, pa të cilën ky punim doktoral do të ishte i pamundur.

TABELA E PËRMBAJTJES

<i>Falenderime</i>	3
<u>LISTA E SHKURTIMEVE</u>	<i>vi</i>
<u>ABSTRAKTI</u>	<i>vii</i>
<u>PARATHËNIE</u>	<i>viii</i>
<u>HYRJE</u>	<i>x</i>
<u>PJESA I- SHOOËRIA SI PERSON JURIDIK</u>	
<u>KAPITULLI I - KRIJIMI I SHOOËRIVE DHE PERSONALITETI JURIDIK</u>	
1. Personaliteti juridik i shoqërive tregtare	
1.1. Teoritë mbi personalitetin juridik	
1.2. Pasojat juridike të personalitetit të veçantë juridik	
1.3. Krijimi i shoqërive sipas legjislacionit Shqiptar	
1.4. Krijimi i degës dhe zyrës së përfaqësimit	
2. Koncepti i pavlefshmërisë së shoqërisë	
2.1. Praktika gjyqësore shqiptare mbi pavlefshmërinë e shoqërive	
2.2. Pavlefshmëria e shoqërive sipas legjislacionit të BE-së	
2.3. Praktika e GJED mbi pavlefshmërinë	
<u>KAPITULLI II - BASHKIMI DHE NDARJA E SHOOËRIVE</u>	
1. Rregullimi ligjor i bashkimit dhe ndarjes së shoqërive	
1.1. Rregullimi ligjor sipas të drejtës Europiane	
1.2. Bashkimi ndërkufitar i shoqërive brenda Bashkimit Europian	
2. Kontrolli i përqëndrimeve	
2.1. Praktikë gjyqësore	
2.1.1. Pozita dominuese	
2.1.2. Bashkimet konglomerate	
2.1.3. Bashkimet Vertikale	
2.1.4. Njoftimi për Bashkim	
<u>KAPITULLI III – E DREJTA E VENDOSJES DHE TRANSFERIMIT TË SHOOËRIVE BRENDA BE</u>	
1. E drejta e vendosjes dhe e lëvizjes së lirë	
1.1. Fusha e zbatimit të të drejtës së vendosjes	
1.2. Rregullat e shteteve të origjinës në kuadër të legjislacionit të BE-së	
1.3. Praktikë gjyqësore mbi të drejtën e vendosjes	
1.3.1. Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen	
1.3.2. C-208/00 Überseering [2002] ECR I-9919	

[1.3.3 Sistemi Sevic](#)

[1.3.4 C-210/06 Cartesio](#)

[2. Procesi i harmonizimit dhe impakti në legjislacionin e vendeve anëtare](#)

[2.1. Direktiva 2009/102/EC “Mbi shoqëritë tregtare me një ortak të vetëm”](#)

[2.2. Direktiva 89 / 666 /EEC 21 Dhjetor 1989 “Mbi kërkesat për publikimin e infomacioneve nga degët të disa shoqërive që janë subjekt i ligjeve të një Vendi tjetër Anëtar”](#)

[2.3. Informacioni i nevojshëm për publikim në rastin e krijimit të degëve nga vendet e treta](#)

KAPITULLI IV - ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE *lxx*

[1. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve \(Ndërmjetësimi\)](#)

[2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me elementë të huaj](#)

[2.1. Referimi mbi praktikën e GJED](#)

[2.2. Gjykimi në mungesë të shoqërive, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve](#)

[3. Dëshmipërblimi kolektiv](#)

[4. Vështrim i përgjithshëm i Rregullores 1215/2012](#)

[4.1.Përcaktimet mbi arbitrazhin](#)

PJESA II - KAPITALI I SHOQËRIVE

KAPITULLI V ASPEKTE TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE

[1. Koncepti i kapitalit dhe llojet e tij](#)

[2. Forma e organizimit të kapitalit](#)

[3. Lëvizja e lirë e kapitalit në BE](#)

[3.1. Kuadri ligjor European](#)

[3.1.1. Ndalimi i masave shtrënguese](#)

[3.1.2 Kufizimi i investimeve direkte](#)

[3.1.3 Autorizimi paraprak për blerjen e aksioneve](#)

[3.1.4. Taksimi i fitimeve nga shitja e aksioneve](#)

[3.1.5. Taksimi i dividendëve](#)

[4. E drejta për themelimin e shoqërive dhe liria e ofrimit të shërbimeve përtej kufijve](#)

[4.1. Lëvizja e lirë e kapitalit](#)

[4.2. E drejta e shoqërive tregtare](#)

[5. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë](#)

[5.1. Pavlefshmëria e zmadhimit të kapitalit](#)

[5.2. Praktika mbi ndryshimin e vlerës së kapitalit](#)

[5.3. Njoftimi për zmadhimin e kapitalit](#)

[6. Shoqëria tregtare si pjesë e pasurisë bashkëshortore](#)

[6.1. Pjesëtimi i shoqërisë](#)

[6.2. Pavlefshmëria e transferimit të kapitalit nga njëri bashkëshort](#)

KAPITULLI VI - MARRËDHËNIET MES ORTAKËVE DHE AKSIONARËVE NË SHOOËRINË TREGTARE

[1. Përgjegjësia personale në shoqëri dhe abuzimi me formën e saj](#)

[1.1. Përgjegjësia e administratorëve/ organeve drejtuese](#)

[1.2. Përgjegjësia në rastin e grupimeve të shoqërive](#)

[1.3. Përgjegjësia personale e administratorit](#)

[1.3.1. Përgjegjësia Civile](#)

[1.3.2. Përgjegjësia Penale](#)

[1.3.3. Detyrimi për të paraqitur gjendjen e falimentit](#)

[2. Marrëdhëniet me ortakëve](#)

[2.1. Përfundimi i ortakut](#)

[2.2. Procedura për përfundimin e ortakut- Kuorumi i nevojshëm](#)

[2.3. Kompesimi i kuotës](#)

[2.4. Problemet ndërkufitare në përgjegjësinë e administratorëve](#)

[3. Qëndrimi i Gjykatave Shqiptare në lidhje me problematikat e administrimit](#)

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

BIBLIOGRAFI

LISTA E SHKURTIMEVE

BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
TFBE	Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian
MSA	Marrëveshja Stabiliz-Asociim
GJA	Gjykata e Apelit
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
KC	Kodi Civil
KF	Kodi i Familjes
KPrC	Kodi i Procedurës Civile
KP	Kodi Penal
Para.	Paragrafi
RSH	Republika e Shqipërisë

ABSTRAKTI

Ky disertacion synon dhënie e një informacioni të kombinuar, doktrinar dhe praktik, me qëllim evidentimin e problematikave më të rëndësishme të hasura në praktikë gjatë zbatimit të kuadrit ligjor shqiptar dhe atij evropian mbi shoqëritë tregtare. Punimi ofron një vështrim mbi aspekte të rëndësishme lidhur me shoqërinë tregtare si person juridik, duke u ndalur veçanërisht në themelimin, bashkimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Gjithashtu reflektohen disa aspekte të rëndësishme të kapitalit si: lëvizja e lirë brenda tregut evropian, zmadhimi i kapitalit, teoritë e ndryshme mbi konceptin e kapitalit, e drejta e transferimit etj.

Në kuadër të aspiratave të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, merr rëndësi analizimi i disa prej çështjeve më të rëndësishme të shqyrtuara nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në kuadër të legjislacionit evropian mbi shoqëritë tregtare, me qëllim evidentimin e problematikave kryesore dhe transpozimin e tyre jo vetëm në legjislacionin shqiptar, por dhe në praktikën tonë gjyqësore. Në kushtet e një tregu dinamik dhe zhvillimit të aktivitetit tregtar përtej kufijve, ky punim analizon mundësinë e bashkëpunimeve brenda Komunitetit Evropian si dhe mundësinë e bashkimeve ndërkuftare në rastin e Shqipërisë.

Fjalët kyçe: shoqëri tregtare, person juridik, kapital, lëvizje e lirë, ortak, kuota

ABSTRACT

This thesis aims to provide a combined information, doctrinal and practical, in order to identify the most important issues encountered in practice during the implementation of the Albanian and European legal framework on commercial companies. The paper provides an overview of important aspects related to the company as a legal entity, focusing in particular on the establishment, merger and settlement of disputes. Also, reflected are some important aspects of capital such as: free movement within the European market, capital increase, various theories on the concept of capital, the right of transfer, etc.

In the context of Albania's aspirations to become part of the European Union, it is important to analyze some of the most important issues reviewed by the Court of Justice of the European Union in the framework of European legislation on companies, in order to identify the main problems and their transposition not only in Albanian legislation, but also in our case law. In the conditions of a dynamic market and the development of trade activity across borders, this paper analyzes the possibility of cooperation within the European Community and the possibility of cross-border mergers in the case of Albania.

Keywords: commercial company, legal entity, capital, free movement, partner, quota

PARATHËNIE

Ky disertacion synon dhënie të një informacioni të kombinuar, doktrinar dhe praktik, me qëllim evidentimin e problematikave më të rëndësishme të hasura në praktikë gjatë implementimit të kuadrit ligjor shqiptar dhe atij evropian mbi shoqëritë tregtare. Punimi ofron një vështrim mbi aspekte të rëndësishme lidhur me shoqërinë si person juridik, duke u ndalur veçanërisht në themelimin, bashkimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe reflektohen disa aspekte të rëndësishme të kapitalit si: lëvizja e lirë brenda tregut evropian, zmadhimi i kapitalit, teoritë e ndryshme mbi konceptin e kapitalit, e drejta e transferimit etj.

Në kuadër të aspiratave të Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian, gjykoj të vlefshme analizën e disa prej çështjeve më të rëndësishme të shqyrtuara nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian në kuadër të legjislacionit evropian mbi shoqëritë tregtare me qëllim evidentimin e problematikave kryesore dhe transpozimin e tyre jo vetëm në legjislacionin shqiptar, por dhe në praktikën tonë gjyqësore. Në kushtet e një tregu dinamik dhe zhvillimit të aktivitetit tregtar përtej kufijve, ky punim analizon mundësinë e bashkëpunimeve brenda Komunitetit Evropian si dhe mundësinë e bashkimeve ndërkuftare në rastin e Shqipërisë.

Në realizimin e këtij punimi, rol të rëndësishëm ka luajtur kërkimi doktrinar, i cili ka konsistuar në evidentimin dhe analizën e literaturës së nevojshme mbi aspektet më kryesore të krijimit të shoqërive, bashkimeve ndërkuftare, aspekteve të krijimit, lëvizjes dhe zmadhimit të kapitalit etj. Evidentimi i literaturës ka përfshirë identifikimin, mbledhjen dhe analizimin e librave, artikujve shkencorë në fushën ligjore dhe me fokus kryesor shoqërinë tregtare. Bibliografia e përzgjedhur është fokusuar veçanërisht në autorët e huaj.

Në kuadër të këtij disertacioni, një nga komponentët më të rëndësishmë të studimit ka qenë evidentimi dhe përpunimi i praktikës gjyqësore shqiptare dhe evropiane mbi çështjet që janë bërë pjesë e punimit. Praktika gjyqësore zë një hapësirë të konsiderueshme të punimit dhe studimi i saj është kryer me qëllim evidentimin e çështjeve më problematike në drejtim të zbatimit të ligjeve tregtare dhe nxjerrjen në pah të elementëve, të cilët kanë nevojë për përmirësim në këtë drejtim.

Me qëllim arritjen e objektivave të studimit, ka qenë e domosdoshme analiza e kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar mbi shoqëritë tregtare. Problemet ligjore dhe praktike janë analizuar nëpërmjet krahasimit të praktikës gjyqësore të gjykatave të Republikës së Shqipërisë, GJED apo gjykatave kombëtare të vendeve anëtare të BE-së. Nëpërmjet analizës krahasimore është bërë i mundur evidentimi i problematikave kryesore në varësi të qasjes së legjislacioneve dhe qëndrimeve të gjykatave kombëtare. Metoda e analizës ligjore ka shërbyer gjithashtu në gjetjen e disa propozimeve për zgjidhjen e problemeve praktike të lindura në kuadër të normave tregtare.

Objektivi i këtij disertacioni është paraqitja e problematikave kryesore të evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit tregtar shqiptar dhe evropian me qëllim paraqitjen e disa zgjidhjeve të mundshme të parashtruara nga doktrina dhe praktika vendase apo e huaj, kryesisht duke u fokusuar në aspektet e mëposhtme:

- *Analiza e problematikave që paraqet në praktikë procedura e krijimit të shoqërive tregtare, veçanërisht në kuadër të pavlefshmërisë së shoqërisë, ligjit të zbatueshëm dhe fitimin e personalitetit juridik;*
- *Evidentimi i praktikës gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të ligjeve tregtare me qëllim huazimin e praktikave më të mira;*
- *Propozimi i ndryshimeve ligjore mbi normat e kuadrit ligjor mbi shoqëritë tregtare, të cilat shfaqen problematike në zbatimin praktik;*

- *Problematikat e hasura në procedurat e bashkimit të shoqërive tregtare;*
- *Problematikat lidhur me kryerjen e aktivitetit ndërkufitar të shoqërive;*
- *Aspekte të lëvizjes së lirë të kapitalit;*
- *Problematika lidhur me përgjegjësitë personale të administratorëve dhe ortakëve;*
- *Aspekte të veprimtarisë tregtare në kuadër të se drejtës ndërkombëtare private;*
- *Aspekte të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve tregtare me ndërmjetësim duke u bazuar në praktikën europiane.*

Ky disertacion është i organizuar në dy pjesë. Pjesa e parë përmban një analizë të shoqërisë si person juridik dhe aspekte të lidhura me të, ndërkohë që pjesa e dytë trajton aspekte të krijimit, zmadhimit dhe tjetërsimit të kapitalit të shoqërive tregtare.

PJESA I është organizuar në katër kapituj si më poshtë:

Kapitulli i parë, i kushtohet mënyrës së fitimit të personalitetit juridik të shoqërive tregtare, si momenti më i rëndësishëm lidhur me krijimin si dhe pasojat përkatëse të cilat vijnë ipso jure me fitimin e këtij personaliteti. Mundësia e krijimit të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive është gjithashtu objekt studimi i këtij kapitulli. Një aspekt i rëndësishëm i përfshirë në këtë kapitull është dhe trajtimi i konceptit të pavlefshmërisë së shoqërisë dhe praktikës shqiptare e evropiane lidhur me këtë çështje.

Kapitulli i dytë, trajton çështje të lidhura me procesin e bashkimit të shoqërive sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar dhe atij evropian, duke u ndalur në praktikën gjyqësore europiane me qëllim ilustrimin e procedurave të bashkimit të parashikuar në direktivat europiane, njoftimin për bashkim, bashkimet konglomerate, bashkimet vertikale etj. me qëllim identifikimin e problematikave kryesore në kuadër të zbatimit të legjislacionit tregtar në këtë kuadër dhe evidentimin e kriterëve të përdorura për analizën e pasojave të bashkimeve mes shoqërive.

Kapitulli i tretë, trajton mundësinë e shoqërive për të kryer aktivitet tregtar ndërkufitar dhe analizon aspekte në lidhje me të drejtën e vendosjes së tyre brenda Bashkimit Evropian, duke parashtruar aspekte ligjore të vendeve të origjinës si dhe dhe rastet praktike të lidhura me çështjen e transferimit të selive të shoqërive. Praktika europiane është e pasur në këtë drejtim dhe veçanërisht çështjet Überseering dhe Cartesio, kanë ndikuar në aspekte të rëndësishme të unifikimit të praktikës mbi shoqëritë, të cilat ushtrojnë aktivitet në disa vende të BE-së. Në këtë kuadër është analizuar dhe procesi i harmonizimit të legjislacionit mes vendeve anëtare duke paraqitur disa elemente thelbësore të direktivave ekzistuese në këtë fushë.

Kapitulli i katërt, i kushtohet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura në shoqëritë tregtare, duke u ndalur në dy momente kryesore: Zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve, duke u fokusuar tek ndërmjetësimi dhe zgjidhjen e tyre në rastin e konflikteve me elementë të huaj.

PJESA II është organizuar në dy kapituj si më poshtë:

Kapitulli i pestë, i kushtohet aspekteve më të rëndësishme lidhur me kapitalin e shoqërive tregtare duke u fokusuar në kontributin për krijimin e kapitalit, transferimin e tij, zmadhimin e kapitalit si dhe çështje të tjera lidhur me të. Në këtë drejtim, është bërë një analizë e hollësishme e praktikës gjyqësore shqiptare dhe jo vetëm. Ky kapitull përfshin çështje të rëndësishme të lëvizjes së lirë të kapitalit brenda BE-së, si një nga katër liritë themelore të garantuara brenda Komunitetit, duke

nxjerrë në pah dhe masat shtrënguese të miratuara nga Vendet Anëtare të cilat pengojnë ose zvogëlojnë mundësinë e lëvizjes së lirë brenda tregut evropian.

Kapitulli i gjashtë, trajton çështje të lidhura me përgjegjësinë e ortakëve apo administratorëve në lidhje me administrimin e shoqërive, në rastin e grupimeve të shoqërive si dhe në rastin e abuzimit me formën e shoqërisë. Marrëdhëniet mes ortakëve të shoqërisë si zotërues të saj, përbëjnë gjithashtu një aspekt të rëndësishëm të ecurisë së shoqërisë, duke shkaktuar shpesh dhe problematika në zbatimin e ligjit, veçanërisht në rastin e likuidimit të kuotave apo shkeljes së marrëdhënies së besimit mes ortakëve.

Ky disertacion, mendoj se do të lehtësojë në mënyrë modeste jo vetëm shoqëritë tregtare të cilat mund të informohen mbi mundësitë ligjore të ofruara në Shqipëri dhe jashtë saj, por dhe studiuesit e së drejtës, gjyqtarët dhe avokatët, të cilët dëshirojnë të eksplorojnë problematikat e zbatimit të ligjeve tregtare në kuadër të praktikës gjyqësore shqiptare dhe evropiane.

HYRJE

Që prej vitit 2008, kur u miratua Ligji nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, institucionet shqiptare kanë marrë një sërë masash, legislative dhe jo vetëm për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar mbi biznesin me *acquis communautaire*.

Në vitin 2011 u miratua Ligji nr.10475, datë 27.10.2011, “Për një ndryshim në ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Ky ndryshim kishte për qëllim të realizonte kërkesat e Direktivës së Dytë të BE-së për përshtatjen e nivelit të kapitalit minimal sipas direktivës.⁶

Një nga ligjet e miratuara në këtë drejtim, është dhe Ligji nr.110/2012, “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”, një ligj ky tërësisht i përafuar me Direktivën 2005/56/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar"⁷.

Ky ligj zbatohet për bashkimet ndërkufitare⁸, nëse, të paktën, njëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim është shoqëri shqiptare.

Më tej, gjithmonë në kuadër të harmonizimit me *acquis communautaire*, përmes Ligjit nr.129/2014, u ndryshua përsëri Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Së bashku dhe me Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe një sërë ligjesh të tjera specifike për biznesin, vlerësohet se Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë në këtë fushë,⁹ të thjeshtë e të harmonizuar me legjislacionin evropian dhe që lehtëson investimet e huaja në vend.

Punimi trajton aspekte të veçanta juridiko-civile dhe raste praktike të zbatimit të ligjit për shoqëritë tregtare, pikërisht duke dhënë panoramën e të drejtës së BE-së për këto aspekte, dhe njëkohësisht duke interpretuar dispozitat e legjislacionit shqiptar në bazë të standardeve ligjore evropiane, duke synuar në të njëjtën kohë që standardet e zbatimit të së drejtës tregtare shqiptare në gjykatat shqiptare, të ndryshohen konform standardeve evropiane.

Një aspekt i rëndësishëm i të drejtës tregtare është themelimi i shoqërisë tregtare. Legjislacioni shqiptar në këtë kuadër është në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe krijon lehtësi maksimale mbi themelimin e shoqërive dhe fitimin e personalitetit juridik. Me ndryshimet e bëra në vitin 2014, Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ka prezantuar për herë të parë konceptin e pavlefshmërisë së krijimit të një shoqërie tregtare duke ecur në drejtim të përshtatjes së legjislacionit me *Acquis Communautaire*, veçanërisht Direktivën e Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968. Ligji përcakton dy regjime të ndryshme: pavlefshmërinë absolute dhe atë relative. Gjykimi mbi ekzistencën e njërës prej këtyre lloj pavlefshmërisë, do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasojat që do të vijnë kundrejt personit juridik të krijuar (shoqërisë tregtare). Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka elaboruar ndryshimet mes pavlefshmërisë së krijimit të shoqërisë tregtare dhe pavlefshmërisë së veprimeve juridike, duke plotësuar kuptimin e dispozitave të parashikuara në ligjin e shoqërive tregtare. Në përfundim të punimit do të analizohet nëse ky interpretim është i mjaftueshëm apo nevojitet një ndërhyrje në ligj.

Përsa i përket ndarjes apo bashkimit të shoqërive tregtare, duhet analizuar jo vetëm teksti i ligjit shqiptar, i cili është në përputhje me direktivat evropiane, por në kushtet kur vetë praktika e GJED

⁶ Direktiva e Dytë e Këshillit 77/91 KEE, datë 13 dhjetor 1976, “Për bashkërendimin e elementëve mbrojtës që u kërkojnë shoqërive tregtare shtetet anëtare për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve, në kuadër të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, lidhur me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar publike dhe ruajtjen dhe ndryshimin e kapitalit për vendosjen në një nivel të këtyre elementëve mbrojtës”.

⁷ Numri CELEX: 32005L0056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 310, datë 25.11.2005, faqe 1 - 9.

⁸ Shih nenin 3 të Ligjit.

⁹ J.Dine, M.Blecher, Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, Teksti me shpjegime, version I rishikuar, 2016, f.6-7.

e paraqet këtë çështje me ndjeshmëri të lartë dhe impakt publik, duhet që kjo praktikë të njihet dhe përqafohet nga gjykatat shqiptare.

Në kuadër të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, si dhe në kuadër të një procesi që po shkon drejt unifikimit të legjislacionit të shoqërive tregtare brenda vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, një set Direktivash janë krijuar me qëllim lehtësimin e tregut të përbashkët dhe krijimin e një seti minimum rregullash të përbashkëta në të gjithë bashkimin.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është çështja e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elementë të huaj. Lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve është një nga hapat më domethënës që Rregullorja Bruksel I e rishikuar ka ndërmarrë. Tashmë nuk do të jetë më e nevojshme deklarimi i një vendimi si “i ekzekutueshëm”, por mjafton që ky vendim të jetë dhënë në një shtet anëtar dhe të jetë i ekzekutueshëm në shtetin anëtar ku është dhënë. Nëse këto dy kushte plotësohen, atëherë vendimi është i ekzekutueshëm në çdo shtet tjetër anëtar.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i shoqërive tregtare është kapitali. Koncepti i kapitalit të shoqërisë është i gjithëpranuar si shuma e përgjithshme e deklaruar në bilanc si aktiv dhe korrespondon me vlerën e kontributeve fillestare të bërë nga ortakët e shoqërisë në momentin e krijimit të saj, si dhe me asetet neto të shoqërisë të cilat janë të destinuara të përdoren për zhvillimin e aktivitetit tregtar. Kapitali përbën një nga garancitë kryesore të kreditorëve në marrëdhëniet kontraktore me shoqëritë dhe ideja e vendosjes së kapitalit minimal kulmoi me miratimin e Direktivës së dytë mbi kapitalin¹⁰. Ekzistenca e rregullave për mbrojtjen e interesave ekonomike të kreditorëve është një zgjidhje e domosdoshme për shkak të mungesës së tregjeve ideale në të cilat transparencja është maksimale dhe ku sjelljet oportuniste nuk janë prezente. Në kushtet e tregjeve ku ekziston mundësia e asimetrisë së informacionit, doktrina e kapitalit ligjor duhet të shikohet e ndërthurur me mekanizmat e mbrojtjes së kreditorëve. Niveli i mbrojtjes së ofruar kundrejt kreditorëve, varion nga një shtet në tjetrin, megjithatë në një vështrim të përgjithshëm, shtete e BE-së janë të orientuara më tepër drejt mbrojtjes së interesave të kreditorëve, ndërkohë që në SHBA vihet re një qasje, e cila ofron më tepër fleksibilitet për ortakët dhe aksionerët e shoqërive në krahasim me kreditorët.

GJED, në praktikën e saj ka analizuar dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga Shtetet Anëtare me qëllim nxitjen e investimeve në tregun e brendshëm dhe kufizimin e investimeve në shoqëri të krijuara në një Shtet tjetër Anëtar. Një nga llojet më të ndeshura të këtij kufizimi, mund të konsiderohet dhe vendosja e disa procedurave të miratimit paraprak, sipas të cilave shoqëria duhet të autorizohet nga shteti para marrjes së vendimeve lidhur me disa aspekte të rëndësishme të menaxhimit të shoqërisë dhe ushtrimit të të drejtave që lindin nga zotërimi i kuotave dhe aksioneve.

Brenda vendeve të Bashkimit Evropian, ka ndryshime të konsiderueshme mbi mekanizmat ligjorë të aplikueshëm për administratorët në përgjithësi dhe llojet e përgjegjësisë së tyre. Analiza e vendimeve gjyqësore shqiptare në këtë drejtim, nxjerr në pah dhe vështirësitë që hasin gjykatat në interpretimin e duhur të dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare. Si qëndron përgjegjësia civile e tyre dhe si duhet aplikuar Kodi i Punës në rastin e administratorëve është një aspekt tjetër i punimit. Po kështu dhe marrëdhëniet mes ortakëve, largimi i ortakut dhe kuorumi i nevojshëm, janë aspekte të rëndësishme të organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare, për të cilat duhet pasur në vëmendje jurisprudenca evropiane.

Aktualisht në Shqipëri ende nuk ka një praktikë gjyqësore të konsoliduar në drejtim të përcaktimit të mënyrës sesi do të veprohet në rastin e një aktiviteti tregtar të bashkëshortëve kur ata vendosin të zgjidhin martesën. Pas zgjidhjes së martesës, kur palët i drejtohen gjykatës për pjesëtimin e

¹⁰ Escher – Weingart, Reform durch Deregulierung im Kapitalgesellschaftsrecht (2001) 59

pasurisë, shfaqen problemet lidhur me mirë administrimin ose jo të veprimtarisë tregtare. Në praktikën shqiptare gjatë administrimit të shoqërive tregtare shtrohen pyetjet: A kërkohet pëlqimi i bashkëshortit në tjetërsimin e kuotave të një shoqërie tregtare? Nëse bashkëshortët ndërmjet tyre kanë bërë marrëveshje mes tyre për transferim kuotash, a është kjo marrëveshje e vlefshme, nëse nuk është bërë me akt noterial për shkak se ortakët në këtë rast janë njëkohësisht dhe bashkëshortë?

Gjyqtari shqiptar gjatë interpretimit të dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare, nuk duhet mjaftuar vetëm me interpretimin strikt të normës, por në rrugën e integritit të Shqipërisë në BE, duhet të “mësohet” të interpretojë si një “gjyqtar evropian” nën dritën e vendimeve të GJED.

PJESA I - SHOQËRIA SI PERSON JURIDIK

KAPITULLI I

KRIJIMI I SHOQËRIVE DHE PERSONALITETI JURIDIK

1. Personaliteti juridik i shoqërive tregtare

Themelimi i shoqërisë tregtare dhe përcaktimi i datës së saktë të fitimit të personalitetit juridik, paraqesin një rëndësi thelbësore në kuadër të krijimit të shoqërisë si person juridik, pasi bazuar në këto premisa përcaktohet dhe mundësia efektive e shoqërisë për të kryer aktivitet tregtar dhe për të hyrë në marrëdhënie me palë të treta. Një shoqëri tregtare në doktrinë shpesh përkufizohet si “set kontratash”, megjithatë ky koncept mbetet i paplotë dhe shpeshherë përdoret thjesht për të evidentuar se shumica e marrëdhënieve më të rëndësishme juridike brenda një shoqërie, veçanërisht ato midis pronarëve, administratorëve dhe punonjësve të shoqërisë, kanë kryesisht karakter kontraktual dhe bazohen në vullnetin e lirë të palëve. Si fillim, vlen të përmendet kategorizimi i shoqërive tregtare si persona juridikë, me qëllim evidentimin e disa elementëve kryesorë, të cilët shoqëria i gëzon *ipso jure* thjesht me krijimin e saj si person: (a) Mundësia për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime si çdo subjekt i së drejtës; si dhe (b) Organizimi i strukturuar (në varësi të llojit të shoqërisë) që lejon kryerjen e aktivitetit tregtar dhe marrjen e vendimeve. Në doktrinën e të drejtës civile, “*Person juridik është çdo subjekt i së drejtës, i ndryshëm nga personi fizik, çdo entitet i aftë të shprehë vullnet, por i ndryshëm nga individi konkret*”¹¹, pra del qartë në pah se personi juridik është një entitet i aftë të shprehë vullnet, i cili në rastin e shoqërive tregtare shfaqet nëpërmjet zërit të personave apo organeve drejtuese të saj (në varësi të llojit të shoqërisë), duke respektuar modelitetet ligjore të paarshikuara në ligjin ‘Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’.

Rëndësia kryesore e një shoqërie është të shërbejë si një person juridik, duke hyrë në marrëdhënie kontraktuale si palë e vetme, e veçuar nga individët, të cilët zotërojnë kapitalin e saj apo e administrojnë. Duke vepruar kështu, rrit aftësinë e këtyre individëve për t’u angazhuar së bashku në projekte të përbashkëta. Me krijimin e saj, shoqëria diponon tashmë jo vetëm personalitet të veçantë, por dhe asetet e saj, të cilat janë në pronësi ekskluzive të shoqërisë si person juridik dhe jo ortakëve apo aksionerëve. Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare njih katër forma kryesore shoqërish: Shoqëritë kolektive, komanditë, me përgjegjësi të kufizuar dhe aksionare. Në varësi të llojit të shoqërisë do të varen dhe elementët e nevojshëm për krijimin, administrimin dhe kapitalin e shoqërisë¹².

1.1. Teoritë mbi personalitetin juridik

Një nga teoritë kryesore mbi personalitetin juridik, ajo etimologjike, e lidh termin “person” me disa kuptime¹³. Termi “*person*” cilësohet si me prejardhje nga termi “*personare*”¹⁴; i cili lidhet me konceptin “*larva histrionalis*” që nënkupton ‘*maskë*’. Ky term latin, është përdorur vite më parë për fenomenin e përdorimit të aparatave, të cilat e bënin zërin me të plotë dhe kumbues në skenë. Më tej, ky term u përdor për vetë aktorët, të cilët recitonin në skenë dhe përdornin maska, të cilat

¹¹ Nuni, A. “E drejta Civile- Pjesa e Përgjithshme” Tiranë 2001, faqe 107.

¹² Sqarime të detajuara do të jepen në seksionet në vijim të cilat trajtojnë elementët e veçantë të secilës prej këtyre formave.

¹³ Maynez G. E. Introduction to law 273, 1980.

¹⁴ Arcelia Quintana Adriano. E. The Natural Person, Legal Entity or Juridical Person and Juridical Personality, botuar në revistën ‘Penn State Journal of Law & International Affairs’, Dhjetor 2015, faqe377

e bënin zërin me të plotë dhe kumbues¹⁵. Nëse do të bënim një paralelizëm me shoqëritë, ndodh i njëjti fenomen, në të cilin ortakët apo aksionerët e shoqërisë, veprojnë nën petkun e shoqërisë, duke krijuar një personalitet të veçantë dhe të ndryshëm nga ai i personalitetit të tyre si persona fizikë. Në vijim doktrina juridike paraqet gjithashtu disa teori mbi personalitetin juridik të cilat mund të kategorizohen si më poshtë:

- Sipas *Hans Kelsen*, personi fizik dhe ai juridik janë një set të drejtash dhe detyrimesh të cilat po të mblidhen bashkë, cilësohen në mënyrë metaforike si “person”. Në këtë mënyrë, personi fizik apo juridik si një mbajtës, ka detyrime ligjore dhe të drejta subjektive të cilat në mënyrë metaforike shprehen në konceptin e personit, i cili nuk është gje tjetër veçse një mishërim i këtij uniteti¹⁶.
- Sipas *Teorisë së fiktivitetit* të propozuar nga *Savigny*, ‘person’ është çdokush i cili është i aftë të jetë mbajtës i të drejtave dhe detyrimeve dhe të drejtat janë të lidhura vetëm me qëniet, të cilat kanë vullnet dhe për rrjedhojë subjektiviteti ligjor është një rezultat i këtij fiktiviteti pasi këto qenie nuk kanë vullnet të lirë¹⁷.
- *Teoria e personalitetit real*, sipas të cilës zbuluesi i personalitetit është ekzistenca e vullnetit, por përvoja sociologjike tregon se vullneti i një grupi ndryshon nga shumica e vullneteve të cilët përbëjnë grupin¹⁸.

Duke iu referuar tri teorieve të mësipërme, është e dukshme se teoria e personalitetit real është më e afërta me shoqëritë tregtare, pasi në çështjet që lidhen me vendimmarrjen e shoqërive, ortakët apo aksionerët marrin vendime sipas kuorumeve dhe shumicës së nevojshme dhe pikërisht mbi vullnetin e shumicës së grupit ndiqet dhe veprimtaria e shoqërisë tregtare. Në këtë kontekst vullneti i secilit prej ortakëve apo aksionarëve nuk përputhet gjithmonë me vullnetin përfundimtar të grupit, edhe pse shoqëria si person juridik do të vijojë veprimtarinë e saj bazuar pikërisht në këto vendime.

1.2. Pasojat juridike të personalitetit të veçantë juridik

Në praktikë, pas themelimit të shoqërisë tregtare, vijnë disa pasoja, të cilat rrjedhin automatikisht nga krijimi i personalitetit të veçantë. Pasoja më kryesore është përfshirja e shoqërisë në marrëdhëniet kontraktore si një subjekt i veçantë dhe për rrjedhojë dhe marrjen përsipër të detyrimeve nga ana e saj. Tashmë, kreditë të cilat janë marrë në emër të shoqërisë i takojnë shoqërisë, dhe jo administratorit apo ortakëve apo aksionarëve. Kjo është konfirmuar për herë të parë në rastin e *Salomonit*¹⁹. Në këtë mënyrë, borxhet ose detyrimet janë përgjegjësi e shoqërisë për shkak të personit të veçantë juridik (përveç rasteve të përgjegjësisë personale të administratorëve apo ortakëve). Së dyti, asetet e blera në emër të shoqërisë i përkasin asaj. Ato asetet nuk u përkasin administratorëve, ortakëve apo aksionarëve edhe pse mund të zotërojnë 100% të kuotave apo aksioneve. Rasti i *Macaura* kundër *Northern Assurance Co Ltd* (1925) AC 619 para *Dhomës së Lordëve*, tregon se një shoqëri mban pronën e saj veç e veç nga prona e anëtarëve të saj. Së treti, një shoqëri, si një entitet i veçantë juridik, mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuale

¹⁵Po aty.

¹⁶ Vernengo J.R, ‘Hans Kelsen – The pure Law theory’ 178, 2000, i cituar nga Arcelia Quintana Adriano. E sipas Footnotës Nr.4 , faqe 370

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Nuni. A, “E drejta Civile- Pjesa e Përgjithshme” Tiranë 2001, faqe 185.

¹⁹ Personaliteti i veçantë i një kompanie që dallon nga aksionerët e saj u themelua nga *Dhoma e Lordëve* në çështjen *Salomon dhe Salomon & Co* [1897]. Kjo çoi në krijimin e konceptit të ‘vellos’ së shoqërisë dhe konfirmoi se një shoqëri e regjistruar është një person juridik i ndarë nga anëtarët e tij. Kjo çështje krijoi precedentin në praktikën angleze të konceptit të personalitetit të veçantë juridik për shoqëritë dhe konsiderohet si rasti kryesor dhe me rëndësi themelore në kuadër të doktrinës dhe praktikës gjyqësore të personalitetit të veçantë të shoqërive.

me aksionarin ose drejtorin për shkak se janë anëtarë të kontrollit të shoqërisë. Kjo mund të ilustron në rastin e Lee/ Lee's Air Farming Ltd (1960)²⁰. Ky rast tregon se shoqëria mund të hyjë në një kontratë pune me zotin Lee. Së fundi, punëdhënësi në një shoqëri, si një entitet ligjor i veçantë, detyrohet të sigurojë një sistem të sigurt të punës pa marrë parasysh punonjësit e dëmtuar, gjithashtu mund të jetë drejtor ose kontrollues i shoqërisë. Për shembull, Gjykata e Lartë në Australi ka marrë vendim në Andar Transport Pty Ltd kundër Brambles Ltd (2004) 206 ALR 387. Ky rast ilustron pasojat që dalin nga kryqëzimi midis parimeve ligjore në të drejtën e korporatave dhe detyrën e kujdesit të punëdhënësit për të siguruar një sistem të sigurt të punës që lind nga Kodi i Punës.

1.3. Krijimi i shoqërive sipas legjislacionit shqiptar

Sipas legjislacionit shqiptar, krijimi i një shoqërie tregtare duhet të plotësojë disa kushte formale dhe materiale me qëllim krijimin e saj dhe fitimin e personalitetit juridik. Në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”²¹ përcaktohet dhe numri minimal i personave të nevojshëm për krijimin: “*Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).*”²²Në këtë dispozitë përcaktohet qartë elementët e nevojshëm për krijimin:

- a) Një numër minimal personash fizikë apo juridikë (në varësi të llojit të shoqërisë që po krijohet);
- b) Vullneti i shprehur mes personave;
- c) Qëllimi: Arritja e objektivave ekonomike të përbashkëta;
- d) Kontributi;
- e) Statuti.

Në vijim, ligji sanksionon dhe detyrimin e këtyre shoqërive për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)²³: “*Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivitetet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara*”. Me regjistrimin në QKB, shoqërive tregtare u lejohej të zhvillojnë aktivitetin e tyre tregtar brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Duke marrë në konsideratë aspiratat e Shqipërisë për të qenë vend anëtar i Bashkimit Evropian, natyrshëm lind pyetja: A ka mundësia një shoqëri e krijuar në një nga vendet anëtare të BE, të zhvillojë aktivitetin e saj tregtar në territorin e një shteti tjetër anëtar? Kjo është një çështje e ngritur prej vitesh nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (CJEU) dhe do të trajtohet më në detaje në seksionin “*E drejta e Vendasjes në BE*” me qëllim analizimin e konceptit të personalitetit juridik sipas legjislacionit të BE.

Ligji për shoqëritë tregtare nuk përmban rregulla të detajuara mbi procesin e regjistrimit fillestar, por referon tek ligji “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”²⁴, i cili përcakton në mënyrë specifike hapat e nevojshëm për regjistrim. Shoqëritë tregtare regjistrohen në regjistrin tregtar, duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme

²⁰Çështje tregtare nga Yelanda e Re, gjithashtu e rëndësishme për të drejtën e shoqërive tregtare në Britani të Madhe, që lidhet me vëllon e shoqërisë dhe me personalitetin e ndarë juridik.

²¹Ligj Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

²²Neni 3 i Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

²³ Aktualisht Institucioni ka ndryshuar emërtim dhe quhet Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)

²⁴ Ligj Nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”

sipas këtij ligji, statutin dhe aktin e themelimit, në rast se janë hartuar si dy dokumente të veçanta, aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme, si dhe aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.²⁵ Sipas nenit 28 paragrafi 4 i ligjit, shoqëritë kolektive, komandite dhe ato me përgjegjësi të kufizuar mund të regjistrohen, gjithashtu, duke depozituar vetëm aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji, dokumentet e identifikimit të anëtarëve apo ortakëve dhe duke nënshkruar deklaratën e posaçme për njohjen, pranimin dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e llojit të shoqërisë që regjistrohet. Në këtë rast, aplikimi për regjistrim fillestar dhe deklarata e mësipërme, e nënshkruar sipas rastit nga ortakët, anëtarët ose nga personat e autorizuar që veprojnë në emër e për llogari të tyre, zëvendëson aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë.

1.4. Krijimi i degës dhe zyrës së përfaqësimit

Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të vendosin hapjen e degëve dhe/ose të zyrave të përfaqësimit të shoqërisë.²⁶ Degët janë vende të ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Ato veprojnë në mënyrë të qëndrueshme, organizohen dhe administrohen më vete dhe ushtrojnë veprimtari me palë të treta, në emër të shoqërisë. Dega vepron nën emrin e regjistruar të shoqërisë tregtare, si dhe nën emrin e saj. Vlen të përmendet se në rastin e krijimit të një dege të shoqërisë, pavarësisht territorit ku operon kjo degë, nuk kemi të bëjmë me krijimin e një subjekti të ri apo personi të ri juridik. Dega në vetvete nuk gëzon një personalitet të vetin juridik, por është një 'fraksion' i shoqërisë mëmë, i cili ka një organizim autonom. Theksoj se kjo autonomi vihet re vetëm në kuadër të organizimit dhe mundësisë për të kryer veprimtari ekonomike me palët e treta, por në vetvete këto nuk përbëjnë premisë të një personaliteti juridik të veçantë. Për rrjedhojë, krijimi i degës do të kushtëzohet vetëm nga ndjekja e disa formaliteteve ligjore të përcaktuara në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", por jo nga ndonjë faktor tjetër.

Ndërkohë, zyrat e përfaqësimit janë vende të veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe kanë të njëjtin personalitet juridik me shoqërinë. Zyrat e përfaqësimit nuk kanë si qëllim krijimin e të ardhurave, por nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë. Këto zyra mund të lidhin marrëveshje në emër e për llogari të saj. Nëse degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive shqiptare krijojnë faqe interneti, ato duhet të publikojnë numrin unik të identifikimit të shoqërisë në këtë faqe interneti. Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen sipas kërkesave të neneve 26 pika 4, 28 pika 5 dhe 37 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"²⁷. Ligji përcakton dhe modalitetet e nevojshme ligjore në rastin e regjistrimit të degëve të shoqërive të huaja si më poshtë:

- a) Aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës apo zyrës së përfaqësimit, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj apo nga çdo person i autorizuar.²⁸
- b) Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me të gjitha të dhënat e detyrueshme sipas këtij ligji si dhe:

²⁵Neni 28/3 Ligj Nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit"

²⁶ Neni 9 i Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

²⁷Aktualisht QKR ka ndryshuar emërtimin e saj dhe cilësohet "Qendra Kombëtare e Biznesit" (QKB)

²⁸Neni 26 paragrafi 4 i Ligjit Nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit"

- Aktin e themelimit e statutin e shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme;
 - Dokumentacionin, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj;
 - Dokumentacionin, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi;
 - Bilancin e shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit;
 - Vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit. Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emër të shoqërisë së huaj.
- c) Pas dorëzimit të dokumentave të aplikimit dhe pas formalizimit të procesit të krijimit të degës apo zyrës së përfaqësimit, informacioni i nevojshëm i cili duhet të vihet në dispozicion për publikim është si më poshtë²⁹:
- Kapitalin e shoqërisë së huaj;
 - Emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj;
 - Kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - Fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar;
 - Selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit;
 - Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit;
 - Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët.

Për sa më sipër, duket se legjislacioni shqiptar ka paracaktuar një set standartesh minimale për regjistrimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit, duke lehtësuar kështu aktivitetin e tyre tregtar në Shqipëri. Theksoj se dispozitat, janë një reflektim i dukshëm i përcaktimeve të Direktivave Europiane dhe janë në përputhje me frymën e legjislacionit Europian, i cili synon krijimin e lehtësirave në lidhje me krijimin dhe lëvizjen e kapitalit dhe maksimizimin e aktivitetit tregtar.

2. Koncepti i pavlefshmërisë së shoqërisë

Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me ndryshimet e bëra në vitin 2014, ka prezantuar për herë të parë konceptin e pavlefshmërisë së krijimit të një shoqërie tregtare. Ligji përcakton dy regjime të ndryshme: pavlefshmërinë absolute dhe atë relative. Gjykimi mbi ekzistencën e njërës prej këtyre lloj pavlefshmërisë, do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasojat që do të vijnë kundrejt personit juridik të krijuar (shoqërisë tregtare). Vlen për t’u theksuar se ligji nuk bën ndonjë specifikim të kushteve të pavlefshmërisë në varësi të llojit të shoqërisë dhe rredhimisht,

²⁹ Neni 37 i Ligjit Nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”

premisat e pavlefshmërisë do të jenë të njëjta për të gjitha kategoritë e shoqërive tregtare. Në këtë kontekst, neni 3/1 i ligjit, vendos në mënyrë të përmbledhura këtë regjim juridik të pavlefshmërisë:

	Pavlefshmëria absolute	Pavlefshmëria relative
Shkaqet e pavlefshmërisë	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentacioni për regjistrimin fillestar të shoqërisë, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, nuk është hartuar në formë shkresore; • Mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e të gjithë themeluesve të shoqërisë; • Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në kundërshtim me ligjin; • Në statutin e shoqërisë nuk përcaktohen emri i shoqërisë, vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, vlera e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar nga të gjithë themeluesit, apo statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë; • Vlera e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nënshkruar nga të gjithë themeluesit, është më e ulët se vlera e kapitalit minimal, të kërkuar për shoqërinë tregtare, sipas parashikimeve të këtij ligji; • Kapitali i nënshkruar i shoqërive aksionare nuk është shlyer nga themeluesit përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në mënyrat dhe në masën e kërkuar nga ky ligj 	<ul style="list-style-type: none"> • Dokumentacioni për regjistrimin fillestar të shoqërisë, sipas nenit 28, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, nuk është hartuar në formë shkresore; • Mungesa e zotësisë juridike për të vepruar e të gjithë themeluesve të shoqërisë; • Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është në kundërshtim me ligjin; • Në statutin e shoqërisë nuk përcaktohen emri i shoqërisë, vlera e kontributeve të nënshkruara nga secili themelues, vlera e përgjithshme e kapitalit të nënshkruar nga të gjithë themeluesit, apo statuti nuk përmban dispozita në lidhje me objektin e shoqërisë; • Vlera e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë, nënshkruar nga të gjithë themeluesit, është më e ulët se vlera e kapitalit minimal, të kërkuar për shoqërinë tregtare, sipas parashikimeve të këtij ligji; • Kapitali i nënshkruar i shoqërive aksionare nuk është shlyer nga themeluesit përpara regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në mënyrat dhe në masën e kërkuar nga ky ligj
Pasojat ndaj shoqërisë	<p>Pavlefshmëria konstatohet nga gjykata dhe sjell për pasojë prishjen e shoqërisë tregtare dhe hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueese, sipas parashikimeve të nenit 190, pika 1, ose të nenit 192, të këtij ligji, me</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Pavlefshmëria relative, e parashikuar në një nga shkaqet e pikës 1, shpallet nga gjykata. Shpallja e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë tregtare nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor, të

	përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi	përmendur në pikën 3, të këtij neni, rrethana që shkakton pavlefshmërinë është korrigjuar, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar <ul style="list-style-type: none"> Gjykata që shqyrton padinë e ngritur në lidhje me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare, gjatë të njëjtit proces gjyqësor, vlerëson nëse rrethana, që shkakton pavlefshmërinë, është korrigjuar dhe publikuar sipas kërkesave të pikës 4 të këtij neni.
Pasojat ndaj të tretëve	Pavlefshmëria e shoqërisë tregtare, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk mund t'u kundrejtohet palëve të treta që kanë fituar të drejta nga shoqëria pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, dhe nuk çliron themeluesit e shoqërisë nga detyrimi për të paguar kontributet e nënshkruara prej tyre, të paktën deri në vlerën e nevojshme për të përballuar detyrimet e marra përsipër ndaj kreditorëve.	
Afati i parashkrimit	Padia për të kërkuar që shoqëria tregtare të shpallet e pavlefshme parashkruhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në çdo rast, padia e lidhur me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare nuk mund të ngrihet pas publikimit të korrigjimit të rrethanës që shkakton pavlefshmërinë, sipas këtij neni, nëse kjo rrethanë mund të korrigjohet.	Padia për të kërkuar që shoqëria tregtare të shpallet e pavlefshme parashkruhet brenda tre vjetëve nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në çdo rast, padia e lidhur me pavlefshmërinë e themelimit të shoqërisë tregtare nuk mund të ngrihet pas publikimit të korrigjimit të rrethanës që shkakton pavlefshmërinë, sipas këtij neni, nëse kjo rrethanë mund të korrigjohet.

2.1. Praktika gjyqësore shqiptare mbi pavlefshmërinë e shoqërive

Pavarësisht se koncepti i pavlefshmërisë së shoqërisë është përfshirë në ligj vetëm vitet e fundit, në praktikë ky ndryshim ka hasur në disa polemika, veçanërisht në kuadër të krahasimit mes pavlefshmërisë së veprimeve juridike dhe pavlefshmërisë sipas ligji tregtar. Praktika gjyqësore, pavarësisht se e pakët në numrin e çështjeve mbi këtë aspekt, ka përpunuar mjaft në detaje konceptin e pavlefshmërisë duke përcaktuar se në dallim nga legjislacioni civil, ligji “Për shoqëritë tregtare” vendos mjaft rregulla të veçanta, të cilat shmangen nga parimet e përgjithshme të pavlefshmërisë së veprimeve juridike e veçanërisht të kontratave, si veprime juridike të

dyanshme. Në nenin 231 të ligjit të sipercituar parashikohet se: *“Pavlefshmëria e një shoqërie ose e një akti që ndryshon statutin mund të rezultojë vetem nga një dispozitë e veçantë e këtij ligji, ose e atyre që rregullojnë ligjërisht pavlefshmërinë e kontratave”*, ndërsa në paragrafin e tretë kjo dispozitë citon: *“Pavlefshmëria e akteve ose veprimeve të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin e mësipërm mund të rezultojë vetëm nga shkelja e një dispozite urdhëruese e ligjit ose e ligjshmërisë në fuqi për kontratat”*³⁰.

Parashikimet specifike për pavlefshmëritë në shoqëritë tregtare nuk janë të rastësishme. Shoqëria tregtare në thelbin e saj përfaqëson një kontratë, e cila për shkak të gjerësisë dhe kohëzgjatjes, shoqërohet me veçori specifike. Ligjvënësi këtu ka patur parasysh faktin se një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare ka filluar të kryejë aktivitet, të hyjë në marrëdhënie juridike, ose të ketë lidhur kontrata me të tretët duke përfutur të drejta e duke marrë përsipër detyrime. Nëse pavlefshmëria absolute, në kuptimin e pasojave që do të sillte do të trajtohej si në legjislaionin civil, kjo gjë do të sillte nulitetin e të gjithë veprimtarisë së shoqërisë, duke dëmtuar veç të tjerash edhe interesat e të tretëve³¹.

Siç shihet nga citimi që iu bë nenit 231 të ligjit, në të flitet për dy lloje pavlefshmërie: për atë të themelimit të shoqërisë dhe për pavlefshmëri të akteve ose veprimeve të tjera të shoqërisë. Sigurisht që pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë, e cila lidhet me rastet e shfaqjes së veseve të vullnetit të palëve që marrin pjesë për realizimin e akteve të themelimit, është rasti më i rëndë i pavlefshmërisë. Ajo mund të shkaktohet vetëm në raste veçanërisht të rënda që lidhen me mosrespektimin e rregullave bazë të themelimit të shoqërisë. Vendimi i GJL shprehet: *“Në çështjen në gjykim nuk pretendohet dhe nuk ndodhemi para një rasti të tillë, por e përmendim atë për të theksuar se ligjvënësi, edhe kur bën fjalë për konstatimin e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, asnjëherë nuk ka parasysh nulitetin e veprimeve të kryera nga shoqëria deri në momentin e këtij konstatimi, sikundër ka vepruar në fakt gjykata duke e kthyer shoqërinë në gjendjen fillestare. Ky legjislaion në rastin më të keq, në kuadrin e zgjidhjes së pasojave, parashikon vetëm shpërndarjen e shoqërisë dhe futjen e saj në rrugën e likuidimit. Ndryshe do të trajtohej problemi për aktet që nxjerrin organet e shoqërisë gjatë aktivitetit të saj, siç do të ishin në çështjen në gjykim vendimet e asamblese së ortakëve, apo dhe kontrata e shitjes së kuotave të kapitalit. Lidhur me to, në paragrafin 3 të nenit 231, ligjvënësi ka përdorur shprehjen nga pavlefshmëria e tyre mund të rezultojë “nga një dispozitë urdhëruese e ligjit” në ndryshim nga paragrafi 1 ku termi i përdorur është “vetëm nga një dispozitë e veçantë e këtij ligji”*³². Ky parashikim i ndryshëm tregon se ligjvënësi në mënyrë të natyrshme i kufizon së tepërmi rastet e pavlefshmërisë së këtyre akteve në raport me paragrafin 1.

Duke parë në tërësi dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare” shihet se trajtimi që ai i bën institutit të pavlefshmërisë së shoqërive, apo akteve të veçanta të tyre, është i ndryshëm nga instituti i pavlefshmërisë së veprimeve juridike në përgjithësi. Në institutin tradicional të pavlefshmërisë, ekzistenca e një shkaku pavlefshmërie e ben të anullueshëm veprimin juridik. Në veprimet juridike absolutisht të pavlefshme, veprimi juridik konsiderohet “nul”, pra nuk mund të shkaktojë pasoja juridike që nga momenti që është kryer. Ndërsa në rastet e pavlefshmërisë relative, veprimi mbetet pa fuqi nga momenti i konstatimit të shkakut të tij nga gjykata, duke u rregulluar prej kësaj të fundit pasojat që ai ka shkaktuar deri në këtë moment. Ndryshe ndodh me ligjin “Për shoqëritë tregtare”. Vetë ky ligj në nenin 234 e trajton këtë pavlefshmëri si të riparueshme. Kjo dispozitë parashikon: *“Gjykata e ngarkuar me shqyrtimin e padisë së pavlefshmërisë ka mundësi të caktojë një afat për të lejuar korrigjimin e pavlefshmërisë”*. Në paragrafët në vijim të kësaj dispozite parashikohen në mënyrë të hollësishme edhe hapat që duhen

³⁰Vendim Nr. 00-2010-197 (15) datë 19.01.2010 (Gjykata e Lartë)

³¹Vendim Nr. 00-2010-197 (15) datë 19.01.2010 (Gjykata e Lartë)

³²Po aty.

ndjekur për të bërë korrigjimin, procedura të detyrueshme edhe për gjykatën duke caktuar afate të ndryshme për të garantuar kryerjen e të gjithë veprimeve të mundshme për të shmangur pavlefshmëritë e padobishme. Pra, ligji parashikon vlefshmësinë e një veprimi juridik, i cili në momentin që është kryer ka patur ekzistencën e shkaqeve për të cilat ligji ka parashikuar pavlefshmërinë. Sigurisht parashikimi i këtyre mundësive nga ligjvënësi lidhet me synimin e tij për të vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet respektimit të rregullave formale në veprimtarinë e shoqërisë, nga njëra anë, dhe moskthimin e këtyre rregullave në një pengesë për mosfunksionimin normal të shoqërisë, nga ana tjetër. Duhet thënë se pavlefshmëritë e parashikuara për shoqëritë tregtare, edhe pse për nga shkaqet u afrohen pavlefshmërive absolute, sepse lidhen me mosrespektim të dispozitave ligjore (e cila tradicionalisht do të konsiderohej pavlefshmëri absolute), për nga mënyra e zgjidhjes së pasojave afrohen me pavlefshmërinë relative. Sipas dispozitës së mësipërme, por jo vetëm, të metat absolute të kontratës së themelimit e aq më shumë të akteve të tjera të shoqërisë mund të korrigjohen brenda afatit 3 vjeçar të parashkrimit, ndryshe nga të metat e veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm që nuk mund të korrigjohen. Ky ligj shkon edhe me tej kur parashikon që këto të meta korrigjohen vetvetiu me kalimin e afatit trevjeçar të ngritjes së padisë.

Duke iu referuar çështjes konkrete, që është marrë në shqyrtim në Vendimin Nr. 00-2010-197 (15) datë 19.01.2010 (Gjykata e Lartë), ka rezultuar se aktet që kërkohen të konstatohen të pavlefshme i perkasin fundit të vitit 1999 dhe fillimit të vitit 2000. Gjykatës i ka rezultuar së shoqëria, e krijuar që në vitin 1996, asnjëherë nuk e ka ndërprerë veprimtarinë e saj dhe vazhdon si e tillë të funksionojë. Ka rezultuar gjithashtu se shumë kohë para ngritjes së padisë në gjykatë, paditësi, ndryshe nga sa pretendon, ka qenë në dijeni të ndryshimeve në statut lidhur me ortakët e shoqërisë (që nga një janë bërë katër) dhe për rrjedhojë dhe të akteve të tjera që i kanë paraprirë këtij ndryshimi (vendimit të Asamblesë së ortakëve dhe kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit). Kështu në dosje ndodhet e administruar një kërkesë më datë 9 Janar 2004, e nënshkruar nga paditësi me cilësinë e administratorit të shoqërisë (nënshkrimi i të cilës asnjëherë nuk është kontestuar prej tij). Nëpermjet saj, i kërkohet gjykatës që të pasqyrojë në regjistrin tregtar ndryshimet që kishin ndodhur pas vdekjes së ortakut L.SH, i cili zotëronte 25% të kapitalit të shoqërisë, duke i kaluar kjo pjesë, si dhe të drejtat e detyrimit që rrjedhin prej saj, trashëgimtarëve të tij A.SH dhe K.SH.

Së bashku me këtë dokument në dosjen gjyqësore, i administruar prej gjykatës, gjendet edhe një vendim i asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë më datë 27.01.2004, nga ku rezulton që të tre ortakët M.SH, G.SH dhe SH.SH, të mbetur në shoqëri pas vdekjes së L.SH, kanë miratuar transferimin e 25% të kuotave të kapitalit të tij të dy të paditurit që e trashëgojnë. Ndodhur në të tilla rrethana, në analizë të dispozitave që cituam më lart, arrihet në konkluzionin se pavarësisht një të mete në aktet e shoqërisë, e metë që lidhet me mungesën e shprehjes së vullnetit nga paditësi M.SH nëpermjet nënshkrimit, aktet nuk duhen konsideruar të pavlefshme. Kjo e metë është riparuar nga vetë ai që e ka pretenduar nëpermjet shfaqjes së vullnetit në një formë tjetër. Duke i kërkuar gjykatës transferimin e pjesës së kapitalit të vëllait të vdekur, paditësi njëkohësisht ka miratuar faktin se L.SH ishte “de facto” deri në atë moment ortak i kësaj shoqërie. Duke qenë se gabimi i gjykatës lidhet me zbatimin e gabuar të ligjit dhe çështja nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme, Kolegji vlerësoi që së bashku me cënimin e të dy vendimeve të zgjidhë vetë konfliktin mes palëve, duke rrëzuar padinë e paditësit për pavlefshmërinë e akteve të shoqërisë.

2.2. Pavlefshmëria e shoqërive sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian

Në të gjitha Shtetet Anëtare të BE, ligjet e të cilave nuk parashikojnë kontroll paraprak administrativ ose gjyqësor, në kohën e formimit të një shoqërie, ligji apo statutet e shoqërisë si dhe çdo ndryshim i këtyre dokumenteve, duhet të hartohen dhe vërtetohen në formën e duhur ligjore. Neni 12 i Direktivës së BE që parashikon pavlefshmërinë e shoqërive tregtare, përcakton se ligjet

e Shteteve Anëtare nuk mund të parashikojnë pavlefshmërinë e shoqërive, përveç se në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë dispozitë: Pavlefshmëria duhet të urdhërohet me vendim të një gjykatë si dhe vetëm në rast se:

- a) Asnjë instrument ligjor nuk është ekzekutuar ose që rregullat e kontrollit preventiv ose formalitetet e kërkuara ligjore nuk janë respektuar;
- b) Objektet e shoqërisë janë të paligjshme ose në kundërshtim me politikën publike;
- c) Ligji ose statutet nuk përcaktojnë emrin e shoqërisë, shumën e abonimit individual të kapitalit, shumën totale të kapitalit të regjistruar ose objektet e shoqërisë;
- d) Mosrespektimi i dispozitave të ligjit kombëtar lidhur me shumën minimale të kapitalit që duhet paguar;
- e) Anëtarëve themelues u mungon zotësia për të vepruar;
- f) Në kundërshtim me ligjin kombëtar që rregullon shoqërinë, numri i anëtarëve themelues është më pak se dy.

Përveç arsyeve të mëparshme të pavlefshmërisë, shoqëria nuk do t'i nënshtrohet asnjë shkaku të mos ekzistencës, pavlefshmërisë absolute apo pavlefshmërisë relative. Ndërkohë, në nenet vijuese sanksionohet nëse një vendim i pavlefshmërisë, i shpallur nga një gjykatë, mund të mbështetet tek palët e treta, do të rregullohet vetëm kur ligji kombëtar i jep të drejtën palës së tretë të kundërshtojë vendimin, ai mund ta bëjë këtë vetëm brenda gjashtë muajsh njoftimi publik për vendimin e gjykatës që i është dhënë. Keqtrajtimi do të sjellë përfundimin e shoqërisë, si dhe shpërbërjen. Pavlefshmëria e shoqërisë nuk do të ndikojë në vetvete në vlefshmërinë e ndonjë angazhimi të lidhur nga ose me shoqërinë, përveçse mbi pasojat e mbylljes. Ligjet e secilit Shtet Anëtar mund të parashikojnë pasojat e pavlefshmërisë ndërmjet anëtarëve të shoqërisë si dhe mbajtësit e aksioneve do të mbeten të detyruar të paguajnë kapitalin e rënë dakord për t'u nënshkruar prej tyre, por që nuk janë paguar deri në masën që angazhimet e lidhura me kreditorët e kërkojnë.

Masat koordinuese të përshkruara nga kjo Direktivë do të zbatohen për dispozitat e përcaktuara me ligj, rregullore ose veprim administrativ në Shtetet Anëtare në lidhje me shoqëritë aksionere. Emri i çdo shoqërie aksionere, do të shoqërohet me një përshkrim më të detajuar se shoqëritë e tjera. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos e zbatojnë këtë direktivë tek shoqëritë e investimeve me kapital të ndryshueshëm dhe në kooperativat e inkuorporuara si një nga llojet e shoqërive të renditura në Direktivë. Nëse ligjet e Shteteve Anëtare e përdorin këtë opsion, ato duhet të përcaktojnë gjithashtu detyrimin e këtyre shoqërive për të përfshirë në emërtimin e tyre emërtimin "shoqëri aksionere me kapital të ndryshueshëm" apo termin "kooperativë" me qëllim evidentimin e tyre nga shoqëritë e tjera. Një shoqëri aksionere me kapital të ndryshueshëm, sipas kësaj Direktive, do të konsiderohen shoqëritë të cilat:

- a) Kanë si qëllim kryesor të kryejë investime në bursë, aksione, toka, ose pasuri të tjera me qëllim të vetëm të përhapjes së rreziqeve të investimeve dhe t'u japë aksionarëve të tyre përfitimin e rezultateve të menaxhimit të pasurive të tyreë
- b) Ofrojnë aksionet e tyre për regjistrim nga publiku, dhe
- c) Statutet e tyre parashikojnë që brenda kufijve të kapitalit minimal dhe maksimal, ato në çdo kohë mund të emetojnë, shlyejnë apo rishesin aksionet e tyre.

Në çdo rast, Direktiva kërkon që për këto shoqëri, statuti apo akti i themelimit të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) Llojin dhe emrin e shoqërisë;
- b) Objektin e shoqërisë tregtare;

- c) Kur shoqëria nuk ka kapital të autorizuar, shumën e kapitalit të nënshkruar;
- d) Kur shoqëria ka një kapital të autorizuar, shumën e saj dhe gjithashtu shumën e kapitalit të regjistruar në kohën kur shoqëria është inkuorporuar ose është e autorizuar të fillojë biznesin dhe në kohën e ndonjë ndryshimi në kapitalin e autorizuar, sipas pikës (e) të Nenit 2 të Direktivës 2009ç101 ç EC;
- e) Kohëzgjatjen e shoqërisë, përveç kur kjo është me afat të pacaktuar.
- f) Zyrën e regjistrimit;
- g) Vlerën nominale të aksioneve të nënshkruara dhe, të paktën një herë në vit, numrin e tyre;
- h) Numrin e aksioneve të nënshkruara pa deklaruar vlerën nominale, ku këto aksione mund të lëshohen sipas ligjit kombëtar;
- i) Kushtet e veçanta, nëse ka, duke kufizuar transferimin e aksioneve;
- j) A janë aksionet e regjistruara ose bartësit, kur ligji kombëtar parashikon të dyja llojet dhe çdo dispozitë që ka të bëjë me konvertimin e aksioneve të tilla, përveç nëse procedura është e përcaktuar me ligj;
- k) Shumën e kapitalit të nënshkruar të paguar në kohën kur shoqëria është inkuorporuar ose është e autorizuar të fillojë biznesin;
- l) Vlerën nominale të aksioneve ose, kur nuk ka vlerë nominale, numrin e aksioneve të emetuara për një shumë të ndryshme se sa në para të gatshme, së bashku me natyrën e shpërblimit dhe emrin e personit që jep këtë konsideratë;
- m) Shumën e përgjithshme ose së paku një vlerësim të gjitha kostove që duhet të paguhet nga shoqëria ose që duhet të paguhet për të, për shkak të formimit të saj dhe, sipas rastit, para se shoqëria të autorizohet të fillojë biznesin; dhe
- n) Çdo avantazh të veçantë të dhënë, në kohën e formimit të shoqërisë ose deri në kohën që merr autorizimin për fillimin e biznesit, kujtdo që ka marrë pjesë në formimin e shoqërisë ose në transaksionet që çojnë në dhënien e autorizimit të tillë.

Kur ligjet e një Shteti Anëtar kërkojnë që një shoqëri të formohet nga më shumë se një anëtar, fakti që të gjitha aksionet mbahen nga një person ose se numri i anëtarëve ka rënë nën minimumin ligjor pas inkuorporimit të shoqërisë, nuk duhet të çojë për shpërbërjen automatike të shoqërisë. Ligjet e Shteteve Anëtare do të kërkojnë që, me qëllim që një shoqëri të inkuorporohet ose të marrë autorizimin për fillimin e biznesit, të nënshkruhet një kapital minimal, shuma e së cilës nuk duhet të jetë më pak se 25 000 euro. Kapitali i nënshkruar mund të formohet vetëm nga aktivet e afta për vlerësim ekonomik. Sidoqoftë, një ndërmarrje për të kryer shërbime të punës ose furnizimit nuk mund të jetë pjesë e atyre pasurive.

Aksionet nuk mund të lëshohen me një çmim më të ulët se vlera nominale e tyre, ose, kur nuk ka vlerë nominale, vlerat e tyre të përgjithshme. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të lejojnë ata që marrin përsipër të vendosin aksione në ushtrimin e profesionit të tyre për të paguar më pak se çmimi i përgjithshëm i aksioneve për të cilat ata nënshkruajnë gjatë atij transaksioni. Shpërblimet e lëshuara për një pagesë duhet të paguhet në kohën kur shoqëria është inkuorporuar ose është e autorizuar të fillojë biznesin me jo më pak se 25% të vlerës nominale të tyre ose, në mungesë të një vlere nominale, vlerat e tyre të përgjithshme. Sidoqoftë, kur aksionet lëshohen për një shumë të ndryshme nga ato në para në kohën kur shoqëria është inkuorporuar ose është e autorizuar të fillojë biznesin, konsiderata duhet të bartet plotësisht brenda pesë viteve të asaj kohe.

2.3. Praktika e GJED mbi pavlefshmërinë

Koncepti i pavlefshmërisë së shoqërisë tregtare ka kërkuar nevojë për interpretim dhe në kuadër të Direktivave të BE-së, veçanërisht mbi mundësinë e thirrjes së shoqërisë tregtare për të cilën pretendohet pavlefshmëria e themelimit si palë e paditur në gjykatë. Në çështjen Ubbink Isolatie BV dhe Dak - en Wandtechnik BV një nga pyetjet drejtuar GJED ishte nëse veprimtaria

tregtare ushtrohet në emër të një shoqërie sipas kuptimit të Direktivës së Parë, e cila, megjithatë, nuk është konstituuar sipas legjislacioni të zbatueshëm kombëtar, sepse asnjë instrument autentik ligjor në kuptim të nenit 11 (2) (A) të Direktivës apo rregullat e tjera të zbatueshme, gjithashtu në kuptim të nenit 11 (2) (a), nuk janë respektuar, a mund të zbatohen rregullat e parashikuara në Seksionin III të Direktivës së Parë që në procedurat kundër saj "shoqëria" të trajtohet si ekzistente për sa kohë që nuk janë kryer procedura për deklarimin e pavlefshmërisë si dhe përfundimin e saj. Gjithashtu, një praktikë e rëndësishme e GJED është krijuar me vendimin e saj në çështjen *Marleasing*³³ në të cilën u trajtua mundësia e shpalljes së pavlefshmërisë së një shoqërie nëse kjo e fundit ka pasur për qëllim kryerjen e një veprimtarie të jashtëligjshme.

2.4. Ngritja e padisë ndaj shoqërisë për të cilën pretendohet pavlefshmëri

Seksioni I i Direktivës së Parë të Këshillit mbi koordinimin e masave mbrojtëse për mbrojtjen e interesave të anëtarëve, (Direktiva 68/151) parashikon një set rregullash në lidhje me informacionin e nevojshëm që duhet t'u ofrohet palëve të treta me qëllim evidentimin e tipareve thelbësore të shoqërive sipas kuptimit të direktivës së lartpërmendur. Palët e treta mund të mbështeten ligjërisht në informacionin e disponueshëm për një shoqëri të tillë, por vetëm nëse ky informacion është servitur sipas përcaktimeve të Direktivës dhe në përputhje me modalitetet përkatëse të parashikuara në legjislacionet e brendshme. Rrjedhimisht, rregullat në lidhje me pavlefshmërinë e shoqërive të përcaktuara në Seksionin III të Direktivës së Parë zbatohen vetëm kur palët e treta, gjatë kryerjes së veprimeve juridike janë udhëhequr nga informacionet e publikuara në përputhje me Seksionin I, të cilat flasin që ekziston një shoqëri brenda kuptimit të Direktivës së Parë. Ato nuk zbatohen kur veprimet në fjalë janë kryer në emër të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me kapital privat, ekzistenca e të cilës nuk është konfirmuar nga regjistri publik i vendit pasi formalitetet e kërkuara për regjistrim nga ligji kombëtar nuk janë plotësuar.

Megjithatë, për sa kohë që veprimet e kryera në emër të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar që nuk është regjistruar ende, konsiderohen nga ligji i kombëtar si veprime që janë kryer nga një shoqëri e cila është në process formimi në kuptim të nenit 7 të Direktivës, është vetë legjislacioni kombëtar ai që duhet të përcaktojë që personat që kryejnë veprime në këtë rast janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës. Objekti i gjykimit ka qenë interpretimi i Direktivës së Parë të Këshillit të Komuniteteve Europiane (61/151/EEC) të 9 Marsit 1968 mbi masat që u kërkojnë Shteteve Anëtare në të cilat janë themeluar shoqëritë sipas paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me synim që këto mbrojtje të jenë ekuivalente në të gjithë Komunitetin (Gazeta Zyrtare, Edicioni Special i Gjuhës Angleze 1968 (I), fq.41).

Me vendimin e datës 24 Prill 1987, i cili u pranua në Gjykatën Europiane të Drejtësisë më 30 Prill 1987, Hoge Raad der Nederlanden i referoi GJED-së (aktualisht e quajtur Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Europian)³⁴ katër pyetje për interpretim paraprak sipas nenit 177 të Traktatit të KEE në kuadër të rregullave të përcaktuara mbi pavlefshmërinë e shoqërive tregtare në Seksionin III të Direktivës së parë të Këshillit (68/151) të 9 marsit 1968 mbi bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, kërkojnë nga shoqëritë në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit (Gazeta Zyrtare, Edicioni Special i Gjuhës Angleze 1968 (I), fq 41) (këtu e tutje referuar si "Direktiva e Parë").

Këto pyetje lindën si pasojë e mospëmbushjes së detyrimeve në kuadër të një kontrate të nënshkruar mes Dak-en Wandtechnik BV dhe shoqërisë Ubbink Isolatie BV (në tekstin e mëtejshëm: "Kërkuesi"). Në kohën e nënshkrimit të kontratës që po goditej në gjykatë, një partneritet ishte regjistruar në regjistrin tregtar me emrin Ubbink Isolatie BV io (Ubbink Isolatie, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar), duke renditur si partnerë shoqërinë Ubbink Nederland BV dhe

³³ C-106/89 *Marleasing SA* dhe *La Comercial Internacional de Alimentación SA*

³⁴ Shënim i autorit

shoqërinë Isetco BV, të dyja shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Ky partneritet, kishte caktuar si përfaqësues të përgjithshëm, me titullin e drejtorit, Z. Juraske. Megjithatë, deri në atë moment, nuk kishte asnjë shoqëri tregtare të regjistruar me emrin Ubbink Isolatie BV. Gjykata kombëtare konstatoi se meqë nuk kishte pasur asnjë akt noterial mbi themelimin e kësaj shoqërie me emrin Ubbink Isolatie BV, nënkuptohej që shoqëria nuk nuk ishte formuar siç duhet.

Kontrata mes palëve, u lidh me Dak-en Wandtechnik në emrin Ubbink Isolatie BV pa shtuar në vijim të emrit të shoqërisë togfjalëshin "gjatë formimit" dhe gjithashtu kur çështja u dërgua në gjykatën hollandeze, shoqëria është cilësuar nga paditësi si "Ubbink Isolatie BV" pa ndonjë sqarim të mëtejshëm se kjo shoqëri është në proces themelimi. Për më tepër, edhe pala e paditur, në gjykatën kombëtare fillimisht e ka paraqitur mbrojtjen e saj me emrin "Ubbink Isolatie BV". Gjatë procesit gjyqësor në gjykatën kombëtare, paditësi pretendoi se Dak - en Wandtechnik kishte gabuar duke sjellë padinë kundër Ubbink Isolatie BV. Summons në këtë emër (dhe pa sqaruar gjendjen e shoqërisë në proces formimi), sepse shoqëria nuk gëzonte ende personalitet juridik dhe për rrjedhojë nuk mund të ishte palë në një proces gjyqësor.

Gjykata vendase u shpreh se edhe në rast se shoqëria nuk është krijuar në përputhje me ligjet përkatëse apo nëse aktet e krijimit të saj kanë defekte, kjo premise nuk mjafton për të thënë se shoqëria nuk ekziston vetëm mbi këtë bazë. Shoqëria do të konsiderohet se ekziston deri në momentin kur ajo likujdohet apo deklarohet e pavlefshme sipas Kodit Civil Holandez. Neni 182 (1) i Librit të dytë të Kodit Civil Holandez, parashikon se kur është kryer veprimtari tregtare në emër apo për llogari të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, e cila nuk është regjistruar në regjistrin tregtar dhe para se dokumentet për krijimin e saj të marrin vlerë juridike dhe të certifikohen përpara noterit, ose pa një deklaratë të Ministrisë se nuk ka pengesa për krijimin e shoqërisë, një deklaratë për pavlefshmëri mund të kërkohet nga çdo palë e interesuar apo nga Prokurori i Përgjithshëm.

Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, ankuesi ka apeluar vendimin, por gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë me të njëjtin arsyetim. Ankuesi iu drejtua Gjykatës së Lartë, me argumentimin se neni 182 i Kodit Civil hollandez nuk mund të aplikohet në këtë rast, pasi shoqëria nuk ka qenë krijuar ende dhe veprimet janë kryer në mënyrë të gabuar në emër dhe për llogari të kësaj shoqërie fiktive. e cila në thelb është një partneritet, i cili nuk ka një strukturë, element ky thelbësor për një shoqëri tregtare. Në këtë kuadër, është pretenduar nga ankuesi se kjo dispozitë e Kodit Civil hollandez duhet të interpretohet në mënyrë të integruar me Seksionin III të Direktivës së Parë, në veçanti Nenet 11 dhe 12 të saj. Gjendur në këtë situatë, Gjykata e Lartë Holandeze ka pushuar gjykimin dhe i ka dërguar Gjykatës Europiane të Drejtësisë katër pyetja paraprake në lidhje me këtë situatë:

1. Nëse veprimtaria tregtare ushtrohet në emër të një shoqërie sipas kuptimit të Direktivës së Parë, e cila, megjithatë, nuk është konstituuar sipas legjislacionit të zbatueshëm kombëtar, sepse asnjë instrument autentik ligjor në kuptim të nenit 11 (2) (A) të Direktivës apo rregullat e tjera të zbatueshme, gjithashtu në kuptim të nenit 11 (2) (a), nuk janë respektuar, a mund të zbatohen rregullat e parashikuara në Seksionin III të Direktivës së Parë që në procedurat kundër saj "shoqëria" të trajtohet si ekzistente për sa kohë nuk janë kryer procedura për deklarimin e pavlefshmërisë si dhe përfundimin e saj?
2. A do të ndryshonte përgjigja ndaj pyetjes së parë, në rast se (a) nëse dokumentat për krijimin e shoqërisë nuk janë implementuar siç duhet ose vetëm masat e kontrollit

parandalues³⁵ nuk janë respektuar (b) dokumentat përkatëse nuk janë ekzekutuar dhe as masat e kontrollit parandalues nuk janë plotësuar?

3. A do të ndryshonte përgjigja ndaj pyetjes së parë, nëse (a) biznesi kryhet në kuadër të një organizimi personash dhe asetesh që - përveç faktit se biznesi bëhet në emër të një shoqërie - në aparençë jep përshtypjen e një shoqërie (b) biznesi vazhdon kur nuk ka dyshim mbi ekzistencën e një organizimi të tillë?
4. A është relevante për përgjigjen e pyetjes 1, fakti se, biznesi kryhet në kuadër të një organizimi, i cili sipas ligjit kombëtar në fuqi ka një formë ligjore të ndryshme nga ajo e shoqërisë në kuptim të Direktivës së Parë, Për shembull formën ligjore të një "vennootschap onderme firma" (partnership) dhe është regjistruar si e tillë në regjistrin tregtar nën një emër i cili, përveç sa i përket indikacionit mbi formën ligjore, është identik me emrin e shoqërisë së pakrijuar në kuadër të së cilës vijon biznesi?

GJED arriti në konkluzionin se dy pyetjet e para të paraqitura nga gjykata kombëtare, të cilat duhet të shqyrtohen së bashku, kërkojnë në thelb të konstatojnë nëse rregullat që rregullojnë pavlefshmërinë e shoqërive tregtare të përcaktuara në Direktivën e Parë, janë ose jo të zbatueshme në rastin kur veprimet janë kryer në emër të një forme ligjore e mbuluar nga Direktiva e Parë, e cila nuk është konstituuar në të drejtën kombëtare për shkak të mosplotësimit të formaliteteve të kërkuara nga ky ligj për formimin e një shoqërie. Ndërkohë, pyetja e tretë dhe e katërt kërkojnë të përcaktojnë nëse përgjigja e dy pyetjeve të para do të ishte ndryshe kur paraqitja e jashtme e një shoqërie në kuptim të Direktivës së Parë është krijuar nga ekzistenca e një organizate personash ose një shoqërie që nuk mbulohet nga Direktiva e Parë. Gjykata arriti në konkluzionin se duhet të merret në konsideratë se qëllimi i Direktivës së Parë është të bashkërendojë masat mbrojtëse të kërkuara nga Shtetet Anëtare ndaj shoqërive aksionere dhe atyre me përgjegjësi të kufizuar për të mbrojtur në veçanti interesat e palëve të treta.

Seksioni I i Direktivës së Parë parashikon formalitetet në lidhje me informacionin që synon t'u ofrojë palëve të treat, informacionin paraprak mbi tiparet thelbësore të shoqërive brenda kuptimit të direktivës së lartpërmendur. Siç tregohet në një nga recitimet në preambulën e direktivës, informacioni ka për qëllim të lejojë palët e treta që të konstatojnë përmbajtjen e dokumenteve themelore të shoqërisë dhe informacione të tjera në lidhje me të, veçanërisht të dhënat e personave të cilët janë të autorizuar të lidhin marrëveshje ligjore me shoqërinë. Rrjedhimisht, palët e treta mund të mbështeten në mënyrë të ligjshme në informacionin që ka të bëjë me një shoqëri sipas kuptimit të Direktivës së Parë, kur ky informacion ka qenë publik, në përputhje me dispozitat e Seksionit I të Direktivës së Parë.

Qëllimi i Direktivës nuk është që të lejojë palët e treta të mbështeten në informacionet e krijuara nga organet ose përfaqësuesit e shoqërisë nëse ato nuk janë në përputhje me informacionin që gjendet në regjistrin publik. Rrjedhimisht, rregullat në lidhje me pavlefshmërinë e shoqërive të përcaktuara në Seksionin III të Direktivës së Parë zbatohen vetëm kur palët e treta janë udhëhequr për të hyrë në marrëdhënie me shoqërinë duke u bazuar në informacionet e publikuara në përputhje me Seksionin I. Në anën tjetër, palët e treta nuk janë në atë pozitë kur nuk është bërë një publikim formal në lidhje me shoqërinë sipas kuptimit të Direktivës së Parë, veçanërisht kur formalitetet e kërkuara nga ligji kombëtar për inkorporim - një instrument i vërtetuar i kushtetutës dhe një kontrolli administrativ parandalues - nuk janë përfunduar dhe për këtë arsye shoqëria paraqitet në regjistrin publik si shoqëri në proces formimi.

Prandaj, përgjigja e dy pyetjeve të para duhet të jetë se rregullat për pavlefshmërinë e shoqërive të përfshira në Direktivën e Parë nuk zbatohen kur veprimet e përfshira janë kryer në emër të një

³⁵Shënim I autorit: Me masa të kontrollit parandalues Gjykata Holandeze i Referohet Masave parandaluese të parashikuara në Direktivën 61/151/EEC.

shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, ekzistenca e të cilës nuk është konfirmuar pasi formalitetet e kërkuara nga ligji kombëtar për regjistrim nuk janë plotësuar. Gjykata më tej, argumentoi se përgjigja e dhënë, e lejon gjykatën kombëtare të zgjidhë çështjen e të drejtës komunitare që është ngritur dhe për rrjedhojë nuk ka nevojë të shqyrtojë dy pyetjet e tjera. Megjithatë, për sa kohë që veprimet e kryera në emër të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar që nuk është regjistruar ende, konsiderohen nga ligji i kombëtar si veprime që janë kryer nga një shoqëri, e cila është në proces formimi në kuptim të nenit 7 të Direktivës, është vetë legjislacioni kombëtar ai që duhet të përcaktojë që personat që kryejnë veprime në këtë rast janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës. Si konkluzion, GJED u shpreh se: *“Rregullat mbi pavlefshmërinë e shoqërive të përfshira në Direktivën e Parë të Këshillit të 9 Marsit 1968 (68/151) nuk zbatohen kur veprimet në fjalë janë kryer në emër të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, ekzistenca e të cilës nuk është e konfirmuar nga regjistri publik pasi formalitetet për inkuorporim të kërkuara nga ligji kombëtar nuk janë përfunduar.”*³⁶

2.5. Shpallja e pavlefshmërisë në rastin e aktiviteteve të jashtëligjshme

Detyrimet e Shteteve Anëtare, që lindin në kuadër të një direktive me qëllim arritjen e rezultateve të parashikuara nga ajo direktivë, dhe nga neni 5 i Traktatit, i cili parashikon detyrimin për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme (qoftë të përgjithshme, qoftë të veçanta), për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve, është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet e Shteteve Anëtare duke përfshirë, për çështjet brenda juridiksionit të tyre, edhe gjykatat. Rrjedhimisht, në zbatimin e ligjit kombëtar, pavarësisht nëse dispozitat në fjalë janë miratuar para ose pas direktivës, gjykata kombëtare e thirrur për të interpretuar, kërkohet ta bëjë këtë, për aq sa është e mundur, në dritën e formulimit dhe qëllimit të direktivës me qëllim arritjen e rezultatit të ndjekur nga ajo, dhe në përputhje me paragrafin e tretë të nenit 189 të Traktatit.

Një Gjykatë Kombëtare, gjatë shqyrtimit të një çështjeje që përfshihet në fushën e zbatimit të Direktivës 68/151 “Mbi koordinimin e masave mbrojtëse të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, u kërkohet nga Shtetet Anëtare të shoqërive, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me qëllim të marrjes së masave të tilla ekuivalente në të gjithë Komunitetin”, i kërkohet të interpretojë ligjin e vet kombëtar në kuadër të qëllimit dhe formulimit të kësaj direktive në mënyrë që të përjashtojë një deklaratë pavlefshmërie të një shoqërie me një bazë tjetër të ndryshme nga ato të renditura në nenin 11 të Direktivës. Këto arsye duhet në vetvete të interpretohen në mënyrë strikte, në dritën e këtij qëllimi, në mënyrë që të sigurohet që pavlefshmëria e deklaruar si pasojë e paligjshmërisë së objektit të shoqërisë ose në kundërshtim me rendin publik, të kuptohet që i referohet ekskluzivisht objektit të shoqërisë siç është përshkruar në aktin e themelimit ose statutin e shoqërisë.

Më 3 prill 1989, Gjykata Spanjolle i drejtoi një pyetje GJED në përputhje me Nenin 177 të Traktatit të KEE-së për një mendim paraprak mbi interpretimin e nenit 11 të Direktivës së Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968. Pyetjet u ngritën në kuadër të një mosmarrëveshje ndërmjet Marleasing SA dhe La Comercial Internacional de Alimentación SA (në vijim: "La Comercial"). Kjo e fundit u krijua në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar prej tre personash, duke përfshirë Barvies SA, e cila kontribuoi me pasuritë e saj. Pretendimi kryesor i ngritur nga Marleasing, bazuar në nenet 1261 dhe 1275 të Kodit Civil spanjoll, sipas të cilit

³⁶Ubbink Isolatie BV dhe Dak - en Wandtechnik BV

kontratat pa shkak ligjor apo shkak i të cilave është i paligjshëm, nuk kanë efekt ligjor, është se kontrata e themeluesve për krijimin e La Comercial është e pavlefshme pasi në krijimin e shoqërisë ka munguar shkak, i cili në thelb ishte kryerja e një transaksion të fshehtë për të mashtruar kreditorët e Barvies SA, një nga bashkëthemeluesit e shoqërisë La Comercial. Për rrjedhojë, ai pretendoi që veprimi duhet të hidhet poshtë në tërësi në terren, në veçanti, se neni 11 i Direktivës 68/151, i cili rendit në mënyrë të plotë rastet në të cilat mund të urdhërohet pavlefshmëria e një shoqërie, nuk përfshin mungesën e shkakut. La Comercial, argumentoi se ky pretendim duhej hedhur poshtë pasi neni 11 i direktivës ka një listë shteruese arsyesh për të deklaruar pavlefshmërinë.

Gjykata kombëtare konstatoi se në përputhje me nenin 395 të Aktit në lidhje me kushtet e pranimit të Spanjës dhe Republikës Portugeze në Komunitetet Evropiane (Gazeta Zyrtare 1985 L 302, fq.23) Mbretëria e Spanjës ishte nën detyrimin për të zbatuar Direktivat që nga data e pranimit, por që ende nuk ishte bërë një hap i tillë. Prandaj, duke marrë parasysh se mosmarrëveshja ngriti një problem në lidhje me interpretimin e të drejtës komunitare, gjykata kombëtare e parashitri çështjen e mëposhtme në Gjykatë: *A është Neni 11 i Direktivës së Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968 (i cili nuk është zbatuar në të drejtën kombëtare), drejtpërdrejt i zbatueshëm në mënyrë që të përjashtojë një deklaratë të pavlefshmërisë së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar mbi një bazë tjetër përveç atyre të përcaktuara në Nenin e lartpërmendur?*

Sa i përket pyetjes nëse një individ mund të mbështetet drejtpërdrejtë në përcaktimet e direktivës pavarësisht ligjit kombëtar, duhet të vërehet se, siç ka konsideruar Gjykata në mënyrë të vazhdueshme, një direktivë nuk mund të vendosë detyrime ndaj një individi dhe rrjedhimisht një dispozitë e direktivës nuk mund t'i kundërdrejtohet një personi³⁷. Megjithatë, nga dokumentet e paraqitura para Gjykatës duket qartë se gjykata kombëtare kërkon në thelb të konstatojë nëse një gjykatë kombëtare që shqyrton një çështje që i përket fushës së zbatimit të Direktivës 68/151, është e nevojshme të interpretojë ligjin e saj kombëtar në dritën e formulimit dhe qëllimit e kësaj direktive me qëllim që të përjashtojë një deklaratë të pavlefshmërisë së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar mbi një bazë tjetër përveç atyre të renditura në nenin 11 të direktivës.

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të theksohet se, siç ka theksuar Gjykata në Vendimin C 14/83, Von Colson dhe Kamann kundër Land Nordrhein-Westfalen [1984] ECR 1891, paragrafi 26: *“Detyrimet e Shteteve Anëtare, që linden në kuadër të një direktive me qëllim arritjen e rezultateve të parashikuara nga ajo direktivë, dhe nga neni 5 i Traktatit, i cili parashikon detyrimin për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme (qoftë të përgjithshme, qoftë të veçanta), për të siguruar përmbushjen e këtyre detyrimeve, është i detyrueshëm për të gjithë Autoritetet e Shteteve Anëtare duke përfshirë, për çështjet brenda juridiksionit të tyre, edhe gjykatat. Rrjedhimisht, në zbatimin e ligjit kombëtar, pavarësisht nëse dispozitat në fjalë janë miratuar para ose pas direktivës, gjykata kombëtare e thirrur për të interpretuar, kërkohet ta bëjë këtë, për aq sa është e mundur, në dritën e formulimit dhe qëllimit të direktivës me qëllim arritjen e rezultatit të ndjekur nga ajo, dhe në përputhje me paragrafin e tretë të nenit 189 të Traktatit.”*³⁸

Nga kjo rrjedh se kërkesa që ligji kombëtar duhet të interpretohet në përputhje me nenin 11 të Direktivës 68/151 përjashton interpretimin e dispozitave të ligjit kombëtar në lidhje me shoqëritë, në mënyrë të tillë që të mund të urdhërohet pavlefshmëria e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar për arsye të ndryshme nga ato të përfshira në mënyrë të detajuar në nenin 11 të direktivës në fjalë. Sa i përket interpretimit që duhet t'i jepet nenit 11 të Direktivës, në veçanti nenit 11 (2) (b), duhet të vërehet se kjo dispozitë ndalon ligjet e Shteteve Anëtare të parashikojnë një deklaram gjyqësor të pavlefshmërisë mbi arsye të tjera përveç atyre të përfshira në direktivë,

³⁷C152/84 Marshall v Southampton dhe South-West Hampshire Area Health Authority [1986] ECR 723.

³⁸C 14/83, Von Colson dhe Kamann kundër Land Nordrhein-Westfalen [1984] ECR 1891

ndër të cilat është arsyeja se objektet e shoqërisë janë të paligjshme ose në kundërshtim me politikën publike.

Sipas Komisionit, shprehja "objekti i shoqërisë" duhet të interpretohet duke iu referuar ekskluzivisht objektit të shoqërisë siç përshtrohet në aktin e themelimit ose të akteve shoqëruese. Nga pikëpamja e Komisionit rrjedh se një deklaratë pavarshmërie për një shoqëri, nuk mund të bëhet në bazë të veprimtarisë së vërtetë të ndjekur prej saj, për shembull mashtrimin të kreditorëve të themeluesve. Ky argument duhet të respektohet. Siç është e qartë nga preambula e Direktivës 68/151, qëllimi i saj ishte kufizimi i rasteve në të cilat mund të lindë nuliteti dhe efekti prapaveprues i një deklaratë të pavarshmërisë për të siguruar "*siguri në ligj lidhur me marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe palës së tretë dhe gjithashtu midis anëtarëve*"³⁹. Për më tepër, mbrojtja e palëve të treta "*duhet të sigurohet me dispozita që kufizojnë në masën më të madhe arsyet mbi të cilat detyrimet e lidhura në emër të shoqërisë nuk janë të vlefshme*". Rrjedhimisht, çdo arsye e pavarshmërisë e parashikuar në nenin 11 të direktivës duhet të interpretohet në mënyrë strikte. Në këto rrethana fjalët "objekt i shoqërisë" duhet të kuptohet objekti i shoqërisë siç përshtrohet në aktin e themelimit ose në statutin e shoqatës.

Për rrjedhojë, përgjigjja për pyetjen e paraqitur, duhet të jetë se një gjykatë kombëtare që shqyrton një çështje që i përket fushës së veprimit të Direktivës 68/151, është e nevojshme të interpretojë ligjin e saj kombëtar në dritën e formulimit dhe qëllimit të kësaj direktive me qëllim që të përjashtojë një deklaratë të pavarshmërisë së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në një bazë tjetër përveç atyre të renditura në nenin 11 të direktivës. Gjithashtu, një gjykatë kombëtare që shqyrton një çështje që i përket fushëveprimit të Direktivës së Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968 mbi koordinimin e masave mbrojtëse të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, u kërkohet nga shtetet anëtare të shoqërive brenda kuptimit i paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me qëllim të marrjes së masave të tilla ekuivalente në të gjithë Komunitetin, kërkohet të interpretojë ligjin e tij kombëtar në dritën e formulimit dhe qëllimit të kësaj direktive për të parandaluar një deklaratë të pavarshmërisë E një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në një bazë tjetër përveç atyre të renditura në nenin 11 të Direktivës.

³⁹Paragrafi i gjashtë i preambulës së Direktivës së Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968

KAPITULLI 2

BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRIVE

1. Rregullimi ligjor i bashkimit dhe ndarjes së shoqërive

Sipas legjislacionit shqiptar, bashkimi i shoqërive mund të kryhet në dy forma:

- 1) Bashkim me përthithje: Kalimi i të gjitha aktiveve e pasiveve të njëjës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, tek një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie.
- 2) Krijimi i një shoqërie të re: Të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re.

Në rastin e bashkimit me përthithje, procesi kalon nëpër këto faza kryesore:

- a) Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, të cilat marrin pjesë në bashkim, hartojnë një projekt marrëveshje me shkrim.
- b) Përgatitja e një raporti të hollësishëm, ku shpjegohet marrëveshja e bashkimit dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të e në veçanti, raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta.
- c) Çdo shoqëri, që merr pjesë në bashkim, jo më vonë se 1 muaj përpara datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë, për vendimin e përcaktuar në nenin 218 të ligjit, depoziton pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe publikon në faqen e internetit të shoqërisë, nëse ka, projekt marrëveshjen dhe raportin e bashkimit, sipas pikës 2 të këtij neni, ndërsa pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë e dokumentet publikohen, në mënyrë të detyrueshme, për të paktën tri vitet e fundit.
- d) Caktimi i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projekt marrëveshjes së bashkimit.
- e) Miratimi i projekt marrëveshjes nga ortakët të cilët marrin pjesë në bashkim.
- f) Publikimi i njoftimit të bashkimit në QKB dhe faqen e internetit të shoqërive.

Në rastin e krijimit të një shoqërie të re, vlejnë të njëjtat hapa të përmendur më sipër dhe shoqëria e krijuar rishtazi konsiderohet si shoqëri përthithëse. Me përfundimin e procesit të bashkimit dhe regjistrimit të bashkimit pranë QKB, shoqëria e krijuar ka një personalitet juridik të sajën dhe pasojat janë si më poshtë:

- Aktivitet dhe pasivet e shoqërisë që përthithet kalojnë tek shoqëria përthithëse;

- Aksionarët apo ortakët e shoqërisë së përrthithur bëhen aksionarë apo ortakë të shoqërisë përrthithëse;
- Shoqëria që përrthithet vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Biynesit pa kaluar në procesin e likuidimit.

Në rastin e bashkimit për krijimin e një shoqërie të re, në vijim të tri ndryshimeve të mësipërme, ndodh dhe regjistrimi i fillestar i shoqërisë së krijuar rishtaz me qëllim fitimin e personalitetit juridik.

1.1. Rregullimi ligjor sipas të drejtës Evropiane

Baza ligjore e cila rregullon çështjet e bashkimit të shoqërive brenda Bashkimit Evropian është Rregullorja e Këshillit Nr. 139/2004 cilësuar si “Rregullorja e Bashkimit”. Në thelb, kjo rregullore synon të ndalojë bashkimin e shoqërive, të cilat reduktojnë në mënyrë të ndjeshme konkurrencën brenda tregut të përbashkët. Institucioni i cili është ngarkuar me ‘filtrimin’ e këtyre rasteve është Komisioni.

Rregullorja e Këshillit Nr. 139/2004 ka përcaktuar rregulla të qarta se cilat do të jenë bashkimet të cilat do të shqyrtohen nga Komisioni. Që në Nenin 1 përcaktohet fusha e veprimit: “.....Kjo rregullore do të zbatohet për të gjitha bashkimet të cilat kanë një dimension komunitar”. Në kuptim të kësaj Rregulloreje koncepti “dimension komunitar” do të nënkuptojë:

Së pari: Bashkimi i shoqërive duhet të plotësojë këto kritere:

- Një xhiro mesatare të agreguar në nivel botëror (duke përfshirë të gjitha ndërmarrjet) të të gjitha shoqërive, të cilat po marrin pjesë në bashkim, është më shumë se 50 milionë Euro; dhe
- Xhiro mesatare e agreguar e përfuar brenda komunitetit e të paktën dy prej shoqërive, të cilat po marrin pjesë në bashkim është më shumë se 250 milionë Euro, përveçse kur një prej ndërmarrjeve të përfshira arrin më tepër se 2/3 e xhiros së agreguar brenda komunitetit në një dhe të njëjtin Vend anëtar.

Së dyti: Në rastin kur bashkimi nuk plotëson treshholdet e paraqitura më lart, “dimensioni komunitar” përcaktohet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Xhiro e agreguar e kombinuar në nivel botëror i të gjitha shoqërive që do të bëhen pjesë e bashkimit është më tepër se 250 milionë Euro;
- Në secilin prej të paktën tri shteteve, xhiro e kombinuar e agreguar e të gjitha shoqërive pjesëmarrëse në bashkim është mbi 100 milionë Euro;
- Në secilin prej të paktën tri vendeve anëtare të cituara në pikën (ii), xhiro e agreguar e secilës prej të paktën dy shoqërive është mbi 25 milionë Euro; dhe
- Xhiro e agreguar e përfuar brenda komunitetit e të paktën dy prej shoqërive të cilat po marrin pjesë në bashkim është më shumë se 100 milionë Euro përveçse kur një prej shoqërive të përfshira arrin më tepër se 2/3 e xhiros së agreguar brenda komunitetit në një dhe të njëjtin Vend anëtar.

1.2. Bashkimi ndërkufitar i shoqërive brenda Bashkimit Evropian

Rastet e bashkimit

Bashkimi i shoqërive brenda territorit të Bashkimit Evropian, rregullohet nga një direktivë e veçantë e cila përcakton standardin minimal, dhe një kuadër ligjor rregullues të përbashkët mbi çështjen e bashkimit. Nëse do t'i referohemi shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, ato rregullohen nga Direktiva 2005/56/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 Tetor 2005 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar". Kjo direktivë zbatohet për bashkimin e shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar të themeluara sipas legjislacionit të një Shteti Anëtar dhe me seli të regjistruar, administratë qendrore apo vendndodhje kryesore të aktivitetit tregtar brenda Komunitetit, me kusht që të paktën dy prej tyre të jenë objekt i legjislacioneve të Shteteve Anëtare të ndryshme ("bashkim ndërkufitar"). Sipas të drejtës evropiane, bashkimi i shoqërive evidentohet në tri raste⁴⁰:

- Një ose më shumë shoqëri tregtare, pas prishjes pa likuidim, i kalojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tregtare tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria tregtare blerëse, në këmbim të emetimit në favor të anëtarëve të tyre të letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare tjetër dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare e cila nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e vlerës nominale, dhe në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të letrave me vlerë apo aksioneve në fjalë; ose
- Dy ose më shumë shoqëri tregtare, pas prishjes pa likuidim, i kalojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tregtare të themeluar prej tyre, e quajtur shoqëria tregtare e re, në këmbim të emetimit në favor të anëtarëve të tyre të letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare të re dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e vlerës nominale, dhe në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të letrave me vlerë apo aksioneve në fjalë; ose
- Një shoqëri tregtare, pas prishjes pa likuidim, i kalon të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të shoqërisë tregtare që mban të gjitha letrat me vlerë apo aksionet që përbëjnë kapitalin e saj.

Në përgjithësi kuadri ligjor mbi çështjet e bashkimit vendos një sërë 'pengesash' me qëllim monitorimin e tregut dhe moslejimit të bashkimit të shoqërive të cilat mund të çënojnë konkurrencën në treg dhe rrjedhimisht të çënojnë të drejtat e fituara në kuadër të tregut të përbashkët. Bashkimi i shoqërive lejohet në rast se bëhet vetëm ndërmjet llojeve të shoqërive tregtare që mund të bashkohen sipas legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare përkatëse ose shoqëria tregtare që merr pjesë në bashkimin ndërkufitar i përmbush dispozitat dhe formalitetet e legjislacionit të brendshëm, të cilit i nënshtrohet. Ligjet e Shteteve Anëtare, të cilat u japin mundësi organeve të brendshme të tyre ta kundërshtojnë një bashkim të brendshëm për arsye të interesit publik, zbatohen edhe për bashkimin ndërkufitar kur të paktën njëra prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse i nënshtrohet ligjit të Shtetit Anëtar.

Procedura

Procesi i bashkimit të shoqërive tregtare konsiston në ndryshime thelbësore në kapitalin dhe administrimin e shoqërisë, të cilat sjellin pasoja jo vetëm për ortakët e shoqërisë, por njëkohësisht dhe për personat e tretë. Me qëllim garantimin e një procesi sa më transparent, eficient dhe që

⁴⁰Neni 4 i Direktivës 2005/56/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 26 Tetor 2005, Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

garanton interesat e kreditorëve, direktiva parashikon një procedurë të detajuar mbi hartimin e projekt-kushteve të bashkimit të shoqërive⁴¹:

- Evidentimi i formës, emërtimit dhe selisë së regjistruar të shoqërive tregtare pjesëmarrëse dhe të dhënat që propozohen për shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- Raporti i zbatueshëm për këmbimin e letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare dhe vlera e pagesës në mjete monetare, nëse ka; kushtet e shpërndarjes së letrave me vlerë ose aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- Pasojat që mund të ketë mbi marrëdhëniet e punës bashkimi ndërkufitar;
- Data prej së cilës mbajtja e këtyre letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare, u jep të drejtë mbajtësve të tyre të marrin pjesë në fitim, dhe çdo kusht të veçantë që ndikon këtë të drejtë;
- Datën prej së cilës veprimet e shoqërive tregtare që bashkohen, trajtohen në kontabilitet si veprime të shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- Të drejtat që u jep shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar anëtarëve me të drejta të veçanta apo mbajtësve të letrave me vlerë, të cilat nuk janë aksione që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare, apo masat që propozohen në lidhje me ta;
- Çdo avantazh që u jepet ekspertëve të cilët bëjnë ekspertizën e projektkushteve të bashkimit apo që u jepet anëtarëve të organeve administrative, drejtuese, mbikëqyrëse apo kontrolluese të shoqërive tregtare që bashkohen;
- Statuti i shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- Informacioni, kur ka, për procedurat përmes të cilave vendosen masat për përfshirjen e punëmarrësve në përcaktimin, sipas nenit 16, e të drejtave të tyre për të marrë pjesë në shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- Informacioni për vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve që i kalojnë shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- Datat e bilancit të shoqërive tregtare që bashkohen, të përdorura për caktimin e kushteve të bashkimit ndërkufitar.

Procesi vijon më tej me publikimin e informacionit sipas mënyrës të parashikuar me ligj në secilin Shtet Anëtar, sipas nenit 3 të Direktivës 68/151/KEE, për secilën prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes së asamblesë në të cilën do të vendoset për to. Për secilën prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, dhe në varësi të kërkesave të tjera shtesë të vendosura nga Shteti Anëtar, objekt i të cilave është shoqëria tregtare në fjalë, në gazetën zyrtare të këtij Shteti Anëtar publikohen: lloji, emërtimi dhe selia e regjistruar të secilës shoqëri tregtare që merr pjesë në bashkim, regjistri në të cilin janë depozituar dokumentet e përmendura në nenin 3 pika 2 të Direktivës 68/151/KEE, në lidhje me secilën shoqëri tregtare pjesëmarrëse në bashkim, dhe numrin e regjistrimit të tyre si dhe një njoftim, për secilën prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, të masave të marra për ushtrimin e të drejtave të kreditorëve dhe të pronarëve të vegjël, nëse ka, të shoqërive tregtare që bashkohen dhe adresën ku mund të merret informacioni i plotë pa pagesë për këto masa. Më tej procedura kërkon miratimin nga Asambleja (Neni 9), por megjithatë çështja e vendosjes së miratimit si kusht, nuk është i detyrueshëm për shtetet anëtare në rast se shoqëritë që i nënshtrohen bashkimit kanë kaluar një auditim paraprak nga eksperti kontabël i miratuar.

Në Shqipëri, Ligji nr.110/2012 është përafëruar plotësisht me Direktivën 2005/56/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 26 tetor 2005 "Për Bashkimin Ndërkufitar të Shoqërive

⁴¹Neni 6 i Direktivës 2005/56/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 Tetor 2005, për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar

me Përgjegjësi të Kufizuar". Në nenin 2 të këtij ligji parashikohet fusha e zbatimit të tij ku përcaktohet se zbatohet për bashkimet ndërkufitare, të përcaktuara sipas nenit 3 të këtij ligji, nëse, të paktën, njëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim është shoqëri shqiptare.⁴²

2. Kontrolli i përqëndrimeve

Si një mekanizëm mbrojtës kundrejt bashkimeve të shoqërive, Komisioni Europian ka miratuar Rregulloren nr. 802/2004 e 7 Prillit 2004 në zbatim të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 139/2004 "Mbi kontrollin e përqëndrimeve ndërmjet ndërmarrjeve" duke përcaktuar detyrimin e shoqërive për të njoftuar bashkimin e tyre sipas modaliteteve të paraqitura në rregullore. Nëse Komisioni synon të marrë një vendim që ndikon negativisht mbi një ose disa palë, ai, informon palët njoftuese dhe palët e tjera të përfshira me shkrim për kundërshtimet e tij dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ato bëjnë të ditura mendimet e tyre me shkrim. Nëse Komisioni ka marrë një vendim pa u dhënë mundësi palëve njoftuese dhe palëve të tjera të përfshira për të shprehur mendimet e tyre, ai pa vonesë u dërgon atyre tekstin e vendimit të përkohshëm dhe cakton një afat kohor brenda të cilit ato bëjnë të ditura mendimet e tyre me shkrim. Sapo palët njoftuese dhe palët e tjera të interesuara kanë bërë të ditura mendimet e tyre, Komisioni merr një vendim përfundimtar që anulon, ndryshon ose vërteton vendimin e përkohshëm. Nëse ato nuk i bëjnë të ditura mendimet e tyre brenda afatit kohor, vendimi i përkohshëm i Komisionit bëhet përfundimtar me kalimin e atij afati.

Pra, Komisioni në asnjë rast nuk mund të marrë një vendim përfundimtar pa zhvilluar një seancë dëgjimore me palët. Ky është një mjet për t'u garantuar palëve mundësinë për të argumentuar arsyet e bashkimit dhe të argumentojnë se pse ky bashkim nuk do të konsistonte në një përqëndrim shoqërisht. Pavarësisht se në Direktivë përmendet mundësia e Komisionit për të marrë vendime pa zhvilluar seancë dëgjimore, këto vendime janë të një natyre të përkohshme dhe Komisionit i lind detyrimi të njoftojë palët për arsyet e refuzimit dhe të caktojë një seancë dëgjimore për të arritur në një vendim përfundimtar. Kjo zgjidhje duket e arsyeshme dhe mund të konsiderohet një mjet efektiv, i cili nuk i garanton Komisionit kompetenca arbitrare, por i ofron mundësinë për të vlerësuar çështjet e bashkimeve të shoqërive me qëllim ruajtjen e një standarti të tregut të përbashkët.

2.1 Praktikë gjyqësore

2.1.1. Pozita dominuese

Një veprim për anulim ngritur nga një person fizik ose juridik është i pranueshëm vetëm për atë që ka një interes në masën e kontestuar të anuluar; ky është pozicioni ku anulimi do të mundësojë përsëritjen në të ardhmen të paligjshmërisë së pretenduar që të shmanget. Ndërmarrja për të cilën është adresuar një vendim duke deklaruar një përqëndrim të papajtueshëm me tregun e përbashkët ka një interes në sjelljen e procedurës dhe në ligjshmërinë e atij vendimi ekzaminuar nga Komuniteti Gjyqësor⁴³. Neni 1 i Rregullores Nr. 4064/89 nuk kërkon, në mënyrën që për një përqëndrim të konsiderohet si të paturit e një dimensionit të Komunitetit dhe, në përputhje me rrethanat, që ajo të bjerë në kuadër të kësaj Rregulloreje, se ndërmarrjet në fjalë duhet të vendosen brenda Komuniteti ose që aktivitetet e prodhimit të mbuluara nga përqëndrimi duhet të kryhet në territorin e komunitetit. Zbatimi i Rregullores Nr 4064/89 është i justifikuar në bazë të së drejtës publike ndërkombëtare, kur ajo është e parashikuar se një përqëndrim i propozuar në mes të ndërmarrjeve të vendosura jashtë Komunitetit do të ketë një efekt të menjëhershëm dhe të

⁴² Neni 2, Ligji nr. 110/2012 "Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare".

⁴³ T-102/96, Gencor

konsiderueshëm brenda Komunitetit. Fakti që, në një treg botëror, pjesë të tjera të botës janë të prekura nga përqendrimi nuk mund të parandalojë Komunitetin nga ushtrimi i kontrollit të tij mbi një përqendrim, i cili në thelb ka një efekt mbi konkurrencën brenda tregut të përbashkët duke krijuar një pozicion dominues.

Është e nevojshme, që gjatë interpretimit të një mase legislative, t'i jepet më pak rëndësi pozicionit të marrë nga një ose një tjetër shtet anëtar, kur masa është ndaluar më shumë në formulimin e objektivave të saj. Fakti që, pas miratimit të një mase, Shtetet Anëtare kontestojnë një interpretim të veçantë, nuk mund të thotë se ajo është e pasaktë. Qëkur Shtetet Anëtare nuk janë të lidhur me pozitat të cilat ata mund t'i pranojnë në kohën e debatit në kuadër të Këshillit, nuk mund të përjashtohet mundësia se njëri prej tyre mund të ndryshojë më vonë pikëpamjen e tij ose të vendosë të ngrejë çështjen e ligjshmërisë së masës para Komunitetit të juridiksionit. Qëkur interpretime të bazuara në formulimin, historinë dhe strukturën konceptuale të një mase të mos lejojnë shtrirjen e saj të saktë për t'u vlerësuar, kjo masë duhet të interpretohet duke iu referuar qëllimit të saj.

Në vlerësimin, në kuadër të përpjekjeve të tij për të kontrolluar përqendrimet, nëse ka një pozicion kolektiv dominues, Komisioni është i detyruar të krijojë, duke përdorur një analizë të mundshme të tregut përkatës, nëse përqendrimi nën hetim do të çojë në një situatë në të cilën konkurrenca efektive në tregun përkatës do të pengohet në mënyrë të konsiderueshme nga ndërmarrjet e përfshira në përqendrim dhe një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera, të cilat së bashku, në mënyrë të veçantë për shkak të faktorëve që kanë shkaktuar një lidhje mes tyre, janë në gjendje të miratojnë një politikë të përbashkët në treg dhe të veprojnë në një masë të konsiderueshme në mënyrë të pavarur nga konkurrentët e tyre, klientët e tyre dhe së fundmi nga konsumatorët. Në këtë lidhje, dispozitat themelore të Rregullores, në veçanti neni 2 i saj, i japin Komisionit një liri të caktuar, veçanërisht në lidhje me vlerësimet e një natyre ekonomike. Si pasojë, shqyrtuar nga Komuniteti gjykimi i të ushtrimit të këtij diskrecioni, që është thelbësor për përcaktimin e rregullave mbi përqendrimet, duhet të marrë parasysh diferencën diskrecionale të nënkuptuar në dispozitat e një natyre ekonomike, të cilat formojnë një pjesë të rregullave mbi përqendrimet.

Ekzistenca e një pozite dominuese rrjedh nga disa faktorë, të cilët të marrë veç, nuk janë domosdoshmërisht vendimtarë. Midis këtyre faktorëve, ekzistenca e aksioneve shumë të mëdha të tregut është shumë e rëndësishme. Megjithatë, një ndarje e konsiderueshme e tregut si dëshmi e ekzistencës së një pozite dominuese nuk është një faktor konstant. Rëndësia e saj ndryshon nga tregu në treg, sipas strukturës së këtyre tregjeve, veçanërisht sa janë të shqetësuar nga prodhimi, furnizimi dhe kërkesa. Megjithatë, aksionet shumë të mëdha të tregut janë në vetvete, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme, dëshmi e ekzistencës së një pozite dominuese. Një ndërmarrje, e cila ka një pjesë shumë të madhe të tregut dhe mban atë për disa kohë, me anë të vëllimit të prodhimit dhe shkallën e furnizimit, të cilën ajo mbështetet - pa ata që kanë aksione shumë më të vogla të tregut, por në gjendje për të plotësuar shpejt kërkesën në ata që do të donin të shkëputeshin nga ndërmarrja që ka pjesën më të madhe të tregut - është pozita e fuqisë që e bën atë një partner tregtar të pashmangshëm dhe i cili, tashmë për shkak të kësaj, siguron për vete, të paktën gjatë periudhave relativisht të gjata, se liria e veprimit është tipar i veçantë i pozitës dominuese.

2.1.2. Bashkimet konglomerate

Përderisa Gjykata pranon se Komisioni ka një diferencë gjykimi në lidhje me çështjet ekonomike, nuk do të thotë se gjykatat e Komunitetit duhet të përmbahen nga rishikimi i

interpretimit të informacionit të një natyre ekonomike të Komisionit⁴⁴. Jo vetëm duhet që gjykatat e Komunitetit, ndër të tjera, të vendosin nëse provat mbi të cilat mbështeten janë faktikisht të sakta, të besueshme dhe të qëndrueshme, por edhe nëse kjo dëshmi përmban të gjitha informatat të cilat duhet të merren parasysh në mënyrë që të vlerësojnë një situatë komplekse dhe nëse ajo është e aftë që të mbështesë konkluzionet e nxjerra prej saj. Një rishikim i tillë është edhe më i nevojshëm në rastin e një analize të ardhshme të kërkuar kur shqyrton një shkrije të planifikuar me efekt konglomerat.

Një analizë e mundshme e llojit të nevojshëm në kontrollin e bashkimit duhet të kryhet me kujdes të madh, meqenëse ajo nuk sjell shqyrtimin e ngjarjeve të kaluara - për të cilat shpesh shumë lloje provash janë në dispozicion të cilat bëjnë të mundur të kuptuarit e shkaqeve ose të ngjarjeve aktuale, por më tepër një parashikim të ngjarjeve të cilat kanë më pak apo më shumë gjasa të ndodhin në të ardhmen, nëse nuk është miratuar një vendim që ndalon përqendrimin e planifikuar apo hedhjen poshtë të kushteve. Kështu, analiza e ardhshme konsiston në shqyrtimin se si një përqendrim mund të ndryshojë faktorët që përcaktojnë gjendjen e konkurrencës në një treg të caktuar në mënyrë që të vendosë nëse do të çojë në një pengesë serioze për konkurrencën efektive. Një analizë e tillë e bën të nevojshme parashikimin e zinxhirëve të ndryshëm të shkakut dhe pasojës me qëllim të konstatimit se cilat prej tyre janë më të mundshme. Analiza e një tipi përqendrimi konglomerat është një analizë e mundshme, në të cilën, për herë të parë, shqyrtimi i një periudhe të gjatë kohore në të ardhmen dhe, së dyti, përdorimi me maksimumin e fitimit e nevojshme për t'i dhënë shkak një pengese të rëndësishme ndaj konkurrencës efektive do të thotë se zinxhirët e shkakut dhe pasojës janë dukshëm të turbullta, të pasigurta dhe e vështira për të vendosur. Duke qenë kështu, cilësia e provave prodhuar nga Komisioni në mënyrë që të vendosë se është e nevojshme të miratojë një vendim që shpall përqendrimin e papajtueshëm me tregun e përbashkët, është veçanërisht e rëndësishme, pasi që provat duhet të mbështesin konkluzionin e Komisionit se, në qoftë se një vendim i tillë nuk u miratua, zhvillimi ekonomik parashikuar prej tij do të jetë bindës⁴⁵.

Analiza e Komisionit mbi efektet e bashkimit të tipit konglomerat duhet të përfshijnë një ekzaminim gjithëpërfshirës të mundësisë së përshtatjes së sjelljes anti-konkurrese të aftë për të rezultuar në një përfitim maksimal, që do të thotë, ajo duhet të marrë parasysh të dy stimujt për të miratuar një sjellje të tillë dhe faktorët përgjegjës për të reduktuar, apo edhe eliminuar, këta stimuj, përfshirë mundësinë që një sjellje e tillë është e paligjshme. Megjithatë, ajo mund të bjerë ndesh me qëllimin e parandalimit të Rregullores Nr 4064/89 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, që duhet të kërkojë Komisionit të shqyrtojë, për çdo bashkim të propozuar, shkalla në të cilën stimujt që miratojnë sjellje anti-konkurrese do të jetë reduktuar, apo edhe eliminuar, si pasojë e paligjshmërisë së sjelljes në fjalë, mundësia e zbulimit të saj, veprimi i ndërmarrë nga autoritetet kompetente, si në nivel komunitar dhe kombëtar, si dhe dënimet financiare, të cilat mund të pasojnë.

Një vlerësim i tillë do të bëjë të nevojshme kryerje e një ekzaminimi të plotë dhe të detajuar të rregulloreve, të urdhrave të ndryshëm ligjore, të cilat mund të jenë të zbatueshme dhe të politikës së zbatimit praktikuar në to. Për më tepër, nëse është e rëndësishme, një vlerësim i tillë kërkon një probabilitet të lartë të shfaqjes së akteve të parashikuara si të aftë për të ngritur kundërshtime me arsyetimin se ata janë pjesë e sjelljes anti-konkurrese. Kjo vijon se, në fazën e vlerësimit të një bashkimi të propozuar, një vlerësim me qëllimin për të vendosur nëse një shkelje e nenit 82 të KE është e mundshme dhe për të konstatuar se kjo do të ndëshkohet në disa urdhra ligjore mund të jetë shumë spekulative dhe nuk do të lejojë Komisionin të bazojnë vlerësimin e tij në të gjitha

⁴⁴ T-5/02, në Vendimin C-12/03, Tetra Laval paragrafi 38-39

⁴⁵ Po aty, paragrafi 42-44

faktet relevante me qëllimin për të përcaktuar nëse ata e mbështesin një skenar ekonomik, në të cilin një zhvillim i tillë si mundësi përfitimi maksimal do të ndodhë⁴⁶.

Sa i përket angazhimeve të ofruara nga ndërmarrjet përkatëse, që janë të aftë të bëjnë përqendrimin e njoftuar në përputhje me tregun e përbashkët, parimi është se këto duhet t'i mundësojnë Komisionit të nxjerrë përfundimin se përqendrimi në fjalë nuk do të krijojë ose të forcojë pozitën dominuese brenda kuptimit të nenit 2 (2) dhe (3) të Rregullores Nr 4068/89 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

Nga ky parim tregohet se kategorizimi i një angazhimi të propozuar si sjellje ose strukturë është jomaterial dhe se nuk mund të përjashtohet automatikisht se angazhimet që janë në dukje të tilla, për shembull një angazhim për të mos përdorur një markë tregtare për një periudhë të caktuar apo për ta vënë një pjesë të kapacitetit të prodhimit të njësisë ekonomike që rrjedh nga përqendrimi në dispozicion të konkurrentëve të palëve të treta ose, më në përgjithësi, për të dhënë qasje në objektet thelbësore në kushte jodiskriminuese, mund të jetë i aftë për të parandaluar shfaqjen apo forcimin nga një pozicion dominues (paragrafi 86).

Ajo vijon nga neni 2 (1) i Rregullores Nr 4064/89 mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve që Komisioni, gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë së një përqendrimi me tregun e përbashkët, duhet të marrë parasysh një numër faktorësh, siç janë struktura e tregjeve përkatëse, konkurrenca aktuale ose potenciale e ndërmarrjeve, pozicioni i ndërmarrjeve pjesëmarrëse dhe fuqia e tyre ekonomike dhe financiare, opsionet e mundshme në dispozicion për furnizuesit dhe përdoruesit, çdo barrierrë e hyrjes dhe trendet sipas kërkesës dhe ofertës. Prandaj, fakti i thjeshtë që ndërmarrja përvetësuese tashmë mban një pozicion të qartë dominues në tregun përkatës, edhe pse përbën një faktor të rëndësishëm, nuk ka në vetvete mjaftueshmëri për të justifikuar gjetjen se një reduktim në konkurrencën potenciale, të cilën ndërmarrja duhet të përballojë, përbën një forcim nga pozicioni i saj. Gara potenciale, e përfaqësuar nga një prodhues i produkteve zëvendësuese në një segment të tregut përkatës është vetëm njëri nga një seri faktorësh që duhet të merren parasysh kur vlerësohet nëse ekziston rreziku që një përqendrim mund të forcojë një pozitë dominuese. Nuk mund të përjashtohet se një reduktim në këtë konkurrencë të mundshme mund të kompensohet nga faktorë të tjerë, me rezultatin se pozita konkurruese e ndërmarrjes tashmë dominuese mbetet e pandryshuar⁴⁷.

2.1.3. Bashkimet Vertikale

Në *Komisioni kundër GE*, Gjykata e mbështeti argumentin e Komisionit se bashkimi mund të kishte krijuar një monopol në tregun botëror për motorët e avionëve të vegjël dhe për avionët e mëdhenj rajonalë. Komisioni ka theksuar, me të drejtë, rëndësinë e këtij tregu nga perspektiva evropiane, duke qenë se avioni i madh rajonal llogaritet në 14% të flotës ajrore Evropiane në 1992 dhe 33% në vitin 1998. Në këtë drejtim, Gjykata mbështeti konstatimin e Komisionit se krijimi i një monopoli në lidhje me motorët e avionëve të vënë lëvizje, do të ketë efekte të dëmshme mbi konkurrencën, duke qenë se ajo do të privojë konsumatorët nga përfitimet e konkurrencës të çmimeve⁴⁸.

Së fundi, Gjykata e mbështeti refuzimin e Komisionit për angazhimin e propozuar nga palët në bashkim për të zgjidhur problemet e konkurrencës që bashkimi do të krijojë në këtë treg. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata hodhi poshtë argumentet e GE-së në lidhje me konstatimet e Komisionit në lidhje me krijimin e pozitave dominuese në treg për motorët e korporatave të

⁴⁶T-5/02, në Vendimin C-12/03, Tetra Laval paragrafi paragrafi 74-77

⁴⁷T-5/02, në Vendimin C-12/03, Tetra Laval paragrafi 125-127

⁴⁸T-210/01, GE/Honeywell

avionëve reaktivë dhe në tregun për turbinat e vogla detare të gazit. Në lidhje me aspekte të tjera të çështjes, që Gjykata mbajti, së pari, se Komisioni mund të konkludojmë, pa bërë një gabim të qartë të vlerësimit, që GE mbajti një pozicion dominues, para bashkimit, në tregun për motorët reaktivë të avionëve të mëdhenj komercialë (tregtarë). Gjykata konstatoi, ndër të tjera, se Komisioni mund të konsiderojë ligjërisht GE se ka përdorur forcën komerciale të filialeve brenda grupit të saj, në veçanti shoqëria avioni leasing GECAS, për të fituar kontrata të cilat ajo nuk mund t'i kishte fituar pa përfshirjen e tyre.

Megjithatë, Gjykata u shpreh se tre aspekte të dallueshme të vendimit të Komisionit ishin të pavlefshme për shkak të paligjshmërisë: Mbivendosje vertikale midis Honeywell motor starters dhe GE motors, si rezultat i bashkimit; Gjykata u shpreh se baza e vendimit të kontestuar në lidhje me forcimin e dominimit të para-bashkimit GE-së në treg për motorët për avionë të mëdhenj komercialë, rezultat nga kjo mbivendosje vertikale, ishte e pabazuar. Më konkretisht, Gjykata u shpreh se Komisioni nuk arriti të marrë parasysh efektin parandalues të nenit 82 KE, pavarësisht rëndësisë së tij, dhe se analiza e Komisionit ishte, si rezultat, e dëmtuar nga gabimi i qartë në vlerësim. Efekte konglomerate rezultuan nga bashkimi për shkak të fuqisë financiare dhe integritimit vertikal të GE-së: Gjykata u shpreh se Komisioni nuk vendosi me shkallë të mjaftueshme probabiliteti se njësi ekonomike e bashkuar mund të kishte shtrirë (përhapur) në tregjet e Honeywell-së (produkte të avionëve ose jo) praktikën e GE-së në treg për motorët e avionëve reaktivë; komercialë, me të cilët GE përdor fuqinë financiare dhe komerciale që rrjedh nga degët e saj.

Në çdo rast, Komisioni nuk ka vendosur në mënyrën e duhur që këto praktika, duke supozuar se ato ishin në fuqi, do të kishte qenë e mundur të krijonin pozita dominuese në tregjet e Avionëve dhe jo-Avionëve në fjalë. Rrjedhimisht, Komisioni bëri një gabim të qartë të vlerësimit. Efekte të përbëra që rrjedhin nga paketa: Gjykata u shpreh se Komisioni nuk përcaktoi mjaftueshëm se njësi e bashkuar do të përshinte shitjet e motorëve të GE me produktet për avion ose jo të Honeywell. Në mungesë të paketave të tilla të shitjes, fakti i qartë se njësi e bashkuar mund të ketë pasur një gamë të gjërë produktesh se sa konkurrentët e saj, nuk ishte e mjaftueshme për të vendosur se pozitat dominuese do të ishin krijuar ose forcuar për të në tregjet e ndryshme në fjalë. Rrjedhimisht, Komisioni gjithashtu bëri një gabim të qartë të vlerësimit në këtë drejtim.

Së fundi, Gjykata shqyrtoi pretendimet e tjera të GE-së, e cila pohonte se të drejtat e saj të mbrojtjes ishin shkelur, dhe u shpreh se asnjëri prej tyre nuk ishte e bazuar mirë. Në përfundim, në aksionin e ngritur nga GE, Gjykata u shpreh se, pavarësisht nga gabimet e dukshme të vlerësimit të bërë nga ana e Komisionit në lidhje me efektet e bashkimit në tregjet e veçanta, rezultatet e tij në lidhje me efektet horizontale që bashkimi do të kishte në tre tregjet e tjera ishin të mjaftueshme për të vendosur se vendimi ndalon bashkimin ndërmjet GE dhe Honeywell, ishin të bazuara mirë. Gjykata gjithashtu hodhi poshtë kërkesën e Honeywell-së, kryesisht për shkaqe teknike që lidhen me fushën e veprimit. Si pasojë, veprimet për anulimin sjellë nga GE dhe Honeywell kundër vendimit të Komisionit u hodhën poshtë.

2.1.4. Njoftimi për Bashkim

Direktiva 2009/109/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat e Këshillit 77/91/KEE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE dhe Direktivën 2005/56/KE, në lidhje me kërkesat për raportimin dhe dokumentimin në rastin e bashkimit dhe ndarjes së shoqërive tregtare për caktun se :

- a) Organet administrative ose drejtuese të secilës prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, hartojnë me shkrim një raport të hollësishëm ku shpjegohen projekti i bashkimit

- dhe përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike për të, e në veçanti raporti i këmbimit të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta.
- b) Në këtë raport përshkruhen edhe vështirësitë e veçanta që janë hasur gjatë vlerësimit.
 - c) Organet administrative ose drejtuese të secilës prej shoqërive tregtare të përfshira e informojnë asamblesën e përgjithshme të shoqërisë së tyre tregtare dhe organet administrative ose drejtuese të shoqërive të tjera tregtare të përfshira, në mënyrë që këto të fundit të mund të informojnë më pas asamblesën e përgjithshme përkatëse, për çdo ndryshim thelbësor në aktivet dhe pasivet, të ndodhur pas datës së përgatitjes të projektit të bashkimit dhe përpara datës së mbledhjes së asamblesës së përgjithshme, ku do të merret vendim për projektin e bashkimit.
 - d) Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që raporti i përmendur në paragrafin 1 dhe/ose informacioni i përmendur në paragrafin 2 të mos kërkohet, nëse kanë vendosur kështu të gjithë aksionarët dhe zotëruesit e titujve të tjerë me të drejtë vote të secilës prej shoqërive tregtare të përfshira në bashkim.”⁴⁹

Në vijim të këtyre përcaktimeve të detajuara, të cilat në thelb bëjnë përcaktime procedurale në lidhje me procesin e bashkimit me qëllim mbrojtjen e konkurrencës. Që në preambulën e direktivës, përcaktohen qartë:

- i. Të zvogëlohet me 25% barra administrative mbi shoqëritë tregtare në mënyrë që të rritet aftësia konkurruese e shoqërive tregtare brenda Komunitetit.
- ii. Në mënyrë që të pasqyrohen ndryshimet në legjislacionin finlandez për shoqëritë tregtare duhet përshtatur fusha e veprimit e Direktivës së dytë të Këshillit 77/91/KEE, datë 13 dhjetor 1976, për koordinimin e masave mbrojtëse të cilat ua kërkojnë shoqërive tregtare Shtetet Anëtare, për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve⁵⁰, në kuadër të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, në lidhje me themelimin e shoqërive aksionare dhe mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit, për vendosjen në një nivel të këtyre masave mbrojtëse dhe i Direktivës së tretë të Këshillit 78/855/KEE, datë 9 Tetor 1978, në bazë të nenit 54 paragrafi 3 germa “g” të Traktatit në lidhje me bashkimin e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara të tregtuara në publik .
- iii. Faqet e internetit të shoqërive tregtare ose faqet e tjera në internet, ofrojnë, në disa raste, një alternativë publikimi nëpërmjet regjistrave tregtarë⁵¹.
- iv. Kërkesat në lidhje me bërjen publike të projektit të bashkimit ndërkuftar, sipas Direktivës 2005/56/KE të Bashkimit Europian dhe të Këshillit, datë 26 Tetor 2005, për bashkimin ndërkuftar të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara duhet të jenë të ngjashme me ato që

⁴⁹Neni 9 i Direktivës 2009/109/KE E Parlamentit Europian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat e Këshillit 77/91/KEE, 78/855/KEE dhe 82/891/KEE dhe Direktivën 2005/56/KE

⁵⁰ Direktiva në paragrafin 7 të preambulës përcakton se pavarësisht masave lehtësuese, asnjë modifikim i Direktivave 78/855/KEE dhe 82/891/KEE që lejon një marrëveshje të tillë të aksionarëve nuk duhet të cenojë sistemet e mbrojtjes së interesave të kreditorëve të shoqërive tregtare në fjalë, dhe as rregullat që synojnë garantimin e dhënies së informacioneve të nevojshme punëmarrësve të këtyre shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike, siç janë autoritetet tatimore, të cilat kanë në kontroll bashkimin ose ndarjen e shoqërive tregtare sipas legjislacionit ekzistues të Komunitetit.

⁵¹Direktiva kërkon që Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje t’i caktojnë këto faqe të tjera në internet që mund t’i përdorin pa pagesë shoqëritë tregtare për këtë publikim, siç janë faqet në internet të shoqatave të biznesit apo të dhomave të tregtisë ose platforma qendrore elektronike e përmendur në Direktivën e parë të Këshillit 68/151/KEE, datë 9 mars 1968, për koordinimin e masave mbrojtëse të cilat ua kërkojnë Shtetet Anëtare shoqërive tregtare për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve, sipas paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me qëllim vendosjen në një nivel të barasvlershëm të masave mbrojtëse në të gjithë Komunitetin. Aty ku është e mundur të përdoret faqet në internet të shoqërisë tregtare apo faqeve të tjera në internet për publikimin e projektushteve të bashkimit dhe/ose ndarjes dhe e dokumenteve të tjera që duhen vendosur në dispozicion të aksionarëve dhe kreditorëve, duke përmbyshur garancitë për sigurinë e faqes së internetit dhe vërtetësinë e dokumenteve.

zbatohen për bashkimet dhe ndarjet e brendshme sipas Direktivës 78/855/KEE dhe Direktivës së gjashtë të Këshillit 82/891/KEE, datë 17 Dhjetor 1982, në bazë të nenit 54 pika 3 germa “g” të Traktatit, që ka të bëjë me ndarjen e shoqërive aksionare.

- v. Shtetet Anëtare duhet të jenë në gjendje të parashikojnë që kërkesat e plota për raportimin ose informimin në lidhje me bashkimin apo ndarjen e shoqërive tregtare, të parashikuara në nenin 9 dhe nenin 11 pika 1 germa “c” të Direktivës 78/855/KEE dhe nenin 7 dhe nenin 9 pika 1 germa “c” të Direktivës 82/891/KEE, të mos jenë të detyrueshme për zbatim nëse kështu bien dakord të gjithë aksionarët e shoqërive tregtare të përfshira në bashkimin ose ndarjen në fjalë.
- vi. Nuk është nevoja të caktohen kërkesa për hartimin e një pasqyre kontabël kur emetuesi, titujt e të cilit janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, publikon raporte financiare gjashtëmujore në përputhje me Direktivën 2004/109/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 2004, për harmonizimin e kërkesave ligjore për transparencë në lidhje me informacionin për emetuesit, titujt e të cilëve pranohen për tregtim në një treg të rregulluar.
- vii. Raporti i ekspertit të pavarur, që parashikohet në Direktivën 77/91/KEE, shpesh nuk nevojitet, nëse duhet hartuar edhe një raport i ekspertit të pavarur në mbrojtje të interesave të aksionarëve dhe kreditorëve në kontekst të bashkimit a ndarjes. Për rrjedhojë, Shtetet Anëtare duhet të kenë mundësinë që në raste të tilla t’i përjashtojnë shoqëritë tregtare nga kërkesat për raportimin sipas Direktivës 77/91/KEE apo të parashikojnë që të dy raportet të mund të hartohen nga i njëjti ekspert.

Ky set i përcaktuar rregullash mbi procedurat e njoftimit për bashkim nga ana e shoqërive tregtare dhe kontrolli paraprak nga ana e Komisionit, përbën një garanci efektive në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës dhe lëvizjes së lirë të kapitalit dhe praktika veçanërisht në çështjen *Gencor* dhe *Tetra Laval* ka konfirmuar rëndësinë e analizës së bashkimeve të shoqërive në kuadër të faktorëve specifikë të vendit anëtar të cilin kërkohet bashkimi.

KAPITULLI III

E DREJTA E VENDOSJES DHE TRANSFERIMIT TË SHOQËRIVE BRENDA BE

1. E drejta e vendosjes dhe e lëvizjes së lirë

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, është konsoliduar dhe një herë qëndrimi i BE në lidhje me të drejtën e vendosjes dhe të lëvizjes së lirë të personave, mallrave apo kapitalit brenda Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Në Nenin 49 të Traktatit të Lisbonës parashikohet se *“Brenda kuadrit të dispozitave të parashikuara më poshtë, ndalohen kufizimet mbi lirinë e vendosjes së shtetasve të një Shteti Anëtar në territorin e një Shteti Anëtar tjetër. Ky ndalim zbatohet edhe për kufizimet mbi ngritjen e agjencive, degëve ose filialeve nga shtetasit e çdo Shteti Anëtar të vendosur në territorin e një Shteti tjetër Anëtar. Liria e vendosjes përfshin të drejtën për të nisur dhe ndjekur veprimtari si persona të vetëpunësuar dhe për të ngritur dhe administruar ndërmarrje, në veçanti shoqëri tregtare apo firma sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54, në bazë të kushteve të përcaktuara për shtetasit e vetë Shtetit Anëtar në legjislacionin e vendit ku realizohet kjo vendosje, në varësi të dispozitave të Kapitullit mbi kapitalin”*.

Në këtë dispozitë përcaktohet qartë se liria e vendosjes prek dy kategori personash:

- Personat fizikë të cilët në cilësisë e shtetasve evropianë kanë të drejtë të vendosen në territorin e çdo vendi anëtar.
- Personat juridikë të cilët janë vendosur në një nga vendet anëtarë të BE-së dhe kërkojnë të zgjerojnë aktivitetin e tyre në territorin e një vendi tjetër anëtar nëpërmjet hapjes së agjensive, degëve apo filialeve.

Në çdo rast, kjo dispozitë nuk zbatohet *“...mbi veprimtaritë të cilat në këtë Shtet janë të lidhura qoftë edhe rastësisht, me ushtrimin e pushtetit publik”*⁵², pra kjo dispozitë nuk do të zbatohet vetëm në raste të veçanta kur shërbimi i cili do të ofrohet ka një natyrë publike si dhe në rastet për të cilat Traktati lejon shprehimisht kufizimet e të drejtave të përcaktuara prej tij. Më tej Traktati i Lisbonës në Nenin 54 bën një përcaktim të veçantë mbi shoqëritë tregtare dhe firmat: *“Shoqëritë tregtare ose firmat e krijuara sipas ligjit të një Shteti Anëtar dhe që e kanë selinë e regjistruar, zyrat qendrore ose vendin kryesor të veprimtarisë brenda Bashkimit, për qëllimet e këtij Kreu, trajtohen njësoj si personat fizikë që janë shtetas të Shteteve Anëtare. Shoqëritë tregtare ose firmat janë shoqëri tregtare ose firma të regjistruara sipas të drejtës civile apo tregtare, duke përfshirë edhe shoqëritë e formës kooperativë si dhe personat e tjerë juridikë që i rregullon e drejta publike apo private, me përjashtim të atyre që janë jofitimprurëse”*.

⁵² Neni 51

Sipas këtij neni është e qartë se rrethi i subjekteve për të cilët zbatohet ky nen janë : shoqëri tregtare, firma të regjistruara sipas të drejtës civile apo tregtare (duke përfshirë edhe shoqëritë e formës kooperativë) si dhe çdo subjekt tjetër, i cili cili rregullohet nga e drejta publike apo private, me përjashtim të organizatave jofitimprurëse për të cilat zbatohen rregulla të veçanta. Pra, në thelb përcaktimi i traktatit nuk jep një listë shterruese të rrethit të subjekteve, por lë një përcaktim të hapur në varësi të legjislacioneve kombëtare të Vendeve Anëtare duke përjashtuar thjesht OJF-të.

Aspekt tjetër i rëndësishëm i këtij neni është vënia e shenjës së barazisë mes personave fizikë dhe juridikë, në kuadër të zbatimit të lirisë së vendosjes. Sipas legjislacionit Evropian, ende nuk ka një lëvizje të lirë të shoqërive. Kjo e drejtë u është njohur personave fizikë dhe mallrave, por ende jo shoqërive të krijuara në një nga vendet anëtare të BE-së. Në thelb, Neni 48 i Traktatit EC parashikon se shoqëritë duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë si personat fizikë, megjithatë legjislacionet kombëtare kanë tendenca të diskriminojnë shoqëritë e krijuara në vende të tjera brenda BE. Kjo ndodh kryesisht pasi legjislacionet kombëtare nuk përmbajnë rregullime të detajuara për vendosjen e një shoqërie të një vendi anëtar në një vend tjetër anëtar.

1.1. Fusha e zbatimit të të drejtës së vendosjes

Një nga çështjet kryesore të ngritura në doktrinën evropiane vitet e fundit është mundësia e shoqërive të krijuara në një nga vendet anëtare, të vendoset në një vend tjetër anëtar dhe në ç' masë kjo është e lejueshme. Tri vendimet më të rëndësishme që kanë hapur debate në lidhje me këtë çështje dhe që kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e një praktike janë *Centros*⁵³, *Überseering*⁵⁴ dhe *Inspire Art*⁵⁵. Pavarësisht se gjykata ka zhvilluar një praktikë të gjerë lidhur me këtë diskutim, duket se ende nuk ka një unifikim të plotë të praktikës gjyqësore dhe shumë çështje të lidhura me të drejtën e vendosjes janë ende të paqarta. Nëse një shoqëri e krijuar që ka selinë qendrore në një vend anëtar të BE-së (X), sipas ligjit të një vendi tjetër anëtar të BE-së (Y), do të trajtohet si një një shoqëri që ka transferuar vendin e kryerjes së aktivitetit të zakonshëm në shtetin (Y) dhe rregullat e shtetit (Y) do të zbatohen si dhe shoqëria do të konsiderohet si subjekt, i cili përfiton nga e drejta e vendosjes në kuadër të traktatit⁵⁶.

Shoqëria do të jetë subjekt i të drejtës së vendosjes. edhe në rast se ajo krijohet në vendin anëtar (X) të të cilin ka dhe selinë qendrore, por në fakt synon të zhvillojë aktivitetin e saj në Vendin anëtar (Y)⁵⁷. Rasti i fundit vlen kur shoqëria e kryen aktivitetin e saj në vendin anëtar (Y) nëpërmjet një dege të regjistruar në të⁵⁸. Megjithatë në bazë të vendimit të dhënë në çështjen *Überseering* dhe *Inspire Art*, duket se e drejta e vendosjes aplikohet edhe në rastet kur vendosja e shoqërisë në shtetin pritës, është e vetmja vendosje⁵⁹. Për rrjedhojë, detyrimi i regjistrimit të një dege në një vend tjetër anëtar lind si detyrim në kuadër të Direktivës së 11-të 89/666/EEC datë 21 Dhjetor 1989 mbi kërkesat ligjore të degëve të shoqërive të krijuara në Vendet Anëtare të BE-së,

⁵³Çështja: C-212/97 *Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen* [1999] ECR I-1459

⁵⁴Çështja: C-208/00 *Überseering BV v. Nordic Construction Company Baumanagement GmbH (NCC)* [2000] ECR I-9919

⁵⁵Çështja: C-167/01 *Kamer van Koophandel en Fabrieken voor Amsterdam v. InspireArt Ltd* [2003] ECR I-10155.

⁵⁶Çështja: C-208/00 *Überseering BV v. Nordic Construction Company Baumanagement GmbH (NCC)* [2000] ECR I-9919, paragrafi 52

⁵⁷*Inspire Art* (n 3) para 95; *Centros* paragrafi 17, dhe *C79/85 Segers* [1986] ECR 2375 paragrafi 16.

⁵⁸ Pavarësisht se ky qëndrim nuk parashikohet në vendimin e gjykatës, mendojme se ky kusht del I qartë në Direktivën e 11-të 89/666/EEC datë 21 Dhjetor 1989 mbi kërkesat ligjore të degëve të shoqërive të krijuara në Vendet Anëtare të BE-së.

⁵⁹Çështja: C-167/01 *Kamer van Koophandel en Fabrieken voor Amsterdam v. InspireArt Ltd* [2003] ECR I-10155, paragrafi 95–96.

por nuk përbën në vetëvete një parakusht për të përfutur nga e drejta e vendosjes e parashikuar në Traktat.

Për sa i përket bashkimeve ndërkuftare të shoqërive, në bazë të legjislacionit Evropian, ato do të përfshihen në fushën e zbatimit të së drejtës së vendosjes dhe madje konsiderohen si një aspekt i rëndësishëm i funksionimit të tregut të përbashkët. Në këtë kuptim, Vendet Anëtare, ndalohen të aplikojnë rregulla të ndryshme për bashkimet ndërkuftare krahasuar me ato të brendshme⁶⁰.

1.2. Rregullat e shteteve të origjinës në kuadër të legjislacionit të BE-së

Një aspekt i rëndësishëm i të drejtës së vendosjes në kuadër të traktatit është dhe legjislacioni i brendshëm i vendeve 'të origjinës' (vendeve në të cilat shoqëritë janë regjistruar dhe kanë selinë). Çfarë do të ndodhë në rast se legjislacionet e vendeve të regjistrimit të shoqërisë do të ndalonin të drejtën e tyre për t'u vendosur në një vend tjetër të BE-së? Në çështjen *Daily Mail*⁶¹, Gjykata ka arritur në konkluzionin se "Neni 49 dhe 54 i Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFEU) (ish nenet 43 dhe 48 EC) nuk mund të interpretohen si një sygjërim ndaj shoqërive të krijuara në një nga vendet anëtare, për të transferuar menaxhimin qendror dhe aktivitetin kryesor në një vend tjetër anëtar, ndërkohë që kanë statusin e shoqërive të krijuara në vendin e parë anëtar". Dyshimet u ngritën në çështjen *Lasteyrie du Sallant*⁶² ku Gjykata u shpreh në lidhje me nenin 49 TFEU (ish-neni 43 KE) gjithashtu se ndalohet Vendi Anëtar i origjinës të pengojë vendosjen e një prej shtetasve të tij në një Vend tjetër Anëtar ...për të parandaluar rrezikun për shmangien e taksave..." Gjithësesi edhe në këtë çështje, gjykata nuk e ka ndryshuar praktikën e saj të krijuar me çështjen *Daily Mail* pasi interpretimi në çështjen *Lasteyrie du Sallant* u bë në kuadër të personave fizikë.

Ndalimi i vendeve të origjinës në përcaktimin e rregullave që pengojnë të drejtën e vendosjes në një vend tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, u sanksionua përfundimisht në çështjen *Marks & Spencer*⁶³ në të cilën Gjykata e Drejtësisë së BE në vendimin e saj tha shprehimisht se në kuadër të së drejtës së vendosjes "...ndalohet Vendi Anëtar i origjinës të pengojë të drejtën e vendosjes në një vend tjetër anëtar të një prej shoqërive të krijuara në atë vend...". Në këtë çështje, u argumentua nga gjykata se një masë kombëtare që lejon shoqërinë mëmë të mbulojë humbjet e shoqërive bija të inkuorporuara në të njëjtin shtet me të, por jo humbjet e shoqërive bija të cilat janë të vendosura në një vend tjetër anëtar, përbënte në thelb një shkelje të të drejtës së vendosjes.⁶⁴

1.3. Praktikë gjyqësore mbi të drejtën e vendosjes

1.3.1. Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen

Janë ngritur pyetje në diskutimet midis Centros Ltd, një shoqëri e limituar private e regjistruar në 18 Maj 1992 në Wells të Anglisë dhe Erhvervs-og Selskabsstyrelsen

⁶⁰Çështja:SEVIC paragrafi 31.

⁶¹Çështja:Daily Mail paragrafi 19

⁶²Case C-9/02 Lasteyrie du Saillant [2004] ECR I-2409 para 42.

⁶³Case C-446/03 Marks & Spencer plc v HM's Inspector of Taxes [2005] ECR I-10837 paragrafi 31

⁶⁴Gjykata e u shpreh se kjo masë nuk ishte e justifikuar.

("Bordi") i cili varet nga Departamenti Danez i Tregëtisë, në lidhje me refuzimin e regjistrimit të një dege të Centros në Danimarkë⁶⁵. Kjo bëhet e qartë nga dokumentat në diskutimet kryesore që Centros nuk ka tregtuar kurrë që nga formimi i saj. Që kur ligji i Britanisë së Madhe nuk imponon asnjë kërkesë për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar si me sigurimin dhe për pagesën e minimumit të kapitalit të përbashkët, kapitali i përbashkët i Centros, i cili shkon në 100 GBP, nuk është paguar asnjëherë dhe as është bërë i disponueshëm për shoqërinë. Ai është i ndarë në dy pjesë dhe mbahet nga Zoti dhe Zonja Bryde, me kombësi daneze dhe residentë në Danimarkë. Znj. Bryde është Drejtore e Centros zyra e të cilës është e vendosur në Mbretërinë e Bashkuar, në shtëpinë e një miku të z. Bryde. Sipas ligjit danez, Centros është një "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar", është trajtuar si një shoqëri e huaj me përgjegjësi të kufizuar. Rregullat që drejtojnë regjistrimin e degëve "filialeve" të shoqërive të tilla janë vendosur nga Anpartsselskabslov (Ligji për shoqëritë private me përgjegjësi të kufizuar). Në veçanti neni 117 i ligjit parashikon:

"Shoqëritë private me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë e huaja me bazë ligjore të ngjashme, të cilat janë vendosur në njërin nga Shtetet Anëtare të Komunitetit Evropian mund të bëjnë biznes në Danimarkë nëpërmjet një dege të saj". Gjatë verës së 1992 znj. Bryde i kërkoi Bordit të regjistrojë një degë të Centros në Danimarkë. Bordi e refuzoi kërkesën në bazë, ndër të tjera se Centros, i cili nuk tregton në Mbretërinë e Bashkuar, po kërkonte në fakt të vendoste në Danimarkë jo një degë por një ndërmarrje qendrore, duke anashkaluar rregullat kombëtare, në veçanti pagesën e kapitalit minimal të vendosur në 200 000 DKK nga ligji Nr 886 i 21 Dhjetorit 1991.

Pyetje në Gjykatë: A është e pajtueshme me Nenin 52 të Traktatit të KE, në lidhje me Nenin 56 dhe 58 të tij të refuzojë regjistrimin e një dege të një shoqërie, e cila e ka të regjistruar zyrën e saj në një shtet tjetër anëtar dhe ka qenë e themeluar në mënyrë të ligjshme me kapitalin e shoqërisë prej 100 GPD (përafërsisht 1000 DKK) dhe ekziston në konformitet me legjislacionin e shtetit Anëtar, ku shoqëria vetë nuk kryen biznes por dëshiron të ngrejë një degë me qëllim që të ngrejë të gjithë biznesin në vendin ku është vendosur dega, dhe ku, në vend që të inkorporojë një shoqëri në këtë Shtet Anëtar, kjo procedurë duhet të konsiderohet se, duke qenë të punësuar, me qëllim të shmangies së pagesës së kapitalit të shoqërisë me jo më pak se 200,000 DKK (tani 125,000 DKR) ?

Gjykata arriti në përfundimin se është në kundërshtim me Nenin 52 dhe 58 të Traktatit të KE për një Shtet Anëtar të refuzojë regjistrimin e një dege të shoqërisë, formuar në përputhje me ligjin e një tjetër Shteti Anëtar, në të cilin ajo ka regjistruar zyrën e saj, por në të cilin ajo nuk kryen biznes, ku dega e saj ka qëllim të mundësojë shoqërinë në çështjen e të vazhduarit të biznesit në Shtetin në të cilin është krijuar dega e saj, duke shmangur nevojën e krijimit të një shoqërie atje, duke shmangur aplikimin e rregullave për formimin e shoqërive, të cilat në atë Shtet janë më strikte në lidhje me pagesën e minimumit të kapitalit të aksioneve.

Ky interpretim, gjithsesi nuk i parandalon autoritetet e Shtetit Anëtar të shqetësuar për adaptimin e masave të parandalimit ose penalizimit të mashtrimit, ose në lidhje me vetë shoqërinë, nëse duhet të jetë në bashkëpunim me Shtetin Anëtar në të cilin ajo është krijuar, ose në lidhje me anëtarët e saj, kur është vendosur se ata në fakt po tentojnë, me kuptimin e formimit të shoqërisë, të shmangin detyrimet e tyre kundrejt kreditorëve publikë dhe privatë në territorin e Shtetit Anëtar në fjalë.

1.3.2. C-208/00 Überseering [2002] ECR I-9919

⁶⁵ C-212/97 Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen [1999] E.C.R. I-1459

Mundet që nenet 43 EC dhe 48 EC të interpretohen në kuptimin se liria e vendosjes së shoqërive pengon kapacitetin ligjor, dhe kapacitetin për të qënë pjesë e një procedimi ligjor, të një shoqërie të inkorporuar në mënyrë të vlefshme sipas ligjit të një Shteti Anëtar, nga të qenit e vendosur sipas ligjit të një tjetër Shteti Anëtar, në të cilin shoqëria ka lëvizur dhe që është aktualisht qendra e administrimit, ku, sipas ligjit të shtetit të dytë, shoqëria nuk mundet të sjellë procedura ligjore atje në lidhje me pretendimet sipas nje kontrate? Nëse përgjigjia e Gjykatës për këtë pyetje është pohuese: A kërkon liria e themelimit të shoqërive (Nenet 43 EC dhe 48 EC) që kapaciteti ligjor i shoqërisë dhe mundësia për të qënë pjesë e procedurave ligjore duhet të përcaktohet sipas ligjit të shtetit ku shoqëria është inkorporuar?

Kur një shoqëri e formuar në përputhje me ligjin e një shteti anëtar ('A') në të cilin ajo ka selinë e regjistruar, konsiderohet, sipas ligjit të një Shteti tjetër Anëtar ('B'), ta ketë lëvizur qendrën e saj aktuale të administrimit tek shteti Anëtar B, nenet 43 KE dhe 48 KE përjashtojnë Shtetin Anëtar B nga mohimi i kapacitetit ligjor shoqërisë dhe rrjedhimisht, kapacitetit për të sjellë procedurat ligjore para gjykatave të saj kombëtare me qëllimin e zbatimit e të drejtave në bazë të një kontrate me një shoqëri të themeluar në shtetin anëtar B. Kur një shoqëri e formuar në përputhje me ligjin e një Shteti Anëtar (A) në të cilin ajo ka regjistruar zyrën, ushtron të drejtën e themelimit në një Shtet tjetër Anëtar (B), nenet 43 EC dhe 48 EC i kërkojnë Shtetit Anëtar B të njohë kapacitetin ligjor dhe rrjedhimisht, mundësinë për të qënë pjesë e procedurave ligjore, të cilat shoqëria i gëzon sipas ligjit të shtetit në të cilin është inkorporuar (A). C-411/03 Sevic Systems AG [2005] ECR I-10805 Kjo duhet të konsiderohet në drejtimin që, rregullat e harmonizuara të Komunitetit janë të dobishme për lehtësimin e bashkimeve ndërkuftare, ndërsa ekziston një harmonizim i tillë.

1.3.3. Sistemi Sevic

Rregullat nuk mund të vendosin një parakusht për implementimin e lirisë së themelimit të përcaktuara nga nenet 43 EC dhe 48 EC (shiko, për këtë qëllim Rastin C-204/90 Bachmann [1992] ECR I-249, paragrafi 11). Megjithatë duhet të theksohet ndërkohë, për arsye të përshtatjes së Direktivës së tretë të Këshillit 78/855/EEC e 9 Tetorit 1978 bazuar në nenin 54(3)(g) të Traktatit lidhur me bashkimet e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar (OJ 1978 L 295, f. 36) rregulla të harmonizuara ekzistojnë në Shtetet Anëtare në lidhje me bashkimet e brendshme, bashkimet ndërkuftare që paraqesin probleme specifike. Në funksion të kësaj, nuk është e mundur të përjashtohet mundësia që arsyeja madhore në interesat publike si mbrojtja e interesave të kreditorëve, aksionerëve të vegjël dhe punonjësve (shih Rastin C-208/00 Überseering [2002] ECR I-9919, paragrafi 92), dhe ruajtja e efektivitetit të mbikëqyrjes fiskale dhe drejtësinë e transaksioneve tregtare (shih Rastin C-167/01 Inspire Art [2003] ECR I-10155, paragraph 132), mundet, në rrethana të caktuara dhe në kushte të caktuara, të justifikojë një masë kufizuese për themelim. Por kjo masë kufizuese duhet të përshtatet gjithashtu për të siguruar arritjen e objektivave të vendosura dhe për të mos dalë përtej asaj që është e nevojshme për t'i arritur ato. Të refuzosh në përgjithësi, në një Shtet Anëtar, të regjistrohen në regjistrin tregtar një bashkim mes një shoqëri të themeluar në atë shtet dhe një tjetër të themeluar në një Shtet tjetër Anëtar, ka si rezultat parandalimin e realizimit të bashkimit ndërkuftar, edhe në qoftë se interesat e përmendur në paragrafin 28 të këtij gjykimi nuk janë të kërcënuar. Në çdo rast, një rregull i tillë shkon përtej asaj që është e nevojshme për të mbrojtur këto interesa.

Në këto rrethana, përgjigjia për pyetjen e përmendur duhet të jetë se nenet 43 KE dhe 48 KE përjashtojnë regjistrimin në regjistrin kombëtar tregtar të bashkimit me shpërbërjen pa likuidim të një shoqërie dhe transferimin e të gjithë asetëve të saj në një shoqëri tjetër nga të qenit refuzuar në përgjithësi në një Shtet Anëtar, ku njëra prej të dyja shoqërive është themeluar në një Shtet tjetër Anëtar, ndërsa një regjistrim i tillë është i mundur, në përputhje me kushtet e caktuara, ku të dy shoqëritë që marrin pjesë në bashkim janë të dyja të vendosura në territorin e shtetit të parë anëtar.

1.3.4. C-210/06 Cartesio

Gjykata referuese pyet nëse nenet 43 EC dhe 48 EC mund të interpretohen si ligje penguese të një shteti anëtar, sipas të cilave një shoqëri e inkorporuar sipas ligjit të një Shteti Anëtar nuk mundet ta transferojë selinë e saj në një tjetër Shtet Anëtar, përderisa do të ruajë statusin e saj si shoqëri e udhëhequr nga ligji i Shtetit Anëtar të përfshirë. (inkorporuar). Nga urdhri i referencës duket qartë që Cartesio- një shoqëri e përfshirë në përputhje me ligjin hungarez dhe e cila, në kohën e përfshirjes, e vendosi qëndrimin në Hungari- transferoi qëndrimin në Itali por dëshiroi të ruajë statusin si një shoqëri e qeverisur nga Ligji Hungarez. Sipas Ligjit Hungarez në regjistrat tregtarë, selia e një shoqërie të qeverisur nga ligji hungarez duhet të jetë vendi ku ajo ka vendosur administratën qendrore të saj.

Gjykata referuese thekson se aplikimi i paraqitur nga Cartesio për amendimin e hyrjes në regjistrin tregtar, në lidhje me selinë e shoqërisë së saj, ishte refuzuar nga gjykata përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit në bazë ku, sipas ligjit hungarez, një shoqëri e vendosur në Hungari, e përshkruar nga ligji në regjistrin tregtar, nuk mund ta transferojë selinë e saj jashtë shtetit, ndërsa vazhdon të jetë subjekt i ligjit hungarez, pasi ligji rregullon statusin e shoqërisë. Një transferim i tillë do të kërkonte, së pari që shoqëria të pushojë së ekzistuari dhe me pas ta ripërfshijë veten në përputhje me ligjin e vendit në të cilin ajo do të vendosë selinë e saj të re. Në lidhje me këtë, Gjykata vërejt në paragrafin 19 të *Daily Mail and General Trust* se janë krijesa të ligjit kombëtar dhe ekzistojnë vetëm në bazë të legjislacionit kombëtar, i cili përcakton përfshirjen dhe funksionimin e tij. Në paragrafin e 20 të *Daily Mail dhe General Trust*, Gjykata deklaroi se legjislacioni i Shteteve Anëtare ndryshon gjerësisht në lidhje me të dy faktorët që sigurojnë një lidhje me territorin kombëtar të nevojshëm për përfshirjen e një shoqërie dhe pyetjen nëse një shoqëri e inkorporuar sipas legjislacionit të një Shteti Anëtar mund ta modifikojë më pas këtë faktor lidhës. Shtete të caktuara kërkojnë që jo vetëm zyra e regjistruar, por edhe selia e vërtetë (siège réel) - që do të thotë, administrata qendrore e shoqërisë - duhet të jenë të vendosura në territorin e tyre, dhe largimi i administratës qendrore nga ai territor supozon likuidimin e shoqërisë me të gjitha pasojat që likuidimi përfshin sipas ligjit. Legjislacioni i shteteve të tjera i lejon shoqëritë të transferojnë administratën qendrore të tyre në një vend të huaj, por disa prej tyre e bëjnë këtë subjekt të kufizimeve të caktuara, dhe pasojat ligjore të transferimit të ndryshojnë nga një shtet anëtar në tjetrin.

Gjykata shtoi, në paragrafin 21 të *Daily Mail and General Trust*, se Traktati i KEE ka marrë në konsideratë këtë shumëllojshmëri në legjislacionin kombëtar. Duke përcaktuar, në nenin 58 të këtij Traktati (me pas Neni 58 i Traktatit të KE, tani neni 48 i KE), shoqëritë të cilat gëzojnë të drejtën e vendosjes, Traktati i KEE i vendos në të njëjtën bazë, si faktorë lidhës, zyrën e regjistruar, administratën qendrore dhe vendin kryesor të biznesit të një shoqërie. Në rastin C-208/00 *Überseering* [2002] ECR I-9919, paragrafi 70, Gjykata ndërsa konfirmon këtë deklaratë, nxjerr nga kjo se çështja nëse një shoqëri e formuar në përputhje me legjislacionin e një Shteti Anëtar mund ta transferojë zyrën e regjistruar të saj ose qendren e saj aktuale të administrimit në një Shtet tjetër Anëtar pa humbur të drejtën ligjore sipas ligjit të Shtetit Anëtar në të cilin është vendosur, dhe, në këto rrethana, rregullat që lidhen me transferimin janë përcaktuar nga ligji kombëtar në përputhje me të cilin shoqëria ishte vendosur. Gjykata arriti në përfundimin se një Shtet Anëtar është i aftë, në rastin kur shoqëria është vendosur sipas ligjit të tij, të bëjë që shoqëria të ruajë të drejtën e saj ligjore sipas ligjit të këtij Shteti Anëtar objekt i kufizimeve për transferimin në një shtet të huaj të qendrës së saj aktuale të administrimit⁶⁶.

⁶⁶ C-210/06 Cartesio, Paragrafi 112

Për më tepër, duhet të theksohet, se Gjykata gjithashtu e arriti këtë përfundim në bazë të formulimit të Nenit 58 të Traktatit të KEE. Siç është përcaktuar, në këtë nen, shoqëritë, të cilat gëzojnë të drejtën e vendosjes (themelimit), Traktati i KEE duke konsideruar ndryshimet në legjislacionin të Shteteve Anëtare, edhe sa i përket faktorit të kërkuar lidhës për shoqëritë subjekt të këtij ligji dhe në lidhje me pyetjen ku dhe, nëse kështu, si zyra e regjistruar (*siège statutaire*) ose selia reale qëndrore (*siège réel*) e një shoqërie vendosur sipas legjislacionit kombëtar (vendas) mund të transferohet nga një Shtet Anëtar në një tjetër kur problemet të cilat nuk janë zgjidhur nga rregullat në lidhje me të drejtën e vendosjes, por të cilat duhet të zgjidhen me legjislacionin e ardhshëm ose konventat (shih, për efekt, *Daily Mail and General Trust*, paragrafi 21 deri 23, dhe *Überseering*, paragrafi 69).

Si rrjedhojë, në përputhje me nenin 48 KE, në mungesë të një për ligji komunitar, përcaktimi i shoqërive, të cilat mund të gëzojnë të drejtën e vendosjes (themelimit) mbi bazën e një faktori të vetëm lidhës që përcakton ligjin kombëtar të aplikueshëm për një shoqëri, pyetja nëse neni 43 KE vepron mbi një shoqëri e cila kërkon të mbështetet në të drejtën themelore sanksionuar në këtë nen - si pyetja nëse një person fizik është shtetas i një Shteti Anëtar, si i tillë ka të drejtë të gëzojë këtë liri – është një çështje paraprake, siç ligji komunitar mbështet, mund të zgjidhet vetëm nga ushtrimi i ligjit vendas. Si pasojë, pyetja nëse shoqëria përballet me një kufizim mbi të drejtën e vendosjes, brënda kuptimit të nenit 43 të KE, mund të ngrihet vetëm nëse ajo ka qenë e themeluar, në dritën e kushteve të parashtruara në nenin 48 të KE, kjo shoqëri ka aktualisht të drejtën e kësaj lirie. Kështu që një Shtet Anëtar ka fuqinë të përcaktojë si faktorin (bashkues) lidhës të kërkuar nga një shoqëri, nëse është ajo që lidhet me themelimin sipas ligjit të Shtetit Anëtar dhe, si e tillë, e aftë të gëzojë të drejtën e themelimit dhe kërkesën nëse shoqëria është e aftë në vazhdimësi të ruajë këtë status. Kjo fuqi përfshin mundësinë e këtij Shteti Anëtar të mos lejojë një shoqëri të qeverisur nga ligji i tij të mbajë këtë status nëse shoqëria ka synim të riorganizojë vetveten në një tjetër Shtet Anëtar, duke lëvizuar selinë e saj në këtë territor në të ardhmen, duke thyer kështu faktorin bashkues (lidhës) të kërkuar sipas ligjit vendas të Shteti Anëtar të vendosjes (inkorporimit). Megjithatë, situata ku vendi i një shoqërie të vendosur sipas ligjit të një Shteti Anëtar është transferuar në një tjetër Shtet Anëtar pa ndryshime në lidhje me ligjin që qeveris këtë shoqëri, qëllon të jetë e dallueshme nga situata kur një shoqëri e qeverisur nga ligji i një Shteti Anëtar zhvendoset në një tjetër Shtet Anëtar me një ndryshim shoqëruar në lidhje me ligjin kombëtar të aplikueshëm, qëkurse në situatën e mëvonshme, shoqëria është konvertuar në formën e një shoqërie, e cila qeveriset nga legjislacioni i Shtetit Anëtar në të cilin është zhvendosur.

Në fakt, në këtë rast të fundit, fuqia referuar paragrafit 110 më lart, larg nga nënkuptimi se legjislacioni vendas mbi vendosjen (përfshirjen) dhe likuidimin e shoqërive gëzon çdo formë të imunitetit prej rregullave të Traktatit të KE mbi lirinë e vendosjes, nuk mundet, në veçanti, të justifikojë Shtetet Anëtare të vendosjes, duke kërkuar fshirjen apo likuidimin e shoqërisë, në parandalimin që nga konvertimi i vetë shoqërisë në një tjetër, në atë masë që kjo është e lejuar nën atë ligj për ta bërë këtë. Një barrierë e tillë për konvertimin aktual të një shoqërie të tillë, pa fshirje paraprake ose likuidime, në një shoqëri të qeverisur nga legjislacioni i Shtetit Anëtar në të cilin ajo dëshiron rivendoset përbën një kufizim në lirinë e themelimit të shoqërisë në fjalë e cila, nëse nuk i shërben kërkesave themelore në interes të publikut, është e ndaluar nga neni 43 i KE (shih për efekt, ndër të tjera *CaixaBank France*, paragrafi 11 dhe 17). Gjithashtu duhet të theksohet se, në vazhdim të gjykimit në *Daily Mail and General Trust* dhe *Überseering*, zhvillimet në fushën e legjislacionit të shoqërisë theksuar në nenin 44 (2) (g) të KE dhe 293 të KE, respektivisht, si vijimësi e legjislacionit dhe marrëveshjeve, akoma nuk ka adresuar kështu diferencat, referuar në këtë gjykim, midis legjislacionit të Shteteve të ndryshme Anëtare dhe, rrjedhimisht, nuk i ka çrrënjësuar këto diferenca. Komisioni pohoi, gjithsesi, se mungesa e legjislacionit komunitar në këtë fushë- vënë në dukje nga Gjykata në paragrafin 23 të *Daily Mail and General Trust*- ishte

rregulluar nga rregullat e Komunitetit, që rregullojnë transferimin e selisë së shoqërisë në një tjetër Shtet Anëtar, e përcaktuar në rregulloret e tilla si Rregullorja Nr 2137/85 në EEC dhe Rregullorja Nr 2157/2001 EC ose, për më tepër, Rregullorja e Këshillit (EC) Nr 1435/2003 e 22 Qershorit 2003 në Statutin për një shoqëri të bashkuar Europiane (SCE) (OJ 2003 L 207, p. 1), si edhe nga legjislacioni hungarez, i përshtatur sipas këtyre rregulloreve. Komisioni argumenton se këto rregulla mund dhe duhet të zbatohen, duke aplikuar 'mutatis mutandis' transferimet ndërkufitare të selisë reale të një shoqërie të vendosur sipas ligjit të një Shteti Anëtar⁶⁷.

Në këtë kuptim, duhet të theksohet se megjithëse këto rregullore, të përshtatura në bazë të nenit 308 të KE, hedhin poshtë një seri rregullash nën të cilat bëhet e mundur për subjekte të reja ligjore, të cilat vendosin të transferojnë zyrat e tyre të rregjistruara (*siège statutaire*) dhe, rrjedhimisht, edhe selinë reale (*siège réel*) – të cilat së bashku duhet, të jenë të vendosura në të njëjtin shtet anëtar – në një Shtet tjetër Anëtar pa qenë e nevojshme të fshijnë përfaqësuesin ligjor origjinal ose të krijojnë një përfaqësues të ri ligjor, një transferim i tillë megjithatë domosdoshmërisht përfshin një ndryshim sa i përket ligjit kombëtar të zbatueshëm të personit që ka bërë një transferim të tillë. Kjo është e qartë, për shembull, në rastin e një shoqërie evropiane, nga nenet 7 deri në 9 (1) (c) (ii) të Rregullores Nr 2157/2001.

Kështu siç është, në rastin përpara gjykatës përkatëse, Cartesio thjesht dëshiron të transferojë selinë e tij nga Hungaria në Itali, ndërsa duke mbetur një shoqëri e qeverisur nga ligji hungarez, prandaj pa ndonjë ndryshim sipas ligjit kombëtar të aplikueshëm. Prandaj, aplikimi 'mutatis mutandis' i Legjislacionit Komunitar, të cilit i referohet Komisioni- edhe nëse do të ishte për të qeverisur transferimin ndërkufitar të selisë së një shoqërie të qeverisur nga ligji i një Shteti Anëtar- në asnjë rast nuk mund të çojë në rezultatin e parashikuar në rrethana të tilla si ato përpara gjykatës referuese. Për më tepër, në lidhje me implikimin e *SEVIC Systems* për parimet e vendosura në *Daily Mail and General Trust* dhe *Überseering*, duhet të theksohet se këto gjykime nuk lidhen me të njëjtin problem dhe rrjedhimisht *SEVIC Systems* nuk mund të thuhet se ka përshtatur qëllimin e *Daily Mail and General Trust* or *Überseering*.

Rasti i cili ngrihet për gjykim në *SEVIC Systems* ka të bëjë me njohjen, në Shtetet Anëtare të një shoqërie, si një operacion vendosjeje i kryer nga kjo shoqëri në një tjetër shtet Anëtar si një bashkim ndërkufitar, e cila është një situatë krejtësisht e ndryshme prej rrethanave në çështje në rastin i cili ngrihet për gjykim në *Daily Mail and General Trust*, por i ngjashëm me situatën e marrë parasysh në gjykime të tjera të Gjykatës (shih Rasti C-212/97 *Centros* [1999] ECR I-1459; *Überseering*; and Rastin C-167/01 *InspireArt* [2003] ECR I-10155). Në situatë të tillë, çështja që duhet të vendoset e para nuk është pyetja, referuar në paragrafin 109 më sipër, nëse shoqëria në fjalë mund të konsiderohet si një shoqëri e cila zotëron kombësinë e Shtetit Anëtar, sipas legjislacionit, të të cilit është vendosur por, më tepër pyetja nëse jo kjo shoqëri, që është e përbashkët, është një shoqëri e qeverisur nga ligji i Shtetit Anëtar- është përballur me vështirësi në ushtrimin e të drejtës së vendosjes në një tjetër Shtet Anëtar⁶⁸.

Në dritën e gjithçkaje të parashtruar, përgjigja për pyetjen e katërt duhet të jetë kjo, siç parashikon e drejta komunitar, nenet 43 dhe 48 KE duhet të interpretohen jo si një legjislacion përjashtues i një shteti anëtar sipas të cilit një shoqëria e vendosur sipas ligjit të këtij shteti anëtar nuk mund të transferojë selinë e saj në një tjetër shtet anëtar, ndërsa mban statusin e saj si një shoqëri e qeverisur nga ligji i shtetit anëtar ku është vendosur.

⁶⁷ C-210/06 *Cartesio*, Paragrafi 116

⁶⁸ Po aty, Paragrafi 122

2. Procesi i harmonizimit dhe impakti në legjislacionin e vendeve anëtare

Në kuadër të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian si dhe në kuadër të një procesi që po shkon drejt unifikimit të legjislacionit të shoqërive tregtare brenda vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, një set Direktivash janë krijuar me qëllim lehtësimin e tregut të përbashkët dhe krijimin e një seti minimum rregullash të përbashkëta në të gjithë bashkimin.

Praktika e Gjykatës së Drejtësisë së BE ka luajtur një rol kyç në drejtim të unifikimit të praktikave evropiane dhe veçanërisht interpretimin e shumë çështjeve praktike në lidhje me disa aspekte civile që prekin shoqëritë tregtare. Përcaktimet e traktateve mbi lirinë e vendosjes së shoqërive janë ndjekur nga një numër i madh direktivash, të cilat trajtojnë aspekte të veçanta të shoqërive. Direktivat që mund të përmenden janë:

- Direktiva e Parë mbi Shoqëritë 68/151/EEC, Mbi koordinimin e masave mbrojtëse (...) për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, shfuqizuar nga 2009/101 EEC;
- Direktiva e Dytë mbi Shoqëritë 77/91/EEC, Mbi krijimin e shoqërive publike dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit, shfuqizuar nga 2012/30/EU;
- Direktiva e Tretë mbi Shoqëritë 78/855/EEC, Mbi bashkimet e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, shfuqizuar nga by 2011/35/EU;
- Direktiva e Katërt Ligjore e Shoqërisë 78/660/EEC, Mbi standartet e kontabilitetit
- Direktiva e Gjashtë mbi Shoqëritë 82/891/EEC, mbi ndarjen e shoqërive publike, amenduar nga 2007/63/EC;
- Direktiva e Shtatë mbi Shoqëritë 83/349/EEC, mbi llogaritë e grupit;
- Direktiva e Tetë mbi Shoqëritë 84/253/EEC, mbi aprovimin e personave përgjegjës për kryerjen e auditave statutorë të dokumentave të kontabilitetit, shfuqizuar nga 2006/43/EC mbi auditimin statutor të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara;
- Direktiva e Dhjetë mbi Shoqëritë 2005/56/EC, mbi bashkimet ndërkuftare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar;
- Direktiva e Njëmbëdhjetë mbi Shoqëritë 89/666/EEC, mbi kërkesat për dhënie informacioni në lidhje me degët e hapura në një shteti anëtar nga disa lloje shoqërisht udhëhequr nga legjislacioni i një shteti tjetër;
- Direktiva e Dymbëdhjetë mbi Shoqëritë 89/667/EEC, mbi Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me një ortak të vetëm, shfuqizuar nga 2009/102/EC;
- Direktiva e Trembëdhjetë mbi Shoqëritë 2004/25/EC, mbi shprehjen e ofertave;
- Direktiva mbi Abuzimin e Tregut 2003/6/EC;
- Direktiva mbi Transparencën e Shoqërive të Listuara (Përbëra) 2004/109/EC;
- Direktiva mbi të Drejtat e Aksionerëve 2007/36/EC, mbi ushtrimin e disa të drejtave të aksionerëve në shoqëritë e përbëra;
- Direktiva e Taksës së Bashkimit 90/434/EEC, mbi sistemin e përbashkët të taksimit i aplikueshëm për bashkimet, ndarjet, transferimet e aseteve dhe shkëmbimet e aksioneve në lidhje me shoqëritë e shteteve të ndryshme anëtare, shfuqizuar nga 2009/133/EC.

2.1. Direktiva 2009/102/EC “Mbi shoqëritë tregtare me një ortak të vetëm”

Një shoqëri tregtare private me përgjegjësi të kufizuar mund të konsiderohet si një shoqëri me ortak të vetëm që nga koha e formimit të saj, ose mund të kthehet për shkak se kuotat e saj blihen nga një ortak i vetëm. Në pritje të koordinimit të dispozitave kombëtare mbi ligjet që kanë të bëjnë me shoqëritë, kjo direktivë synon që Shtetet Anëtare të parashikojnë disa dispozita të veçanta për rastet kur një person fizik është ortak i vetëm i një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ose kur një shoqëri e vetme ose ndonjë person tjetër juridik është ortak i vetëm i një shoqërie. Kjo Direktivë

në përmbajtjen e saj përcakton disa rregulla minimale me qëllim vendosjen e disa standarteve të përbashkëta brenda vendeve Anëtare të BE-së, pa cënuar dispozitat e tyre të brendshme. Parashikimet e kësaj Direktive, synojnë që të ofrojnë disa garanci më tepër në rastet e sh.p.k-ve me kapital privat, të cilat kanë një ortak të vetëm.

Dispozitat e saj synojnë kryesisht në publikimin e informacioneve për publikun dhe vendosjen e disa rregullave më strikte për shkak të vetë situatës së menaxhimit të shoqërisë. Në thelb, shoqëria me një ortak të vetëm është një rast në të cilin kontrolli dhe menaxhimi zotërohet nga një person fizik apo juridik, i cili mund të ndodhet dhe në situatën e abuzimit me formën e shoqërisë. Rrjedhimisht dhe rregullat që do të zbatohen në këtë drejtim duhet të jetë të mjaftueshme për të garantuar një standart minimal besueshmërie për këtë shoqëri. Fakti që të gjitha kuotat zotërohen nga një ortak i vetëm, duhet të publikohet së bashku me emrin e ortakut. Gjithashtu, vendimet e marra nga ky ortak që ushtron kompetencat e mbledhjes së përgjithshme duhet të regjistrohen me shkrim.

Disa nga kërkesat kryesore të Direktivës janë⁶⁹:

- a) Kontratat në mes ortakut të vetëm dhe shoqërisë së tij, të përfaqësuar prej tij, duhet të regjistrohen me shkrim, për aq sa këto kontrata nuk kanë të bëjnë me veprime të administrimit të zakonshëm;
- b) Masat koordinuese të përshkruara nga kjo Direktivë do të zbatohen në ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të Shteteve Anëtare;
- c) Një shoqëri mund të ketë një ortak të vetëm kur të formohet si e tillë, si dhe kur kuotat e saj transferohen në një ortak të vetëm (person fizik apo juridik);
- d) Shtetet anëtare, në pritje të bashkërendimit të ligjeve kombëtare, mund të parashikojnë dispozita të veçanta për rastet kur:
 - një person fizik është i vetmi ortak i disa shoqërive; ose
 - një shoqëri me një ortak ose çdo person tjetër juridik është i vetmi ortak i një shoqërie.
- e) Fakti që të gjitha kuotat zotërohen nga një ortak i vetëm, duhet të publikohet së bashku me emrin e ortakut;
- f) Anëtari i vetëm ushtron kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë;
- g) Vendimet e marra nga anëtari i vetëm regjistrohen në procesverbal ose përpilohen me shkrim;
- h) Kontratat ndërmjet anëtarit të vetëm dhe shoqërisë së tij të përfaqësuar prej tij regjistrohen në procesverbal ose përpilohen me shkrim;
- i) Një Shtet Anëtar nuk duhet të lejojë formimin e shoqërive me një ortak të vetëm në rast se legjislacioni i brendshëm parashikon se një sipërmarrës individual mund të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me një kapital të caktuar dhe për një aktivitet të caktuar, përveçse kur parashikohen masa mbrojtëse për të tilla shoqëri dhe masat janë ekuivalente me ato të vendosura nga kjo direktivë ose me ndonjë dispozitë të tjera të Komunitetit të aplikueshme për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me kapital privat.

Si konkluzion, është e qartë që vendosja e këtyre standarteve minimale të përbashkëta brenda komunitetit, lehtëson garancitë ndaj kreditorëve të shoqërive veçanërisht në vijim të praktikës

⁶⁹ Informacioni i përdorur në këtë seksion është një ekstrakt i dispozitave të Direktivës 2009/102/EC "Mbi shoqëritë tregtare me një ortak të vetëm"

gjyqësore mbi të drejtën e vendosjeve të shoqërive brenda vendeve anëtare. Duke qenë se tashmë shoqëritë mund të ushtrojnë aktivitetin e tyre të zakonshëm në vende të ndryshme të komunitetit, standarte të ndryshme në vende të ndryshme mund të krijonin vakuume dhe mundësi për shoqëritë që të abuzonin me formën e tyre, duke zgjedhur një vend anëtar që ofron rregulla më pak strikte në këtë drejtim.

2.2. Direktiva 89/666 /EEC 21 Dhjetor 1989 “Mbi kërkesat për publikimin e infomacioneve nga degët të disa shoqërive që janë subjekt i ligjeve të një Shteti tjetër Anëtar”

Një aspekt i rëndësishëm i funksionimit të degëve të shoqërive tregtare brenda Shteteve Anëtare, është publikimi i infomacioneve tregtare të lidhura me to. Kjo direktivë, përcakton dokumentacionin e nevojshëm që duhet të publikohet nga degët e shoqërive, të cilat janë krijuar në një nga vend anëtar të BE-së, por operojnë në një vend tjetër gjithashtu anëtar. Në lidhje me dokumentet dhe të dhënat që lidhen me një degë të hapur në një Shtet Anëtar nga një shoqëri që rregullohet nga ligji i një Shteti tjetër Anëtar do të zbatohet Direktiva 68/151/ EEC dhe të gjitha këto infomacione duhet të paraqiten në përputhje me ligjin e Shtetit Anëtar të degës. Kur kërkesat për dhënie të infomacioneve shpjeguese në lidhje me degën, ndryshojnë nga ato në lidhje me shoqërinë, kërkesat e zbulimit të degës kanë përparësi.

Ketëgortë e të dhënave të cilat janë të nevojshme të publikohen janë si më poshtë⁷⁰:

- a) Adresa e degës;
- b) Lloji i aktivitetit e degës;
- c) Regjistri në të cilin mbahet dosja e shoqërisë mëmë së bashku me numrin e regjistrimit në atë regjistr;
- d) Emrin dhe formën ligjore të shoqërisë dhe emrin e degës nëse kjo është e ndryshme nga emri i shoqërisë;
- e) Datën e krijimit, datën e prishjes (nëse është e përcaktuar)⁷¹ dhe detajet e personave, të cilët janë të autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta, qofshin këto persona fizikë apo organe të përhershme të saj;
- f) Detaje në lidhje me procedurat e likuidimit duke përfshirë këtu dhe likuiduesit, kompetencat e likuiduesve etj;
- g) Të dhëna financiare bazuar në legjislacionin përkatës të vendit ku operon dega e shoqërisë.

Shteti Anëtar, në të cilin dega është hapur, mund të sigurojë publikimin e infomacioneve si: nënshkrimin e personave themelues, instrumentet ligjore dhe memorandumet dhe statutet nëse ato përmbahen në një instrument të veçantë së bashku me ndryshimet dhe amendimet përkatëse të këtyre dokumenteve, një vërtetim nga regjistri në të cilin mbahen të dhënat e shoqërisë mëmë, një tregues të letrave me vlerë në pronësinë e shoqërisë që ndodhet në atë Shtet Anëtar, nëse një publikim i tillë lidhet me vlefshmërinë e këtyre letrave me vlerë. Në rast se infomacionet do të publikohen, Shteti Anëtar duhet t'i vendosë në dispozicion në një gjuhë zyrtare të komunitetit si dhe në kopje të certifikuara. Në rast se një shoqëri ka krijuar degë në më tepër se një vend Anëtar, regjistrimi do të bëhet në regjistrin që do të zgjedhë vetë shoqëria. Më pas, publikimi i këtyre të dhënave (së bashku me numrin e regjistrimit ku janë depozituar) do të reflektohet në regjistrat përkatës të degëve.

⁷⁰Infomacioni i përdorur në këtë seksion është një ekstrakt i dispozitave të Direktivës (89 / 666 / EEC) 21 Dhjetor 1989 “Mbi kërkesat për publikimin e infomacioneve nga degët të disa kompanive që janë subjekt i ligjeve të një Vendi tjetër Anëtar”

⁷¹ Shënim i autorit, pasi është e qartë se kjo datë do të shënohet vetëm në rast se shoqëria apo dega janë krijuar me një kohëzgjatje të përcaktuar

Një qasje e tillë kundrejt publikimit të informacionit duket e drejtë, sepse në vetvete, informacionet e listuara janë të dhëna publike, të cilat nuk çenojnë interesat e shoqërisë apo të dhëna sensitive të saj, por vetëm garantojnë transparencën e veprimtarisë ekonomike të shoqërive brenda Bashkimit, duke shmangur në këtë formë qëllimet abuzive.

2.3. Informacioni i nevojshëm për publikim në rastin e krijimit të degëve nga vendet e treta

Në rastin e shoqërive, të cilat janë krijuar në vende të treta (jashtë Bashkimit Evropian), niveli i informacionit të kërkuar për publikim është disi më i lartë në krahasim me atë të kërkuar për shoqëritë e krijuara brenda komunitetit. Ky përcaktim, duket se nuk ka aspak baza diskriminuese, por është vetëm një premisë për të garantuar që standartet e transparencës të ndjekura në vendet anëtare të zbatohet njëjloj për të gjitha degët, pavarësisht vendit të origjinës së shoqërisë mëmë. Duke qenë se legjislacioni evropian ecën kryesisht me hapa të njëjtë kur bëhet fjalë për standarde bazë (pavarësisht se legjislacionet brenda vendeve anëtare mund të ndryshojnë), duhet që ky standard të ruhet dhe për degët, të cilat shoqëritë mëmë i kanë të krijuara në vende jashtë Bashkimit.

Në lidhje me dokumentet dhe të dhënat që lidhen me një degë të hapur në një Shtet Anëtar nga një shoqëri që rregullohet nga ligji i një shteti tjetër, i cili nuk është vend anëtar, do të zbatohet Direktiva 68/151/EEC dhe të gjitha këto informacione duhet të paraqiten në përputhje me ligjin e Shtetit Anëtar të degës. Kur kërkesat për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me degën ndryshojnë nga ato në lidhje me shoqërinë, kërkesat e zbulimit të degës kanë përparësi. Për sa i përket informacionit të detyrueshëm, të dhënat që duhet të paraqiten janë: adresa e degës, lloji i aktiviteteve të degës, regjistri në të cilin mbahet dosja e shoqërisë mëmë së bashku me numrin e regjistrimit në atë regjistër, emri dhe forma ligjore e shoqërisë dhe emri i degës, nëse kjo është e ndryshme nga emri i shoqërisë, data e krijimit, data e prishjes (nëse është e përcaktuar)⁷² dhe detajet e personave, të cilët janë të autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta, qofshin këto persona fizikë apo organe të përhershme të saj, detaje në lidhje me procedurat e likuidimit, duke përfshirë këtu dhe likuiduesit, kompetencat e likuiduesve etj, të dhëna financiare bazuar në legjislacionin përkatës të vendit ku operon dega e shoqërisë.

Informacioni i rëndësishëm në rastin e degëve të krijuara është ligji i aplikueshëm mbi shoqërinë mëmë si dhe detaje të mëtejshme mbi shoqërinë mëmë siç janë: kapitali, ndarja e kapitalit dhe informacione të tjera të nevojshme në kuadër të ligjit të aplikueshëm për shoqërinë mëmë. Siç u argumentua dhe më sipër, një nevojë e tillë lind si një domosdoshmëri me qëllim zotërimin e një informacioni të plotë dhe transparent mbi veprimtarinë e shoqërisë mëmë.

Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar informacionin e detyrueshëm nga shoqëritë sipas nenit 1, të së paku dokumenteve dhe të dhënave të mëposhtme: instrumentin e statuteve nëse ato përmbahen në një instrument të veçantë, çdo ndryshim në instrumentet e përmendur në pikën (a), duke përfshirë çdo zgjatje të kohëzgjatjes së shoqërisë, pas çdo ndryshimi të instrumentit të statutit, teksti i plotë i instrumentit ose statuteve të ndryshuar deri më tani, caktimi dhe të dhënat e personave që ose si organ të formuar sipas ligjit ose si anëtarë të ndonjë organi të tillë janë të autorizuar të përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta dhe në procedurat ligjore. Duhet të jetë e qartë nëse personat e autorizuar për të përfaqësuar shoqërinë mund ta bëjnë këtë vetëm ose duhet të veprojnë bashkërisht, etj.

Të paktën një herë në vit, shumën e kapitalit të regjistruar, ku statuti përmend një kapital të autorizuar, përveç rastit kur rritja e kapitalit të nënshkruar kërkon ndryshimin e statutit. Në çdo

⁷² Shënim i autorit pasi është e qartë se kjo datë do të shënohet vetëm në rast se shoqëria apo dega janë krijuar me një kohëzgjatje të përcaktuar

Shtet Anëtar, një dosje do të hapet në një regjistër qendror, regjistrin tregtar ose regjistrin e shoqërive, për secilën prej shoqërive të regjistruara aty. Për qëllimet e këtij neni, "me mjete elektronike" nënkupton që informacioni dërgohet fillimisht dhe pranohet në destinacionin e tij me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (përfshirë kompresimin digjital) dhe ruajtjen e të dhënave dhe transmetohen tërësisht, dhe të marra në një mënyrë që do të përcaktohet nga Shtetet Anëtare me tel, radio, me mjete optike ose me mjete të tjera elektromagnetike. Të gjitha dokumentet dhe të dhënat që duhet të zbulohen në pajtim me nenin 2 mbahen në dosje, ose futen në regjistër. Lënda e shënimeve në regjistër duhet të paraqitet në dosje në çdo rast. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që dosja nga shoqëtitë, si dhe nga personat dhe organet e tjera të kërkuara për të bërë ose ndihmuar në bërjen e njoftimeve, të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të cilat duhet të zbulohen në pajtim me nenin 2, është e mundur me mjete elektronike. Përveç kësaj, Shtetet Anëtare mund të kërkojnë që të gjitha ose kategoritë e caktuara të shoqërive të paraqesin të gjitha ose llojet e caktuara të këtyre dokumenteve dhe të dhënave me anë të mjeteve elektronike.

Të gjitha dokumentet dhe të dhënat e përmendura në nenin 2 që janë paraqitur, qoftë me mjete letre ose me mjete elektronike, mbahen në dosje ose regjistrohen në formë elektronike. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha dokumentet dhe të dhënat e tilla të cilat janë dorëzuar me mjete letre konvertohen nga regjistri në formë elektronike. Dokumentet dhe të dhënat e përmendura në nenin 2 që janë paraqitur me mjete letre deri më 31 Dhjetor 2006 nuk do të kërkohej të konvertohen automatikisht në formë elektronike nga regjistri. Shtetet Anëtare megjithatë sigurojnë që ato të konvertohen në formë elektronike nga regjistri pas marrjes së një kërkesë për zbulimin me anë të mjeteve elektronike të paraqitura në përputhje me masat e miratuara për të dhënë efektin e paragrafit 4.

Një kopje e të gjithë ose ndonjë pjese të dokumenteve ose të dhënave të përmendura në Nenin 2 duhet të jetë e pranueshme për aplikim. Aplikimet mund të dorëzohen në regjistër me mjete letre ose me anë të mjeteve elektronike, siç zgjedh aplikanti. Kopjet e referuara në nënparagrafin e parë duhet të jenë të pranueshme nga regjistri me mjete letre ose me mjete elektronike, siç zgjedh aplikanti. Kjo do të zbatohet në rastin e të gjitha dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të vendosin që të gjitha ose llojet e caktuara të dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura me letër në ose para një date që nuk mund të jetë më vonë se 31 Dhjetori 2006 nuk mund të merren nga regjistri me mjete elektronike nëse një periudhë e caktuar Kalon ndërmjet datës së depozitimit dhe datës së aplikimit të paraqitur në regjistër. Periudha e tillë e specifikuar nuk mund të jetë më pak se 10 vjet.

Çmimi i marrjes së një kopje të tërë ose ndonjë pjese të dokumenteve ose të dhënave të përmendura në nenin 2, qoftë me mjete letre ose me mjete elektronike, nuk duhet të tejkalojë koston administrative të saj. Kopjet e letrave të furnizuara do të certifikohen si 'kopje të vërteta', përveç nëse aplikanti e shpërndan me një vërtetim të tillë. Kopjet elektronike të furnizuara nuk do të certifikohen si 'kopje të vërteta', përveç nëse aplikuesi kërkon një certifikatë të tillë. Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të siguruar që certifikimi i kopjeve elektronike garanton vërtetësinë e origjinës së tyre dhe integritetin e përmbajtjes së tyre, me anë të së paku një nënshkrimi të avancuar elektronik brenda kuptimit të Nenit 2 (2) të Direktivës 1999 /93/ EC (1). 5. Shpalosja e dokumenteve dhe të dhënave të përmendura në paragrafin 3 do të bëhet me botimin në gazetën kombëtare të caktuar për këtë qëllim nga Shteti Anëtar, qoftë me tekstin e plotë ose me një tekst të pjesshëm, ose me anë të një referimi në Dokument i cili është depozituar në dosje ose është futur në regjistër.

Gazeta kombëtare e caktuar për këtë qëllim mund të mbahet në formë elektronike. Shtetet Anëtare mund të vendosin të zëvendësojnë botimin në gazetën kombëtare me mjete të njëtrajtshme, e cila do të përfshijë të paktën përdorimin e një sistemi me anë të së cilit informacioni i zbuluar mund të arrihet në mënyrë kronologjike nëpërmjet një platforme elektronike qendrore. Dokumentet dhe të

dhënat mund të mbështeten nga shoqëria kundrejt palëve të treta vetëm pasi të jenë zbuluar në përputhje me paragrafin 5, përveç nëse shoqëria dëshmon se palët e treta kanë njohuri për to. Megjithatë, në lidhje me transaksionet që ndodhin para ditës së gjashtëmbëdhjetë pas zbulimit, dokumentet dhe të dhënat nuk do të mbështeten tek palët e treta që vërtetojnë se ishte e pamundur që ata të kenë pasur njohuri për to. Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të shmangur ndonjë mospërputhje midis asaj që shpалoset në përputhje me paragrafin 5 dhe asaj që del në regjistër ose dosje. Megjithatë, në rast të mospërputhjes, teksti i paraqitur në përputhje me paragrafin 5 nuk mund të mbështetet në të kundërtën ndaj palëve të treta. Palët e treta, megjithatë, mund të mbështeten në to, përveç nëse shoqëria dëshmon se ata kanë njohuri për tekstet e depozituara në dosje ose janë futur në regjistër. Palët e treta, për më tepër, gjithmonë mund të mbështeten në çdo dokument dhe hollësi në lidhje me të cilën formalitetet e zbulimit nuk janë përfunduar ende, përveç kur mos zbulimi shkakton që ato të mos kenë efekt.

Përfundimi i formaliteteve të zbulimit të të dhënave lidhur me personat të cilët, si organ i shoqërisë, janë të autorizuar për ta përfaqësuar atë, përbën pengesë për çdo parregullsi në emërimin e tyre, duke u mbështetur tek palët e treta, përveç nëse shoqëria vërteton se palët e treta kishin njohuri për këtë. Veprat e kryera nga organet e shoqërisë janë të detyrueshme për të, edhe nëse këto akte nuk janë objekt i shoqërisë, përveç nëse veprimet e tilla i tejkalojnë kompetencat që i jep ligji ose lejon t'u jepet atyre organeve. Megjithatë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që shoqëria nuk do të jetë e lidhur aty ku veprimet e tilla janë jashtë objektit të shoqërisë, nëse vërteton që pala e tretë e dinte që akti ishte jashtë këtij objekti ose nuk mund të ishte në pamundësi që rrethanat të ishin të ditura nga ana e saj. Bërja publike e statuteve nuk do të jetë dëshmi e mjaftueshme për të. Kufijtë e kompetencave të organeve të shoqërisë, që rrjedhin nga statutet ose nga një vendim i organeve kompetente, nuk mund të mbështeten kundër palëve të treta, edhe nëse ato janë zbuluar.

KAPITULLI IV

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve (Ndërmjetësimi)

Me miratimin e Ligjit Nr.10385, datë 24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i është hapur një rrugë e re zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve. Kjo perspektivë e re, merr një rëndësi të veçantë për mosmarrëveshjet me natyrë tregtare, pasi paraqet përparësi të mëdha në krahasim me zgjidhjen gjyqësore të konflikteve. Neni 2 i ligjit parashikon se “Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare” dhe nuk parashikon ndonjë rast në të cilin ndërmjetësimi

të jetë i detyrueshëm në rastin e mosmarrëveshjeve tregtare. Megjithatë, në nenin 4 parashikohet detyrimi i gjykatës për të thirrur palët në ndërmjetësimin në rastet e mëposhtme: Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës apo familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve⁷³:

- a) Në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;
- b) Në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes;
- c) Me karakter pasuror me objekt padie deri në 500 mijë lekë, si dhe për paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit.

Rasti i fundit, është qartazi i aplikueshëm në rastin e çështjeve tregtare pasi këto të fundit, duke pasur një karakter pasuror mund të përfshihen në rrethin e çështjeve për të cilat gjykata ka detyrimin të ftojë palët në ndërmjetësim. Megjithatë, në këndvështrimin tim, gjykata nuk duhet të kufizohet vetëm në rastet e shprehura në mënyrë eksplicite në ligj, kjo pasi vetë ligji përcakton se rastet që ai liston nuk janë shteruese: "... detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to...". Në këtë mënyrë, legjislatori e ka lënë të hapur mundësinë e gjykatës për të ftuar palët në ndërmjetësim. Dhe nga përmbajtja e dispozitës, është e qartë se shumica e vendosur prej 500,000 lekë, është një shumë dysheme me qëllim mos investimin e gjykatës, për çështje të cilat kanë një vlerë ekonomike të vogël dhe që mund të zgjidhen në mënyrë më të efektshme me ndërjetësim. Vlen për tu theksuar se ndërmjetësimi si proces garanton disa parime themelore të cilat e kthejnë këtë lloj zgjidhje mosmarrëveshjesh në një zgjidhje tërheqëse dhe efektive. Ndërmjetësimi bazohet në parimin e barazisë së palëve, konfidencialitetit të të dhënave, si dhe në respektimin e fleksibilitetit e të transparencës së procedurave dhe të vullnetit të palëve në proces. Ndërmjetësi, në ushtrimin e funksionit të tij, siguron zgjidhjen e çështjes me efikasitet, drejtësi dhe paanshmëri, si dhe në mënyrë profesionale e pa paragjykime ndaj palëve apo çështjes, objekt ndërmjetësimi⁷⁴. Gjithashtu, palët në procesin e ndërmjetësimit janë të lira t'i japin çështjes zgjidhjen që mendojnë më të volitshme, mjafton që zgjidhja të mos bie në kundërshtim me legjislacionin në fjalë. Ky përcaktim përbën një nga avantazhet më të mëdha të ndërmjetësimit, pasi shpeshherë, palët duke tentuar të ruajnë një marrëdhënie miqësore mes tyre, në ndërmjetësim kanë të drejtë të arrijnë në një zgjidhje e cila nuk është në përputhje me ligjin (por pa qenë në kundërshtim me të). Për shembull, nëse një konflikt ka lindur mes familjarëve, njëra palë, pavarësisht se ka një titull pronësie mbi një tokë objekt konflikti, mund të zgjedhë në ndërmjetësim që kjo tokë t'i kalojë palës tjetër. Nëse një tokë do të ishte objekt i një procesi gjyqësor, sigurisht që kjo mundësi nuk do të ekzistonte dhe prona objekt gjykimi do t'i dorëzohej pales, e cila ka titullin e pronësisë në bazë të ligjit. Ndërmjetësimi është një proces vullnetar dhe palët kanë lirinë të përcaktojnë disa aspekte të rëndësishme si: të zgjedhin ndërmjetësimin, si mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të përcaktuara në këtë ligj, të përcaktojnë kushtet, procedurën, si dhe afatet për aq sa ato janë të lejueshme, të heqin dorë, në çdo kohë, nga zgjidhja e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim. Ndërmjetësi është një palë e tretë asnjëanëse, e cila nuk ndikon dhe nuk imponon në zgjidhjen e konfliktit, por thjesht lehtëson procesin e bisedimit mes palëve me qëllim evidentimin e interesave të përbashkëta, nuk ka përgjegjësi nëse ndërmjet palëve për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësim nuk arrihet marrëveshje, ose nëse marrëveshja është arritur, por nuk zbatohet nga palët.

⁷³Neni 4 i Ligjit Nr.10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve"

⁷⁴Neni 3, i Ligjit Nr.10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve"

Një aspekt i rëndësishëm i procesit të ndërmjetësimit mbetet mbrojtja e palëve nga konflikti i interesit. Pavarësisht se, në thelb, ndërmjetësi nuk zgjidh mosmarrëveshjen, por thjesht lehtëson vijimin normal të procesit, nëse ndërmjetësi do të ishte në një situatë konflikti i interesit, kjo do të çenonte sigurisht besimin e palës tjetër në proces dhe rrjedhimisht do të ndikonte në ndërprerjen e ndërmjetësimit. Me qëllim shmangien e ketyre situatave, legjislatori ka ofruar disa garanci kundrejt palëve pjesëmarrëse në proces. Ligji parashikon se ndërmjetësi duhet të sigurojë që ndërmjet tij dhe palëve në një procedurë ndërmjetësimi nuk ekziston asnjë konflikt i interesit. Kur ka dyshime për pavarësinë dhe paanshmërinë e tij, ndërmjetësi heq dorë nga procedurat e ndërmjetësimit. Kjo zgjidhje duket e arsyeshme, pasi duke qenë se ndërmjetësimi është një proces i pavarur, nuk ekziston ndonjë autoritet i jashtëm, i cili të mund të përcaktojë situatën e konfliktit të interesit. Për rrjedhojë është më e arsyeshme që vetë ndërmjetësi të evidentojë situatat e këtij konflikti. Konsiderohet se ka konflikt i interesit kur⁷⁵:

- Ndërmjetësi ka një interes personal, të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të apo të afërmit e tij, në çështjen për të cilën kërkohet ndërmjetësimi;
- Ndërmjetësi është kujdestar apo përfaqësues i njëres prej palëve;
- Ndërmjetësi vetë, bashkëshortja ose të afërmit e tij, deri në shkallën e dytë, janë në konflikt gjyqësor, në marrëdhënie kredie ose huaje me njëren prej palëve;
- Ekziston një arsye serioze dhe e mjaftueshme që tregon një situatë konflikti i interesit.

Kur një personi i ofrohet mundësia për t'u zgjedhur si ndërmjetës, ai duhet të deklarojë, si dhe të vërë në dijeni palët për çdo rrethanë që mund të dëmtojë ose të shkaktojë dyshime për paanshmërinë dhe pavarësinë e tij në lidhje me rastin që ndërmjetësohet. Ndërmjetësi, duke filluar nga koha e caktimit në këtë detyrë dhe gjatë kohës së procedurës së ndërmjetësimit, duhet t'u deklarojë pa vonesë palëve çdo rrethanë që mund të përbëjë cenim ose dyshim në paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. Me përcaktimin "*çdo rrethanë që mund të përbëjë cenim*", ligji e le të hapur rrethin e situatave në të cilat ndërmjetësi mund të konsiderohet si në konflikt i interesit. Për rrjedhojë (edhe pse ligji nuk e parashikon shprehimisht) mund të aplikohen si konflikt i interesit të gjitha rrethanat e parashikuara në ligjin e posaçëm mbi konfliktin e interesit apo dhe çdo rrethanë tjetër që do të identifikohet rast pas rasti. Pavarësisht se ligji parashikon se duhet të jetë vetë ndërmjetësi i cili duhet të deklarojë gjenden e konfliktit, në këndvështrimin tim, nuk ka asnjë pengesë ligjore që palët të ngrenë pretendime për konfliktin e interesit apo dhe të refuzojnë pjesëmarrjen në proces në rast se kanë të dhëna për një situatë faktike apo të mundshme të konfliktit të interesit.

Me qëllim dhënien e garancive efektive në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, ligji për ndërmjetësimin parashikon në mënyrë të detajuar kushtet që duhet të plotësojnë individët për të qenë ndërmjetës, mënyrën e zhvillimit të procesit si dhe pasojat e marrëveshjes së ndërmjetësimit. Objektivi i Direktivës 2008/52/EC "Mbi disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare" me të cilën është përafëruar ligji, është të lehtësojë aksesin në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe të nxisë zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjeve, duke inkurajuar përdorimin e ndërmjetësimit dhe duke siguruar një marrëdhënie të balancuar mes ndërmjetësimit dhe procedurave gjyqësore. Kjo direktivë do të zbatohet, në mosmarrëveshjet ndërkufitare, në çështjet civile dhe tregtare, përveçse në lidhje me të drejtat dhe detyrimet që nuk janë në dispozicion të palëve në bazë të ligjit përkatës në fuqi dhe nuk aplikohet, në veçanti, në të ardhurat, doganat ose çështjet administrative ose në përgjegjësinë e shtetit për veprimet dhe mosveprimet në ushtrimin e autoritetit shtetëror (*acta iure imperii*). Sipas përcaktimeve, efektet e Direktivës nuk do të shtrihen në çdo lloj mosmarrëveshjeje, por aplikimi do të kufizohet në mosmarrëveshjet në

⁷⁵ Neni 11i Ligjit Nr.10385, datë 24.2.2011 "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve"

të cilat të paktën njëra palë ka vendbanim ose banim të zakonshëm në një Shtet Anëtar tjetër nga ai i cilit figuron pala tjetër në datën në të cilën:

- Palët bien dakord të përdorin ndërmjetësimin pas mosmarrëveshjes së lindur;
- Ndërmjetësimi urdhërohet nga një gjykatë;
- Një detyrim për të përdorur ndërmjetësimin lind sipas ligjit kombëtar.

Shtetet Anëtare do të inkurajojnë, me çdo mjet që ata i konsiderojnë të përshtatshëm, zhvillimin dhe ndjekjen e kodeve vullnetare të sjelljes nga ndërmjetësuesit dhe organizatat që ofrojnë shërbime të ndërmjetësimi, si dhe mekanizma të tjerë efektivë të kontrollit të cilësisë lidhur me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimi si dhe duhet të inkurajojnë trajnimin fillestar dhe të mëtejshëm të ndërmjetësve për të siguruar që ndërmjetësimi të kryhet në mënyrë efektive, të paanshme dhe kompetente në lidhje me palët⁷⁶.

Një nga garancitë themelore të ofruara në nivel evropian në lidhje me procesin e ndërmjetësimi është zbatimi i detyrueshëm i marrëveshjes. Gjykata, para së cilës është sjellë një veprim, mundet, kur është e përshtatshme dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit, t'i ftojë palët të përdorin ndërmjetësimin për të zgjidhur mosmarrëveshjen. Gjykata mund t'i ftojë gjithashtu palët të marrin pjesë në një sesion informimi mbi përdorimin e ndërmjetësimi nëse këto seanca mbahen dhe janë lehtësisht të disponueshme. Gjithashtu, Direktiva nuk paragjykon legjislacionin kombëtar që bën përdorimin e ndërmjetësimi të detyrueshëm ose i nënshtrohet stimujve ose sanksioneve, qoftë përpara ose pas fillimit të procedimeve gjyqësore, me kusht që legjislacioni i tillë nuk i pengon palët të ushtrojnë të drejtën e tyre për qasje në sistemin gjyqësor.

Shtetet Anëtare të BE-së, duhet të sigurojnë që marrëveshje me shkrim e arritur në procesin e ndërmjetësimi, të bëhet e zbatueshme. Përmbajtja e një marrëveshjeje të tillë do të bëhet e zbatueshme përveç rasteve kur, në rastin në fjalë, përmbajtja e kësaj marrëveshjeje është në kundërshtim me ligjin e Shtetit Anëtar ku kërkesa është bërë ose ligji i atij Shteti Anëtar nuk e parashikon zbatueshmërinë e saj. Përmbajtja e marrëveshjes mund të bëhet e zbatueshme nga një gjykatë ose një autoritet tjetër kompetent në një aktgjykim ose vendim ose në një instrument autentik në përputhje me ligjin e Shtetit Anëtar ku është bërë kërkesa. Shtetet Anëtare do të informojnë Komisionin për gjykatat ose autoritetet e tjera kompetente për të marrë kërkesat dhe asgjë në këtë nen nuk do të ndikojë në rregullat e zbatueshme për njohjen dhe zbatimin në një Shtet tjetër Anëtar të një marrëveshjeje të bërë të zbatueshme në përputhje me Direktivën⁷⁷.

1.1. Konfidencialiteti i ndërmjetësimi

Duke pasur parasysh që ndërmjetësimi ka për qëllim të ndodhë në një mënyrë që respekton konfidencialitetin, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që, përveçse kur palët bien dakord ndryshe, as ndërmjetësuesit, as ata që janë të përfshirë në administrimin e procesit të ndërmjetësimi, nuk janë të detyruar të japin dëshmi në çështje dhe procedurat gjyqësore civile dhe tregtare ose arbitrazhi lidhur me informacionin që rrjedh nga ose në lidhje me një proces ndërmjetësimi, përveç:

⁷⁶Neni 4 “Sigurimi i cilësisë së ndërmjetësimi”

⁷⁷Neni 6 “Zbatueshmëria e marrëveshjeve që rezultojnë nga ndërmjetësimi”

- a) kur kjo është e domosdoshme për zbatimin e marrëveshjeve të politikës publike të Shtetit Anëtar në fjalë, veçanërisht kur kërkohet të sigurohet mbrojtja e interesave në të mirë të fëmijëve ose për të parandaluar dëmtimin e integritetit fizik ose psikologjik të një personi; ose
- b) kur zbulimi i përmbajtjes së marrëveshjes që rezulton nga ndërmjetësimi është i nevojshëm për zbatimin ose imponimin e marrëveshjes.

Asgjë nga paragrafi 1 nuk përjashton Shtetet Anëtare nga miratimi i masave më të rrepta për të mbrojtur konfidencialitetin e ndërmjetësimit. Direktiva e ndërmjetësimit ka patur një impakt të rëndësishëm në legjislacionin e disa Shteteve Anëtare. Shtrirja e ndikimit të Direktivës mbi Shtetet Anëtare ndryshon sipas nivelit ekzistues të sistemeve të tyre kombëtare të ndërmjetësimit:

- a. 15 Shtete Anëtare tashmë kishin një sistem gjithëpërfshirës të ndërmjetësimit para se të miratohej Direktiva. Në këto Shtete Anëtare, Direktiva ka sjellë pak ose aspak ndryshime në sistemin e tyre.
- b. 9 Shtete Anëtare ose kishin shpërndarë rregullore që rregullonin ndërmjetësimin ose ndërmjetësimi në sektorin privat bazohej në vet-rregullimin. Në këto Shtete Anëtare transpozimi i Direktivës nxiti miratimin e ndryshimeve thelbësore në kuadrin ekzistues të ndërmjetësimit.
- c. 4 Shtete Anëtare adaptuan sistemin e ndërmjetësimit për herë të parë për arsye të transpozimit të Direktivës. Në këto Shtete Anëtare transpozimi i Direktivës nxiti krijimin e kornizave të përshtatshme legjislative që rregullojnë ndërmjetësimin.

Nga studimet e kryera në kuadër të transpozimit të Direktivës dhe miratimin e ndryshimeve thelbësore në kuadrin ekzistues të ndërmjetësimit ose futjen e një sistemi të ndërmjetëm gjithëpërfshirës, është bërë një hap i rëndësishëm përpara në promovimin e qasjes në zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe arritjen e një marrëdhënieje të balancuar mes ndërmjetësimit dhe procedurave gjyqësore. Megjithatë, u identifikuan vështirësi të caktuara në lidhje me funksionimin e sistemeve kombëtare të ndërmjetësimit në praktikë. Këto vështirësi lidhen kryesisht me mungesën e një "kulture" të ndërmjetësimit në Shtetet Anëtare, njohuri të pamjaftueshme se si të merren me rastet ndërkufitare, nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të ndërmjetësimit dhe funksionimin e mekanizmave të kontrollit të cilësisë për ndërmjetësuesit. Të anketuarit në konsultimet publike argumentuan se ndërmjetësimi nuk ishte ende mjaft i njohur dhe se "ndryshimi kulturor" është ende i nevojshëm për të siguruar që qytetarët të besojnë në ndërmjetësim dhe theksuan gjithashtu se gjykatësit dhe gjykatat ngurrojnë t'u referojnë palëve ndërmjetësim. Të anketuarit në konsultimet publike njohën rolin e rëndësishëm të ndërmjetësimit në veçanti në çështjet e të drejtës familjare (posaçërisht në procedurat lidhur me kujdestarinë mbi fëmijët, të drejtat e qasjes dhe rastet e rrëmbimit të fëmijëve), përveç mosmarrëveshjeve tregtare.

Studimi dhe konsultimi publik tregojnë se është shumë e vështirë të sigurohen të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse mbi ndërmjetësimin, si p.sh. numri i rasteve të ndërmjetësuar, gjatësia mesatare dhe norma e suksesit të proceseve të ndërmjetësimit, me një fokus të veçantë në ndërmjetësimin ndërkufitar. Në veçanti, nuk ka të dhëna gjithëpërfshirëse dhe të krahasueshme për të gjitha juridiksionet. Megjithatë, në konsultime shumë ndërmjetësues dhanë të dhëna në lidhje me aktivitetin e tyre, në veçanti numrin e ndërmjetësimeve të kryera, dhe - shpesh mbresëlënëse - normat e suksesit. Të tjerë thanë se normat e suksesit vareshin nga numri i palëve, lënda në fjalë dhe gjendja e individit, faktorë që ata i konsiderojnë se kanë gjithashtu një ndikim në kohëzgjatjen e procedurave. Të tjerët u ankuan për faktin se pa një bazë të dhënash të besueshme, është shumë e vështirë të bëhet rasti ndërmjetësimit dhe efektiviteti i tij për të fituar besimin e publikut. Në përgjithësi, të anketuarit duket se pajtohen se ndërmjetësimi arrin kursime të konsiderueshme të kostos në një gamë të gjerë mosmarrëveshjesh civile dhe tregtare dhe në shumë raste redukon

ndjeshëm kohën e nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Përderisa është pranuar se për shkak të natyrës "jozyrtare" të ndërmjetësimit në krahasim me procedurat gjyqësore formale, është më e vështirë të sigurohen të dhëna gjithëpërfshirëse për ndërmjetësimin, një bazë më e fortë e të dhënave do të ishte me rëndësi të madhe për të nxitur më tej përdorimin e ndërmjetësimit. Rrjeti gjyqësor evropian në çështjet civile dhe tregtare ka filluar punën për të përmirësuar mbledhjen e të dhënave kombëtare mbi aplikimin e instrumenteve të Bashkimit në çështjet civile dhe tregtare, duke përfshirë Direktivën 2008/52 /EC.

Pothuajse të gjitha shtetet anëtare kanë zgjeruar fushëveprimin të masave të tyre për transpozimin e Direktivës përtej rasteve ndërkufitare për rastet e brendshme. Vetëm 3 shtete anëtare kanë zgjedhur të transpozojnë Direktivën vetëm në rastet ndërkufitare, duke përdorur përkufizimin "ndërkufitar" të Direktivës. Shtrirja e fushëveprimit në rastet e brendshme është për t'u mirëpritur, qëkurse numri i rasteve të brendshme tejkalon atë të rasteve ndërkufitare. Rregullat e Direktivës shtrihen kështu përtej qëllimit të saj, në dobi të përdoruesve të ndërmjetësimit. Zgjerimi i rasteve të brendshme gjithashtu tregon se Shtetet Anëtare në përgjithësi kanë dashur të trajtojnë njësoj çështjet e brendshme dhe ndërkufitare. Duke marrë parasysh përmbajtjen e rregullave të Direktivës, nuk ka arsye për dallim në mes të dy llojeve të rasteve. Për më tepër, duhet të theksohet se ndërsa në praktikë, ligji i familjes duket të jetë fusha ku ndërmjetësimi përdoret në masën më të madhe, Direktiva zbatohet për të gjitha çështjet civile dhe tregtare. Një fushë ku ndërmjetësimi mbetet i pazhvilluar është ai i procedurave të falimentimit. Duhet të kujtojmë se në Rekomandimin e tij për një qasje të re ndaj dështimit të biznesit dhe paaftësisë paguese, Komisioni ka inkurajuar emërimin e ndërmjetësve nga gjykatat ku e konsiderojnë të nevojshme për të ndihmuar debitorin dhe kreditorët në drejtimin e suksesshëm të negociatave mbi një plan ristrukturimi.

1.2. Kodet e Sjelljes së ndërmjetësve

Miratimi i kodeve të sjelljes në nivel kombëtar perceptohet nga palët e interesuara si një mjet i rëndësishëm për të siguruar cilësinë e ndërmjetësimit. 19 Shtetet Anëtare kërkojnë zhvillimin dhe respektimin e kodeve të sjelljes, ndërsa në Shtetet e tjera Anëtare ofruesit e ndërmjetësimit vendosin kodet e tyre të etikës. Në disa raste, Shtetet Anëtare shkuan përtej kërkesave minimale të Direktivës, duke respektuar kodet e sjelljes të detyrueshme për ndërmjetësuesit dhe organizatat e ndërmjetësimit. *Kodi Evropian i Sjelljes për Ndërmjetësuesit* luan një rol kyç në këtë kontekst, ose sepse përdoret drejtpërdrejt nga palët e interesuara ose sepse ka frymëzuar kode kombëtare ose sektoriale. Në disa shtete anëtare, zbatimi i Kodit Evropian parashikohet me ligj, ndërsa në Shtetet e tjera Anëtare Kodi zbatohet në praktikë pa u përcaktuar me ligj. Shumica e palëve të interesuara ishin të mendimit se inkurajimi i zhvillimit dhe ndjekjes së kodeve vullnetare të sjelljes nga ndërmjetësuesit dhe organizatat që ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit të kërkuara nga Direktiva ka qenë efektive. Prandaj, duket se në lidhje me kodet e sjelljes, zbatimi i Direktivës përgjithësisht është i kënaqshëm.

Shtetet Anëtare kanë rregulla në lidhje me mekanizmat e kontrollit të cilësisë në lidhje me ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit. Shumica e shteteve anëtare kanë procedura të detyrueshme të akreditimit dhe krijojnë regjistrat për ndërmjetësuesit. Kur legjislativi nuk parashikon regjistrat ose procedurat e akreditimit, organizatat e ndërmjetësimit zakonisht i kanë krijuar ato. Tani ekziston një larmi e madhe e mekanizmave të kontrollit të cilësisë në BE. Në konsultim, një numër i madh i të anketuarve ishin në favor të zhvillimit të standardeve të cilësisë në mbarë BE-në për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, mes tyre në veçanti shumë ndërmjetës. Sidoqoftë, kishte shumë pak mbështetje nga Shtetet Anëtare.

Të anketuarit në favor të zhvillimit të standardeve të cilësisë në mbarë Evropën u ndanë midis atyre që favorizojnë standardet uniforme të BE-së që e konsiderojnë të nevojshme për të nxitur më tej marrjen e ndërmjetësimit dhe ato në favor të standardeve minimale që do të siguronin qëndrueshmëri, por që gjithashtu do të bënte të mundur marrjen parasysh të dallimeve lokale në kulturat e ndërmjetësimit. Të tjerë theksuan se standardet evropiane duhet të bazohen në standardet më të larta kombëtare ekzistuese për të shmangur që ato të bëhen produkt me emërues të përbashkët. Të anketuarit kundër zhvillimit të standardeve të cilësisë në mbarë Evropën argumentuan se standardet e tilla nuk janë të nevojshme për suksesin e ndërmjetësimit, që standardet kombëtare janë shumë të ndryshme, se zhvillimi i këtyre standardeve duhet t'i lihet Shteteve Anëtare ose që vetërregullimi në secilin treg kombëtar është i mjaftueshëm. Ata gjithashtu theksuan se Shtetet Anëtare kanë dallime domethënëse kulturore dhe ligjore në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat ndikojnë në mënyrën në të cilën palët përdorin ndërmjetësimin. Uniformiteti do të kufizonte zgjedhjen e konsumatorit dhe do të çonte në mosmarrëveshje. Për më tepër, Bashkimi Evropian duhet të promovojë dhe lehtësojë ndarjen e praktikave të mira. Duke marrë parasysh ngurrimin e Shteteve Anëtare kundrejt standardeve të cilësisë të BE-së, por gjithashtu edhe përkrahjen e rëndësishme nga palët e interesuara, një mënyrë e mëvonshme mund të konsistojë në sigurimin e fondeve të BE-së për një zhvillim të orientuar nga palët e interesit për standardet e cilësisë në BE.

Nga studimet rrjedh se ndërmjetësimi është i detyrueshëm në raste të caktuara të specifikuara në 5 shtete anëtare. Për shembull, në Itali ndërmjetësimi është i detyrueshëm në shumë dhe lloje të ndryshme mosmarrëveshjesh, në Hungari dhe Kroaci në çështje të caktuara familjare. Shumë Shtete Anëtare promovojnë përdorimin e ndërmjetësimit duke ofruar stimuj financiarë për palët. 13 Shtete Anëtare ofrojnë stimuj financiarë për ndërmjetësim nëpërmjet reduktimeve ose rimbursimit të plotë të tarifave dhe shpenzimeve të procedurave gjyqësore nëse marrëveshja arrihet përmes ndërmjetësimit gjatë procedurave gjyqësore të pezulluara. Për shembull, në Sllovaki, 30%, 50% ose 90% e taksave gjyqësore rimbursohen, në varësi të fazës së procedurës në të cilën arrihet një zgjidhje e ndërmjetësuar. Në disa shtete anëtare, vetë ndërmjetësimi ofrohet falas ose me kosto të ulët, sipas gjendjes ekonomike të palëve.

Ka edhe stimuj financiarë në formën e ndihmës juridike. Shtetet Anëtare aplikojnë rregulla të ndryshme për llojet e ndryshme të mosmarrëveshjeve ose proceseve të ndërmjetësimit. Për shembull, në Gjermani, ndihma juridike gjithmonë zbatohet për ndërmjetësimin e gjykatës, por është e kufizuar në lidhje me ndërmjetësimin jashtë gjykatës. Në Slloveni, ajo zbatohet vetëm për ndërmjetësimin e gjykatës. Në Luksemburg, ndihma juridike është në dispozicion për ndërmjetësim gjyqësor dhe ndërmjetësim familjar të kryer nga një ndërmjetës i certifikuar. Në Itali, ndihma juridike është në dispozicion për ndërmjetësim të detyrueshëm. Në këtë kontekst, duhet të theksohet se Neni 10 i Direktivës 2003/8/ EC, e shtrin të drejtën për ndihmë juridike në kontestet ndërkufitare për procedurat jashtëgjyqësore, duke përfshirë ndërmjetësimin, nëse ligji kërkon nga palët t'i përdorin ato, ose nëse palët në mosmarrëveshje janë urdhëruar nga gjykata për t'iu drejtuar atyre. Shtetet Anëtare vendosin sanksione si një mjet për të promovuar përdorimin e ndërmjetësimit. Në Hungari, ka sanksione për palët të cilat pas përfundimit të një marrëveshje ndërmjetësimi, përsëri shkojnë në gjykatë ose nuk i përmblushin detyrimet e marra sipas një marrëveshje ndërmjetësimi. Në Irlandë, sanksionet aplikohen për një refuzim të pajustificuar për të konsideruar ndërmjetësimin. Në Itali, pala e suksesshme në procedurat gjyqësore nuk mund të mbulojë shpenzimet nëse më parë ka refuzuar një propozim të ndërmjetësimit që ka të njëjtat kushte si gjykimi i gjykatës. Sanksionet ekzistojnë edhe në rastet kur ndërmjetësimi është i detyrueshëm dhe palët nuk e përdorin atë, por shkojnë në gjykatën e vendit. Në Poloni, nëse një palë e cila më parë ka pranuar ndërmjetësimin, pa arsyetim refuzon të marrë pjesë në të, gjykata mund të urdhërojë që ajo të paguajë shpenzimet e procedurës, pavarësisht nga rezultati i çështjes. Në Slloveni, gjykata mund të urdhërojë një palë që pa arsyetim

refuzon referimin e çështjes në një ndërmjetësim të bashkëngjitur në gjyq për të paguar të gjitha ose një pjesë të shpenzimeve gjyqësore të palës kundërshtare.

Pyetja nëse ndërmjetësimi duhet të jetë i detyrueshëm apo jo është e diskutueshme. Disa palë të interesit konkludojnë se mungesa e ndërmjetësimit të detyrueshëm pengon promovimin e ndërmjetësimit. Nga ana tjetër, të tjerë konsiderojnë se në varësi të llojit të ndërmjetësimit, mund të jetë vetëm vullnetar për të funksionuar siç duhet dhe se do të humbasë atraktivitetin e tij në krahasim me procedurat gjyqësore nëse ai bëhet i detyrueshëm. Është me rëndësi të rikujtojmë se ndërmjetësimi i detyrueshëm ndikon në ushtrimin e së drejtës për një zgjidhje efektive para gjykatës siç është përcaktuar në nenin 47 të Kartës së Të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Një shumicë e palëve të interesuara është në favor të një qasjeje më të detyrueshme ndaj ndërmjetësimit. Megjithatë, shumica e Shteteve Anëtare dhe akademikët janë kundër. Midis atyre që favorizojnë një qasje më të detyrueshme, një grup i të anketuarve përkrahu marrjen e ndërmjetësimit të detyrueshëm për kategori të caktuara të rasteve (si rastet komerciale, të drejtën familjare, ligjin e punësimit ose pretendimet e vogla). Në një masë më të vogël, mbështetet përkrahja e ndërmjetësimit të detyrueshëm për çdo lloj rasti. Përgjithësisht kishte pak mbështetje për sanksionimin e mungesës së përdorimit të ndërmjetësimit, megjithëse kishte disa mbështetje për imponimin e kostove për palët që e kundërshtonin ndërmjetësimin pa arsye. Inkurajimi i palëve për të përdorur ndërmjetësimin u mbështet më në përgjithësi. Shembuj të stimujve të dobishme të përmendura nga të anketuarit janë tarifata më të ulëta të gjykatave për palët që kanë provuar ndërmjetësimin para paraqitjes së kërkesës së tyre, zbritjet fiskale efektive dhe atraktive, ndërmjetësimin pa pagesë ose të paktën mbështetjen financiare të shërbimeve të ndërmjetësimit nga shteti.

Përdorimi i stimujve duket i dobishëm për të motivuar palët që të përdorin ndërmjetësimin. Kostot që lidhen me zgjidhjen e mosmarrëveshjes janë një faktor i rëndësishëm për palët kur vendosin nëse ata përpiqen të ndërmjetësojnë ose të shkojnë në gjykatë. Prandaj, stimujt financiarë që e bëjnë atë më tërheqës në aspektin ekonomik për palët që të përdorin ndërmjetësimin në vend që të drejtohen në procedurat gjyqësore, mund të konsiderohen si praktika më e mirë. Vendosja e ndërmjetësimit brenda kornizës së një procedure gjyqësore mund të konsiderohet kur palët mund - për shkak të natyrës së marrëdhënieve të tyre - të kenë arsye për mosmarrëveshje të përsëritura, si në çështje të caktuara familjare (p.sh. të drejtat e qasjes ndaj fëmijëve) ose në kontestet fqinje. Duhet theksuar se edhe në raste të tilla, duhet të respektohet e drejta e qasjes në sistemin gjyqësor, i cili garantohet me nenin 47 të Kartës së Të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Në dritën e sa më sipër, Neni 5 (2) i Direktivës mund të konsiderohet i përshtatshëm. Të gjitha Shtetet Anëtare parashikojnë zbatueshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësimit siç përshkruhet nga Direktiva. Disa Shtete Anëtare shkuan përtej kërkesave të Direktivës: Belgjika, Republika Çeke, Hungaria dhe Italia nuk kërkojnë shprehimisht pëlqimin e të gjitha palëve. Në Greqi dhe Sllovakia, një kërkesë për ekzekutueshmëri mund të bëhet nga njëra palë pa pëlqimin e qartë nga të tjerët. Sipas ligjit polak, duke nënshkruar marrëveshjen, palët japin pëlqimin e tyre të kërkojë miratimin e gjykatës për përmbarrim.

Mund të ketë përjashtime nga zbatueshmëria e përgjithshme e marrëveshjeve të ndërmjetësuar të tilla. Përjashtimet mund të jenë, për shembull, kur marrëveshja është në kundërshtim me rendin publik ose kundër interesit të fëmijëve në mosmarrëveshjet familjare. Një shumicë e palëve të interesuara i konsideron praktikatat në lidhje me zbatueshmërinë e marrëveshjeve që rezultojnë nga ndërmjetësimi si efektive. Ata argumentuan se një nevojë për zbatimin e një zgjidhjeje që lind nga ndërmjetësimi është jashtëzakonisht e rrallë. Sipas pikëpamjes së tyre, vetë natyra e ndërmjetësimit bën të mundur që duke dhënë pëlqimin e tyre, palët do të respektojnë marrëveshjen. Disa të anketuar që i konsiderojnë praktikatat si jo efektive janë të mendimit se të gjitha marrëveshjet që rezultojnë nga ndërmjetësimi duhet të jenë të zbatueshme,

pavarësisht nga vullneti i palëve. Në të vërtetë, për të siguruar efektivitetin e ndërmjetësimit, praktika më e mirë mund të konsistojë në lejimin e një pale të kërkojë ekzekutimin e marrëveshjes, edhe pa pëlqimin e shprehur të palës tjetër.

2. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me elementë të huaj

Në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me elementë të huaj në fushën e çështjeve civile dhe tregtare, Bashkimi Evropian operon bazuar në Rregulloren e Brukselit Nr.44/2001, e cila ka hyrë në fuqi më 2 Dhjetor 2000. Ajo rregullon juridiksionin si dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështjet civile dhe tregtare. Impakti i madh i saj në këto marrëdhënie është i pamohueshëm. Objektivat kryesorë të kësaj Rregulloreje janë :

- a) Themelimi i juridiksionit ndërkombëtar të Gjykatave Evropiane;
- b) Bashkëpunimi i Gjykatave në rast të transferimit të çështjeve nga një Gjykatë e Bashkimit në një tjetër;
- c) Detyrueshmëria e vendimeve të marra nga Gjykatat e mësipërme;
- d) Ndikimi në tërësinë e ligjeve të miratuara për ligjin civil dhe tregtar në Bashkimin Evropian.

Kjo rregullore lindi si pasojë e nevojës së vazhdueshme për të krijuar një bazë ligjore, e cila do të rregullonte marrëdhëniet në fushën e legjislacionit privat ndërkombëtar. Duke qënë se tregu i përbashkët dhe lëvizja e lirë ishin dy nga shtyllat kryesore të Bashkimit, u pa i nevojshëm unifikimi i legjislacionit. Aplikimi i kësaj rregulloreje nuk varet nga asnjë mekanizëm ligjor i brendshëm dhe përdorimi i saj është automatik, pa patur nevojë për thirrje nga palët, edhe në Shtetet të cilat nuk e aplikojnë këtë parim. Fusha e veprimtarisë së kësaj rregulloreje janë marrëdhëniet civile dhe ato tregtare që përfshinë shtetas, jo vetëm të dy shteteve anëtare, por edhe të një shteti anëtar dhe një shteti jo anëtar. Kjo rregullore nuk mund të zbatohet në rastin e marrëdhënieve tregtare doganore apo çështjeve administrative⁷⁸ me përjashtimin e vetëm se në disa raste të caktuara mund të zbatohet për mosmarrëveshje të lindura midis autoriteteve publike administrative dhe individëve. Përsa i përket interpretimit të saj, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian e interpreton Rregulloren në mënyrë të detyrueshme, por nuk mund të konsiderojë si të pazbatueshme disa prej rregullave të saj apo të shkojë përtej tyre duke ndikuar në ligjet kombëtare⁷⁹. Një shqyrtimi i tillë mund të kërkohej vetëm nga Gjykatat e Shteteve Anëtare. Rregullorja në vetvete përmban disa zgjidhje specifike ku përmendet :

- Përkufizimi material i “gjykimit”⁸⁰;
- Referon në ligjin e brendshëm substancial⁸¹;
- Referon në ligjin privat ndërkombëtar të një Shteti Anëtar⁸².

Qëllimi kryesor i Rregullores së Brukselit është i deklaruar që në nenet e para, ku ndër të tjerash theksohet se cilat janë ato raste specifike në të cilat një padi ligjore e ngritur përpara një Gjykate të Shteteve Anëtare, do të jetë objekt i rregullores. Kushti kryesor dhe i padiskutueshëm për të zbatuar këtë konventë është ai i vendbanimit/qendrës/selisë së paditësit dhe të paditurit,

⁷⁸E sanksionuar që në nenet e para të Rregullores të cilat flasin për Juridiksionin dhe Kompetencën

⁷⁹ Sipas vete Shprehjes së Gjykatës në një prej çështjeve të marra në shqyrtim

⁸⁰ Shih Nenin 32 të Rregullores

⁸¹ Shih Nenin 59 të Rregullores

⁸² Shih Nenin 22/2 të Rregullores

pavarësisht faktit nëse kemi të bëjmë me persona fizikë apo juridikë. Rregulli kryesor në bazë të të cilit përcaktohet koncepti “vendbanim” është ligji i brendshëm i shtetit anëtar pranë gjykatës ku paraqitet padia. Në rast se pala që ngre padinë nuk e ka vendbanimin në shtetin pranë të cilit është ngritur padia, atëherë do të aplikohet ligji i vendit në të cilin i padituri ka vendbanimin real. Në rastin e personit juridik tregtar “vendbanim” do të konsiderohet vendi i përcaktuar në Statutin e shoqërisë, në mungesë të një përcaktimi të tillë do të zgjidhet vendi ku është themeluar selia qendrore dhe në rast të pamundësisë për të identifikuar këtë qendër, si vendbanim do të konsiderohet vendi ku shoqëria ushtron pjesën më të madhe të aktivitetit tregtar.

Kjo Rregullore i njeh gjithashtu të drejtën paditësit që është rezident në një Shtet, i cili nuk e ka ratifikuar Rregulloren, të ngrejë një padi në kuadër të Rregullores përse kohë i padituri është rezident në një nga vendet e BE-së. Sidoqoftë nëse Gjykata pranë së cilës është paraqitur padia, nuk gjen arsye për të shpallur juridiksionin e saj për shqyrtimin e çështjes, mjaftohet vetëm me nxjerrjen jashtë juridiksionit të saj padinë pa u shprehur nëse kjo padi i takon një juridiksioni të një Gjykate tjetër të një shteti anëtar. Në një vështrim analitik arrijmë të evidentojmë se në disa raste taksative të përcaktuara nga vetë rregullorja në nene të ndryshme të saj, deklarohet se vendbanimi i paditësit është ai që ka rëndësi thelbësore dhe prodhon tagra ekskluzive. Ky përcaktim është i vlefshëm në rastin e marrëdhënieve të lindura me mbajtësit e policave të sigurimit, në rastin e shfaqjes së klauzolës së ndërprerjes së punës, dhe në rastet që lidhen me mosmarrëveshje të lindura nga administrimi dhe mirëmbajtja e ambjenteve të përbashkëta.

Në mënyrë të përmbledhur kjo rregullore është e aplikueshme për çështjet e mëposhtme: zotësia e personave për të vepruar, çështjet martesore, testamentit dhe trashëgimia⁸³, falimentimi, sigurimet shoqërore dhe arbitrazhi.⁸⁴

Rregullorja Bruksel I ka themeluar një sistem të njohjes së ndërsjellë të vendimeve gjyqësore. Njohja dhe ekzekutimi i këtyrë vendimeve mund të mohohet vetëm bazuar në një numër shumë të kufizuar rastesh, e shprehur kjo në nenet 34,35 të Rregullores Bruksel I. Përse i përket padive kolektive, kjo nuk është një çështje që përbën problem në zbatimin ndërkufitar. Ajo që paraqet risi është njohja e efektit prekluziv të marrëveshjes, sepse ai është i rëndësishëm në rast se një zgjidhje është miratuar nga një Gjykatë dhe i ka shtrirë efektet edhe mbi palët e dëmtuara që nuk kanë marrë pjesë në padi. Në rast se viktimat kanë kundërshtime përse i përket negociimit dhe marrëveshjes për shpërblim mund të ngrenë një padi individuale për kërkimin e një shume më të madhe shpërblimi. Kjo padi mund të ngrihet në Gjykatën e një Shteti Anëtar në rast se nuk zbatohet efekti prekluziv. Megjithatë ende nuk është paraqitur përpara GjED-së një rast i tillë që t'i lejojë Gjykatës mundësinë të shprehet mbi të.

2.1. Referimi mbi praktikën e GJED

Z.A shtetas britanik gjatë pushimeve verore në Xhamaika futet të lahet në det dhe kur lartësia e ujit i arriti mbi mes vendosi të zhytej. Në momentin e zhytjes ai përplasat me një “dunë rëre” nënujore. Nga kjo përplasje ai u paralizua tërësisht. Kështu vendosi të hedhë në Gjyq shoqërinë B me të cilën kishte rezervuar pushimet dhe resortin në të cilin qëndronte për mungesë të përgjegjësisë dhe mos vendosjen e shenjave paralajmëruese. Gjatë hetimit u zbulua se ky nuk ishte rasti i parë i këtij lloji. Bazuar në nenin 2 të Rregullores përse i përket zbatimit të saj dhe kompetencës së gjykatës, Z.A ngriti padi për shkelje të kontratës duke pretenduar se ishte shkelur

⁸³ Rregullorja Bruksel nuk shprehet specifikisht për çështjet e martesës dhe trashëgimisë. Këto gjejnë rregullim në dy Rregullore të tjera të emërtuara Bruksel II dhe IV

⁸⁴ Arbitrazhi është një nga fushat në të cilat janë bërë ndryshime në Rregulloren e re që ka hyrë në fuqi në Janar 2015

një klauzolë e kontratës, në të cilën thuhej shprehimisht se “Z.A do të kishte akses në një plazh privat, i cili do të ishte në një nivel të arsyeshëm i sigurt dhe i lirë nga rreziqet e fshehura⁸⁵.”

Kështu pas aksidentit Z.A pretendonte se këto shoqëri jo vetëm nuk kishin respektuar vënien e shenjave të rrezikut në plazh, por nuk kishin marrë masa për të trajtuar me kujdesin e duhur aksidentin e mëparshëm. Të paditurit B kundërshtuan juridiksonin e Gjykatës duke pretenduar se kjo çështje kishte lidhje më të ngushta me shtetin e Xhamaikës dhe se Gjykatat Xhamaikiane ishin forume më kompetente për trajtimin e çështjes dhe më të përshtatshme për të përmbushur interesat e të gjitha palëve të përfshira në proces. Gjykata arriti në përfundimin se kjo çështje ishte brenda juridiksionit të saj përsa kohë që njëra nga palët ishte rezidente në një vend të BE-së. Ajo e arsyetoi këtë vendim me doktrinën “*Forum non conveniens*”, e cila shpjegohet si fuqia diskrecionare që lejon Gjykatën të pushojë një çështje në rast se ajo konstaton se një Gjykatë tjetër është më e përshatshme për të gjykuar çështjen. Megjithatë, kjo doktrinë nuk e ndalon paditësin të riparaqesë padinë pranë një forumi (gjykatë, arbitrazh, ndërmjetësim) që ai e gjykon më të përshatshëm.

Në këtë kontekst përpara Gjykatës u shtruan dy pyetje:

1. A është në kundërshti me Konventën e Brukselit kur kërkuesi pretendon se juridiksioni dhe diskrecioni që i jepet Gjykatës nga neni 2 për të ushtruar diskrecion në bazë të ligjit të brendshëm, të mos pranojë të marrë parasysh pretendimet e një personi që ka vendbanimin në Shtetin anëtar në favor të një gjykate që operon në një shtet jo-kontraktues?
2. Nëse përgjigja për pyetjet (a) dhe (b) është po, a do të zbatohet në të gjitha rrethanat apo në vetëm disa prej tyre, dhe nëse vetëm në disa prej tyre, në cilat?

Për të kundërshtuar argumentin se neni 2 zbatohet për një situatë ligjore që përfshin vetëm një shtet kontraktues dhe një ose më shumë shtete jo kontraktuese, paditësit dhe Qeveria e MB në procesin kryesor cituan parimin e efektit relativ të traktatit, çka do të thotë se Konventa e Brukselit nuk mund t'i shtrijë efektet e saj mbi shtete që nuk kanë rënë dakort për ratifikimin e saj. Në këtë aspekt duhet theksuar se caktimi i gjykatës së një shteti kontraktues si gjykata që ka juridiksion në vendbanimin e të paditurit, edhe në procedime që janë pjesërisht të lidhura për shkak të subjektit të tyre ose të vendbanimit të kërkuesit me një shtet jo Kontraktues, nuk imponon një detyrim në këtë shtet.

Rregullat uniforme të juridiksionit të përcaktuara në Konventën e Brukselit nuk kanë për qëllim të aplikohen vetëm në situata në të cilat ekziston një lidhje reale dhe e mjaftueshme me punët e tregut të brendshëm të shteteve anëtare. Mjafton të vëzhgojmë konsolidimin e rregullave të konfliktit si dhe njohjen dhe detyrueshmërinë e vendimit të përcaktuar në Konventën e Brukselit në rastet e çështjeve me një element të huaj, është padyshim qëllimi për të eliminuar pengesat për funksionimin e tregut të brendshëm, të cilat mund të rrjedhin nga mungesa e harmonizimit të legjisllacionit të brendshëm me atë evropian. Gjykata u shpreh se parimi i sigurisë ligjore kërkon në veçanti se rregullat juridiksionale që devijonë nga rregullat e përgjithshme të përcaktuara nga neni 2 i Konventës së Brukselit duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që t'i mundësojë të paditurit informimin në mënyrë të arsyeshme për të parashikuar se në cilat gjykata ai mund të paditet. Mbrojtja ligjore e personave do të jetë gjithashtu e vështirë.

Së pari, një i paditur i cili është në pozitë më të mirë në momentin që padia ngrihet në gjykatën e vendit të tij, nuk do të ishte në gjendje në mënyrë të arsyeshme të parashikonte gjykatën në të cilën mund të paditet.

⁸⁵ *Owusu v Jackson* (C-281/02)

Së dyti, kur një apelim është ngritur në një gjykatë apo forum, që mund të jetë më e përshtatshme për të gjykuar çështjen, mund të ndikojë në bindjen e të paditurit se mund të mos marrë drejtësinë e merituar ose në rast se gjykata vendos të mos njohë juridiksionin e gjykatës tjetër apo se paditësi nuk ka më praktikë qasje në drejtësinë efektive para asaj gjykate pavarësisht kostos së shkaktuar nga ringritja e një padie dhe zgjatjen e afateve procedurale. Përsa i përket pyetjes së dytë, sipas urdhrin për referencë dhe observimet e të paditurve, gjykata e hodhi poshtë me pretendimin se kemi rrethana speciale prezente dhe nuk e pa të arsyeshme të jepte një përgjigje.⁸⁶

2.2. Gjykimi në mungesë i shoqërive, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve

Më 14 dhjetor 2006, Gjykata Evropiane e Drejtësisë dha një vendim paraprak për interpretimin e nenit 34 (2) i Rregullores së Këshillit (KE) Nr 44/2001 të datës 22 Dhjetor 2000 mbi juridiksionin dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në fushën e ligjit civil dhe çështje tregtare. Neni 34 (2) i Rregullores së Brukselit parashikon se gjykimi nuk mund të njihet kur është dhënë në mungesë, nëse i padituri nuk ishte njoftuar për procesin ose me një dokument tjetër të barazvlefshëm, i cili do t'i krijonte mundësinë të ndërtonte mbrojtjen e tij, përveçse kur provohet se i padituri nuk arriti të fillojë procedurat e kundërshtimit të padisë në momentin që kjo ishte e mundur⁸⁷. Në çështjen ASML (Ç-288/05) pas procesit në gjykatat gjermane, referenca është bërë në rrjedhën e procedimit mes ASML Holandë një shoqëri e themeluar në Hollandë dhe SEMIS GmbH një shoqëri e themeluar në Austri, në lidhje me vendimin e dhënë në mungesë paraqitje nga ana e një Gjykate Holandeze duke urdhëruar SEMIS t'i paguajë ASML-së shumën prej 219918.60 Euro bashkë me interesat dhe shpenzimet e procesit. Në këtë moment përpara Gjykatës së Drejtësisë lindi pyetja:

Nëse Neni 34 (2) i Rregullores duhet të interpretohet se nënkupton që kushti⁸⁸ që duhet të jetë i mundshëm brenda kuptimit të kësaj dispozite për të filluar procedurat për të kundërshtuar aktgjykimin në mungesë, në lidhje me të cilat kërkohet përmbartimi, kërkon që i padituri duhet të ishte informuar drejtpërdrejt për gjykimin apo është e mjaftueshme që ky i fundit të ishte vënë në dijeni për procesin edhe me shpallje të përgjithshme për ekzistencën e tij në fazën e procedurave të ekzekutimit në shtetin në të cilin kërkohet zbatimi.

Gjykata e Drejtësisë u përgjigj se në dritën e të gjitha konsideratave të mëparshme, përgjigjja për pyetjen duhet të jetë fakti se neni 34 (2) i Rregullores së Brukselit, duhet të interpretohet në kuptimin që është "e mundur" për një të paditur të sjellë përpara Gjykatës kundërshtimin e tij, vetëm nëse ai është njohur realisht me përmbajtjen e padisë ndaj tij dhe vetëm në rast se i është dërguar atij në një kohë të mjaftueshme për të mundësuar ndërtimin e mbrojtjes përpara gjykatës në të cilën është dhënë vendimi.

3. Dëmtshpërblimi kolektiv

Situatat e dëmtimeve masive, shumë shpesh përfshijnë një element ndërkufitar⁸⁹. Produktet, mallrat dhe shërbimet e të gjitha llojeve shpërndahen dhe ofrohen në të gjithë Evropën. Dëmtimet që vijnë nga shkelja e kontratave të konsumit ose produkteve defekte mund të bëhen çështje gjykimi për kërkim dëmtshpërblimi nga viktimat e dëmtimit të cilat banojnë në një prej Shteteve

⁸⁶ Gjykata shprehet vetëm për atë çka i kërkohet shprehimisht nga palët dhe jo mbi pyetje të cilat ajo nuk i konsideron në lidhje me procesin.

⁸⁷ Çështja C-283/05

⁸⁸ Kushti është një element që njihet edhe nga legjislati shqiptar, por GjED është përpjekur në këtë rast të japë një shpjegim të gjithë pranueshëm që ndikon në të drejtën e ngritjes së padisë.

⁸⁹ Elementi ndërkufitar është i pranishëm kur në një çështje janë të përfshirë shtetas të dy ose më shumë Shteteve të ndryshme që janë pjesë e Bashkimit Evropian.

Anëtare. Gjithashtu aksidentet në masë, siç janë ato me tren apo avion apo rastet më të rralla si ai i “Costa Concordia” në Janar të 2012 apo rastet e ndotjes së ambientit, dëmtojnë viktimat që kanë vendbanimin në një prej Shteteve Anëtare. Të tilla procedime kolektive ofrojnë mundësinë e bashkimit të një numri të madh të kërkesave që dalin nga i njëjti akt për kërkim shpërblim dëmi, por ato njëkohësisht ngrënë çështje komplekse të së drejtës ndërkombëtare private. Çfarë ndodh në të tilla raste dhe nën juridiksionin e cilës gjykatë do të ngrihet padia?

Nëse pala potencialisht përgjegjëse është banuese në një prej shteteve anëtare të BE-së, atëherë do të zbatohet Rregullorja e Brukselit 44/2001. Sistemi aktual juridiksional i Rregullores së Brukselit kërkon që Gjykata që ka në kompetencë shqyrtimin e njëres prej çështjeve, të shprehet edhe për kërkesat e tjera që do të vijnë si pasojë e pranimit të padisë kolektive. Kjo rezulton nga fakti se vendimi i gjykatës do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët, duke përfshirë edhe “paditësit në mungesë”⁹⁰. Bazuar në nenin 2 të vetë Rregullores, gjykatat në Shtetin Anëtar në të cilin i padituri ka vendbanimin, kanë juridiksion mbi çdo akt civil të ndërmarrë kundrejt tij. Megjithatë, duke marrë për bazë natyrën e marrëdhënies mes palëve, juridiksion mund të ketë edhe gjykata e vendit ku duhet të përmbushet detyrimi kontraktual⁹¹ ose gjykata e vendit ku ndodhi dëmi⁹². Gjithashtu neni 6/1 i Rregullores lejon pretenduesin të padisë disa të paditur në Shtetin Anëtar, ku vetëm njëri prej tyre ka vendbanimin, nëse pretendimet janë të lidhura ngushtë dhe ekziston rreziku i dhënies së vendimeve të papajtuësme me njëra tjetrën si rezultat i procedimeve të ndara. Sidoqoftë kjo Rregullore nuk përmban asnjë dispozitë që të përcaktojë se çfarë mund të bëhet kur disa paditës kanë ndërmend të padisin të njëjtën palë përgjegjëse.

Në mungesë të dispozitave të veçanta për paditë e përbashkëta, juridiksioni ndërkombëtar varet nga aplikimi i nenit dy (2) ose pesë (5) të Rregullores. Vetëm në disa raste taksative të ashtuquajtura raste dëmtimi të shpëputura ose të izoluara (përplasjet e trenave ose të avionëve) është neni 5/3 ai që përcakton juridiksionin e gjykatës së vendit të aksidentit për shqyrtimin e çështjes dhe dëmshpërblimin e të gjitha viktimave. Në rast se dëmtimet e viktimave kanë ndodhur në vende të ndryshme dhe kohë të ndryshme si p.sh rastet e blerjes së produkteve defekte, vetëm gjykatat e vendbanimit të të paditurit do të kenë juridiksion për shqyrtimin e kërkesave. Megjithatë mundësia për paraqitjen e një padie në emër të të gjithë personave të prekur nga ngjarja, do të varet nga disponueshmëria e instrumenteve të dëmshpërblimit kolektiv në Shtetin Anëtar ku gjykohet çështja.

4. Vështrim i përgjithshëm i Rregullores 1215/2012

Rregullorja Bruksel I e rishikuar (1215/2012) përbën një nga instrumentet më të rëndësishëm në fushën civilo-tregtare brenda komunitetit të Bashkimit Evropian. Versioni i rishikuar ka hyrë në fuqi më 10 Janar 2015 dhe aplikohet në gjykatat e të gjitha vendeve anëtare duke përfshirë dhe Mbretërinë e Bashkuar dhe Danimarkën. Rregullorja Bruksel I(44/2001), është padyshim një instrument i suksesshëm, por pavarësisht unifikimit dhe sukseseve të arritura, shpesh herë në praktikë janë vërejtur problematika në lidhje me mënyrën e implementimit. Problematika të mëdha janë shfaqur kryesisht në zbatimin e parimit të “*lis pendens*” madje dhe në vetë mënyrën e formulimit të kësaj rregulloreje apo mënyrën se si vende të ndryshme anëtare e kanë aplikuar. Bruksel I e rishikuar, sheshon problematikat që janë hasur gjatë implementimit të rregullores së mëparshme, duke lehtësuar kështu unifikimin e të drejtës në fushën civilo-tregtare dhe duke lehtësuar ekzekutimin e vendimeve të dhëna në vendet anëtare. Ndryshimet që i janë bërë kësaj rregulloreje janë kryesisht shtrirë në këto drejtime: ndryshime lidhur me parimin e “*Lis pendentis*”,

⁹⁰ Paditës në mungesë konsiderohen si paditësit që nuk janë paraqitur në gjyq për arsye objektive ashtu edhe ata që nuk janë njoftuar për gjyqin

⁹¹ Neni 5/1 i Rregullores Bruksel I

⁹² Neni 5/3 i Rregullores Bruksel I

zgjerrim i fushës së juridiksionit ekskluziv, ekzekutim i drejtpërdrejtë i vendimeve të dhëna nga një shtet anëtar, përcaktime të reja lidhur me arbitrazhin etj.

4.1. Ndryshimet lidhur me përcaktimin e juridiksionit ekskluziv

Një nga risitë që ka sjellë Rregullorja 1215/2012 është mundësia e palëve që nuk kanë vendbanim në një nga vendet anëtare, t'ia besojnë juridiksionin ekskluziv gjykatave të vendeve anëtare. Bruksel I, përcaktonte se: *"Nëse palët, një ose më shumë prej të cilave kanë vendbanim në një nga vendet anëtare, kanë rënë dakort se një gjykatë ose gjykatat e një shteti anëtar kanë juridiksion për të vendosur mbi një konflikt, i cili ka lindur ose mund të lindë në të ardhmen në lidhje me një marrëdhënie të caktuar juridike, atëherë ajo gjykatë ose ato gjykata do të kenë juridiksion. Ky juridiksion do të jetë ekskluziv, përveçse kur palët kanë parashikuar ndryshe"*⁹³ Nga kjo dispozitë dallohen qartazi dy kushtet për përcaktimin e juridiksionit ekskluziv: Të paktën një nga palët ndërgjyqëse duhet të ketë vendbanimin në një vend anëtar dhe juridiksioni duhet t'i njihet gjykatave të një vendi anëtar.

Një nga ndryshimet më thelbësore që kjo rregullore e rishikuar ka sjellë, është pikërisht aplikimi i këtij neni dhe për personat, të cilët nuk kanë vendbanim në BE. Përcaktimi i ri, ka zgjeruar në mënyrë të dukshme fushën e zbatimit të këtij neni, duke e ndryshuar si më poshtë: *"Nëse palët, pavarësisht vendbanimit, kanë rënë dakort se një ose disa gjykata të vendeve anëtare kanë juridiksion për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që kanë lindur apo mund të lindin në të ardhmen në lidhje me një marrëdhënie juridike të caktuar, ajo gjykatë ose ato gjykata do të kenë juridiksion, përveçse kur marrëveshja është nul për shkak të pylefshmërisë substanciale në bazë të ligjit të atij vendi anëtar. Ky juridiksion do të jetë ekskluziv, nëse palët nuk kanë rënë dakort ndryshe"*. (Neni 25). Nga leximi i neni 25 të Rregullores së rishikuar, duket qartë se ndryshimet që ka pësuar ky nen janë dy: Së pari, zgjerimi i rrethit të personave që mund t'i caktojnë juridiksion ekskluziv gjykatave të vendeve anëtare. Ky ndryshim duket tejet pozitiv pasi është një hap cilësor drejt zgjerimit të autonomisë së palëve në zgjedhjen e gjykatës, së cilës do t'i besohet juridiksioni ekskluziv. Së dyti, përcaktimi i këtij neni, nuk vlen nëse marrëveshja e arritur, është e pavlefshme sipas legjislacionit të vendit anëtar të cilit i përket gjykata e zgjedhur nga palët. Në dukje ky përcaktim duket i qartë dhe efektiv, por në praktikë, lind pyetja: Po në rastin e "klauzolave hibride" cila do të jetë gjykata që do të përcaktojë nëse marrëveshja është e pavlefshme apo jo? Është më se e pritshme që një problem i tillë do të ndodhë në praktikë. Kjo, pasi palët zakonisht shprehin tendencë që në marrëveshje të përdorin gjerësisht klauzolat hibride apo të quajtura ndryshe dhe "unilaterale"

4.2. Parimi i Lis Pendens

Në momentin që një çështje paraqitet para gjykatës, qëllimi primar është zgjidhja sa më e mirë dhe e shpejtë e çështjes, si dhe shmangia e gjykimeve paralele, ekzistenca e gjykimeve paralele do të çonte në një situatë kaotike për të drejtën pasi gjykata të vendeve të ndryshme, për shkak të sistemeve të ndryshme ligjore, do të konkludonin në zgjidhje të ndryshme për të njëjtën çështje. Edhe Rregullorja Bruksel I, ka sanksionuar në një dispozitë të veçantë parimin e Lis Pendens: *"Kur procese që kanë të njëjtin objekt dhe të njëjtat palë janë dërguar në gjykata të vendeve të ndryshme anëtare, çdo gjykatë, përveç asaj që është investuar e para, duhet të pezullojë gjykimin"*

⁹³Neni 23 Rregullorja 1215/2012 e parlamentit dhe këshillit e datës 12.12.12 "Mbi juridiksionin, njohjen dhe ekzekutimin në çështjet civile dhe tregtare."

me iniciativën e saj deri sa gjykata që është investuar e para të vendosë mbi juridiksionin⁹⁴. Neni i mësipërm kërkon që për zbatimin e parimit të Lis pendens të plotësohen njëkohësisht 3 kushte:

- a) Identiteti i palëve të jetë i njëjtë;
- b) Objekti i çështjeve të jetë i njëjtë;
- c) Shkaku ligjor të jetë i njëjtë (të dy çështjet të bazohen në të njëjtat fakte dhe rregullime ligjore).

Gjykata e Drejtësisë së BE ka dhënë dhe interpretim të “*shkakut të njëjtë të veprimit*” (same cause of action). Gjykata ka interpretuar në çështjen: Erich Gasser GmbH v. MISAT Srl. (Çështja Gasser) se: “*Parimi i Lis pendens do të zbatohet edhe kur gjykata që është investuar e dyta ka juridiksion mbi çështjen. Edhe nëse palët pretendojnë se shqyrtimi i çështjes në gjykatë që është investuar e para, kërkojnë shumë kohë, ky nuk do të jetë një justifikim për shmangien nga parimi. Së dyti, edhe nëse ka juridiksion ekskluziv për më shumë se një gjykatë, sërish juridiksioni i përket gjykatës e cila është investuar e para*”⁹⁵.

Në çështjen Gubicsh Mashinenfabrik KG v. Giulio Palumbo jemi para një situatë ku njëra nga palët kërkon detyrimin e palës tjetër të njohë ekzistencën e kontratës (në Gjykatën Gjermane) dhe pala tjetër kërkon shpalljen e pavlefshmërisë së kontratës (në Romë). Pyetja që lind është: A kanë këto dy çështje objekt të njëjtë dhe cila do të jetë gjykata që ka juridiksion? Gjykata në këtë çështje është shprehur se “*Që çështjet të kenë të njëjtin objekt, nuk duhet të kenë detyrimisht kërtime identike dhe gjykata kompetente do të jetë gjykata gjermane pasi është investuar e para dhe vendimi i saj do të jetë i detyrueshëm në të gjitha vendet anëtare*”⁹⁶. Lind pyetja: Po në rastin kur gjykata që është investuar e para nuk është në një vend anëtar? Pavarësisht mendimeve të ndryshme në doktrinë, mendimi më i pranuar është se parimi i “Lis pendens” do të zbatohet edhe nëse gjykata që është investuar e para për çështjen, nuk është në një nga vendet anëtare. Duke qenë se ky parim ka qënë një problematikë e dukshme e Rregullores Bruksel I, e rishikuar e ka rregulluar situatën si më poshtë: “*.....kur gjykata e cila ka juridiksion ekskluziv është investuar, çdo gjykatë tjetër e vendeve anëtare duhet ta pezullojë çështjen deri sa vetë gjykata që është investuar e para të deklarojë se nuk ka juridiksion mbi çështjen*”. Përcaktimi i mësipërm duket se do t'i japë zgjidhje problematikave të shumëta lidhur me përcaktimet që bënte rregullorja e mëparshme.

4.3. Ekzekutimi i vendimit të dhënë në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai ku kërkohet ekzekutimi

Sipas Rregullores Bruksel I, një vendim i dhënë në një nga shtetet anëtare, në mënyrë që të ekzekutohet në një shtet tjetër anëtar, duhet të deklarohet më parë i ekzekutueshëm në atë shtet. Megjithatë, Rregullorja Bruksel I e ndryshuar përcakton se vendimi i dhënë në një shtet anëtar, është i ekzekutueshëm në çdo shtet anëtar pa pasur nevojë të deklarohet i ekzekutueshëm. Pala, e cila kërkon ekzekutimin në një vend anëtar, të vendimit të dhënë në një vend tjetër anëtar, duhet të paarqesë:

- a) Kopje të vendimit të dhënë (e cila duhet të përmbush; kushtet e nevojshme për t'u cilësuar si origjinale),

⁹⁴Neni 27 i Rregullores 44/2001 datë 22 Dhjetor 2000 mbi juridiksionin , njohjen dhe ekzekutimin në çështjet civile dhe tregtare.

⁹⁵Erich Gasser GmbH v. MISAT Srl., C-116/02, 2003

⁹⁶Gubicsh Mashinenfabrik KG v. Giulio Palumbo, ECJ C-144/86

- b) Një çertifikatë lëshuar nga gjykata e origjinës. (Kjo çertifikatë konsiston në plotësimin e një formati standart, i cili gjendet në aneksin I të rregullores së ndryshuar).

4.4. Përcaktimet mbi arbitrazhin

Rregullorja Bruksel I nuk bën përcaktime të zgjeruara mbi arbitrazhin, por thjesht përcakton se arbitrazhi nuk përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje (neni 1/2/d). Pavarësisht se përcaktimi që bëhet në këtë dispozitë duket i qartë, duke qënë se nuk shpjegohet se si lënia e arbitrazhit jashtë fushës së zbatimit të Rregullores do të zbatohet në praktikë, gjykatës shpeshherë i është dashur të bëjë interpretime në lidhje me këtë nen. Problemi kryesor është se nuk ka pasur kufij të qartë ndarës mes juridiksionit të gjykatave të vendeve anëtare për të vepruar në mbështetje të arbitrazhit në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm dhe juridiksionit të tyre për të vepruar në përputhje me Bruksel I. GJED është munduar të sqarojë këto kufij në çështjen *West Tankers (Allianz SpA v West Tankers Inc (C-185/07)*, por sërisht rezultatet nuk kanë qënë të kënaqshme. Pyetja që iu bë GJED-së në këtë çështje ishte: A mundej gjykata angleze të lëshonte një urdhër për mosfillimin e çështjes në ndonjë juridiksion tjetër (në Itali) nga ana e Allianz, me arsyetimin se Allianz ka rënë dakort me West Tankers për zgjidhjen e çështjes me arbitrazh dhe duke qënë se arbitrazhi është jashtë fushës së zbatimit të Rregullores Bruksel I, gjykata angleze nuk duhej të ndalohej nga lëshimi i një urdhri të tillë?⁹⁷ GJED arriti në përfundimin se: “*Kërkimi i Allianz në Itali, ishte shpërblim dëmi nga një kontratë, i cili përfshihet në fushën e zbatimit të rregullores dhe duke qënë se dhe pyetja nëse klauzola e arbitrazhit është e vlefshme, përfshihet në këtë kërkim, atëherë gjykata Italiane mund të vendoste mbi këtë çështje dhe gjykata angleze nuk mund të nxirrte urdhër për mosfillimin e çështjes në ndonjë juridiksion tjetër*”⁹⁸. Përveç kësaj, vendimi i mësipërm i hapi rrugë shumë abuzimeve në lidhje me klauzolat e arbitrazhit. Palët filluan të paraqisnin para gjykatave pretendime që nga ana substanciale ishin nën juridiksionin e Rregullores Bruksel I, por ndërkohë përcaktonin zgjidhjen e mosmarrëveshjes me arbitrazh. Kjo u bë e mundur duke kërkuar në mënyrë abuzive shpalljen e pavlefshme të Rregullores së arbitrazhit (me pretendimin se kërkimi është nën fushën e zbatimit të rregullores, dhe meqë rregullorja nuk përfshin në fushën e zbatimit të saj arbitrazhin, klauzola e arbitrazhit do të jetë e pavlefshme) dhe pengimin e gjykatave ku duhej të zhvillohej procedura e arbitrazhit për shqyrtimin e çështjes.

Ndryshimet në lidhje me arbitrazhin kanë prekur preambulën e rregullores dhe jo ndonjë nen të saj. Megjithatë përcaktimi i ri ka shërbyer për të mënjeluar disi efektet negative të çështjes Tankers. Kjo pasi në paragrafin 3 të recitalit 12 në preambulën e Bruksel I parashikohet se :“...Nëse gjykata e një vendi anëtar, në zbatim të kësaj rregulloreje apo legjislacionit kombëtar ka vendosur se klauzola e arbitrazhit është e pavlefshme, e pamundur për t’u përmbushur, kjo nuk duhet të pengojë gjykatën për themelin e çështjes ...” dhe gjithashtu Konventa e New York –ut “ Mbi njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit “do të prevalojë mbi Rregulloren. Duke thënë këtë, do të jenë dispozitat e konventës të cilat do të përcaktojnë nëse një vendim arbitrazhi do të njihet apo jo në një nga vendet anëtare. Pavarësisht këtij përcaktimi, në praktikë nuk dihet ende se sido të veprohet pasi rregullorja sërisht nuk jep specifikime të detajuara për raportin Konventë –Rregullore. Një përcaktim i detajuar dhe i vlefshëm është ai i paragrafit të fundit të recitalit 12 i cili parashikon se kjo rregullore nuk do të aplikohet për veprimet që kanë lidhje me: gjykatën e arbitrazhit, sjelljen e arbitrave, rregullat e aplikueshme dhe as për gjykime që lidhen me anullimin, rishikimin, njohjen apo ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit. Ndryshimet që ka sjellë Rregullorja Bruksel I e rishikuar, duket se janë pozitive pasi kanë reflektuar në tekstin e ri, problematikat që janë hasur në praktikë me rregulloren e mëparshme.

⁹⁷Çështja *West TankersAllianz SpA vs West Tankers Inc (C-185/07)*

⁹⁸Çështja *West TankersAllianz SpA vs West Tankers Inc (C-185/07)*

Një hap cilësor do të konsideronim faktin se rregullorja e re zgjeron rrethin e personave që mund t'i drejtohen gjykatave të vendeve anëtare, pasi tashmë dhe persona që nuk kanë vendbanim në një shtet anëtar, mund t'ia besojnë juridiksionin ekskluziv një gjykate të një vendi anëtar. Me hyrjen në fuqi të rregullores së rishikuar, u jepet zgjidhje problematikave të shpeshta të hasura në praktikë lidhur me parimin e “Lis pendens”, pasi gjykata të cilës palët i kanë besuar juridiksionin ekskluziv, do të jetë ajo që do të prevalojë pavarësisht se cila është gjykata e cila është investuar e para. Në këtë pikë, mbetet akoma e papërcaktuar mënyra se si do të zgjidhet çështja në rastin e klauzolave asimetrike, por kjo duket se do të jetë një sfidë e mundshme për rregulloren.

Lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve është një nga hapat më domethënës që kjo rregullore ka ndërmarrë. Tashmë nuk do të jetë më e nevojshme deklarimi i një vendimi si “i ekzekutueshëm”, por mjafton që ky vendim të jetë dhënë në një shtet anëtar dhe të jetë i ekzekutueshëm në shtetin anëtar ku është dhënë. Nëse këto dy kushte plotësohen, atëherë vendimi është i ekzekutueshëm në çdo shtet tjetër anëtar. Kjo shmang një procedurë burokratike, e cila shpeshherë ka sjellë problem gjatë implementimit të Bruksel I.

Një arritje e pamohueshme mbetet sqarimi që rregullorja e rishikuar i bën çështjes së arbitrazhit. Pavarësisht se këto sqarime nuk janë inkorporuar në nene, por janë të përmendura në preambulën e rregullores, vlen të theksohet fakti se rregullorja i jep përparësi Konventës së New York-ut. Së fundmi, pavarësisht se shumë probleme të hasura gjatë implementimit të Rregullores së Bruksel I ende nuk janë inkorporuar në tekstin e rregullores së rishikuar, duket se ndryshimet që janë bërë janë ndryshime cilësore dhe që pritet të sjellin një zhvillim pozitiv në kuadrin e unifikimit të së drejtës në çështjet civile-tregtare, veçanërisht në fushat e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit, të cilat mbulohen nga kjo rregullore.

PJESA II-KAPITALI I SHOQËRIVE

KAPITULLI V

ASPEKTE TË KAPITALIT TË SHOQËRIVE

1. Koncepti i kapitalit dhe llojet e tij

Një nga komponentët kryesorë të shoqërisë tregtare pas themelimit të saj, është ekzistenca e një kapitali minimal, i cili në varësi të formës së shoqërisë, ndahet në kuota apo aksione. Koncepti i kapitalit të shoqërisë është i gjithëpranuar si shuma e përgjithshme e deklaruar në bilanc si aktiv dhe korrespondon me vlerën e kontributeve fillestare të bërë nga ortakët e shoqërisë në momentin e krijimit të saj, si dhe me asetet neto të shoqërisë të cilat janë të destinuara të përdoren për zhvillimin e aktivitetit tregtar⁹⁹. Kapitali përbën një nga garancitë kryesore të kreditorëve në marrëdhëniet kontraktore me shoqëritë dhe ideja e vendosjes së kapitalit minimal kulmoi me miratimin e Direktivës së dytë mbi kapitalin¹⁰⁰. Ekzistenca e rregullave për mbrojtjen e interesave ekonomike të kreditorëve është një zgjidhje e dmosdoshme për shkak të mungesës së tregjeve ideale në të cilat transparencja është maksimale dhe ku sjelljet oportuniste nuk janë prezente. Në kushtet e tregjeve ku ekziston mundësia e asimetrisë së informacionit, doktrina e kapitalit ligjor duhet të shikohet e ndërthurur me mekanizmat e mbrojtjes së kreditorëve. Niveli i mbrojtjes së ofruar kundrejt kreditorëve, varion nga një shtet në tjetrin megjithatë në një vështirësi të përgjithshme, shtetet e BE-së janë të orientuara më tepër drejt mbrojtjes së interesave të kreditorëve, ndërkohë që në SHBA vihet re një qasje, e cila ofron më tepër fleksibilitet për ortakët dhe aksionerët e shoqërive në krahasim me kreditorët¹⁰¹.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga shoqëria, mbajtja e kapitalit realizohet nëpërmjet shprehjes së dividendëve vetëm pasi është siguruar një fitim i mjaftueshëm si dhe kur vlera neto e aseteve të shoqërisë është në mënyrë të konsiderueshme më e lartë se kapitali ligjor¹⁰². Për më tepër, ekziston 'disiplina' e transaksioneve midis ortakëve dhe shoqërisë që mund të çojnë në një rezultat të ngjashëm, si p.sh. riblerja e aksioneve dhe dhënia e ndihmës financiare për këtë qëllim¹⁰³. Pavarësisht se kapitali ligjor në vetvete përbën një nga avantazhet kryesore të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, pasi ato përgjigjen deri në vlerën e nënshkruar të kapitalit, në doktrinën juridike ka gjithashtu teza që nxjerrin në pah mangësitë e teorisë së kapitalit ligjor. Së pari, kapitali ligjor bazohet në rregulla të detyrueshme që janë shumë të rrepta për firmën që i nënshtrohet atyre, si dhe për sa i përket mbrojtjes së kreditorëve, ajo është në një nivel të ulët në rastin e shoqërive për të cilat niveli i kapitalit minimal të kërkuar është i vogël. Nëse do t'i referohemi legjislacionit shqiptar, niveli i kërkuar i kapitalit të nevojshëm për regjistrim dhe forma e organizimit të tij, është i përcaktuar me ligj dhe ndryshon në varësi të llojit të shoqërisë tregtare. Gjithashtu kontributet e nevojshme në kapital janë subjekt ndryshimesh në varësi të formës së organizimit të shoqërisë tregtare:

⁹⁹ Miola, M, Legal Capital and Limited Liability Companies: the European Perspective ECFR 2005, 413–486

¹⁰⁰ Escher – Weingart, Reform durch Deregulierung im Kapitalgesellschaftsrecht (2001) 59

¹⁰¹ Kübler, Aktie, Unternehmensfinanzierung und Kapitalmarkt(1989) 57 et seq

¹⁰² Le capital social dans le droit américain des sociétés, in Couret-Le Nabasque (n 1) 153

¹⁰³ For a comparative cospectus of capital maintenance and distribution regimes, Rickford (n 3) 998

1.1. Shoqëria kolektive¹⁰⁴

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme, të drejta, krah pune dhe shërbime). Ortakët e shoqërisë kolektive i vlerësojnë kontributet në natyrë, duke i shprehur vlerat e tyre në para, me anë të një marrëveshjeje të ndërsjellë me njëri-tjetrin. Nëse nuk arrihet marrëveshja, secili prej ortakëve mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse për të caktuar, me një vendim detyruës, një ekspert vlerësues. Raporti i ortakëve ose i ekspertit për vlerësimin e kontributeve i dorëzohet Qendrës Kombëtare të Biyenesit së bashku me të dhënat e tjera, të kërkuara për regjistrim. Ortaku nuk është i detyruar ta rrisë vlerën e kontributit të vet mbi shumën, për të cilën është rënë dakord, ose ta shtojë atë, nëse ky kontribut është zvogëluar nga humbjet. Ortaku nuk mund ta zvogëlojë vlerën e kontributit të vet, pa miratimin e ortakëve të tjerë.¹⁰⁵

Në fund të çdo viti financiar, shoqëria përgatit pasqyrat vjetore financiare, ku përcaktohen fitimi dhe humbja, si dhe pjesa që i përket në to secilit ortak. Secili ortak ka të drejtë të përfitojë pjesë të barabartë të fitimeve dhe është i detyruar të marrë pjesë, në mënyrë të barabartë, në mbulimin e humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria. Ortaku nuk mund të heqë dorë, të transferojë apo të vendosë barrë mbi të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqëri, pa miratimin e ortakëve të tjerë. Të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqërinë kolektive, mund t'u transferohen, pa asnjë kufizim, ortakëve të tjerë.

1.2. Shoqëria komandite

Shoqëri komandite është shoqëria, në të cilën përgjegjësia e të paktën njërit prej ortakëve është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, ndërsa përgjegjësia e ortakëve të tjerë nuk është e kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i kufizuar. Ortaku, përgjegjësia e të cilit nuk është e kufizuar deri në vlerën e kontributit të tij, quhet ortak i pakufizuar. Ortaku i pakufizuar ka statusin e ortakut të shoqërisë kolektive. Ortaku i kufizuar përballon humbjet e shoqërisë deri në vlerën e pjesës së tij në kapital dhe vlerën e kontributeve ende të pashlyera.

1.3. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar¹⁰⁶

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit: a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj; b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim. Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë. Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

¹⁰⁴ Neni 25 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁰⁵ Neni 22-55, Po aty.

¹⁰⁶ Neni 68, Po aty.

1.4. Shoqëria aksionare

Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 2 000 000 lekë. Shoqëria aksionare me ofertë publike nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 10 000 000 lekë. Çdo aksion ka të njëjtën vlerë nominale. Aksionet nuk mund të emetohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Aksionet e emetuara më parë janë të pavlefshme. Themeluesit përgjigjen në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara ndaj zotëruesve të aksioneve, me emetim të parakohshëm. Të drejtat e lidhura me aksionet nuk mund të transferohen përpara regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Vlera e përgjithshme nominale e aksioneve të emetuara nuk mund të jetë më e vogël se kapitali i regjistruar i shoqërisë. Rrjedhimisht, shoqëria nuk mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim nën vlerën e tyre nominale. Shoqëria mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim më të lartë se vlera e tyre nominale.

2. Forma e organizimit të kapitalit

2.1. Aksionet¹⁰⁷

Aksionet mund të jenë të zakonshme ose aksione me përparësi. Aksionet e zakonshme u japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në asamblenë e përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfutur pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetura pas likuidimit, në raport me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet me përparësi u japin zotëruesve të tyre tagrin që nga ndarja e dividendëve të vendosur nga asambleja e përgjithshme të përfitojnë një shumë të caktuar ose një përqindje të caktuar të vlerës nominale të aksioneve të tyre, përpara shpërndarjes së fitimeve, në favor të aksionarëve të zakonshëm, përparësi në ndarjen e pasurive të shoqërisë, të mbetura pas likuidimit dhe të drejta të tjera të përcaktuara me ligj apo në statut. Shënimi në statut i përparësive, që rrjedhin nga zotërimi i këtyre aksioneve, prezumohet shterues. Aksionet, që japin të njëjtat të drejta, përbëjnë aksione të së njëjtës kategori (aksione të zakonshme, aksione me përparësi, aksione me të drejtë vote dhe aksione pa të drejtë vote).

2.2. Obligacionet

Obligacioni është një titull afatgjatë borxhi, i cili e detyron emetuesin që, në një datë të caktuar, në një ose më shumë këste, t'i paguajë titullarit të obligacionit vlerën nominale të obligacionit, si dhe interesin¹⁰⁸. Obligacionet mund të klasifikohen:

- i. Sipas mënyrës së garantimit të të drejtave: me garanci ose pa garanci.
- ii. Sipas mënyrës së ushtrimit të së drejtës mbi interesin: obligacione me kupon zero, të cilat janë obligacione me interes të pagueshëm menjëherë; b) obligacione me kupon, të cilat janë obligacione me interes të pagueshëm në këste.
- iii. Sipas interesit: obligacione të skontueshme; obligacione me normë interesi fikse; obligacione me normë interesi të ndryshueshme.
- iv. Sipas mënyrës së ushtrimit të së drejtës së marrjes së vlerës nominale: obligacione, që shlyhen me një këst; obligacione, që shlyhen me disa këste.
- v. Sipas mënyrës së ushtrimit të së drejtës së shlyerjes së vlerës nominale nga emetuesi: obligacione të shlyeshme para datës së maturimit; obligacione të pashlyeshme para datës së maturimit.
- vi. Sipas të drejtave të veçanta: obligacione me pjesëmarrje, të cilat janë obligacione që, krahas interesit, i japin titullarit të drejtën të përfitojë edhe dividend; obligacione, të cilat janë të

¹⁰⁷Neni 116-122 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁰⁸Neni 16 Ligji Nr.9879, datë 21.2.2008 "Për titujt"

konvertueshme në aksione; obligacione të konvertueshme, të cilat janë obligacione që i japin titullarit të drejtën e parablerjes së aksioneve.

2.3. Justifikimi për aplikimin e "Aksioneve të arta"

Duke pasur parasysh faktin se autorizimi paraprak përbën një kufizim të parimit të lëvizjes së lirë të kapitalit, Gjykata analizon zbatimin e parimit të proporcionalitetit në mënyrë që të përcaktojë legjitimitetin e kësaj skeme. Është përcaktuar qartë se çdo autorizim paraprak duhet të jetë në proporcion me qëllimin e ndjekur dhe analizon nëse nuk ka ndonjë masë tjetër të përshtatshme (më pak kufizuese) për arritjen e këtij qëllimi. Sipas doktrinës, në praktikën e saj GJED ka përcaktuar drejtimit mbi të cilat duhet të analizohet aplikueshmëria e 'aksioneve të arta': Këto duhet të jenë "jodiskriminuese", "jodiskrecionale" dhe "proporcionale". "Jodiskriminues" në kuptimin që ato nuk duhet të diskriminojnë në bazë të kombësisë. "Jodiskrecionale" duhet të kuptohet në mënyrë të tillë që ata duhet të jenë përcaktuar mbi bazën e kritereve të njohura publikisht. Bazuar në vendimet e GJED, "... *legjislacioni kombëtar duhet të jetë i përshtatshëm për të siguruar objektivin që ndjek... objektivi nuk mund të arrihet me masa më pak kufizuese*". Në këtë kontekst, ekzistojnë qëndrime të ndryshme në doktrinë: Disa autorë si për shembull Camara, mbajnë qëndrimin se parimi i proporcionalitetit përbëhet nga dy kërkesa kumulative siç janë përshtatshmëria dhe domosdoshmëria, ndërkohë, autorë të tjerë si Kronenberger mbajnë qëndrimin se kriteri kryesor është ekzistenca (apo mungesa) e sigurisë ligjore për operatorët ekonomikë, veçanërisht investitorët. Në përgjithësi, sipas tij dhe në bazë të konsideratave të GJED-së, koncepti i sigurisë ligjore në këtë kontekst, nënkupton objektivitetin dhe transparencën e kritereve mbi të cilat do të bazohen procedura të tilla, si edhe ekzistenca e mjeteve juridike për shoqëritë të cilat janë të ballafaquar me një refuzim.

Një nga arsyet e privatizimit të ndërmarrjeve shtetërore është përmirësimi i ekonomisë dhe krijimi i mjediseve konkurruese. Në praktikë kontrolli shtetëror është i lidhur drejtpërdrejtë me privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, mbi të cilat shteti kërkon sërish të ketë një nivel të caktuar kontrolli veçanërisht në shoqëritë të cilat ofrojnë shërbime sensitive ose me një interes të veçantë publik. Pikërisht për këtë arsye janë krijuar 'aksionet e arta' të cilat ofrojnë mundësinë e të pasurit një nivel të caktuar kontrolli në shoqëri. Gjatë viteve të fundit në Evropë ka një tendencë të lidhur me procesin e liberalizimit të tregut dhe krijimit të kushteve konkurruese. Në fakt, mund të thuhet se liberalizimi në Bashkimin Evropian ka qenë kryesisht një pasojë e pashmangshme e krijimit të tregut të brendshëm. Është e qartë që një treg i bazuar në konkurrencën dhe qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve, njerëzve dhe kapitalit është në kundërshtim me sistemet e bazuara në monopole kombëtare. Liberalizimi mund të konceptohet si një instrument i domosdoshëm për themelimin e tregut të brendshëm. Zakonisht argumentet më të përdorura për privatizimin mbi pronësinë e shtetit mbi shoqëritë private janë të lidhura me faktin se aktivitetet e sektorit publik kanë një sistem menaxhimi që nuk është efikas dhe aktiv. Në këtë aspekt këtu duket relevante opinioni i Prof. Szyszczak "(...) *Transferimi i asetëve shtetërore në sektorin privat shihet si një komponent thelbësor i Procesit të integritit evropian, duke u bërë një nga kriteret e heshtura për sukses anëtarësimi në Bashkimin Evropian*".

2.4. Praktika e GJED lidhur me "Aksionet e arta"

Vendimet e GJED-së në lidhje me "Aksionet e arta" kanë ngjallur shumë polemika mes studiuesve të së drejtës, të cilët kanë dhënë dhe mendimet e tyre mbi disa arsyetime të ndryshme. Në tre vendimet e para GJED tha: "... *shqetësime të caktuara mund të justifikojnë mbajtjen nga Shtetet Anëtare të një shkalle ndikimi në ndërmarrjet që ishin fillimisht publike dhe më pas janë privatizuar, ku këto ndërmarrje janë aktive në fushat që përfshijnë ofrimin e shërbimeve me interes publik apo shërbime strategjike*". Gjykata shqyrton se çfarë duhet të përbëjë siguri publike duke

e përkufizuar këtë të fundit "... kjo mund të mbështeten në vetëm nëse ekziston një kërcënim i vërtetë dhe mjaft serioze për një interes themelor i shoqërisë". Në çështjen Komisioni kundër Italisë (C-58/99), Gjykata arriti në përfundimin se të gjitha kompetencat e veçanta që i janë dhënë Autoritetit në fjalë ndikojnë në pengimin apo e bëjnë më pak tërheqëse ushtrimin e lirive themelore të garantuara të Traktatit të KE, përveç rasteve kur këto kufizime përmbushin katër kushtet si vijon: duhet të zbatohen në mënyrë jodiskriminuese, duhet të jetë e justifikuar për shkak të interesit të përgjithshëm, duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar realizimin e objektivit që synohet të arrihet, nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur këtë objektiv. Në çështjen në fjalë, Republika Italiane nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 43 dhe nenit 56 të EC. Qeveria italiane pranoi se ligji objekt gjykimi shkel Traktatin e KE kështu që Gjykata nuk ka nevojë për të shqyrtuar ligjin në mënyrë që të përcaktojë nëse ai ka kufizuar lëvizjet e kapitalit. Ndërkohë, në çështjen Komisioni kundër Francës (C-483/99), Gjykata arriti në përfundimin se megjithëse masat e ligjit francez kishin për qëllim për ruajtjen e furnizimeve të produkteve të naftës në rast krize (e cila konsiderohet pjesë e sferës së interesit të ligjshëm publik), natyra kufizuese e kësaj procedure autorizimi paraprak nuk ishte proporcionale me objektivin që synohej të realizohej. Gjykata deklaroi se dispozitat në fjalë do të dekurajojnë investitorët nga Shtetet e tjera Anëtare, duke shkelur edhe parimin e lirisë së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të kapitalit. Në vijim, çështja Komisioni kundër Portugalisë (C-367/98) sanksionoi se interesat financiare nuk mund të përbëjnë një arsytim të vlefshëm për kufizimet në tregun e kapitalit. Përsëri Gjykata kujton se baza ekonomike nuk mund të shërbejë si justifikim për kufizimet ndaluar nga traktati. Gjykata gjithashtu deklaroi se procedura e autorizimit paraprak për marrjen e aksioneve në disa ndërmarrje portugeze ishte në kundërshtim me nenin 73b Traktatit të KE-së.

Në çështjen Komisioni kundër Belgjikës (C-503/99), arsyetimi dhe trajtimi i ndjekur ishin plotësisht të ndryshme në krahasim me praktikën e mëparshme mbi "Aksionet e arta". Gjykata vendosi se procedura belge ishte në përputhje me lëvizjen e lirë të kapitalit pasi ajo është gjetur e justifikuar për shkak të sigurisë publike. Gjykata theksoi se masat "konsiderohen padyshim në kuadër të një interesi legjitim publik dhe skema mund të arrinte në mënyrë efektive arritjen e objektivit. Një qëndrim interesant mund të përkufizohet dhe ai i mbajtur nga GJED në çështjen C-463/00 Komisioni kundër Spanjës, në të cilën u përcaktua se sektorët bankarë dhe ato të duhanit nuk mund të përkufizohen si sektorë të cilë ofrojnë shërbime publike, ndërsa për sektorët e energjisë dhe të telekomunikacionit, Gjykata vërejtë se ato mund të përfshihen në sferën e sigurisë publike për të cilat në parim mund të justifikohen kufizimet në lëvizjen e lirë kapitalit. Për shembull ruajtja e furnizimeve në rast të krizës energjetike mund të jetë një justifikim legjitim. Në këtë rast, Gjykata hodhi poshtë sistemin e autorizimit paraprak për shkak se nuk ishte garantuar siguria ligjore dhe proporcionaliteti i masës së ndërmarrë me gjendjen e shkaktuar.

Për sa i përket pjesëmarrjes së shtetit në aksionet e shoqërive tregtare në Holandë, GJED arriti në konkluzionin në çështjen C-282/04 dhe C-283/04 Komisioni kundër Holandës se përfshirja në statut e klauzolave të cilat përcaktojnë detyrimin e shoqërive për të bërë pjesë të kapitalit disa aksione të veçanta të cilat do të zotëroheshin nga shteti, përbënte një cënim të Nenit 56 të Traktatit. Këto të drejta të veçanta janë të miratojnë vendime të caktuara menaxhimin e organet e atyre shoqërive, të cilat nuk janë të kufizuara në rastet kur ndërhyrja e shtetit është e nevojshme për arsye thelbësore në interes të përgjithshëm të njohur nga Gjykata. GJED vendosi se pjesa e 'aksioneve të arta' mbajtur nga shteti nuk i plotësonte kërkesat e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.

Në vijim GJED, në çështjen C-174/04 Komisioni kundër Italisë ka marrë në shqyrtim një ligj Italian, i cili nuk garantonte të drejta të veçanta për shtetin në shoqëritë të cilat ishin privatizuar, por përkundrazi, kishte synuar të kufizonte ndërhyrjen e shtetit të këto të fundit. Gjykata konstatoi se meqenëse qëllimi i dekretit në fjalë është të shmangë "sulmet anti-konkurruese nga subjektet

publike që vepronë në të njëjtin sektor në shtetet anëtare", ajo ka efektin e kufizimit të ndërmarrjeve publike të themeluara në shtetet e tjera anëtare në blerjen e aksioneve në ndërmarrjet italiane që vepronë në sektorin e energjisë.

Një nga aspektet më të rëndësishme të analizës së aksioneve të arta është përfshirja e detyrueshme e shtetit në kapitalin e shoqërisë duke u bërë mbajtës i aksioneve si dhe pjesëmarrja në vendime të administrimit të shoqërisë. Në çështjen Komisioni kundër Gjermanisë C-112/05, qeveria federale dhe Saksonia e Ulët mbajtën 20% të aksioneve të shoqërisë Volkswagen si dhe ruajtën të drejtën e emërimit të dy anëtarëve të bordit këshillues. Përveç kësaj, të drejtat e votës të një personi të vetëm nuk mund të kalonin 2% të kapitalit dhe vendimet duhet të merren me të paktën 80% të votave totale. Shteti Gjerman argumentoi se struktura e qeverisjes së Volkswagen nuk është një masë kombëtare, por një rezultat i një marrëveshjeje mes sindikatave, punëtorëve, dhe qeverisë ku sindikatat dhe punëtorët hoqën dorë nga një nivel i caktuar kontrolli, në mënyrë që të parandalonin mundësinë që ndonjë aksionar i madh të mund të fitonte kontrollin e shoqërisë. Gjykata deklaroi se kjo është në interes të shtetit më tepër se aksionerëve në përgjithësi dhe se dispozita që lejonte emërimin e anëtarëve të bordit në këto rrethana mund të pengonte investimet dhe ishte në shkelje të Nenit 56 KE Traktatit. Shteti Gjerman argumentoi se dispozita ishte e justifikuar për shkak të interesit të përgjithshëm i cili në këtë rast ishte mbrojtja e punëtorëve. Në përfundim, Gjykata arriti në përfundimin se ky kufizim nuk ishte proporcional.

Gjithashtu praktika gjyqësore në çështjen C-274/06 Komisioni kundër Spanjës, ka mbajtur qëndrimin se kur një njësi ekonomike të kontrolluar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga një autoritet publik merr kontrollin ose fiton një pjesë të rëndësishme të aksioneve në një ndërmarrje në sektorin e energjisë, Këshilli i Ministrave mundet që brenda një periudhe prej dy muajsh të vendosë "mosnjohjen", ose të vendosë në kushte të caktuara, ushtrimin të drejtave përkatëse që lidhen me administrimin e shoqërisë. Ky qëndrim pavarësisht se u konsiderua i justifikuar, ishte në fakt joproporcional.

2.5. Proporcionaliteti midis pronësisë mbi aksionet dhe kontrollit

Lidhur me procesin e privatizimit dhe rolin e shtetit në këtë proces, disa autorë argumentojnë se përdorimi i "aksioneve të arta" mund të bëjë ndërmarrjet e privatizuara të duken ndryshe, duke krijuar marrëdhënie të veçanta (pas privatizimit) me shtetin duke u kthyer në "shoqëri hibride" që përdorin ligjin e shoqërive tregtare private për qëllime publike. Në situatën e "ndërmarrjeve hibride" ekzistenca e tregut konkurrues është pothuajse e pamundur për shkak të ndërhyrjes së shtetit.

Në përgjithësi privatizimi ndikon në rritjen e nivelit të llogaridhënies së shoqërisë për shkak se ajo mundëson pronarët-aksionarët për të vënë para përgjegjësisë personat të cilët menaxhojnë kapitalin në emër të tyre. Zakonisht llogaridhënia mund të arrihet nëpërmjet monitorimit të performancës së menaxhimit dhe rritjen e stimuljeve për menaxhimin më efektiv. Duke marrë parasysh këto fakte, këtu vlen të përmendet teoria bashkëkohore e shoqërive tregtare, e cila parashikon se shoqëritë në fakt kanë si qëllim realizimin e administrimit të shoqërive larg ndërhyrjes shtetërore. Është shumica e aksionerëve, të cilët marrin vendime bazuar në kuorimet dhe shumicën e nevojshme si dhe mbajnë rrezikun e kostos për monitorimin e politikës së menaxhimit. Aplikimi i "aksioneve të arta" duhet të shihet më tepër si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, i cili aplikohet vetëm në raste të veçanta kur kërkohet mbrojtja e një interesi të veçantë. Në përgjithësi, situata të gjitha të ngjashme, të cilat mund të pengojnë pavarur drejtimin e shoqërisë dhe për këtë arsye përdorimi i "aksioneve të arta" duhet të jetë i kufizuar në një mënyrë që i lejon shoqëritë e privatizuara për të vepruar dhe për të kontrolluar në mënyrë të pavarur. Për më tepër është e rëndësishme që shoqëria të mos jetë e kushtëzuar nga kufizimi i Shtetit për çështje të cilat nuk janë të lidhura me sigurinë publike dhe nuk janë konsideruar të jetë rrezik për

ekzistencën dhe zhvillimin e politikës ekonomike kombëtare. Për më tepër, emetimi i këtyre aksioneve duhet të përcaktohet qartazi në ligj.

Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nuk parashikon shprehimisht ekzistencën e aksioneve të arta dhe nuk përfshin situata në të cilat lind si detyrueshmëri pjesëmarrja e shtetit me kuota apo aksione në shoqëritë tregtare. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni. Ky ligj parashikon emetimin e aksioneve të një lloji të veçantë “Aksione me përparësi” megjithatë këto lloj aksionesh nuk mund të barazohen me “aksionet e arta”, pasi aksionet me përparësi emetohen me qëllim mënjanimin nga e drejta e votës dhe pjesëmarrja vetëm në fitimin e shoqërisë, ndërkohë e kundërta ndodh me ‘aksionet e arta’ të cilat emetohen me qëllim rritjen e nivelit të kontrollit në shoqëri nga ana e shtetit. Sipas legjislacioni shqiptar, aksionet me përparësi mund të emetohen pa të drejta vote. Në këtë rast, aksionet me përparësi nuk mund të përfaqësojnë më shumë se 49 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë. Gjithashtu ndalohet emetimi i aksioneve, të cilat i japin zotëruesit të tyre më shumë të drejta vote, në raport me pjesën e kapitalit, që aksioni përfaqëson. Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

3. Kalimi i kuotave¹⁰⁹

Kuota e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar mund të zotërohet nga një ose më shumë persona. Në rastin kur një kuotë e kapitalit të shoqërisë zotërohet nga më shumë se një person, në marrëdhënie me shoqërinë këta persona trajtohen si një ortak dhe të drejtat e tyre ushtrohen, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Këta persona përgjigjen personalisht dhe në mënyrë solidare për detyrimet që lindin nga zotërimi i kuotës. Personat që zotërojnë një kuotë të kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga kjo kuotë. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo. Veprimet e shoqërisë ndaj kuotës së zotëruar nga më shumë se një person krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të saj edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve. Shoqëria tregtare mund të lëshojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë lëshohet në emër të personit apo të personave, që zotërojnë kuotën dhe nuk përbën letër me vlerë. Nëse personat që zotërojnë një kuotë nuk arrijnë një marrëveshje, sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë zbatohen dispozitat e Kodit Civil për bashkëpronësinë.

Kuotat, si send në pronësi të mbajtësve të tyre, mund të transferohen nga një ortak në tjetrin, siç qarkullohen sendet e tjera në qarkullim civil, sigurisht duke ndjekur procedurat e parashikuara në shoqëritë tregtare dhe duke aplikuar rregullat e Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile për sa kohë ato janë të aplikueshëm. Së pari, ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ka sanksionuar mënyrat e fitimit të kuotave: *“Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj”*¹¹⁰. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Duke marrë në konsideratë dhe përcaktimet e Kodit Civil mbi veprimet juridike, kontrata për kalimin e kuotave duhet të përbushë disa kushte kumulative: të kryhet nga një person me zotësi juridike për të vepruar, të jetë kryer me vullnet të lirë dhe të pavesuar, si dhe të kryhet në formë të shkruar. Veprimi në fjalë nuk duhet të vijë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; të kryhen për të mashtruar ligjin apo të bëhet në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar) pasi në një rast të tillë, veprimi do të konsiderohej i pavlefshëm.

¹⁰⁹ Neni 72 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

¹¹⁰ Neni 73i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit sipas përcaktimeve të kërkuara në ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ dhe nuk përbën në vetvete mënyrën e fitimit të pronësisë mbi kuotën, por vetëm një garanci ndaj të tretëve. Për rrjedhojë dhe përgjegjësia e njohur nga legjislatori në rast mosregjistrimi të kuotës është solidare me qëllim mbrojtjen e interesave të kreditorëve dhe të tretëve.

Pala paditëse ka kërkuar pavlefshmërinë e veprimit juridik-shitjes së kuotave të kapitalit themeltar të zotëruara prej tij në këtë shoqëri në masën 33,3%, me pretendimin se ka qenë i mashtruar nga ortakët e tjerë të shoqërisë (pala blerëse në kontratë) në kryerjen e këtij veprimi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 537 datë 01.02.2007 ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me argumentet e mëposhtme : “Pala paditëse pretendon se:ka qenë i mashtruar duke iu referuar “mashtrimin të bërë nga të paditurit, në mirëbesimin e tij dhe në kushtet e vështira që ishin prezent në zyrën e noteres”. Në veprimin juridik të shitjes, ...asnjëra prej palëve në këtë gjykim nuk kontestoi firmën e saj në këtë akt noterial të datës 01.02.2005; nuk u kontestua as paraqitja pranë noteres e palëve kontraktuese; Pala paditëse, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në momentin e nënshkrimit...i kishte të gjitha mundësitë (duhej dhe mund) që me një përkujdesje të zakonshme të njihej plotësisht me përmbajtjen e tyre dhe me atë çfarë ai po nënshkruante; Kontrata e shitjes së kuotave është një akt noterial, i kërkuar si i tillë nga ligji me qëllim hartimin-përpilimin nga ana e noterit, gjë që do të thotë një respektim më i plotë i ligjit në hartimin e këtij akti dhe një siguri më e madhe për personat pjesëmarrës në të. Sa më lart bën tërësisht të pabazueshëm pretendimin e palës paditëse mbi mashtrimin e bërë atij në lidhje me nënshkrimin e akteve në “kushtet e vështira që ishin prezent në zyrën e noteres”.

Një pretendim tjetër i ngritur gjatë këtij gjykimi ka qenë se midis ortakëve të shoqërisë është mbajtur vetëm një mbledhje, ajo e datës 31.01.2005 në të cilën nuk është diskutuar për transferim kuotash të tij dhe në lidhje me këtë pretendim pala paditëse nuk arriti të provonte se cila është gënjeshtra e përdorur nga palët e paditura kundrejt tij në respektim të nenit 95 të K.Civil. Mbajtja e mbledhjes së ortakëve të datës 31.01.2005, nuk mundet në vetvete të mohojë mbajtjen e mbledhjes së asamblesë së datës 01.02.2005 ... Pra kemi të bëjmë me dy akte të nënshkruara nga paditësi, madhor me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, të cilat reflektojnë qartë vullnetin e tij për transferimin e kuotave që zotëron në Shoqërinë “D Energji” shpk. Duke iu referuar proces-verbalit të mbledhjes së datës 31.01.2005-i paraqitur si provë nga pala paditëse - vihet re se ai nuk është i nënshkruar as nga administratori dhe as nga ortaku tjetër edhe pse ky i fundit nuk rezulton që të ketë qenë kundër. Në përfundim gjykata ... çmon se kërkesëpadia e paraqitur pranë saj në mbështetje të nenit 94/ç dhe 95 të K.Civil nuk është e drejtë dhe e bazuar në prova”.

Gjykata e Apelit ka mbajtur të njëjtin qëndrim duke arsyetuar se ndër të tjera se: “Qëndrimi mbajtur nga gjykata, që i ka rrëzuar padinë paditësit ... është i drejtë pasi është i bazuar në ligj ...Tjetërsimet e kuotave të kapitalit, paditësi... i ka bërë në përshtatje të plotë me Ligjet nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” si dhe Ligjin nr.7667, datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar”. Vendimet e asamblesë... dhe kontrata noteriale ... janë akte zyrtar me fuqi të plotë provuese”. Dispozitat e Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Ligjit nr.7667 datë 28.01.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhet respektuar nga shoqëritë tregtare”, në të cilat është parashikuar modalitetet

e nevojshme për çështjet që lidhen me veprimet juridike dhe transferimin e kuotave si një lloj i veçantë veprimi juridik¹¹¹.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se shkaqet e paraqitura në rekursin e paditësit, me anë të të cilit ka kërkuar prishjen e dy vendimeve, nuk janë nga ato që parashikohen në nenin 472 të K.Pr.Civile. Gjykata e shkallës së parë pasi ka administruar në përputhje me dispozitat procedurale e vlerësuar provat e marra në shqyrtim, ka arritur në përfundimin se: "... në kushtet kur asnjëra nga palët në gjykim nuk kontestoi firmën e saj në aktin noterial të datës 01.02.2005, nuk u kontestua as paraqitja pranë noteres e palëve kontraktuese, -pala paditëse, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, në momentin e nënshkrimit të akteve (vendimit të asamblesë së datës 01.02.2005, i marrë në respektim të kërkesave të ligjit tregtar dhe kontratës objekt gjykimi), i kishte të gjitha mundësitë që me një përkujdesje të zakonshme të njihej plotësisht me përmbajtjen e tyre dhe me atë çfarë ai po nënshkruante.....Pala paditëse nuk arriti të provonte se cila ishte gënjeshtra e përdorura nga palët e paditura kundrejt tij në respektim të nenit 95 të K.Civil".

Gjykatat e faktit kanë ardhur në një përfundim logjik edhe për arsyen se i padituri Emro Dosku, i cili fillimisht ka qenë ortak në Shoqërinë "Dardania Energji" sh.p.k., së bashku me paditësin Agim dhe të paditurin Kujtim Kolgjini, me nga 33,3% secili të kapitalit themeltar, ka tjetërsuar te ortaku tjetër (i padituri Kujtim Kolgjini), pas mbledhjes së asamblesë së datës 25.02.2005, 50% të kuotave që i përkisnin atij (E.Doskut), vlerë kuotash që ky i paditur i kishte arritur, pas blerjes së ½ së kuotave nga paditësi Agim Lika. Kështu nëpërmjet këtij arsyetimi të drejtë të gjykatave të faktit, bie poshtë deklarimi i të paditurit E.D se nuk dinte gjë se në mbledhjen e asamblesë datë 01.02.2005 ishte diskutuar e vendosur shitja e kuotave nga paditësi, në një kohë kur vetë i padituri kishte përfituar ½ e kuotave të shitura nga paditësi. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vlerësim të pretendimeve e shkaqeve të ngritura në rekursin e paditësit, çmon se shkaqet e ngritura nuk qëndrojnë dhe nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 472 të K.Pr.Civile.

3.1. Kalimi i aksioneve

Për sa i përket kategorive të mënyrave të fitimit të pronësisë mbi aksionet, mund të evidentohet mënyra origjinale e fitimit të aksioneve (krijimi i tyre) që ndodh në momentin fillestar të krijimit të shoqërisë apo në rastet e zgjerimit të kapitalit, si dhe mënyrat klasike derivate: shitblerje, trashëgimi, dhurim si dhe çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj. Aksionet e të drejtat e fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi të jetë regjistruar në regjistrin e posaçëm të aksioneve, që mban shoqëria. Kjo garanci vlen për të njëjtën arsye siç u përmend në rastin e kalimit të kuotave (efekt deklarativ). Akti i emetimit të aksioneve hartohet në çastin e emetimit fillestar të aksioneve dhe përmban të dhënat e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Në rastin e ofertës private apo publike të aksioneve, akti i emetimit të aksioneve duhet të ndjekë, gjithashtu, procedurat e përcaktuara në ligjin për titujt. Shoqëria lëshon certifikatën e aksionit me shpenzimet e aksionarit që e kërkon atë si dhe vendimi për lëshimin e certifikatës merret nga themeluesit apo

¹¹¹Neni 94 i Kodit Civil "Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga:

- a) të miturit mbi katëmbëdhjetë vjeç, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit;
- b) personat, të cilët për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit;
- c) personat, të cilët në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar;
- ç) personi që ka kryer veprimin juridik duke qenë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe.

nga asambleja¹¹². Shoqëritë aksionare mbajnë një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesve të aksioneve të shoqërisë, si: emri e mbiemri i aksionarit, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e aksionit, adresa e banimit apo zyra qendrore e aksionarit dhe data e kryerjes së regjistrimit¹¹³. Parregullsia në mbajtjen e regjistrit të aksioneve përbën elementë të veprave penale të parashikuara në seksionet IV, VII e VIII të kreut III të pjesës së posaçme të Kodit Penal.

Çështja e transferimit të aksioneve përbën një rëndësi të veçantë në shoqëritë tregtare për shkak të mundësisë së ndryshimit të përqindjes në pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë dhe rrjedhimisht ndryshimit të balancave në kontrollin e shoqërisë. Për këtë arsye, legjislatori ka parashikuar se Statuti mund të parashikojë që kalimi i aksioneve të kushtëzohet nga pëlqimi i organeve drejtuese të shoqërisë dhe/ose nga e drejta e parablerjes, në favor të aksionarëve të tjerë. Pavarësisht se ligji nuk e njeh shprehimisht këtë të drejtë, në formën e një dispozite lejuese u njeh mundësinë aksionarëve të shoqërisë të kontrollojnë lëvizjen dhe transferimin e aksioneve. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i zotërimit të aksioneve është zotërimi nga më shumë se një aksionar. Personat që zotërojnë në mënyrë të përbashkët një aksion, në marrëdhënie me shoqërinë, ushtrojnë të drejtat e aksionarit, nëpërmjet një përfaqësuesi të përbashkët. Personat që zotërojnë një aksion në mënyrë të përbashkët, përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet, që rrjedhin nga zotërimi i aksionit. Situata është e ngjashme me rastin e bashkëpronësisë. Gjithashtu mendoj se vlen të përmendet dhe aplikimi i të drejtës së parablerjes për bashkë-aksionarin në këtë rast. Një qasje e tillë do të ishte me vlerë të përfshihej në statutin e shoqërisë duke marrë në konsideratë se ky qëndrim është në përputhje të plotë dhe me dispozitat e Kodit Civil, i cili i njeh të drejtën e parablerjes bashkëpronarit. Praktika gjyqësore ka sanksionuar gjithashtu dhe natyrën e kësaj të drejte duke parashikuar se sipas nenit 761/1 të Kodit Civil, *“Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale, të cilat ajo i pranon”*. Atëherë, për rrjedhojë, shtrohet pyetja nëse e drejta e parablerjes konsiderohet një e drejte reale. Duhet të kemi parasysh se e drejta e parablerjes mund të krijohet me ligj ose me kontratë. E drejta e parablerjes e trashëgimtares së ish-pronarit për objektet mbi truallin e ish-pronarit (trashëgimlënësit të saj) është një e drejte parablerje ligjore. Në këtë rast e drejta e parablerjes e njohur nga ligji mund t’u kundrejtohet të tretëve dhe titullari i saj mund t’ia kërkojë sendin çdo të tretë që e ka fituar atë. Për këtë arsye, parablerja ligjore konsiderohet si e drejte reale (që ndjek sendin), ndërsa e drejta e parablerjes e krijuar me kontratë ka vetëm efekte detyrimi¹¹⁴.

Personat që zotërojnë një aksion, merren vesh ndërmjet tyre për ndarjen e të drejtave e të detyrimeve, që rrjedhin nga ky aksion. Këto të drejta e detyrime mund të ndahen në mënyrë të barabartë ose jo dhe veprimet e shoqërisë ndaj aksionit të zotëruar nga më shumë persona krijojnë pasoja ndaj të gjithë zotëruesve të tij, edhe nëse veprimi i shoqërisë i drejtohet vetëm njërit prej zotëruesve.

4. Lëvizja e lirë e kapitalit në BE

Një nga katër liritë themelore brenda tregut të përbashkët evropian, është lëvizja e lirë e kapitalit. Edhe pse Traktati nuk e përkufizon shprehimisht termin ‘lëvizje të kapitalit’, termi është përkufizuar në praktikën gjyqësore mbi Direktivën 88/361 (C-222/97 Trummer and Mayer¹¹⁵), e cila së bashku me të dhënat e paraqitura në Aneksin e saj, mund të përdoret për të përkufizuar

¹¹² Neni 118i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

¹¹³ Neni 119i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

¹¹⁴ Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 17 i Regj.Themeltar, Nr. 23 i Vendimit datë 01.04.2002

¹¹⁵ C-222/97 Trummer and Mayer [1999] ECR I-1661, paragrafi 20 dhe 21.

nocionin e lëvizjes së kapitalit¹¹⁶. Në këtë vendim, GJED analizon se likujtimi i një investimi në pasuri të paluajtshme (Pika II e Aneksit të Direktivës) si dhe garancitë apo të drejtat e pengut (Pika IX e Aneksit të Direktivës) përbëjnë lëvizje kapitali. Megjithatë, lista e parashikuar në Aneksin e Direktivës, nuk mund të konsiderohet shteruese. Ndërkohë, është e qartë nga Traktati se transferimi fizik i asetëve nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 30 dhe 59, por përfshihen në fushën e veprimit të nenit 67¹¹⁷.

Lëvizja e kapitalit përfshin në fushën e veprimit dhe investimin direkt në formën e pjesëmarrjes në një shoqëri nëpërmjet zotërimit të aksioneve, qoftë duke marrë pjesë në menaxhimin dhe kontrollin e shoqërisë (investim direkt) apo për qëllime investimi pa pasur për qëllim pjesëmarrjen në aspekte të menaxhimit apo kontrollit të shoqërisë (investime në portofol)¹¹⁸. Aneksi i Direktivës si dhe shënimet sqaruese mbi të, parashikojnë se dhe investimi direkt, në formën e pjesëmarrjes në një shoqëri nëpërmjet blerjes së letrave me vlerë, përbën lëvizje të kapitalit. Ky qëndrim, u konfirmua dhe nga GJED në çështjen C-367/98 - *Commission v Portugal*¹¹⁹, paragrafi 38. Edhe pse neni 56 nuk e përkufizon termin “lëvizje e kapitalit”, investimet direkte ndërkufitare përfshihen gjithashtu brenda këtij koncepti. Kjo karakterizohet veçanërisht nga mundësia për të marrë pjesë efektivisht në menaxhimin dhe kontrollin e një shoqërie. Blerja e pronave (holdings) si dhe ushtrimi i të drejtës së votës që lidhet me këto prona, konsiderohen gjithashtu ‘lëvizje kapitali’¹²⁰. Blerja e letrave me vlerë, nënkupton gjithashtu një formë të lëvizjes së kapitalit¹²¹ dhe veçanërisht shitja e holdings të një shoqërie rezidente nga investitorë jorezidentë, konsiston në një lëvizje kapitali. Për rrjedhojë, edhe blerja e aksioneve nga një person resident, në një shoqëri rezidente aksionet e së cilës zotërohen nga një shtetas jorezident, konsiderohen gjithashtu lëvizje kapitali¹²².

4.1. Kuadri ligjor Evropian

4.1.1. Ndalimi i masave shtrënguese

Pavarësisht sanksionimit të lëvizjes së lirë të kapitalit si një nga katër liritë themelore të Bashkimit Evropian, në praktikë janë vendosur nga shtetet anëtare disa lloje masash shtrënguese mbi lëvizjen e lirë të kapitalit, të cilat janë evidentuar kohë pas kohe nga GJED. Këto masa kanë konsistuar kryesisht në vendosjen e tatimeve ndaj dividendëve të përfituar nga shoqëritë e regjistruara jashtë territorit të një shteti anëtar (*Komisioni kundër Holandës*), me vendosjen e masave të autorizimit paraprak nga shteti në lidhje me tjetërsimin e aksioneve apo me krijimin e disa mekanizmave shtetëror kufizues për shoqëritë, të cilat gezojnë dhe kapital shtetëror (*si në rastin Volkswagen*). Në vijim do të analizohet praktika gjyqësore në lidhje me evidentimin e këtyre masave dhe rëndësia prktike e këtyre vendimeve të GJED.

Masat të cilat kufizojnë lëvizjen e aksioneve apo kufizojnë në mënyrë direkte apo indirekte pjesëmarrjen efektive në menaxhimin apo kontrollin e shoqërisë (për shembull duke vendosur një sistem miratimi paraprak), përbëjnë kufizim të së drejtës së lëvizjes së kapitalit. Masat shtrënguese nuk do të analizohen në kuadër të shtetësisë së investitorit, por në kuadër të mundësisë së tij efektive për të blerë aksione dhe për të përfituar nga të drejtat që lidhen me to, pra pavarësisht se një masë shtrënguese mund të jetë e njëjtë si për shtetësit rezidentë si për ata jo rezidentë, sërish ajo duhet të analizohet në kuadër të efekteve që sjell. Në çështjen *Komisioni kundër Spanjës*, GJED

¹¹⁶ C-483/99 - *Commission v France*, paragrafi 36

¹¹⁷ C-358/93 - *Bordessa and Others*, paragrafi 13

¹¹⁸ Ky qëndrim i GJED është sanksionuar në çështjet: C-222/97 *Trummer and Mayer* [1999] ECR I-1661, paragrafi 21; *Commission v France*, paragrafi 36 and 37, *Commission v United Kingdom*, paragrafi 39, 40) si dhe në çështjen C-282/04 - *Commission v Netherlands*, § 19.

¹¹⁹ C-367/98 - *Commission v Portugal*, paragrafi 38.

¹²⁰ C-174/04 - *Commission v Italy*, paragrafi 12.

¹²¹ C-265/04 - *Bouanich*, paragrafi 29 dhe C-329/03 - *Trapeza tis Ellados*, paragrafi 34.

¹²² C-182/08 - *Glaxo Wellcome*, paragrafi 42-44.

analizoi nëse rregullat e vendosura në Spanjë në ligjin 51995 dhe disa Dekrete Mbretëore përbënin apo jo kufizim të lirisë së kapitalit, pasi përcaktonin miratim paraprak të disa vendimeve lidhur me shoqëritë tregtare:

- i) Likujdimin, bashkimin apo ndarjen;
- ii) Ndryshim në objektin e shoqërisë;
- iii) Masat që duhet të ndërmerren nëse kapitali zvogëlohet 10% ose më tepër;
- iv) Blerjen e aksioneve me vlerë të paktën 10% të kapitalit në rasts e aksionet shtetërore janë ulur me 10%, kur kapitali ka rënë me 50%.

Pavarësisht se masat e mësipërme ishin njëlloj të aplikueshme si për shtetasit rezidentë, si për ata jorezidentë, u konsiderua nga GJED se ato ndikojnë në pozicionimin e personit i cili kërkon të blejë aksione, duke kufizuar në këtë mënyrë aksesin e tyre në treg¹²³. Gjithashtu është e nevojshme të shqyrtohet nëse fakti që një Shtet Anëtar refuzon të përjashtojë tatimpaguesit e tij nga tatimi mbi dividendët që marrin për aksionet në një shoqëri që është vendosur në një Shtet tjetër Anëtar, a përbën një kufizim të lëvizjes së kapitalit sipas kuptimit të nenit 1 të Direktivës 88/361¹²⁴. Një dispozitë e tillë si ajo në fjalë, ka për qëllim pengimin e shtetasve që jetojnë në Holandë nga investimi i kapitalit të tyre në shoqëri që kanë selinë në një Shtet tjetër Anëtar. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë arsyen e përfshirjes së një norme të tillë në legjislacionin Holandez, është e qartë se kishte për qëllim veçanërisht të nxiste investimet e individëve në shoqëri të themeluara në Holandë për të rritur kapitalin e tyre. Një dispozitë e tillë gjithashtu ka një efekt kufizues në lidhje me shoqëritë e themeluara në Shtetet e tjera Anëtare dhe përbën një pengesë për ngritjen e kapitalit në Holandë, pasi dividendët që këto shoqëri paguajnë për banorët e Holandës marrin trajtim tatimor më pak të favorshëm sesa dividendët e shpërndarë nga një shoqëri e themeluar në Holandë, në mënyrë që aksionet e saj të jenë më pak tërheqëse për investitorët që banojnë në Holandë sesa aksionet në shoqëritë që kanë selinë e tyre në atë Shtet Anëtar¹²⁵.

4.1.2. Kufizimi i investimeve direkte

GJED, në praktikën e saj ka analizuar dhe masat shtrenguese të ndërmarra nga Shtetet Anëtare me qëllim nxitjen e investimeve në tregun e brendshëm dhe kufizimin e investimeve në shoqëri të krijuara në një Shtet tjetër Anëtar. Një nga llojet më të ndeshura të këtij kufizimi, mund të konsiderohet dhe vendosja e disa procedurave të miratimit paraprak, sipas të cilave shoqëria duhet të autorizohet nga shteti para marrjes së vendimeve lidhur me disa aspekte të rëndësishme të menaxhimit të shoqërisë dhe ushtrimit të të drejtave që lindin nga zotërimi i kuotave dhe aksioneve.

Siç u përmend dhe më sipër, për investimet direkte (siç mund të konsiderohen aksionet dhe obligacionet), në çështjen *Komisioni kundër Holandës*¹²⁶, GJED arriti në konkluzionin se në bazë të aksioneve të veçanta, një sërë vendimesh shumë të rëndësishme të menaxhimit të organeve të shoqërisë, që kanë të bëjnë me aktivitetet e këtyre dy shoqërive dhe struktura e tyre (në veçanti çështjet e bashkimit, ndarjes dhe likujdimin) varen nga miratimi paraprak i shtetit holandez. Kështu, në radhë të parë, siç e ka theksuar me të drejtë Komisioni, këto aksione të veçanta i japin shtetit hollandez një ndikim mbi menaxhimin e shoqërive, i cili nuk është i justifikuar nga madhësia e investimit të saj dhe është dukshëm më i madh se ai i cili aksionet e zakonshme në ato

¹²³ C-463/00 - Commission v Spain, paragrafi 54 dhe 61 si dhe C-98/01 Commission v United Kingdom [2003] ECR I-4641, paragrafi 47

¹²⁴ C-282/04 - Commission v Netherlands

¹²⁵ C-35/98 - Verkooijen, paragrafi 31 dhe 34-35.

¹²⁶ C-282/04 - Commission vs. Netherlands, paragrafi 21, 23-25 dhe 27.

shoqëri normalisht do ta lejonin atë të merrte. Për më tepër, ato aksione kufizojnë ndikimin e aksionarëve të tjerë në lidhje me madhësinë e zotërimit të tyre në shoqëri. Për më tepër, ato aksione të veçanta mund të tjetërsohen vetëm me pëlqimin e Shtetit Holandez. Në mënyrë të ngjashme, aksionet e veçanta në fjalë mund të kenë efekt parandalues në investimet e portofolit të shoqërive dhe një refuzim i mundshëm i Shtetit Holandez për të miratuar një vendim të rëndësishëm, të propozuar nga organet e shoqërisë në fjalë, si të jetë në interes të shoqërisë, do të ishte në gjendje të ndikonte vlerën e aksioneve të asaj shoqërie dhe kështu të zvogëlonte atraktivitetin e aksioneve të tilla.

Paragrafi 4 (3) i Ligjit holandez krijonte një instrument që i mundësonte autoriteteve federale dhe shtetërore të prokurojnë për vete një pakicë bllokimi që u lejon atyre të kundërshtojnë rezolutat e rëndësishme, në bazë të një niveli më të ulët investimesh sesa do të kërkohej sipas ligjit të përgjithshëm të shoqërive tregtare. Duke zotëruar të drejtën e votës në të njëjtin nivel prej 20%, paragrafi 2 (1) i Ligjit plotësonte një kuadër ligjor, i cili mundësonte autoritetet federale dhe shtetërore të ushtrojnë ndikim të konsiderueshëm në bazë të një investimi të tillë. Duke kufizuar mundësinë që aksionarët e tjerë të marrin pjesë në shoqëri me qëllim krijimin ose mbajtjen e lidhjeve ekonomike të qëndrueshme dhe të drejtpërdrejta me të, të cilat do të mundësonin pjesëmarrjen efektive në menaxhimin e asaj shoqërie ose nën kontrollin e saj, kjo situatë mund të pengonte direkt investitorë nga shtetet e tjera anëtare. Siç ka argumentuar Komisioni, kufizimet në lëvizjen e lirë të kapitalit që përbëjnë objektin e këtyre procedurave lidhen me investimet e drejtpërdrejta në kapitalin e shoqërisë Volkswagen¹²⁷. Sa i përket investitorëve të drejtpërdrejtë, duhet të theksohet se duke krijuar një instrument të tillë i cili mund të kufizojë mundësinë e këtyre investitorëve për të marrë pjesë në një shoqëri me qëllim krijimin ose mbajtjen e lidhjeve ekonomike të qëndrueshme dhe të drejtpërdrejta me të duke mundësuar pjesëmarrjen efektive në menaxhimin dhe kontrollin e saj, këto instrumenta zvogëlojnë interesin për të blerë aksione. Prandaj, u konsiderua se kombinimi i paragrafëve 2 (1) dhe 4 (3) të Ligjit për VW përbën një kufizim të lëvizjes së kapitalit në kuptim të nenit 56 (1) të KE. Sipas paragrafit 4 (1) të Ligjit për VW, shteti federal dhe toka e Saksonisë së Poshtme kanë secili të drejtë të emërojnë dy përfaqësues si anëtarë të këshillit mbikëqyrës të Volkswagen, me kusht që ata të jenë aksionarë në shoqëri (rra gjithsej katër persona). Duke kufizuar mundësinë që aksionarët e tjerë të marrin pjesë në shoqëri me qëllim krijimin ose mbajtjen e lidhjeve ekonomike të qëndrueshme dhe të drejtpërdrejta me të, të tilla që t'u mundësojnë atyre të marrin pjesë në mënyrë efektive në menaxhimin e asaj shoqërie ose nën kontrollin e tij, paragrafi 4 (1) i Ligjit për VW është i detyruar të pengojë investitorët e drejtpërdrejtë nga Shtetet e tjera Anëtare për të investuar në kapitalin e shoqërisë¹²⁸. I njëjti qëndrim u mbajt dhe në çështjen kundër Protugalisë, ku gjykata u shpreh se mbajtja e aksioneve me përparësi nga ana e shtetit Portugez, në lidhje me të drejtat e veçanta që këto aksione u japin mbajtësit të tyre, përbën një kufizim të lëvizjes së lirë të kapitalit në kuptim të nenit 56 (1) KE¹²⁹.

Për sa më sipër, është e nevojshme të shqyrtohet nëse legjislacioni në fjalë, i cili (a) ndalon blerjen nga investitorët e shteteve të tjera anëtare të një numri të caktuar aksionesh në shoqëri të caktuara portugeze dhe (b) kërkon dhënien e autorizimit paraprak nga Republika Portugeze për blerjen e një përqindje të caktuar të një shoqërie, përbëjnë një kufizim të lëvizjes së kapitalit mes Shteteve Anëtare. Rrjedhimisht, sa i përket ndalimit që përjashton investitorët nga Shtetet e tjera Anëtare nga marrja e më shumë se një numri të caktuar aksionesh në ndërmarrje të caktuara portugeze, vendoset mosrespektimi i nenit 73b të Traktatit. Sa i përket obligimit për të marrë autorizim paraprak nga Republika Portugeze për blerjen e aksioneve në shoqëri të caktuara portugeze që tejkalojnë një nivel të specifikuar, qeveria portugeze ka pranuar se në parim që kufizimet që dalin

¹²⁷C -283/04, Komisioni kundër Hollandës [2006] ECR I-9141, paragrafi 19

¹²⁸C-112/05 - Komisioni kundër Gjermanisë, paragrafi 50-52, 54, 56, 59 dhe 61

¹²⁹C-212/09 - Komisioni kundër Portugalisë, paragrafi 69.

nga rregullat përbëjnë një kufizim të lëvizjes së lirë të kapitalit, por argumenton se rregullat zbatohen pa dallim për aksionarët kombëtarë dhe për aksionarët që janë shtetas të Shteteve të tjera Anëtare. Për këtë arsye, ato nuk përfshijnë ndonjë trajtim diskriminues ose veçanërisht kufizues të shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare.

Edhe pse rregullat në fjalë nuk shkaktojnë trajtim të pabarabartë, ato pengojnë blerjen e aksioneve në shoqërinë në fjalë dhe pengojnë investitorët në Shtetet e tjera Anëtare për të investuar në këto shoqëri¹³⁰. I njëjti qëndrim është mbajtur dhe në rastin e Mbretërisë së Bashkuar ku u gjykua se duke vendosur dispozitat që kufizojnë mundësinë e marrjes së aksioneve me të drejtë vote, si dhe procedurë që kërkon pëlqimin për shitjen e aseteve të shoqërisë, kontrollin e filialeve të saj dhe mbylljen e saj, Mbretëria e Bashkuar nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 56 të KE¹³¹.

4.1.3. Autorizimi paraprak për blerjen e aksioneve

Siç u diskutua dhe në çështjet e mësipërme, tek të cilat reflektohet se një nga llojet e kufizimeve të lëvizjes së lirë të kapitalit ishte vendosja e një detyrimi paraprak nga shteti pritës, i njëjti qëndrim u mbajt dhe në çështjet C-163/94, C-165/94 dhe C-250/94 *Sanz de Lera* dhe të tjerë [1995] ECR I-4821, paragrafët 24 dhe 25, të cilat rikonfirmojnë se një dispozitë e ligjit kombëtar që e bën një investim të huaj të drejtpërdrejtë subjekt autorizimi paraprak, përbën një kufizim të lëvizjes së kapitalit në kuptim të nenit 73b (1) të Traktatit.

4.1.4. Taksimi i fitimeve nga shitja e aksioneve

Në çështjen *Grønfeldt* u trajtua koncepti i tatimit të fitimit nga shitja e aksioneve dhe u analizua nga gjykata kombëtare në vitin 2001 se fitimet nga shitja e aksioneve në shoqëritë e huaja me përgjegjësi të kufizuar, ishin të tatueshme sapo vlera e aksioneve arrinte në 1% të kapitalit të shoqërisë. Për të njëjtin vit, në rrethana identike, fitimet nga shitja e aksioneve në shoqëritë e kufizuara të qeverisura nga ligji kombëtar, ishin të tatueshme vetëm kur vlera e aksioneve të atij aksionari arrinte në 10% të kapitalit të shoqërisë. Një ndryshim i tillë në trajtim në bazë të vendit të investimit të kapitalit u analizua se sillte efekte dekurajuese ndaj një aksionari që dëshironte të investonte kapitalin e tij në një shoqëri të themeluar në një shtet tjetër dhe gjithashtu ka një efekt kufizues mbi shoqëritë e themeluara në shtetet e tjera¹³².

4.1.5. Taksimi i dividendëve

Në çështjen *Verkooijen*, u mor në shqyrtim një dispozitë ligjore, e cila ndikonte në kufizimin e shtetasve të një Shteti Anëtar që jeton në Holandë nga investimi i kapitalit të tyre në shoqëri që kanë selinë në një Shtet tjetër Anëtar. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë kontekstin e nxjerrjes së kësaj norme, është e qartë se përjashtimi nga taksimi i dividendëve të përfutur nga shoqëritë e krijuara në Holandë, kishte për qëllim veçanërisht të nxiste investimet e individëve në shoqëri të themeluara në Holandë për të rritur kapitalin e tyre. Një dispozitë e tillë gjithashtu ka një efekt kufizues në lidhje me shoqëritë e themeluara në Shtetet e tjera Anëtare: ajo përbën një pengesë për ngritjen e kapitalit në Holandë, pasi dividendët që këto shoqëri paguajnë për banorët e Holandës marrin trajtim tatimor më pak të favorshëm sesa dividendët e shpërndarë nga një shoqëri e themeluar në Holandë, në mënyrë që aksionet e tyre të jenë më pak tërheqëse për investitorët që banojnë në Holandë sesa aksionet në shoqëritë që kanë selinë e tyre në atë Shtet Anëtar.

¹³⁰C-163/94, C-165/94 dhe C-250/94 *Sanz de Lera* dhe të tjerët [] ECR I-4821, paragrafi 25, dhe Rasti C-302/97 *Konle* [1999] ECR I-3099, paragrafi 44) C-367/98 - Komisioni kundër Portugalisë, § 39, 42-43 dhe 45

¹³¹C-98/01 – *Commission vs United Kingdom*, paragrafi 50 dhe C-174/04 - *Commission v Italy*, paragrafi 29-31

¹³²C-446/04 [2006] ECR I-11753, paragrafi 166). C-436/06 - *Grønfeldt*, paragrafi 13-14

Rrjedhimisht, për të bërë dhënien e një avantazhi tatimor (në formën e përjashtimit të taksimit të dividendëve) që kanë të bëjnë me tatimin e të ardhurave të personave fizikë që janë aksionarë, të cilët janë subjekt i kushtit që dividendët të paguhen nga shoqëritë e themeluara brenda territorit kombëtar, përbën një kufizim të kapitalit sipas nenit 1 të Direktivës 88/361¹³³.

Në vijim të këtij arsyetimi, një rast i ngjashëm është trajtuar mbi tatimin në burim, dhe gjykata ka arritur në konkluzionin se përjashtimi i dividendëve të përfituar nga një shoqëri e huaj nga fusha e zbatimit të marrëveshjeve të taksimit të dyfishtë, përbën gjithashtu një kufizim të lëvizjes së lirë të kapitalit, pasi personat të cilët dëshirojnë të investojnë do të jenë subjekt i një tatimi të dyfishtë dhe nuk do të mund të kreditojnë në shtetin e tyre shumën e tatimit të paguar në shtetin pritës¹³⁴. Ky qëndrim mbi taksimin e dyfishtë u rikonfirmua dhe në çështjen *Kerckhaert and Morres*¹³⁵. Gjykatës kombëtare në këtë çështje iu kërkua të analizonte nëse nenet 56 dhe 58 të KE përjashtojnë nga fusha e zbatimit legjislacionin e një Shteti Anëtar, i cili, për aksionet e shoqërisë mëmë në kapitalin e filialit të përcaktuar në nenin 5 (1) të Direktivës 90/435, nuk parashikon një tatim në burim për dividendët e shpërndarë nga një shoqëri e themeluar në atë Shtet Anëtar në një shoqëri të themeluar në një Shtet tjetër Anëtar, duke përjashtuar nga ai taksë dividendët e paguar për një shoqëri që është përgjegjëse për tatim në korporatë në Shtetin e Parë Anëtar ose që ka një seli të përhershme në Shtetin e parë Anëtar që zotëron aksione në shoqërinë që paguan dividendët. Në rastin në fjalë, për qëllimet e përjashtimit nga tatimi në burim të dividendit, nenet 4 parashikojnë një ndryshim në trajtimin ndërmjet, shoqërive që marrin dividendë në Holandë ose që kanë një seli të përhershme atje nga njëra anë dhe personave që përfitojnë dividendë nga shoqëri që nuk janë themeluar në Holandë. Trajtimi i diferencuar në tatimin e dividendëve u konsiderua si një kufizim të lëvizjes së lirë të kapitalit, sipas nenit 56 të KE¹³⁶.

4.1.6. Taksa e korporatave

Në kuadër të taksimit të korporatave, praktika gjyqësore ka qenë gjithashtu e pasur. Një ndër aspektet më të hasura në praktikë ka qenë baza për llogaritjen e vlerës së detyrimit tatimor kur vlera e aksioneve ulet. Në rast se një tatimpagues rezident në një vend anëtar të BE-së zotëron aksione në një shoqëri kapitali rezidente, e cila përbëhet nga aksionarë jo-rezidentë, ulja e vlerës së aksioneve nga të cilat rrjedh shpërndarja e dividendëve, nuk ndikon në bazën e vlerësimit të detyrimit tatimor, ndërsa në rast se aksione të tilla ishin fituar nga një aksionar rezident, ulja e vlerës do të ndikonte në bazën e vlerësimit. Ky kufizim në marrjen parasysh të reduktimit të vlerës së aksioneve zbatohet që nga viti i blerjes së tyre dhe për nëntë vitet e ardhshme dhe kishte të bënte vetëm me reduktimin e fitimeve që rrjedhin nga tjetërsimi ose nga transferimi. Kjo masë u konstatua nga GJED si kufizuese pasi në thelb kjo dispozitë i garantonte avantazh një tatimpaguesi rezident vetëm kur ai merr aksione në një shoqëri rezidente nga një aksionar rezident dhe nuk vlen në rastin e një personi jorezident dhe për rrjedhojë, për këta të fundit, kjo kategori aksionesh automatikisht bëhet më pak tërheqëse dhe investitorët nuk do të prirën t'i blejnë.

Përveç kësaj, një ndryshim i tillë në trajtim ka të ngjarë që t'i tërheqë investitorët jo-rezidentë nga blerja e aksioneve në shoqërinë rezidente dhe për këtë arsye kjo përfaqëson një pengesë për akumulimin e kapitalit të shoqërisë nga shtetet e tjera anëtare. Gjykata gjithashtu ka argumentuar se një legjislacion i tillë si ky në fjalë, përbën një kufizim në lëvizjen e lirë të kapitalit që është e ndaluar, në parim, sipas nenit 73b të Traktatit. Në arsyetimin e saj, gjykata shtoi gjithashtu se kur një Shtet Anëtar ka vendosur një sistem për parandalimin e taksimit të dyfishtë apo lehtësi të tjera tatimore, ai duhet t'u garantojë trajtim të barabartë edhe personave të cilët kanë investuar në

¹³³ C-35/98 - Verkooijen, § 34-36

¹³⁴ C-194/06 - Fondi Orange Smallcap Evropian, paragrafi 65

¹³⁵ C-513/04 - Kerckhaert and Morres, paragrafi 24

¹³⁶ C-379/05 - Amurta, § 15, 25 dhe 28.

shoqëri jorezidente¹³⁷. Për sa i përket veprimet kryesor, është e qartë se një shoqëri rezidente nuk mund të zbrësë nga reduktimet e saj të tatueshme të të ardhurave në fitim që rezulton nga zhvlerësimi i pjesshëm i pronave në shoqëritë jorezidente. Në të kundërt, në të njëjtin vit dhe, për më tepër, në rrethana të njëjta, një shoqëri rezidente mund të zbrësë reduktime të tilla në fitim nga të ardhurat e saj të tatueshme, ku ata në lidhje me pronat në shoqëritë rezidente. Siç u konstatua nga gjykata referuese, shoqëritë rezidente që mbajnë aksionet e amortizuara në shoqëritë jorezidente ishin në vitin 2001 në një situatë më pak të favorshme nga ato që zotëronin këto aksione në shoqëritë rezidente. Megjithatë, një ndryshim i tillë në trajtim, në varësi të investimit të kapitalit, siç u prezantua nga KStG (versioni i ri) para periudhës së vlerësimit tatimor në të cilin ky legjislacion u bë i zbatueshëm, ishte i detyruar të dekurajonte një aksionar nga investimi në një shoqëri të themeluar në një shtet tjetër përveç Republikës Federale të Gjermanisë dhe gjithashtu të ketë një efekt kufizues në lidhje me shoqëritë e themeluara në Shtetet e tjera, duke përfaqësuar, për sa i përket këtyre të fundit, një pengesë për ngritjen e kapitalit në Gjermani¹³⁸.

Në këtë rast, legjislacioni tatimor në fjalë ka efektin të frenojë tatimpaguesit që jetojnë në Austri për të investuar kapitalin e tyre në shoqëritë e vendosura në një Shtet tjetër Anëtar. Legjislacioni lejon një tatimpagues të tillë, në lidhje me tatimin e të ardhurave të tij të brendshëm nga kryeqyteti, për të zgjedhur në mes të tatimit përfundimtar në normën fikse prej 25% dhe tatimit mbi të ardhurat të zakonshëm në një normë të reduktuar përgjysmë, ndërsa të ardhurat e tij nga kryeqyteti me origjinë në një tjetër Shtet anëtar është subjekt i aplikimit të tatimit mbi të ardhurat të zakonshëm, shkalla e cila mund të jetë sa më shumë se 50%. Që legjislacioni gjithashtu prodhon një efekt të kufizuar në lidhje me shoqëritë e krijuara në Shtete të tjera Anëtare, duke qenë se ajo përbën një pengesë për kapitalin e tyre në Austri. Në masën që të ardhurat nga kapitali me origjinë në një Shtet tjetër Anëtar marrin trajtim tatimor më pak të favorshëm sesa të ardhurat nga kapitali me origjinë austriake, aksionet e shoqërive të themeluara në Shtetet e tjera Anëtare janë për investitorët që jetojnë në Austri, më pak tërheqëse sesa aksionet e shoqërive të themeluara në atë Shtet Anëtar. Ajo vijon se legjislacioni i tillë si ky në fjalë përbën një kufizim në lëvizjen e lirë të kapitalit e cila është, në parim, i ndaluar nga neni 73b (1) të Traktatit¹³⁹.

5. E drejta për themelimin e shoqërive dhe liria e ofrimit të shërbimeve përtej kufijve

E drejta e themelimit është parashikuar me nenin 49 të Traktatit të Lisbonës, ndërsa paragrafi dy i këtij neni e përkufizon lirinë si “... të drejtë për të marrë përsipër dhe për të zhvilluar aktivitete si persona të vetëpunësuar dhe për të themeluar dhe krijuar ndërmarrje, në veçanti shoqëri ose firma...”. Në anën tjetër, çdo kufizim i lirisë për të ofruar shërbime ndalohet kur kemi të bëjmë me qytetarët e Shteteve Anëtare, të cilët janë të vendosur në një Shtet Anëtar që është i ndryshëm nga ai i personit për të cilin ofrohen shërbimet¹⁴⁰, dhe shërbime konsiderohen ato që “...normalisht ofrohen kundrejt një shpërblimi, për aq sa nuk rregullohen nga dispozitat, që lidhen me lirinë e lëvizjes së mallrave kapitalit dhe personave ...”¹⁴¹. Qëllimi kryesor i Direktivës për Shërbimet është heqja e barrierave ligjore dhe administrative ndaj tregtisë në sektorin e shërbimeve. Më në fund, njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale dhe shërbimeve postare zbatohen si mjet për lehtësimin e efikasitetit të lirisë së themelimit dhe ofrimit të shërbimeve.

5.1. Lëvizja e lirë e kapitalit

¹³⁷C-446/04

¹³⁸C-377/07 - STEKO Industriemontage, § 25-27.

¹³⁹C-315/02 - Lenz, paragrafi 20-23.

¹⁴⁰ Treaty on the Functioning of the European Union, neni 56, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2010:083:0047:0200:en:PDF>

¹⁴¹ Po aty, Neni 57

Lëvizja e lirë e kapitalit është një nga katër liritë themelore të shpallura nga Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian. Ideja prapa promovimit të kësaj lirie është qasja më e lehtë në tregjet financiare, nëpërmjet heqjes së kufizimeve. Për këtë arsye, neni 63 (1) i TFEU parashtron parimin e përgjithshëm të kësaj lirie duke përcaktuar se “... të gjitha kufizimet mbi lëvizjen e kapitalit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta do të ndërpriten.” Ky nen ndryshon në krahasim me liritë e tjera, sepse nuk është dhënë vetëm për shtetet anëtare, por ajo gjithashtu i jep të drejta vendeve të treta. Arsyeja e thjeshtë pas lehtësimit të hyrjes në treg të shoqërive financiare që vijnë nga shtetet e treta anëtare për të investuar në BE është në interes reciprok financiar të të gjitha palëve të interesuara (shoqërive, qeverive dhe individëve). Direktiva e Këshillit 88/361/EEC për zbatimin e [ish] nenit 67 të Traktatit është një nga aktet nënligjore, duke marrë parasysh efektin direkt të lirive. Megjithatë, ky i fundit është veçanërisht i rëndësishëm duke pasur parasysh përkufizimin që ofron për lëvizjen e kapitalit. Bazuar në këtë Direktivë, pjesa në vijim formon pjesë të këtij përkufizimi:

- Investimet e huaja direkte;
- Investime në/ose blerjet e pasurive të patundshme;
- Investimet në Letra me vlerë;
- Dhënia e huave dhe kredive;
- Operacione të tjera me institucionet financiare¹⁴².

Përveç paragrafit të parë të nenit 63, paragrafi i dytë merret me pagesat, dhe ajo që ky nen proklamon është se “... të gjitha kufizimet mbi pagesat ndërmjet Shteteve Anëtare dhe midis Shteteve Anëtare dhe vendeve të treta do të ndërpriten”. Kështu që, sipas vërejtjes nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, kjo liri është aty, për të lejuar individë që të kryejnë detyrimet për pagesat transnacionale pa kufizime¹⁴³. Rëndësia e kësaj lirie është nënvizuar edhe nga efekti i drejtpërdrejtë i natyrës së nenit 63, i cili drejtpërdrejt i jep të drejta individëve që të mbështeten në të para gjykatave kombëtare.

5.2. E drejta e shoqërive tregtare

Rëndësia e së drejtës së shoqërive tregtare, përfshirë kontabilitetin dhe auditimin e shoqërive, është një nga elementet kryesore të tregut të përbashkët evropian. Arsyetimi që qëndron prapa kësaj renditjeje sipas rëndësisë, është në të vërtetë interesi ekonomik i BE-së, i cili mund të arrihet përmes sigurimit të një tregu të shëndoshë të brendshëm në fushën e së drejtës së shoqërive, kontabilitetit dhe auditimit të shoqërive. Prandaj, një treg i brendshëm nënkupton heqjen e pengesave që u imponohen shoqërive, sidomos shoqërive të cilat synojnë të angazhohen në aktivitete ndërkufitare. Në këtë aspekt, objektivat kryesore të vendosura nga Komisioni Evropian për të arritur këtë qëllim të përgjithshëm përfshijnë “sigurimin e mbrojtjes ekuivalente për aksionarët dhe palët e tjera të interesuara për shoqëritë, sigurimin e lirisë për themelimin e shoqërive në tërë BE-në, nxitjen e efikasitetit dhe konkurrueshmërisë së bizneseve, promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar në mes të shoqërive në shtetet e ndryshme anëtare, dhe nxitjen e diskutimeve ndërmjet shteteve anëtare në modernizimin e së drejtës së shoqërive dhe qeverisjes së korporatave.” Kjo fushë është reformuar vazhdimisht, gjithashtu me fokus në harmonizimin në çështjet e bashkimit dhe ndarjes së shoqërive, si dhe në mbrojtjen e interesave të aksionarëve, auditim dhe kontabilitetin vjetor. Në përgjithësi, një Marrëveshje e ardhshme e Stabilizim-

¹⁴² Nomenclature of the Capital Movements Referred to in Article 1 of the Directive, http://ec.europa.eu/internal_market/capital/docs/nomenclature_en.pdf.

¹⁴³ European Union Law: Cases and Material, Damian Chalmers, Gareth Davies, dhe Giorgio Monti, f. 726

Asociimit me Bashkimin Evropian ka shumë mundësi që do të kërkojë trajtim jo më pak të favorshëm për shoqëritë e BE-së nga ai që u bëhet shoqërive vendore, si dhe trajtim jo më pak të favorshëm nga ai që u bëhet shoqërive vendore dhe secilës degë apo filiali të një shoqërie të një vendi të tretë, pasi ato të jenë themeluar¹⁴⁴. Për të kompletuar kornizën ligjore në fushën e së drejtës së shoqërive, është thelbësore që të ketë rregulla të kontabilitetit dhe auditimit të shoqërive. Rëndësia e këtyre dy proceseve qëndron në detyrimin e shoqërive për transparencë dhe bërjen publike të raportimit financiar. Me procesin e harmonizimit që aktualisht është duke u zhvilluar në këtë fushë në BE, duhen marrë parasysh dy direktivat kryesore të BE-së: Direktivën e Katërt, për llogaritë vjetore për llojet e caktuara të shoqërive, dhe Direktivën e Shtatë, për llogaritë e konsoliduara.

Korniza aktuale ligjore iu mundëson operatorëve ekonomikë, të cilët janë ligjërisht të themeluar dhe vepronë në një shtet tjetër për të ngritur ose për të vazhduar veprimtarinë e tyre ekonomike në Shqipëri në përputhje me ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Ligji ka përcaktuar kuadrin rregullues të shoqërive të cilat themelohen në Shqipëri si dhe mundësitë për bashkimin, ndarjen apo krijimin e degëve të shoqërive të huaja. Nuk ka të dhëna për ndonjë vlerësim të hollësishëm të kryer me qëllim të vlerësimit të nivelit të pajtueshmërisë së ligjit për shoqëritë tregtare me legjislacionin e BE-së. Në përgjithësi, ideja që është krijuar mbi ecurinë e përgjithshme të ligjit, është e ndërlidhur me thjeshtimin e procedurave të regjistrimit të biznesit. Megjithatë, duke pasur parasysh rëndësinë e kësaj zone të tregut të brendshëm, dhe me qëllim të harmonizimit të mëtejshëm të rregullave, një vlerësim i plotë i kornizës ligjor duhet të kryhet.

Ligji për Shoqëritë Tregtare garanton të drejtën e shoqërive nga shtetet anëtare të BE-së, që në mënyrë aktive të marrin pjesë në menaxhimin e shoqërive të themeluara në Shqipëri, duke përfshirë blerjen e aksioneve në një mënyrë jo-diskriminuese, në varësi të dispozitave të këtij ligji. Një nga aspektet e lëvizjes së lirë të kapitalit për qytetarët është blerja e pronave të patundshme. Nuk ka kufizime për këtë, ndërsa Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka përkufizuar edhe konceptin e lirisë ekonomike. Në këtë kuadër, nuk vihet re ndonjë kufizim real apo potencial i investitorëve të huaj në kuadër të blerjes së aksioneve apo obligacioneve. Duke qenë se Shqipëria aspiro për t'u bërë pjesë e BE, vlen për t'u analizuar nëse situatat e kufizimit të lëvizjes së lirë të kapitalit janë apo jo prezente në Shqipëri. Duke marrë në konsideratë praktikën gjyqësore shqiptare, nuk është konstatuar ndonjë rast kufizimi apo diskriminimi kundrejt investitorëve të huaj, të cilët janë ortakë apo aksionerë në shoqëritë tregtare shqiptare dhe kërkojnë të marrin pjesë aktive në menaxhimin dhe kontrollin e tyre.

6. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë

Çështjet që lidhen me kapitalin e shoqërive mbeten gjithnjë komplekse, dhe me qëllim ilustrimin e problematikave kryesore të lindura në praktikën gjyqësore shqiptare, në këtë seksion do të trajtoj disa nga çështjet kryesore lidhur me zmadhimin e kapitalit të shoqërive.

6.1. Pavlefshmëria e zmadhimit të kapitalit

Në çështjen objekt gjykimi, Kolegji konstaton se në momentin e krijimit dhe regjistrimit të shoqërisë me datë 22.02.1999 kapitali themeltar i saj paraqitet si kontribut në para në vlerën prej 100.000 lekë dhe është nënshkruar dhe derdhur nga të dy ortakët e shoqërisë në masën 50% secili (pra secili prej ortakëve ka kontribuar në kapitalin themeltar të saj me para në vlerën 50.000 lekë). Në vitet në vijim, referuar ekstraktit të QKR si dhe dokumentacionit të administruar në gjykimet, në fakt rezultoi se nga ana e ortakëve të shoqërisë janë marrë disa vendime në kuadër të

¹⁴⁴ Për më tepër hollësi mbi kërkesat e vendosura për Shqipërinë, shihni Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/albania/st08164.06_en.pdf

funksionimit dhe të zhvillimit të aktivitetit të saj dhe më konkretisht gjejmë vendime për caktim ekspertësh me qëllim vlerësimin e kontributeve në natyrë që përbën zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, miratimin e raportit të ekspertëve, etj.

Ndërsa, me vendimin nr.3, datë 04.11.2001 i Asamblesë së Ortakëve është vendosur zmadhimi i kapitalit të shoqërisë dhe ndryshimi i kuotave të ortakëve në kapitalin themeltar, për ortakun N.T 51% dhe për ortakun K.T 49%. Vendimi sa sipër i asamblesë së ortakëve është pretenduar si i pavlefshëm nga paditësi me qëllimin e kthimit të së drejtës të kuotave zotëruese nga 50% për secilin ortak. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr.2096, datë 26.07.2012, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë të pikës 2 të vendimit nr.3, datë 04.11.2001, të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregtare "E" Sh.p.k, Korçë, sot "T" Sh.p.k, për miratimin e ndarjes së pjesëve të kapitalit themeltar midis ortakëve themelues të shoqërisë tregtare në masën: për ortakun N.T 51% ose 2841 pjesë me vlerë 28410000 lekë dhe për ortakun K. T 49 % ose 2730 pjesë me vlerë 27297814 lekë. Rimarrjen e së drejtës të zotërimit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare në masën 50% të tij nga secili ortak, duke arsyetuar se vendimi nr.3, datë 04.11.2001 i asamblesë së shoqërisë, për vendimmarrjen që lidhet me ndryshimin e pjesëmarrjes së kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare midis dy ortakëve themelues nuk është i mbështetur në dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare. Kjo pasi si dhe u argumentua, ky ndryshim nuk mbështetet nga zmadhimi i kapitalit në para dhe/ose në natyrë, nuk mbështetet nga transferimi i kuotave midis ortakëve, por mbështetet nga një marrëveshje e heshtur ndërmjet tyre. Duke qenë një marrëdhënie juridike, ajo konstatohet se nuk është parashikuar nga ligji për shoqëritë tregtare dhe kushtet e ekzistencës së saj nuk janë rrjedhojë e asnjë dispozite materiale apo procedurale e këtij ligji. Për rrjedhojë kemi të bëjmë me një marrëveshje juridike, e cila është absolutisht e ndaluar nga ligji tregtar dhe lloji i pavlefshmërisë së saj në këtë rast individualizohet se është pavlefshëm absolute.

Në të kundërt Gjykata e Apelit e cila ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e të paditurve "T" sh.p.k dhe N.T mbi të njëjtat akte me vendimin nr.282, datë 14.05.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se në kundërshtim me sa pranon Gjykata e Rrethit, marrëdhënia e krijuar midis ortakëve të shoqërisë N.T dhe K.T. për ndryshimin e kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të shoqërisë është tërësisht një akt i shoqërisë që gjen rregullim ligjor në dispozitat e ligjit nr.7638, dt.19.11.1992, "Për Shoqëritë tregtare". Gjykata e Apelit duke e konsideruar vendimin nr.3, datë 04.11.2001, të Asamblesë së Ortakëve si një akt të shoqërisë me të cilin janë shqyrtuar çështje pas themelimit të saj bazuar në nenin 238 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, "Për Shoqëritë Tregtare" ka arritur në përfundimin se padia është e parashkruar.

Kolegji vlerëson se ky përfundim i gjykatës së apelit është i drejtë ligjërish dhe i mbështetur në aktet e administruara në gjykim. Kështu rezulton se vendimi nr.3 i Asamblesë së Ortakëve është marrë në datë 04.11.2001, ndërsa padia për konstatimin e pavlefshëm të këtij vendimi është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë me datë 05.03.2012, pothuajse pas 11 vjetësh nga marrja e tij. Kolegji Civil konstaton se dhe pas marrjes së vendimit nr.3, datë 04.11.2001, të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria ka funksionuar mbi kuotat e pranuar nga ortakët respektivisht 49% për paditësin dhe 51 % për të paditurin. Ky ndryshim është pranuar dhe në vendimin nr.7, datë 12.04.2004, të Asamblesë së Ortakëve të nënshkruar nga ortakët N.T dhe K.T. Siç u pranua dhe nga palët ndërgjyqëse në gjykim, mbi kuotat e ndryshuara është realizuar dhe ndarja e fitimit të shoqërisë për vite të tëra pa shfaqur pretendime asnjëra palë. Për sa sipër Kolegji Civil vlerëson se pretendimet e ngritura në rekursin e palës paditëse për zbatim të gabuar të ligjit nr.7638, datë 10.11.1992, "Për shoqëritë tregtare" (ligj i kohës në të cilin është marrë vendimi i asamblesë së ortakëve) nuk qëndrojnë. Në nenin 238 të ligjit nr.7638, datë 10.11.1992, "Për shoqëritë tregtare" është parashikuar se: *"Paditë për pavlefshmërinë e shoqërisë ose të akteve dhe çështjeve të shqyrtuara pas themelimit të saj parashkruhen për tre vjet, duke filluar nga dita kur shoqëria vihet përballë aktit të pavlefshmërisë(...)"*.

6.2. Praktika mbi ndryshimin e vlerës së kapitalit

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson të theksojë se është e domosdoshme që pikësëpari të analizohet baza ligjore, e cila ka shërbyer për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje. Është e natyrshme që, meqë vetë shoqëria tregtare përfaqëson në vetvete një marrëdhënie juridike civile, si një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij. (Neni 1074 i Kodit Civil), në rregullimin e saj do të shtrihen dispozitat e përgjithshme juridiko-civile (Kodi Civil). Në të njëjtën kohë, në bazë parimit "*lex specialis derogat generali*", pra kur në një gjykim zbatohen njëkohësisht dy ligje (*materiale apo procedurale*), atëherë do të zbatohet ligji i posaçëm (*lex specialis*) pasi ai ka prioritet mbi ligjin e përgjithshëm, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se duke pasur një ligj të posaçëm për shoqëritë tregtare, baza e rregullimit të marrëdhënies së krijuar midis palëve do të jetë ligji material i kohës kur kjo marrëdhënie është krijuar, dhe konkretisht Ligji nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", i cili ka pasur për objekt rregullimin e mënyrës së krijimit, formimit të kapitalit themeltar, pozicionin e ortakëve, marrëdhëniet midis tyre, organet drejtuese dhe modalitetet e tjera të funksionimit të shoqërive tregtare.

Për sa rezulton nga kërkesë padia e paraqitur në këtë proces gjyqësor, konstatohet se nga ana e palës paditëse nëpërmjet këtij gjykimi, është kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë anulimi i vendimeve të marra nga Asambleja e Aksionarëve në datën 05.07.2008 dhe 08.08.2008 me anë të të cilave është vendosur: (i) ndryshimi i aksioneve të aksionarëve në përputhje me nivelin e investimit; (ii) vazhdimi i investimeve në mënyrë individuale; (iii) ristrukturimi i Këshillit Mbikëqyrës duke vendosur shkarkimin e Kryetarit P.P. dhe emërimin e M.K. kryetar dhe anëtar M.L.; (iv) miratimi e raportit të ekspertit kontabël dhe ndryshimin e nenit 7 dhe 21, të Statutit të Shoqërisë "Q" Sh.a. Pala paditëse në këtë proces gjyqësor i ka mbështetur kryesisht pretendimet e saj në faktin se mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve e datës 05.07.2008 dhe 08.08.2008 është bërë pa qenë të pranishëm shumica e nevojshme, apo kuorumi i duhur për vlefshmërinë e vendimmarrjes së kësaj natyre, pasi ndryshimi i kapitalit kryhet me vendim unanim të aksionarëve, ndërsa vendimet për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të aksionarëve. Në të njëjtën kohë, në mbështetje të nenit 22, të Statutit të Shoqërisë Tregtare "Q" sh.a, është asambleja e zakonshme ajo që emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë. Nga ana e gjykatave të faktit, nuk janë analizuar çështje të rëndësishme ligjore të cilat ndikojnë në vlefshmërinë e vendimeve të marra në asamblenë e aksionarëve, dhe që kanë të bëjnë kryesisht me: (i) natyrën juridike të akteve të organeve të shoqërisë tregtare; (ii) natyrën e vendimmarrjes së mbledhjeve së aksionarëve (lloji i vendimeve); (iii) thirrjen e mbledhjes së asamblesë dhe mënyrën e njoftimit; (iv) natyrës së mbledhjes së aksionarëve; (v) kuorumin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes së asamblesë së aksionarëve; (vi) lloji i vendimmarrjes; si dhe (vii) kuorumin e nevojshëm për vendimmarrje.

Për t'iu dhënë përgjigje problemeve të shtruara më sipër për diskutim, Kolegji Civil çmon se lidhur me natyrën juridike të akteve të organeve të shoqërisë tregtare, të cilat nxirren nga gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj, janë akte juridike të cilat shprehin vullnetin e palëve pjesëmarrëse në këto akte. Në këtë kuadër, këto akte hyjnë në kategorinë e veprimeve juridike të cilat kanë për qëllim krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave ose detyrimeve juridiko-civile. Në mbështetje të nenit 3 të ligjit nr.7638/1992 "Për shoqërinë tregtare", aktet e themelimit të një shoqërie tregtare, ashtu edhe vendimet që merren nga kjo shoqëri tregtare, janë veprime juridike të njëanshme ose të dyanshme. Këto akte përbëjnë veprime juridike, të përcaktuara në mbështetje të nenit 79 të Kodit Civil.

Duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 231, të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare", në të cilin sanksionohet se: "*Pavlefshmëria e një shoqërie ose e një akti që*

ndryshon statutin, mund të rezultojë vetëm nga një dispozitë e veçantë e këtij ligji ose e atyre që rregullojnë ligjërisht pavarëshmërinë e kontratave...Pavlefshmëria e akteve ose e vendimeve të tjera nga ato të parashikuara nga paragrafi i mësipërm mund të rezultojnë vetëm nga shkelja e një dispozite urdhëruese të këtij ligji ose e ligjshmërisë në fuqi për kontratat.”

Kolegji Civil vëren se në mbështetje të nenit 128 të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, në të cilin parashikohet se: “*Asambleja e jashtëzakonshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën 1/2 e aksioneve dhe ...Ajo merr vendim me një shumicë votash prej 3/4 që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.”* nga ana e Shoqërisë “Qeramika-Albania” Sh.a, janë respektuar kërkesat e legjislacionit tregtar mbi kuorumin e pjesëmarrjes për zhvillimin e asamblesë së jashtëzakonshme, si dhe në të njëjtën kohë janë respektuar kërkesat ligjore lidhur me kuorumin e vendimmarrjes. Gjithashtu, ky Kolegj vëren se natyra juridike e konfliktit objekt gjykimi është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me funksionimin e brendshëm të Shoqërisë Tregtare “Q” sh.a., në këtë kuadër, për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje krahas dispozitave të legjislacionit të posaçëm, ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” (*lex specialis*) do të zbatohen edhe normat e statutit të Shoqërisë Tregtare “Q” sh.a. Në analizë të raportit që ekziston ndërmjet normave statutores dhe ato të legjislacionit të posaçëm tregtar, Kolegji Civil vlerëson se parashikimet në normat statutores duhet të jenë në përputhje me frymën dhe parashikimet e përgjithshme të legjislacionit të posaçëm tregtar. Në të njëjtën kohë, këto parashikime mund të përmbajnë rregullime të ndryshme për sa parashikohet nga legjislacioni i posaçëm tregtar, vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht nga dispozita të veçanta të këtij legjislacioni (*norma referuese*). Në të kundërt çdo normë statusore, e cila bie ndesh me një dispozitë të legjislacionit të posaçëm tregtar, do të jetë e pavlefshme.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson të gabuar përfundimin e arritur nga Gjykata e Apelit Korçë se: “*...Këto vendime rezultojnë se nuk janë dërguar për regjistrim pranë regjistrimit pranë Q.K.R e cila ka detyrim për të konstatuar vlefshmërinë e tyre dhe bazueshmërinë në ligj...”* Kolegji çmon se në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe konkretisht nenit 21 “Efektet e regjistrimit”, regjistrimi i të dhënave në regjistrin tregtar ka vetëm vlerë deklarative, njohëse dhe nuk ka vlerë krijuese (konstitutive). Gjithashtu në mbështetje të nenit 54§2 të Ligjit 9723/2007, Kolegji Civil çmon se *QKR-ja nuk mund të shqyrtojë saktësinë e të dhënave ose vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim.* Në mbështetje të këtij parashikimi, nëpunësi i QKR-së vetëm asiston aplikantin në plotësimin e formularit të aplikimit, i cili ka karakter deklarativ. Nga ana e këtij nëpunësi bëhet verifikimi i identitetit të personit, i cili paraqitet si aplikant, nëse është personi i autorizuar me ligj për të kryer këtë veprim, por në asnjë rast ai nuk mund të verifikojë vlefshmërinë e dokumentacionit, i cili është paraqitur për të depozituar si të dhëna në regjistrin tregtar...Kolegji Civil vlerëson se të gjitha vendimet e mbledhjes së asamblesë të datës 05.07.2008 dhe datës 08.08.2008 janë të vlefshme, pasi nuk ekzistojnë rastet e parashikuara në ligj për pavlefshmërinë e tyre.

6.3. Njoftimi për zmadhimin e kapitalit

Gjykata në praktikën e saj ka sanksionuar se për shkak të rëndësisë që paraqesin vendimet mbi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, njoftimi për këto vendime, duhet të kryhet paraprakisht dhe të njoftohet në rendin e ditës, duke i dhënë mundësi ortakëve jo vetëm për të qenë të pranishëm në mbledhje, por dhe për të reflektuar mbi qëndrimin ndaj këtyre ndryshimeve. Dispozitat në lidhje me zmadhimin e kapitalit të shoqërisë janë konstatuar si urdhëruese, dhe gjykata ka mbajtur qëndrimin se pavarësisht specifikimeve që mund të jenë kryer nga ortakët në statut apo aktin e themelimit, nëse përcaktimet që lidhen me zmadhimin e kapitalit do të bien ndesh me përcaktimin e ligji, ato do të konsiderohen të pavlefshme,

“.....Vendimi i datës 16.06.2013, më anë të të cilit është vendosur zmadhimi i kapitalit, nuk i është njoftuar palës paditëse Shoqëria “E.E” srl, sipas neneve 83 dhe vijues të ligjit. Pra, rezulton në mënyrë të qartë që ortakët e shoqërisë në këtë mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, ne keqbesim kundrejt ortakut tjetër të Shoqërisë “E.E”, në atë kohë zotërues i masës prej 40% të kuotave të shoqërisë, nuk janë mjaftuar vetëm me miratimin e bilancit, por kanë miratuar në kundërshtim të plotë me ligjin dhe Statutin e Shoqërisë, zmadhimin e kapitalit, ndërkohë që ky zmadhim nuk i është njoftuar ortakut mbajtës i 40% të kuotave të shoqërisë dhe nuk është parashikuar në rendin e ditës, ndaj si pasojë është i pavlefshëm. Zmadhimi i kapitalit është një veprim që kërkon shumicë të cilësuar nga neni 87 i Ligjit e për pasojë duhet njoftuar rregullisht sipas dispozitave ligjore e nuk mund të përfshihet në pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës”. Në këtë aspekt, Gjykata gjen të bazuar pretendimin e palës paditëse Shoqëria “E.E” në likujdim. Thirrja e asamblesë së Shoqërisë “H.L” shpk me rend dite: “Aprovimi i projekt draftit të bilancit” dhe “Të ndryshme”, nuk përlligj marrjen e vendimeve të vlefshme për shkak të ezaurimit të procedurës së parashikuar në nenin 83 të ligjit, jo vetëm për ndryshimet në Statut dhe zmadhimin e kapitalit, por për çdo çështje tjetër, e cila, në bazë të ligjit dhe të Statutit, është në kompetencën dhe përgjegjësinë e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. *Kjo dispozitë procedurale ka karakter urdhërues dhe prevalon mbi çdo parashikim të kundërt në Akt themelimin apo Statutin e Shoqërisë.*

Përsa i përket, kthimit të ortakëve në pjesën e zotërimit të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “H.L” shpk, para zmadhimit të kapitalit datë 16.06.2013, Gjykata arrin në perfundimin se Shoqëria “G.S.S” shpk, kthehet në gjendjen e mëparshme zotërues i 10% të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “H.L” shpk apo në vlerë kapitali 10.000 leke. Ndërsa, kjo pasojë nuk mund të zbatohet për ortakun tjetër, Shoqërine “Sil.Co” shpk, e cila në bazë të kontratave Nr.4301Rep., Nr.1629Kol., date 30.06.2013, dhe kontratës noteriale Nr.12449 Rep., Nr.3904Kol., datë 31.10.2013, i ka kaluar 100% e kuotave të zotëruara nga Shoqëria “E” srl në Shoqërine “H.L” shpk, e cila shkon në zotërues të 50% të kuotave të kapitalit apo në vlerë kapitali 50.000 lekë.

7. Shoqëria tregtare si pjesë e pasurisë bashkëshortore

7.1. Pjesëtimi i shoqërisë

Një rëndësi të veçantë paraqet studimi i shoqërisë tregtare në kuadër të së drejtës familjare. Në Shqipëri janë të shumta rastet e krijimit të shoqërive tregtare gjatë martesës dhe natyrshëm lind pyetja: A janë kuotat/aksionet apo obligacionet e një shoqërie tregtare në të cilën njëri bashkëshort është ortak apo aksionar, pjesë e bashkësisë ligjore? Për të arritur në një konkluzion, duhen analizuar fillimisht dy çështje kryesore:

- A mund të konsiderohet aksioni apo kuota e njërit prej bashkëshortëve pjesë e pasurisë së krijuar gjatë martesës?
- Cili është ligji që prevalon midis Kodit të Familjes dhe Ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare?

Në rastin e ushtrimit të një veprimtarie tregtare gjatë martesës, çështja e pjesëtitimit të pasurisë sigurisht që paraqitet komplekse pasi ndërthuret veprimtaria tregtare me një element të veçantë siç është martesa. Theksojmë se çështja e pjesëtitimit të shoqërive tregtare në rastet e divorcit, merr një rëndësi thelbësore nëse bashkëshortët nuk kanë hartuar një kontratë paramartesore dhe janë automatikisht pjesë e regjimit të bashkësisë ligjore. Kjo pasi në rastin e regjimit të pasurive të ndara, çdo send apo e drejtë e fituar gjatë martesës, mbetet e atij bashkëshorti që e ka fituar atë pavarësisht momentit të fitimit të sendit apo të drejtës.

Legjislacioni ynë, nuk ka përcaktuar shprehimisht nëse kuotat apo aksionet e një shoqërie do të bëjnë pjesë në rrethin e sendeve të cilët do të pjesëtohen me përfundimin e martesës dhe për rrjedhojë duhet hulumtuar në përcaktimet e bëra në ligjin Nr. 9901 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Kodit të Familjes. Në ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, shoqëritë tregtare ndahen në dy grupi të mëdha: Shoqëri personi (shoqëri kolektive dhe komandite) dhe kapitali (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shoqëri aksionere). Dallimi midis dy grupimeve konsiston në formën e organizimit, kapitalin, nivelin e përgjegjësinë që mbajnë ortakët për detyrimet e gjeneruara etj. Për efekt të analizës së marrëdhënieve pasurore mes bashkëshortëve në rastin e shoqërive tregtare, vlen të analizohet çështja e tjetërsimit të aksioneve apo kuotave bazuar në kategori të ndryshme shoqërisht.

Në rastin e shoqërive kolektive, ligji përcakton se ortaku nuk mund të heqë dorë, të transferojë apo të vendosë barrë mbi të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqëri, pa miratimin e ortakëve të tjerë. Të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut (pjesa) në shoqërinë kolektive, mund t’u transferohen, pa asnjë kufizim, ortakëve të tjerë.¹⁴⁵ Për shoqërinë komandite ligji parashikon se do të zbatohen për sa kohë nuk bien në kundërshtim, dispozitat për shoqërinë kolektive. Për sa kohë që nuk përcaktohet ndonjë rregull i veçantë për tjetërsimin e kuotave në rastin e shoqërive komandite, arrijmë në konkluzionin se kjo çështje do të trajtohet bazuar në parashikimet për shoqërinë kolektive. Në këto kushte, bashkëshortët nuk mund të bëhen automatikisht pjesë e shoqërisë dhe të fitojë të drejtën mbi kuotat e tyre. Në rastin e shoqërive të kapitalit, këto karakteristika personale të pjesëmarrësve në këto shoqëri nuk kanë rëndësi. Ortakët ose aksionerët kanë të drejtë të transferojnë kuotat/aksionet e tyre te të tretët me ose pa shpërblim, si në çdo formë tjetër ligjore të kalimit të pronësisë. Megjithatë rregulla më specifike vendosen në statutet e shoqërive pasi ligji nuk vendos kufizime në këtë drejtim.

Kodi i Familjes, parashtron gjithashtu mënyrën e trajtimit të veprimtarisë tregtare mes bashkëshortëve, duke sanksionuar në nenin 74 se veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës është pjesë e bashkësisë ligjore aktuale (pjesë e bashkësisë ligjore që nga data e fitimit të tyre). Nëse veprimtaria tregtare është krijuar përpara lidhjes së martesës dhe gjatë martesës ajo drejtohet nga të dy bashkëshortët, vetëm fitimet e këtij aktiviteti do të jetë pjesë e bashkësisë ligjore. Nëse kapitali i përdorur për themelimin e shoqërisë tregtare është fituar gjatë martesës, shoqëria do të konsiderohet pjesë e pasurisë bashkëshortore, pavarësisht nëse kapitali i përdorur për themelimin e saj përbëhet nga të ardhurat e njërit apo të të dy bashkëshortëve. Nëse vërtetohet se këto të ardhura janë fituar para lidhjes së martesës, aktiviteti tregtar konsiderohet zëvendësim i një kundërvlefte vetjake, e cila në bazë të nenit 77 të Kodit të Familjes konsiderohet pasuri vetjake. Fitimet e krijuara nga shoqëria tregtare, sipas përcaktimeve të nenit 74 të Kodit të Familjes, do të konsiderohen të përbashkëta vetëm nëse vërtetohet se aktiviteti tregtar i krijuar para martesës, administrohet gjatë martesës nga bashkëshorti jopronar. Nëse ky kusht nuk plotësohet, fitimet e veprimtarisë tregtare do të jenë pjesë e bashkësisë eventuale (sende të përbashkëta vetëm nëse në çastin e mbarimit të martesës ekzistojnë dhe janë të pakonsumuara), duke u konsideruar fitimet e aktivitetit tregtar si fruta civile të pasurisë vetjake të njërit bashkëshort, në bazë të nenit 74/c të Kodit të Familjes. Nëse të ardhurat nga aktiviteti tregtar janë marrë dhe nuk janë konsumuar, ato do i nënshtrohen pjesëtimit ashtu si pjesa tjetër e sendeve të bashkësisë ligjore. Në lidhje me frutat civile, që në këtë rast do të konsiderohen të tilla, fitimet e aktivitetit të shoqërisë tregtare, ato konsiderohen se janë marrë nëse janë bërë gati për t’u mbledhur, pavarësisht nëse bashkëshorti titullar i ka marrë apo jo në dorëzim. Bazuar në përcaktimet e Kodit të Familjes, frutet e sendeve të bashkësisë do të konsiderohen sende të përbashkëta dhe prandaj ato do të pjesëtohen, edhe pse janë mbledhur pas mbarimit të martesës.

¹⁴⁵ Neni 30 i ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Siç u analizua dhe më sipër, në parim veprimtaria tregtare e bashkëshortëve (krijuar gjatë martesës) është pjesë e bashkësisë ligjore. Nëse veprimtaria tregtare ka ekzistuar para lidhjes së martesës, por gjatë martesës ajo administrohet nga të dy bashkëshortët, atëherë frutet e saj janë pasuri e përbashkët. Në dukje, ky përcaktim i dhënë nga Kodi i Familjes rregullon qartë marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, por në fakt, duke qenë se në praktikë shfaqen një shumëllojshmëri kategorish të veprimtarive tregtare, gjykatës i është dashur të bëjë një interpretim më të zgjeruar këtij neni.

Problematika kryesore, lidhet me pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, kur kjo e fundit përbëhet nga një shoqëri tregtare. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Vendimin Nr.340, datë 26.06.2012 ka marrë në shqyrtim dy aspekte kryesore të veprimtarisë tregtare mes bashkëshortëve : Cili do të konsiderohet në këtë rast ligji specifik, Kodi i Familjes apo Ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” ? Dhe A do të konsiderohen kapitalet e një shoqërie sende të luajtshme ose të paluajtshme, në mënyrë ato që të jenë të afta për t’iu nënshtruar pjesëtimin?

Rrethanat e çështjes ishin si mësi më poshtë: Palët ndërgjyqëse B.P dhe I.K kanë qenë bashkëshortë që nga viti 1992 dhe kanë krijuar dy shoqëri tregtare me emrat “X” sh.p.k dhe “Y” sh.p.k me qendra në Tiranë, për pjesëtimin e të cilave nuk janë marrë vesh me njëri tjetrin. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (i cili lë në fuqi Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Apelit) shprehet se: *“Kolegji Civil e vlerëson të pabazuar në ligj pretendimin që ngrihet në rekurs nga pala e paditur se, në rastin në gjykim, pjesëtimi duhet të bëhet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, dhe jo sipas dispozitave të Kodit të Familjes e dispozitave të tjera ligjore ku referon ky i fundit, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me dy ortakë, të cilët kanë qenë bashkëshortë me njëri tjetrin.”*

Gjithashtu kjo Gjykatë arrin në përfundimin se Kodi i Familjes qëndron më lart në hierarki se Ligji nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, për shkak të shumicës së cilësuar që kërkon votimi i tij në Parlament. Gjithashtu ky Kod, duke qenë ligji specifik që rregullon martesën dhe regjimin pasuror të bashkëshortëve, parashikon rregullime deri në detaje se çfarë bëhet me pasurinë e bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, prandaj për këto tre shkaqe nuk ka vend që të zbatohet ligji që rregullon fushën e shoqërive tregtare, për sa i përket pjesëtimin të kuotave të kapitalit që kanë ish-bashkëshortët në këto shoqëri. Në këndvështrimin tonë arsyetimi i Gjykatës mbi përcaktimin e ligjit specifik është i gabuar, pasi ligji specifik është ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe jo Kodi i Familjes. Kodi i Familjes rregullon marrëdhënie të ndryshme të krijuara para, gjatë dhe pas martesës si për shembull: përgjegjësia prindërore, kontributi ushqimor, amësia dhe atësia, regjimi pasuror etj. Pra institutet dhe marrëdhëniet që rregullohen nga Kodi i Familjes janë të shumta në numër, ndërkohë që ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” analizon specifikisht situatën e shoqërisë tregtare dhe institutet e lidhur me të. Termi i përdorur në Kodin e Familjes, “veprimtari tregtare” është një term shumë i gjerë. Shoqëritë tregtare janë vetëm një aspekti i veprimtarisë tregtare dhe për shkak të natyrës së veçantë, ato rregullohen nga një ligj specifik siç është ligji “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Nëse do të ishte Kodi i Familjes ligji specifik dhe shoqëria tregtare do t’i nënshtronte pjesëtimin sipas Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile, atëherë kjo nuk do të bënte sens ligjor, pasi çdo shoqëri në mënyrë që të fitojë personalitet juridik duhet të regjistrohet dhe ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”. Përsa i përket argumentit se Kodi i Familjes prevalon, si Kod i miratuar me shumicë të cilësuar në Parlament, mendojmë se është i pavend në situatën konkrete. Ky argument do të vlente nëse dispozitat e Kodit të Familjes do të bënin ndonjë përcaktim mbi shoqëritë tregtare dhe këto përcaktime do të binin në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në rastin konkret, në Kodin e Familjes bëhet një përcaktim evaziv “veprimtari tregtare” dhe për rrjedhojë nuk ka ndonjë kundërshtim mes Kodit të Familjes dhe ligjit që rregullon veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Në lidhje me pyetjen e dytë, nëse konsiderohen kapitalet e një shoqërie sende te luajtshme ose të paluajtshme, në mënyrë ato që të jenë të afta për t'iu nënshtruar pjesëtimit, Gjykata është përgjigjur si më poshtë : *“...Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes ka rezultuar se aktiviteti i ndërgjyqësve në këto shoqëri është një veprimtari e mirëfilltë tregtare, e cila është krijuar gjatë martesës, prandaj kjo veprimtari është pjesë e bashkësisë ligjore, pjesëtimi i së cilës bëhet sipas parashikimeve të nenit 98 e vijues të Kodit të Familjes, i cili në nenin 107 të tij përcakton se: Pjesëtimi i pasurisë së bashkëshortëve bëhet sipas këtij Kodi, Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile.”*

Pra, gjykata në thelb, arsyeton se kapitalet e një shoqërie tregtare janë sende të luajtshme (kontribut në para, etj.) apo të paluajtshme, ndaj edhe i nënshtrohen pjesëtimit. Dy shoqëritë tregtare janë themeluar dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre pas lidhjes së martesës mes palëve ndërgjyqëse, pra kemi të bëjmë me pasuri të vënë gjatë martesës. Ndërkohë në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” është përcaktuar qartë fakti se shoqëria tregtare është një person juridik dhe ka një personalitet të vetin, personalitet të cilin e fiton me regjistrimin në QKR. Rrjedhimisht, në momentin që bëhet fjalë për ekzistencën e një personi në kuptim të Kodit Civil, në këndvështrimin tim është jo i bazuar arsyetimi se shoqëria do të përbëjë pjesë të rrethit të sendeve objekt pjesëtimi në rastin e martesës.

Konsiderohet i arsyeshëm qëndrimi se ortakët zotërojnë kuota në përpjesëtim me kontributin e dhënë, por nuk kanë të drejta pronësie mbi sendet e luajtshme apo paluajtshme të shoqërisë. Për rrjedhojë padisë së ngritur i mungon objekti material pasi ish-bashkëshortët i kanë të përcaktuara tashmë kuotat e tyre në shoqëri dhe për më tepër nuk mund të kërkojnë pjesëtimin e shoqërisë, së pari sepse shoqëria ka një personalitet juridik dhe nuk mund të pjesëtohet bazuar në dispozitat e Kodit Civil dhe së dyti, sepse pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme janë pronë e vetë shoqërisë dhe ortakët nuk mund të kërkojnë pjesëtimin e sendeve, të cilat nuk i kanë në pronësi.

Theksojmë se çështja e veprimtarisë tregtare mes bashkëshortëve është trajtuar në mënyrë të detajuar në çështjen në fjalë dhe nga pakica, e cila ka parashtruar se *“Konfondohet dukshëm koncepti juridik i shoqërisë tregtare me ato të sendit, pronësisë, etj. Shoqëria tregtare nuk është send, por është një marrëdhënie kontraktore e posaçme e natyrës tregtare. Si rrjedhojë e kësaj kontrate lind dhe themelohet një person juridik i ri, tek i cili palët kontraktore tjetërsojnë vlera në të holla apo në natyrë e shërbime, që bëhen pas kësaj pronë ekskluzive të shoqërisë. Po kështu shoqëria fiton pasuri të tjera gjatë ekzistencës së saj, të cilat edhe ato janë pronë e shoqërisë...Kuotat dhe aksionet, pas derdhjes së kontributeve, nuk janë sende (që pjesëtohen), por ato në thelb janë një e drejtë pasurore”*. Pra dy argumentet bazë mbi të cilat mbështete ky arsyetim janë:

- Natyra e aksioneve të një shoqërie tregtare, dhe
- Kategorizimi i shoqërive tregtare si një marrëdhënie kontraktore e posaçme.

Arsyetimi i mësipërm është plotësisht në përputhje me natyrën e shoqërisë tregtare dhe mënyrën e funksionimit të shoqërive tregtare, megjithatë në vazhdim dhe Gjykata Kushtetuese ka mbajtur të njëjtin qëndrim me Gjykatat e tjera. Kjo çështje është trajtuar në vijim dhe nga Gjykata Kushtetuese, të cilës i janë drejtuar pretendimet e mëposhtme:

- Shkelje e Nenit 4/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Duke lejuar pjesëtimin e dy shoqërive tregtare, pa pasur si bazë ligjore Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, gjykatat kanë dalë jashtë përcaktimit të së drejtës;
- Shkelje të nenit 7 të Kushtetutës, pasi Gjykata ka marrë në shqyrtim një çështje që nuk i përket asaj;

- Është shkelur neni 11/1 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë cenuar lirinë e tij në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, duke ndërhyrë në ndarjen e kuotave që tashmë kanë qenë të ndara dhe duke e bërë atë pjesë të një hetimi fiktiv.

Gjykata Kushtetuese në lidhje me pretendimin e parë, nuk është ndalur të shpjegojë se cili është në këtë rast ligji specifik që do të aplikohet, por është shprehur se: *“Lidhur me pretendimin se nuk është respektuar parimi i shtetit të së drejtës, pasi vendimet gjyqësore nuk kanë pasur si bazë ligjore Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ky pretendim nuk qëndron. Konkretisht, Gjykata e Lartë ka argumentuar se: Së pari, pasuria, e cila i është nënshtruar pjesëtimit, konsiderohet pasuri e bashkësisë ligjore të çiftit Paskali-Kapxhiu; Së dyti, Kodi i Familjes qëndron më lart në hierarkinë e ligjeve, se ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si ligj i miratuar me shumicë të cilësuar; Së treti, Kodi i Familjes është vlerësuar si ligj specifik, i cili rregullon deri në detaje se çfarë bëhet me pasurinë bashkëshortore pas zgjidhjes së martesës.”*

Kjo Gjykatë e mbështeti argumentin e mësipërm thjesht duke cituar vendimet e saj të mëparshme (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.11, datë 02.04.2008; nr.7, datë 09.03.2009; nr.23, datë 23.07.2009; nr.38, datë 30.12.2010; nr.8, datë 16.03.2011), vendime të cilat nuk i japin një përgjigje situatës konkrete, por thjesht parashikojnë detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet e dhëna. Pra, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se meqë Gjykatat e instancave të tjera kanë dhënë argumente të detajuara mbi arsyen e mbajtjes së atij qëndrimi, pretendimi i I.K nuk qëndron dhe për rrjedhojë nuk kemi pasur shkelje të Kushtetutës. Në fakt, I.K nuk ka pretenduar në asnjë moment se Gjykata nuk ka arsyetuar vendimin e saj, por ka pretenduar arsyetim jo të drejtë nga ana e Gjykatave.

Duke mbajtur këtë qëndrim mbi pretendimin e parë, rrjedhimisht Gjykata Kushtetuese ka vazhduar në të njëjtën vijë logjike me Gjykatat e mëparshme, duke mos marrë parasysh dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”: *“Në lidhje me pretendimin se me gjykimin e padisë së pjesëtimit është shkelur parimi i ndarjes së pushteteve, pasi gjykatat nuk kishin se pse të jepnin vendim përfundimtar për pranimin e padisë, por duhej ta pushonin atë, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat e shkallës së parë, të Apelit dhe Gjykatës së Lartë..... I gjithë procesi gjyqësor ka provuar se mes dy palëve të përfshira ka konflikt dhe se palët nuk bien dakord jashtëgjyqësisht për ndarjen e pasurive të tyre. Në këto kushte dhe para kërkesës së njërës prej palëve, gjykata nuk mund të refuzojë të japë vendim për pjesëtimin e pasurive që ata kanë në bashkëpronësi. Janë pikërisht ligjet, si Kodi Civil dhe Kodi i Familjes, ata që parashikojnë prezumimin se pasuria e vënë nga bashkëshortët, gjatë martesës, në mungesë të një kontrate martesore, është në pjesë të barabarta për secilin.”*

Në lidhje me pretendimin e cënimit të veprimtarisë ekonomike, qëndrimi është gjithashtu i gabuar pasi Gjykata Kushtetuese është shprehur se: *“Në lidhje me pretendimin se gjykimi i pjesëtimit ka cenuar lirinë e ushtrimit të veprimtarisë ekonomike, duke ndërhyrë në ndarjen e kuotave që tashmë ishin të ndara, Kolegji vlerëson se është kontradiktor dhe i pabazuar. Nga njëra anë pranohet nga vetë kërkuesi dhe pohohet se kuotat kanë qenë të ndara, nga ana tjetër kundërshtohet ndarja e kuotave për efekt të pjesëtimit gjyqësor.”*

Lejimi i pjesëtimit të një pasurie, që përfshin si sende të paluajtshme ashtu dhe të luajtshme (tituj pronësie-kuotat e shoqërisë), nuk presupozon se personi juridik në vetvete do të prishet dhe nuk do të ekzistojë më. Në rastin konkret kemi dy shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, të cilat janë në pronësi të barabartë të të dy palëve ndërgjyqëse dhe është propozuar, nga njëra palë, që secili prej tyre të mbajë një të shoqëri. Pjesëtimi gjyqësor nuk presupozon prishje të shoqërive, si persona juridikë, pasi këta të fundit do të kenë po ato të drejta dhe detyrime siç kanë pasur më

parë, me ndryshimin se do të jenë me një ortak të vetëm. Pra, nuk ka cenim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike”.

7.2. Pavlefshmëia e transferimit të kapitalit nga njëri bashkëshort

Palët paditëse V.H, L.H, S.H, R.H dhe I.H, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane me padinë me objekt: “1. Detyrimi i të paditurve të njohin paditësit pronarë edhe mbi 60% të aksioneve të Shoqërisë “TCH” sh.a., shoqëri e së drejtës shqiptare, për shkak se Kontrata e Shitblerjes së Aksioneve me Nr.1154Rep. dhe Nr.598ç/Kol., datë 15.06.2007 e lidhur përpara noterit Artan Treska, është absolutisht e pavlefshme, pasi është kryer në kundërshtim me ligjin si dhe Urdhërimin e ç’regjistrimit nga regjistri i aksionarëve të Shoqërisë “TCH” sh.a të të paditurve A.S. dhe A.B. dhe nga regjistri i ekstraktit të Shoqërisë në QKR, pasi titulli në bazë të të cilit është bërë regjistrimi i tyre në regjistër, është i pavlefshëm”. Pala paditëse V.H dhe i ndjeri D.H kanë lidhur martesë ligjore më datë 17.08.1991. Palët e paditura L.H, S.H, R.H dhe I.H, janë femijet e të ndjerit D.H.

Shoqëria “TCH” sh.a., është një person juridik i së drejtës shqiptare, fillimisht e regjistruar me vendimin Nr.25561, datë 29.03.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në formën e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm, të ndjerin D.H, si zotërues i 100% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë. Me vendimin Nr.25561/6/7, datë 24.03.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur shndërrimi i Shoqërisë “TCH” Shpk, në shoqëri anonime dhe me objekt të ushtrimit të aktivitetit në fushën e veprimtarive televizive, prodhim, transmetim dhe ritransmetim i programeve, informacioneve, etj. Nga momenti i shndërrimit në shoqëri anonime dhe në vijim, 100% e aksioneve të Shoqërisë “TCH” sh.a., zotëroheshin nga i ndjeri D.H. Me kontratën e shitblerjes Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, i ndjeri D.H, në cilësinë e aksionerit të vetëm, ka disponuar shitjen e 40% të aksioneve të Shoqërisë “TCH” sh.a, tek blerësi, palë e paditur A. S, si dhe shitjen e 20% të aksioneve tek blerësi tjetër, i padituri A.B. Kontrata rezultoi e depozituar në regjistrin tregtar me vendimin Nr.25561/8, date 15.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në datë 23.05.2008, rezultoi e provuar se ka ndërruar jetë i ndjeri D.H. Me vendimin Nr.5259, datë 06.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore të të ndjerit, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshorten, paditesen V.H, dhe fëmijët, paditesit e tjerë Lorela, Sara, Redia dhe I.H. Më datë 18.01.2016, palët paditëse V.H, L.H, S.H, R.H dhe I.H, me cilësitë e bashkëshortes dhe trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit D.H, dhe njëkohësisht në cilësinë e aksionerëve të shoqërisë “TCH” sha, i janë drejtuar Gjykatës me padinë objekt gjykimi.

Argumentet e parashtruara nga pala paditëse:

- i. Paditësja V.H ka lidhur martesë ligjore me të ndjerin D.H, më datë 17.08.1991. Gjatë kohëzgjatjes së martesës, ndër të tjera, në bashkësinë ligjore është përfshirë edhe pasuria e krijuar me krijimin e Shoqërisë tregtare "Top Channel" sh.p.k, sot "Top Channel" sh.a. Rezulton se gjatë kohës së qënies gjallë të bashkëshortit të paditëses, të ndjerit D.H, ky i fundit me kontratën noteriale me Nr.1154Rep., Nr.598/2Kol., datë 15.06.2007 ka tjetërsuar 60% të aksioneve të zotëruara në Shoqërinë Top Channel sh.a, tek të paditurit A.S dhe Aurel Baçi, pa marrë pëlqimin e bashkëshortes së tij.
- ii. Pjesa e secilit bashkëshort është e papërcaktuar dhe për të kryer veprime disponimi apo veprime që tejkalojnë veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të përditshëm, mbi një send apo të drejtë, që përfshihet nën bashkësinë ligjore, duhet të ekzistojë pëlqimi i njëkohshëm i të dy bashkëshortëve.

- iii. Disponimi i sendeve në bashkësi ligjore mes bashkëshortëve nuk është i rregulluar drejtpërdrejt në mënyrë të shprehur në Kodin e Familjes. Meqenëse edhe veprimtaria tregtare përfshihet në pasurinë e përbashkët, duhet që sipas nenit 208 të Kodit Civil të japin pëlqimin të dy bashkëshortët, në përputhje edhe me nenin 90 të Kodit të Familjes. Neni 90 i Kodit të Familjes është një dispozitë urdhëruese e ligjit dhe mosrespektimi i saj sjell pavlefshmëri absolute të veprimit të disponimit të pasurisë.
- iv. Të vlerësojmë nëse duhet të gjejë aplikim afati i parashkrimit të nenit 94 i Kodit të Familjes. Rreziku i keqkuptimit të kësaj dispozite është vërtetë aktual, por mendojmë se edhe nga leximi i kujdesshëm i saj, i orientuar nga konceptet e drejta të së drejtës civile mund të kuptohet se nuk ka arsye të gjejë zbatim në rastin konkret. Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve. Në rradhë të parë ky nen bën fjalë për anulimin e veprimeve të bëra nga njëri prej bashkëshortëve. Termi anulim është i lidhur qartë me ato veprime që janë të anulueshme, pra veprimet juridike relativisht të pavlefshme. Përfundimisht, caktimi i një afati parashkrimi për ngritjen e kësaj padie, përjashton definitivisht mundësinë që të kemi të bëjmë me një veprim absolutisht të pavlefshëm, për shkak se kjo lloj pavlefshmërie është e pashërueshme nga çdo afat kohor. (Kështu, tjetërsimi i aksioneve të Shoqërisë "Top Channel" sh.a është kryer pa pëlqimin e të dy bashkëshortëve dhe për gjithë sa u tha më lart, ky veprim disponimi është nul dhe nuk ka prodhuar asnjë pasojë ligjore dhe për këtë shkak konsiderohet sikur nuk është kryer ndonjëherë dhe në përputhje me këtë, të drejtat e palëve quhet se nuk kanë ndryshuar ndonjëherë statusin juridik. Kjo do të thotë se kalimi i aksioneve nga i ndjeri D.H tek të paditurit A.Sdhe Aurel Baçi, nuk është kryer asnjëherë).
- v. Kontrata e shitjes së aksioneve si një veprim juridik fiktiv, si shkak i pavlefshmërisë. Në fakt kontrata e lidhur mes Dritan Hoxhës dhe të paditurve ka qenë një veprim fiktiv. Ajo është lidhur vetëm për të plotësuar për sy e faqe kriteret e nenit 20 të ligjit Nr.9742, datë 08.05.2007, që kërkonte që asnjë subjekt në fushën e medias të mos zotërohej për më shumë se 40% nga një person i vetëm. Është për këtë shkak që D.H lidhi për sy e faqe një kontratë me dy të njohur të tij, siç ishin të paditurit. Vlerësimi i fiktivitetit të kësaj marrëveshjeje është shumë i thjeshtë, pasi ai lidhet me caktimin dhe pagimin e çmimit të kontratës. Çmimi për të paditurin Albert Sino, për 40% të aksioneve, ishte 210,160,000 lekë dhe për të paditurin Aurel Baçi, për 20% të aksioneve, ishte 105,080,000 lekë. Këto çmime thuhet në kontratë se janë paguar jashtë zyrës së noterit, ndërkohë që nuk rezultojnë asnjëherë kryerja e kësaj pagese. Këto çmime ishin jo vetëm të pamundur për t'u paguar nga të paditurit, por edhe nëse do të ishin paguar, ato nuk mund të vërtetohen me deftesë të thjeshtë, për shkak se në kuadër të ligjit, ato duhet të paguheshin detyrimisht në rrugë formale bankare, për shkak të kufijve të caktuar me ligj. Kontrata e lidhur nuk mundet kurrsesi të zëvendësojë apo të shërojë veset e pagesës informale, që nuk është kryer asnjëherë dhe që nuk ka patur qëllim të kryhej për shkak se palët kanë simuluar veprimin juridik.

Argumentet e palës së paditur

- i. Shitja e aksioneve është bazuar mbi vendimin e aksionarit të vetëm të Shoqërisë "Top Channel" Sh.a, deri në atë moment, të ndjerit D.H, i marrë prej tij në datën 13.06.2007. Vendimi i aksionarit të vetëm i datës 13.06.2007 dhe kontrata e shitjes së aksioneve e datës 15.06.2007, janë depozituar, në përputhje me përcaktimet e ligjit të kohës, në regjistrin tregtar, me anë të vendimit Nr.25561/8, datë 15.06.2007 të gjyqtarit të vetëm të seksionit tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- ii. Duke analizuar dispozitat ligjore, rezulton se padia është ngritur mbi një bazë ligjore të gabuar. Sipas bazës ligjore të padisë rezulton se pala paditëse i mbështet kërkimet e saj mbi bazën e neneve 199 dhe 208 të Kodit Civil, nene këto nuk rregullojnë pasurinë bashkëshortore si pjesë e bashkëpronësisë në tërësi, por japin rregullim për bashkëpronësinë në pjesë.
- iii. Paditësja V.H, me cilësinë e përfituesit të aksioneve si pasojë e trashëgimisë nga i ndjeri D.H, ka që nga viti 2008 me këtë cilësi në shoqëri, ajo ka qenë plotësisht në dijeni të faktit të pronësisë së aksioneve të të dy të paditurve A.S. dhe A. B. Në këto kushte, ajo ka pasur dijeni për pronësinë e aksioneve nga dy të paditurit si edhe për origjinën e pronësisë së aksioneve të tyre.
- iv. Theksohet fakti se origjina e pronësisë së të paditurve mbi aksionet e Shoqërisë "Top Channel" Sh.a., është publike edhe nëpërmjet regjistrimit në regjistrin tregtar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, të kontratës së shitblerjes së aksioneve me Nr.1154Rep., dhe Nr.598/2Kol., datë 15.06.2007, e lidhur përpara noterit Artan Treska, si edhe të vendimit të aksionarit të vetëm, që ka miratuar shitjen e këtyre aksioneve. Në këto kushte, prezumohet se me anë të regjistrimit të kontratës së shitjes së aksioneve si edhe të vendimit të aksionarit, është kryer marrja dijeni e çdo personi për kryerjen e një akti të tillë. Në këto kushte, prezumohet edhe fakti se data e marrjes dijeni për shitjen e aksioneve, nëpërmjet kontratës së shitjes nga i ndjeri D.H tek të paditurit A.S. dhe A. B, është data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Sa më sipër, rezulton se e drejta e padisë është parashkruar, pasi padia nuk është ngritur brenda afatit 1-vjeçar, nga dita e marrjes dijeni. Pala paditëse ka njohur, pranuar dhe marrë vendime së bashku me të paditurit A.S. dhe A. B, në jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) raste, vendime të Mbledhjes së Aksionarëve dhe akte të tjera thelbësore për funksionimin e këtij subjekti tregtar në 6-7 vite, si bashkëaksionarë në Shoqërinë "Top Channel" Sh.a.
- v. Po kështu e drejta e ngritjes së padisë është parashkruar edhe për faktin tjetër, që kjo padi nuk është ngritur brenda 1 viti nga data që bashkëpronësia ndërmjet bashkëshortëve ka përfunduar. Sipas germës "a" të nenit 96 të Kodit të Familjes është parashikuar se: "bashkësia mbaron me vdekjen e njërit pret bashkëshortëve...". Në rastin objekt gjykimi, rezulton e provuar se bashkësia midis bashkëshortëve Dritan dhe Vjollca Hoxha ka mbaruar në datën 23.05.2008, datë në të cilën ka ndërruar jetë i ndjeri D.H. Ndërsa, në datën 06.06.2008 është vetë paditësja V.H, e cila i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur të lëshojë dëshminë e trashëgimisë ligjore për të ndjerin. Në këto kushte, edhe sikur t'i marrim të mirëqena pretendimet e ngritura nga pala paditëse, përsëri rezulton se kjo padi është ngritur jashtë afatit 1 (një) vjeçar të parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 96 të Kodit të Familjes.
- vi. Në rastin objekt gjykimi, provohet dhe se shitja e aksioneve nga shitësi D.H tek blerësit A.S. dhe A. B, është bërë kundrejt çmimit nominal të tyre, përkatësisht 210.160.000 lekë dhe 105.080.000 lekë. Aksionet nuk janë tjetërsuar me një çmim më të ulët se ai nominal dhe as nuk janë dhuruar në ndonjë mënyrë nga i ndjeri D.H, tek të paditurit në gjykim. Sipas legjislacionit të kohës, që ka qënë në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës për shitjen e aksioneve, nuk ka pasur ndonjë dispozitë ligjore, e cila lidhte vlefshmërinë apo fiktivitetin e veprimeve juridike civile me mënyrën apo formën e kryerjes së pagesave. Ligji i kohës lejonte palët në qarkullimin civil, që pagesat për çfarëdo shume të kryheshin

nëpërmjet palëve në çdo formë që ato binin dakord me njëra tjetren.

- vii. Nga ana tjetër kërkojmë të sqarojmë se, bashkësia ligjore dhe regjimi i saj vërtet cilësohet se përbëhet edhe nga "veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës", por nga ana tjetër, duhet që *kjo veprimtari tregtare, të ekzistojë edhe në momentin e përfundimit të bashkësisë*, pra në rastin objekt gjykimi, në momentin e ndërrimit jetë të bashkëshortit D.H dhe fitimit të cilësisë së trashëgimitarit nga paditësit në këtë gjykim. Çka do të thotë që, nëse veprimtaria tregtare (apo pjesë e saj) nuk ekziston më si e tillë në emër të bashkëshortit që ka ndërruar jetë në momentin e përfundimit të bashkësisë, ajo nuk i nënshtrohet përcaktimeve të nenit 74 të Kodit të Familjes.

Në përfundim, pas analizës së faktit, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve ndërgjyqëse dhe analizës së parashikimeve në ligj, bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile dhe nën Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë Nr.3, datë 29.03.2012, Gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar tek dispozitat ligjore, të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj, duke zgjidhur çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjykata paraqitet në rolin e një arbitri asnjans, i cili vlerëson në mënyrë të paanshme pretendimet e palëve dhe në fund i shpall ato të bazuara apo jo. Palët kanë të drejtë të parashtojnë para gjykatës interpretimin apo përcaktimin e tyre për faktet dhe të drejtat që lidhen me zgjidhjen e çështjes, por gjykata në ushtrim të pavarësisë dhe paanësisë së saj, i çmon vetë këto çështje, e nëse i gjen të bazuara pretendimet e palëve i pranon, në të kundërt i rrëzon. Parimi iura novit curia në këtë rast do të thotë se gjykata nuk i merr si të mirëqena shpjegimet e palëve në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por si njohëse e ligjit, e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, të bazuar në kriteret që parashikon Kushtetuta, Kodi i Procedurës Civile dhe ligjet e veçanta.... Gjykata vërtet e mbështet vendimin tek faktet e paraqitura gjatë gjykimit, por vlerësimin e tyre e bën në mënyrë të pavarur, d.m.th. nuk i merr të mirëqena përcaktimet e palëve, por pasi analizon provat e marra gjatë gjykimit e vlerëson vetë ekzistencën e fakteve me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Pra, gjykata nuk lidhet me përcaktimin që bëjnë palët në lidhje me faktet apo me ligjin që zbatohet për këto fakte.

Bazuar në nenet 314, 73 dhe 74 të Kodit të Familjes, në mungesë të një kontrate martesore midis bashkëshortëve V.H dhe të ndjerit D.H, Gjykata çmon se marrëdhëniet pasurore ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen regjimit pasuror të bashkësisë ligjore. Në nenin 74 gërma ç të Kodit të Familjes parashikohet si objekt i bashkësisë dhe veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës, e cila njihet në teorinë e së drejtës si bashkësi aktuale. Veprimtaria tregtare, sipas këtij neni, përfshin një listë joshtruese të formave me të cilat veprimtaria tregtare shfaqet në treg, që nga personi fizik, si subjekt i së drejtës tregtare, deri tek personat juridikë tregtarë. Në këtë aspekt, kjo dispozitë e Kodit të Familjes duhet të interpretohet në mënyrë të harmonizuar me legjislacionin që rregullon shoqëritë tregtare. Kështu, përse i përket shoqërive tregtare, do të konsiderohen se bëjnë pjesë në bashkësinë ligjore, pjesëmarrjet e njërit bashkëshortit në kapitalin e shoqërisë, të fituar gjatë martesës, kur pjesët e fituara prej tij, nuk bazohen në cilësitë personale dhe nuk përfshijnë aktivitetin personal të tij në administrimin e shoqërisë. Në rastin e shoqërive anonime, si shoqëri kapitali, ku cilësitë e bashkëshortit nuk janë të rëndësishme në zhvillimin e aktivitetit tregtar, aksionet e krijuara apo fituara gjatë martesës, bëjnë pjesë në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve. Sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se pjesëmarrjet në kapitalin e shoqërisë "TCH" sh.a., të të ndjerit D.H, në cilësinë e zotëruesit të 100% të aksioneve të saj, me natyrë nominative, bëjnë pjesë në bashkësinë ligjore të bashkëshortëve dhe si rrjedhojë do t'i nënshtrohet rregullimit ligjor sipas dispozitave të Kodit të Familjes të vitit 2003.

Bashkësia ligjore ndërmjet bashkëshortëve përfaqëson një bashkëpronësi sui generis, e cila shoqërohet nga një regjim juridik i posaçëm. Pra, bashkësia ligjore përfaqëson një modalitet të së drejtës së pronës private që i përket personave fizikë, e cila përbëhet dhe nga të mirat e fituara, nga secili bashkëshort apo të dy së bashku, gjatë martesës, mbi të cilat ata kanë një të drejtë pronësie të pandarë, e drejtë kjo që i jep mundësinë e ushtrimit të përbashkët të tagreve të posedimit, përdorimit dhe disponimit të këtyre sendeve apo të mirave. Në bazë të nenit 90 të Kodit të Familjes, rezultoi se kryerja e veprimeve të administrimit të bashkësisë, i nënshtrohen një rregullimi të ndryshëm, në varësi të llojit të administrimit, nëse ai është i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm. Në lidhje me këto koncepte nuk ekzistojnë përkufizime apo kritere ligjore, për të kategorizuar nëse një veprim administrimi cilësohet apo jo i zakonshëm. Megjithatë, sipas teorisë të së drejtës do të konsiderohen si veprime të administrimit të zakonshëm, çdo veprim nëpërmjet të cilit parandalohet zvogëlimi apo humbja e pasurisë, siç janë veprimet juridike që parandalojnë humbjen e një të drejte, veprimet juridike që realizojnë shfrytëzimin ekonomik të bashkësisë, disa veprime disponimi, veprimet juridike pa kundërshtim etj.

Sa më lart, arrihet në përfundimin se veprimet e administrimit jo të zakonshëm do të konsiderohen të gjitha ato veprime, të cilat do të konsiderohen me rëndësi për bashkësinë. Në këtë kontekst, do të konsiderohen me rëndësi të veçantë për bashkësinë edhe të gjitha ato veprime, të cilat kanë për qëllim të tjetërsojnë përfundimisht një send apo të krijojnë të drejta reale mbi të, në favor të personave të tjerë. Pra, nëse veprimi i administrimit jo të zakonshëm, siç është dhe tjetërsimi apo alienimi, kryhet nga njëri prej bashkëshortëve, bashkëshorti tjetër që nuk ka dhënë pëlqimin e tij, mund të vleftësojë veprimin, pra të japë pëlqimin e mëvonshëm, ose të kërkojë gjyqësisht me padi anulimin e veprimit juridik, sipas rregullave që rregullojnë pavlefshmërinë relative. Dhënia e pëlqimit të mëvonshëm për tjetërsimin nga ana e bashkëshortit të përjashtuar, i jep stabilitet përfundimtar apo siguri juridike, pasojave të një tjetërsimi të rregullt. Neni 94 i Kodit të Familjes synon të mbrojë arsyet që, bashkëshorti i përjashtuar nga dhënia e pëlqimit, nuk ka mundur t'i shfaqë si kundërshtime të mundshme në veprimet e kryera nga bashkëshorti tjetër. Pra, në rastin kur pas kryerjes së veprimit, bashkëshorti i përjashtuar tregon dhe pranon efektet juridike të kontratës së nënshkruar në mënyrë të veçantë nga bashkëshorti tjetër, nuk mund të mohojë një sjellje të tillë, në kuptimin e dhënies së pëlqimit. Duke u nisur nga specifika e marrëdhënies bashkëshortore, kërkimi i pavlefshmërisë relative ka natyrë personale dhe si rrjedhojë mund të paraqitet si vetëm nga bashkëshorti i jashtëm në veprim, i cili mund të vlerësojë, a posteriori, leverdisshmërinë e veprimit dhe të vendosë ngritjen e një padie.

Neni 94 i Kodit të Familjes përbën një parashikim jonormal, sipas të cilit një subjekt legjitimohet të kundërshtojë një kontratë të lidhur nga subjekte të tjera, të cilët janë bashkëshorti tjetër dhe i treti, që merr pjesë në veprim. Neni 94 disiplinon fatin e veprimeve të administrimit jo të zakonshëm, të kryera nga njëri prej bashkëshortëve pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër. Për këtë arsye, parashikohet një afat i limituar, brenda të cilit bashkëshorti i interesuar mund të kërkojë deklarimin e pavlefshëm të aktit të kryer, pa pëlqimin e tij, sipas deklarimit të pavlefshëm të veprimeve juridike në përgjithësi.

Nisur nga sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se tjetërsimi i aksioneve nga ana e të ndjerit D.H, me kontratën e shitblerjes Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, në cilësinë e aksionerit të vetëm, tek blerësi, palë e paditur A. S., dhe tek blerësi tjetër, i padituri A. B. legjitimon palën paditëse V.H, me cilësinë e bashkëshortes, për të kundërshtuar dhe kërkuar pavlefshmërinë e kësaj kontrate me anë të ngritjes së padisë, sipas nenit 94 të Kodit të Familjes dhe jo sipas nenit 92 dhe 208 të Kodit Civil. Koncepti i bashkësisë ligjore nuk mbivendoset me të drejtën e bashkëpronësisë mbi sendet e përbashkëta. Bashkësia ligjore është një tërësi të drejtash dhe detyrimesh, ku të drejtat formojnë aktivin e bashkësisë, ndërsa detyrimet pasivin e saj. Bashkësia ligjore është regjimi pasuror ndërmjet bashkëshortëve, i ndryshëm nga bashkëpronësia e zakonshme, dhe për të cilën

gjejnë zbatim vetëm dispozitat e Kodit të Familjes, si ligji i posaçëm që rregullon këto lloj marrëdhëniesh juridike civile.

Mbi prapësimin e palëve të paditura për parashkrimin e së drejtës së padisë së palës paditëse V.H, në cilësinë e bashkëshortes, Gjykata vëren se neni 94 i Kodit të Familjes, parashikon një afat të limituar prej një viti, brenda të cilit bashkëshorti i përjashtuar nga dhënia e pëlqimit dhe që nuk e ka dhënë atë më vonë, duhet të ushtrojë padinë për deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik, i cili nuk përbën një administrim të zakonshëm të pasurisë bashkëshortore. Sipas nenit 117 të Kodit Civil dhe nenit 94 të Kodit të Familjes, ky afat fillon nga data e marrjes dijeni për veprimin e tjetërsimit, pra të kontratës noteriale Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007 dhe ne çdo rast jo më vonë se data e mbarimit të bashkësisë, që është data, në të cilën ka ndërruar jetë i ndjeri D.H, 23.05.2008. Në interpretim logjik dhe sistematik, sipas nenit 112 të Kodit Civil, parashkrimi i padisë përmban kurdoherë dy kushte thelbësore, të cilat janë: Kalimi i një periudhe kohe të caktuar dhe Mosveprimin e titullarit për të ushtruar këtë të drejtë gjatë kësaj kohe¹⁴⁶.

Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, nga materialet e dosjes gjyqësore dhe nga sa është vërtetuar gjatë gjykimit, rezulton e provuar se pala paditëse V.H prezumohet se ka marrë dijeni për këtë veprim në datën në të cilën kontrata rezulton e depozituar në regjistrin tregtar, me vendimin Nr.25561/8, datë 15.06.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra afati brenda të cilit duhej të paraqitjesh padia ka përfunduar në datë 15.06.2008. Ndërkohë, që afati maksimal brenda të cilit, pala paditëse V.H duhet të ushtronte të drejtën e padisë, sipas nenit 94 të Kodit të Familjes, përfundonte, pavarësisht nga dijenia, në datë 23.05.2009, pra një vit pas mbarimit të bashkësisë, për shkak të vdekjes të të ndjerit D.H, në datë 23.05.2008.

Sa më lart, bazuar në nenin 112 të Kodit Civil, pala paditëse V.H nuk ka ushtruar të drejtën e padisë për deklarimin e pavlefshëm të veprimit juridik të kontratës noteriale Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, brenda afatit të parashikuar nga neni 94 i Kodit të Familjes, dhe si rrjedhojë e drejta e saj e padisë, në kuptimin substancial është shuar, dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës apo organi tjetër kompetent. Përsa i përket, pretendimeve për pavlefshmërinë absolute të kontratës noteriale Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, për shkak të mungesës së dhënies së pëlqimit të paditëses V.H, sipas neneve 92 dhe 208 të Kodit Civil dhe të legjitimitimit dhe të paditësve të tjerë për të kërkuar këtë pavlefshmëri, ashtu siç dhe u argumentua dhe më lart, Gjykata i gjen ato të pabazuar në ligj dhe si të tilla duhet të rrëzohen.

Një pretendim që ngrihet nga palët paditëse me padinë objekt gjykimi, është dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, për shkak të kontratës noteriale Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, ishte lidhur si një kontratë fiktive, pa patur si qëllim të krijojë pasojat e parashikuar në të për subjektet nënshkruese të saj. Palët paditëse pretendojnë se fiktiviteti provohet nga parashikimet në ligjin Nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili kërkonte që asnjë subjekt në fushën e medias të mos zotërohej për më shumë se 40% nga një person i vetëm. Është për këtë shkak që i ndjeri, D.H lidhi për sy e faqe një kontratë me dy të njohur të tij, siç ishin të paditurit. Në lidhje me këtë pretendim, me vendimin Nr.932, date 22.06.2000, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë unifikuar së në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mosperputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij, e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.

Në kuadër të pretendimit për fiktivitet, palët paditëse pretendojnë se çmimi i vendosur në kontratë, ishte i pamundur për t'u paguar nga të paditurit dhe nuk rezulton asnjëherë kryerja e kësaj pagese

¹⁴⁶ Paragrafi 61

jashtë zyres noteriale, për shkak se në kuadër të ligjit ato duhet të paguheshin detyrimisht në rrugë formale bankare, për shkak të kufijve të caktuar me ligj. Në vijim, palët paditëse argumentojnë se kontrata e lidhur nuk mundet kurrësesi të zëvendësojë apo të shërojë veset e pagesës informale, që nuk është kryer asnjëherë dhe që nuk ka patur qëllim të kryhet për shkak se palët kanë simuluar veprimin juridik.

Po kështu, bazuar në tërësinë e provave shkresore, sjellja e palëve të paditura A.S.dhe A.B., në cilësinë e aksionerëve të Shoqërisë "TCH" sh.a., në ushtrimin e tagrave të posedimit dhe të administrimit të aksioneve në shoqëri, pas lidhjes së kontratës noteriale Nr.1154Rep., Nr.598Kol., datë 15.06.2007, krijoi bindjen tek Gjykata se kontrata në fjalë nuk ka qënë fiktive, pra sa për sy e faqe. Gjykata çmon se lidhja e kontratës së tjetërsimit të aksioneve nga ana e të ndjerit D.H tek të dy të paditurit e tjerë A.S. dhe A.B., për t'iu përshtatur apo për plotësuar kërkesat ligjore për licënsimin e Shoqërisë "TCH" sh.a., në fushën e veprimtarisë për të cilën ajo ishte krijuar, jo vetëm që nuk çon në nivel provshmërie fiktivitetin, por nuk sjell as dyshimin për ekzistencën e një shkakut të tillë pavlefshmërie. Ky fiktivitet i pretenduar nga palët paditëse, në rast se do të provohej, jo vetëm që do të konsideronte kontratën objekt gjykimi si të tillë, por do të kategorizonte këtë veprim dhe si veprim juridik të kryer në mashtrim të ligjit, sipas nenit 92/b të Kodit Civil, dhe do të sillte si pasojë restitucionin në favor të shtetit, sipas nenit 106, po të Kodit Civil.

Një aspekt i rëndësishëm i transferimit të kuotave është kombinimi i transferimit të kuotave mes bashkëshortëve dhe personave të tretë, veçanërisht në rastet kur bashkëshortët kanë zgjedhur regjimin e bashkësisë ligjore. Në këtë rast, situata paraqitet komplekse pasi bazuar në praktikën gjyqësore sipas të cilës është mbajtur qëndrimi se kuotat përbëjnë pjesë të bashkësisë ligjore, por ndërkohë, cila do të jetë zgjidhja në rastin e një dhurimi mes bashkëshortëve? A vlen interpretimi i gjykatave shqiptare edhe në rastet kur njëri bashkëshort i dhuron kuota bashkëshortit tjetër? Nëse do të arsyetonim në këtë formë, do të kundërshtonim dispozitat e Kodit Civil i cili përcakton se *"Dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat kjo i pranon"*¹⁴⁷. Pra në thelb dhurimi (në këtë rast i aksioneve apo kuotave të një shoqërie) synon t'i transferojë palës, e cila përfiton dhurimin një send pa kundërshtëpërblim. Nëse do të supozonim se sendi i dhuruar nga njëri bashkëshort tek tjetri do t'i nënshtrohej pjesëtimit dhe do të konsiderohej send i përbashkët, kjo do të binte në kundërshtim më vetë qëllimin për të cilin është lidhur kjo kontratë. Praktika gjyqësore¹⁴⁸ ka qënë e pasur në këtë drejtim dhe ka marrë në shqyrtim çështjen si më poshtë : E.D dhe A.D. kanë lidhur martesë ligjore më datë 12.03.1996. Me vendimin nr.12935, datë 29.11.1995 është regjistruar si person juridik shoqëria tregtare "Fati B" SHPK, me ortakë A.D, zotërues i 10% të kuotave dhe I.Z, zotërues i 90% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë. Pas disa ndryshimeve në zotërimin e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë, ortakë të shoqërisë janë A.D dhe V.Ç, secili nga 50% të kuotave të kapitalit themeltar. Më datë 26.04.2000, ortakë e shoqërisë bëhet dhe paditësja E.D. duke zotëruar 20% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë (i ka blerë bashkëshortit 20 % të kuotave). Në vijim, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është shndërruar në shoqëri aksionare sipas vendimit të asamblesë së ortakëve dhe aksionerë të saj janë me aksionerë A.D, E.D dhe V.Ç. më tej E.D i ka rishitur bashkëshortit të saj kuotat e zotëruara dhe ky i fundit ia ka dhuruar të atit M.D. gjysmën e aksioneve që zotëronte në shoqëri. Më pas, më datë 15.11.2005, i padituri M.D. i ka shitur të paditurit tjetër L.P, 50% të aksioneve që zotëronte në shoqëri dhe paditësja E.D. ka pretenduar pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së kuotave me pretendimin se ato janë pjesë e bashkësisë ligjore dhe nuk mund të tjetërsohen pa miratimin paraprak të bashkëshortes duke pretenduar dhe pavlefshmërinë e veprimeve vijuese si veprime të cilat janë mbështetur në veprime juridike absolutisht të pavlefshme. Të paditurit në

¹⁴⁷ Neni 761 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

¹⁴⁸ Vendimi i Gjykatës së Lartë Nr.00-2014 – 1515 i Vendimit (36) date 06.02.2014

parashtrimet e tyre kanë parashtruar se kalimi i 80.000\$ është kryer në përputhje me ligjin, pasi sipas nenit 87 të K.Civil vitit 1981, mosmarrja e pëlqimit për tjetërsimin e sendeve të luajshme është një veprim i lejuar nga kjo dispozitë (kjo dispozitë është e ngjashme me nenin 74/b të K.Familjes në fuqi), ndërsa në lidhje me kontratën e dhurimit kanë parashtruar se ajo është bërë në përputhje me nenet 197, 198, 206 e 207 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”, për këtë transferim është i mjaftueshëm pëlqimi i dhënë nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë, po kështu edhe kontrata e kalimit të aksioneve të padituri L.P është e ligjshme pasi aksionet janë nominative dhe të drejtën për të disponuar e ka zotëuesi i tyre.

Gjykata arsyeton në pjesën që ka pranuar padinë se: “... sipas nenit 94 të K.Familjes tjetërsimi i shumës prej 80.000\$ nga i padituri A..D në favor të të paditurës Xh.D. është bërë pa pëlqimin e paditëses, që “në fakt ka kryer një veprim juridik në tejkallim të të drejtave të tij mbi pasurinë në bashkësi” e për rrjedhojë është i pavlefshëm.” Në lidhje me pjesën e padisë që ka rrëzuar gjykata, duke cituar edhe vendimin unifikues nr.3, datë 03.02.2006, arsyeton se: “... personi juridik ku i padituri A.D. ka patur në zotërim kuota të kapitalit themeltar është krijuar para lidhjes së martesës; me shitjen që paditësja u ka bërë aksioneve të saj tek i padituri, bashkëshorti, ajo “është zhveshur nga pronësia e saj mbi këto kuota, duke ia kaluar pronësinë ekskluzivisht të paditurit A.D. që bëhet pronar i vetëm i tyre”. Mbi ankimin e të dy palëve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1535, datë 10.12.2007, ka vendosur: “Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr.5646, datë 24.10.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke konstatuar pjesërisht të pavlefshme kontratën datë 2 Shtator 2005 lidhur ndërmjet të paditurve A.D e M.D dhe datë 15 Nëntor 2005 lidhur ndërmjet të paditurve M.D dhe L.P , vetëm përsa i përket 20% të aksioneve, duke i kthyer në gjendjen e mëparshme nëpërmjet ndryshimeve në regjistrin tregtar. Lënien në fuqi të vendimit për pjesën tjetër.”

Në arsyetimin e ndryshimit të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, gjykata e apelit arsyeton se: “... I padituri A.D, para lidhjes së martesës zotëronte 10% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë dhe se për këto kuota paditësja nuk mund të ketë pretendime, por në “vështrim të kërkesave të nenit 74/ç të Kodit të Familjes, “bashkësia përbëhet...veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës...Po ashtu, paditësja E.D. nuk mund të ketë pretendime për 20% të aksioneve që ka tjetërsuar në favor të të paditurit A.D....Mirëpo nga ana tjetër, diferenca prej 20% (50% - 10% - 20%) në aksionet prej 50% që i padituri A.D. ka tjetërsuar në favor të babait të tij...dhe nga ky i fundit tek i padituri tjetër L.P , janë kapitale të fituara gjatë periudhës martesore, kështu që ai nuk mund kurrsesi t'i tjetërsonte tek të tretët (...) pa marrë më parë pëlqimin e bashkëshortes së tij, paditëses E.D.. Të dy veprimet juridike (kontrata datë 2 shtator 2005 dhe 15.11.2005), pjesërisht vijjnë ndesh me kërkesat e ligjit dhe për rrjedhojë pjesërisht janë të pavlefshme”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se duke shqyrtuar provat e administruara ka konstatuar se ato nuk janë vlerësuar në lidhje me zgjidhjen e kërtimeve të palës paditëse, por ka interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin, në lidhje me kërkimin në padi për tjetërsimin e shumës 80.000 USD nga i padituri A.D. tek e paditura Xh.D. (nëna e të paditurit). Ndërsa në lidhje me kërkimin për konstatimin e pavlefshmërisë së dhurimit të aksioneve prej 50% të kapitalit të Shoqërisë “FATI B” sh.a., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se gjykata e apelit, e cila ka vendosur të ndryshojë pjesërisht vendimin nr.5646, datë 24.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit të aksioneve vetëm përsa i përket 20% të aksioneve dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Në lidhje me këtë kërkim drejt ka vendosur gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar në përputhje me ligjin se: “Me dt.26.04.2000 paditësja fiton pronësinë mbi 20% të kuotave të kësaj shoqërie dhe më vonë më dt.02.005.2003 ia shet ato të paditurit A.D. Duke disponuar në favor të të paditurit, i cili është bashkëshorti i saj, konsiderohet se paditësja është zhveshur nga pronësia e saj mbi këto kuota, duke ia kaluar pronësinë ekskluzivisht të paditurit Arben Dibra, që bëhet

pronar i vetëm i tyre”...E gjejmë me vend të citojmë vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë nr.3, datë 03.02.2006, ku përcaktohet se....”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka gjetur të drejtë këtë përfundim të gjykatës së shkallës së parë, pasi ashtu siç ka rezultuar e provuar i padituri A.D. ka qenë ortak i Shoqërisë Tregtare “Fati B” SHPK, me vendimin nr.12935, datë 29.11.1995, zotërues i 10% të kuotave së bashku me Ivan Zlatinov, zotërues i 90% të kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë. Pas disa ndryshimeve në zotërimin e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë sipas vendimit nr.12935/2, datë 27.01.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, ortakë të shoqërisë janë A.D. dhe V.Ç. secili nga 50% të kuotave të kapitalit themeltar. Paditësja E.D. dhe i padituri A.D. kanë lidhur martesë ligjore më datë 12.03.1996. Pra bashkëshortët bëhen posedues së bashku edhe të 40% të kuotave të shoqërisë, ndërkohë që 10% i padituri i kishte patur që përpara lidhjes së martesës. Duke qenë se paditësja më datë 02.05.2003, paditësja E.D. i ka shitur të paditurit A.D. 20% të aksioneve që ajo zotëronte në këtë shoqëri, përfundimisht paditësja E.D. nuk është më ortak e shoqërisë, duke mbetur kështu i padituri A.D. pronar i 50 % të aksioneve, ndërkohë që pjesa tjetër prej 50% ishte e ortakut tjetër V.Ç. Përsa u arsyetua më lart, ky Kolegj arrin në përfundimin se gjykata e apelit, e cila ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor në lidhje me pavlefshmërinë e dhurimit të kuotave nga i padituri A.D. te babai i tij i ndjeri M.D. (për të cilin është bërë kalimi procedural, pasi ka rezultuar se ka vdekur pas vendimit të gjykatës së apelit), është i pambështetur në prova e në ligj, duke gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor për këtë kërkim.Për pasojë të rrezimit nga gjykata e rrethit të këtij kërkitimi, për arsye e mësipërme, është i pabazuar edhe kërkitimi në padi për konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitjes së aksioneve të Shoqërisë “FATI B” sh.a. nga M.D te i padituri tjetër L.P. Duke arritur në përfundimin se i padituri A.D. ka qenë pronar i aksioneve prej 50 % në shoqërinë “FATI B” sh.a. dhe ai kishte të drejtë t’i shiste ato dhe kontrata e kundërshtuar është e vlefshme, për pasojë edhe tjetërsimi ndërmjet të paditurve M.D e L.P. është i ligjshëm.

Në lidhje me kërkimin në padi për pavlefshmërinë e kalimit të shumës 80.000 USD, e cila ndodhej në një llogari rrjedhëse pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë në emër të të paditurit A.D, nga ky i fundit tek e paditura XH.D, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon se gjykatat e faktit nuk kanë kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes, prandaj për këtë pjesë të padisë duhet të prishen të dy vendimet dhe çështja duhet të kthehet për rishqyrtim. Nga provat e administruara dhe të shqyrtuara nga gjykatat e faktit ka rezultuar se më datë 23 Shtator 2005 nga paditësja E.D. është ngritur padia për zgjidhjen e martesës. Gjykata e shkallës së parë me vendimin nr.5651, datë 16.07.2007 ka zgjidhur martesën dhe çështja është për gjykim pranë gjykatës së apelit. Në Tetor 2005 paditësja me padi ka kërkuar pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore, ndër të tjera edhe pjesëtimin e kuotave të Shoqërisë “Fati B” sh.a. dhe të shumave të ndodhura në llogarinë bankare pranë Bankës Amerikane.

Ndërkohë paditësja ka ngritur dhe këtë padi, për të cilën janë dhënë vendimet nr.1535, datë 10.12.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr.5646, datë 24.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Rezulton se padia objekt gjykimi bazohet në nenin 92 të Kodit Civil dhe në nenin 94 të Kodit të Familjes, kështu gjykatat e rigjykimit duhet të vlerësojnë në lidhje me atë pjesë të kërkitimit për të cilën çështja kthehet për rigjykim, pra të tjetërsimit të shumës prej 80.000 USD dhe kthimit të saj, mund të ngrihet si padi e mëvetësuar apo kjo pavlefshmëri konstatohet gjatë shqyrtimit të një padie themeli, pra mund të zgjidheshin gjatë shqyrtimit të padisë së pjesëtimin të pasurisë të ngritur nga paditësja E.D., pasi ashtu siç përcaktohet në dispozitat procedurale e materiale, në gjykimin për pjesëtimin e pasurisë gjykata heton dhe vendos rreth sendeve që janë në bashkëpronësi të palëve, bashkëpronarët dhe pjesët takuese duke mbajtur parasysh kontributin e bashkëpronarëve. Duhet të hetohet në lidhje me pretendimin për anulimin e tjetërsimit të shumës që gjendej në një llogari rrjedhëse, në emër të të paditurit A.D. dhe ku ai herë pas here, ashtu siç del nga kopja e gjendjes së llogarisë bashkangjitur shkresës së Bankës Amerikane të Shqipërisë

dt.05.01.2006, ka kryer derdhje e tërheqje, të cilat mund të kenë qenë për efekt të kryerjes së veprimtarisë së shoqërisë ku ai ishte ortak, apo kemi të bëjmë me pasuri në bashkësi.

Së fundmi, në një situatë të tillë, duhet mbajtur në konsideratë se pasuria e tjetërsuar pa pëlqimin e bashkëshortit tjetër, shuma në dollarë janë fituar para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Familjes, për rrjedhojë rregullohen nga dispozitat e Kodit Civil vitit 1981. Gjykata e rigjykimit duhet të përcaktojë saktë pas hetimit të plotë ligjin e zbatueshëm në mënyrë që të zgjidhë çështjen në përputhje me ato dispozita ligjore që zbatohen për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, duke patur parasysh se llogaria në fjalë është llogari rrjedhëse individuale dhe jo “depozitë kursimi”, ku dhe transaksionet në këtë llogari kanë qenë të vazhdueshme që nga viti 2000 kur është hapur. Padia është ngritur në vitin 2006, dhe sipas nenit 94/2 të K.Familjes padia për tejkallim të drejtave nga njëri prej bashkëshortëve mbi pasurinë në bashkësi mund të ngrihet për të kërkuar anulimin e veprimit “*brenda 1 viti nga data e marrjes dëjani për veprimin dhe, në çdo rast, jo më vonë se një vit nga mbarimi i bashkësisë*”, veprim që mbetet për t’u verifikuar nga gjykata e rigjykimit. Gjithashtu, duhet theksuar se qëndrimi i gjykatës në çështje të ngjashme do të duhej të fokusohet në aspekte procedurale me qëllim identifikimin e respektimit të afateve pasi tashmë çështja e përfshirjes së kuotave të shoqërive në bashkësinë ligjore është kthyer në një praktikë të konsoliduar.

- Përfshirimi i ortakut për shkak të dëmtimit të imazhit dhe shkeljes së detyrimit të e besnikërisë

Në çështjen konkrete, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve e shoqërisë (sh.p.k) e cila ushtron veprimtarinë e saj në prodhimin e birrës, ka vendosur përjashtimin e një prej ortakëve të shoqërisë me pretendimin se ai ka kryer shkelje të rënda dhe të përsëritura të procesit teknologjik për prodhimin e birrës, gjatë administrimit si administrator, me detyrën e kimistit teknolog, mori vendim që ai të zhdëmtonte dëmin e shkaktuar nga prodhimi i birrës jashtë standartit, duke e shlyer atë nëpërmjet mbajtjes së një milion lekëve, që ishte masa e kontributit fillestar të tij në krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë. Duke mbetur pa kontribut, paditësi përjashtohet nga shoqëria. Këtë vendim të saj mbledhja e Asamblesë së Ortakëve e ka bazuar në Statutin e shoqërisë dhe nenet 53, 55 e 59, të Ligjit nr.7638, date 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Vendimin e mësipërm të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, paditësi e kundërshtoi, duke kërkuar, gjyqësisht, konstatimin e pavlefshmërisë së tij, me pretendimin se, jo vetëm që ai nuk ishte emëruar administrator i shoqërisë tregtare “B.K” sh.p.k., por edhe se, shuma prej 1 milion lek; që ishte kontribut i tij në kapital, i qe mbajtur në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare” si dhe nuk mund të përjashtohet si ortak i kësaj shoqërie, pa dhënë pëlqimin e tij. Në këtë përfundim u arrit pasi, nga përmbajtja e dispozitave të kreut të IV-t të Ligjit nr.7698, date 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të cilat rregullojnë mënyrën e krijimit, formimin e kapitalit themeltar, pozicionin e ortakëve, marrëdhëniet midis tyre, organet drejtuese dhe modalitetet e tjera të funksionimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, rezultoi që ortakut (kur janë më shumë se një) i një shoqërie të kësaj forme (sh.p.k.) nuk mund të përjashtohet nga të qëniti ortak, pra, nga ortakëria, për asnjë veprimtari të ushtruar prej tij në këtë shoqëri, pavarësisht nga natyra dhe pasojat që mund t’i vijnë shoqërisë nga kjo veprimtari¹⁴⁹.

Pas plotësimit me korrektësi të detyrimeve që rrjedhin nga Akti i Themelimit (kontrata) dhe statuti i shoqërisë që është pjesë e pandarë përbërëse e tij, sikurse janë nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar (neni 40 i Ligjit nr.7638, date 19.1.1992), ofrimi efektiv i kontributeve (kur ndodhemi para rastit të krijimit të kapitalit themeltar me kontribute në natyrë, secili prej ortakëve të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, gëzon të gjitha të drejtat që burojnë nga fakti i të qëniti ortak i saj, natyrisht, në masën e përcaktuar nga ligji, masë, e cila kushtëzohet nga vlera konkrete e pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë, e cila, aritmetikisht, llogaritet në përqindje.

¹⁴⁹Vendimi i Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr.37 i Regj.Themeltar, Nr.39 datë 30.05.2002

Mbarimi i mandatit nominal i një ortaku të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, përveç vdekjes së tij, vërtetohet në praktike në njërin prej rasteve që parashikohen në dispozitat e neneve 46 (Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgim ose brenda familjes), 47 (transferimi të të tretët) dhe 49 (Transferimi ndërmjet ortakëve) të Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, rrethana këto që, sikurse rezultojnë nga aktet që janë administruar gjatë gjyqimit të çështjes, nuk kanë ekzistuar në rastin e marrjes së vendimit nr.1, datë 03.11.1994, të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë tregtare “B.K” -sh.p.k. Përveç kësaj, gjatë shqyrtimit të akteve që ndodhen në dosje, ndryshe nga sa përmendet në vendimin e asamblesë së ortakëve, paditësi nuk figuron të ketë qenë emëruar as administrator i saj, as i punësuar si teknolog në këtë shoqëri. Së fundmi, duhet theksuar se ky vendim paraqet rëndësi për studim pasi sanksionon nevojën e formalizimit të procedurave të brendshme të shoqërive sipas standardeve të kërkuara në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Në rastin konkret, mungesa e sanksionimeve të nevojshme mbi administrimin e shoqërisë kanë shkaktuar një konflikt gjyqësor, i cili vetëm ka rikonfirmuar se gjykata në procesin e administrimit të provave në çështjet që lidhen me shoqëritë tregtare, merr në konsideratë vendime të formalizuara, të regjistruara në QKB si dhe vendime të asamblesë, të cilat janë kryer në përputhje me procedurën e nevojshme. Duke qenë se Asambleja e Përgjithshme ka marrë vendim për përjashtimin e një ortaku duke i atribuar atij tagra dhe përgjegjësi, të cilat lidhen me administrimin e shoqërisë, ndërkohë që nuk ka pasur akte formale të cilat të vërtetojnë angazhimin e këtij të fundit në administrim, përbën një devijim nga përcaktimet ligjore.

Në një çështje tjetër gjyqësore¹⁵⁰, Gjykata e Lartë ka marrë sërish në shqyrtim një çështje që lidhet me transferimin e kuotave të shoqërisë. Në rastin në fjalë në momentin e krijimit dhe regjistrimit të shoqërisë më datë 22.02.1999, kapitali themeltar i saj paraqitet si kontribut në para në vlerën prej 100.000 lekë dhe është nënshkruar dhe derdhur nga të dy ortakët e shoqërisë në masën 50% secili (pra secili prej ortakëve ka kontribuar në kapitalin themeltar të saj me para në vlerën 50.000 lekë). Në vitet në vijim, referuar ekstraktit të QKR si dhe dokumentacionit të administruar në gjykimet, në fakt rezultojnë se nga ana e ortakëve të shoqërisë janë marrë disa vendime në kuadër të funksionimit dhe të zhvillimit të aktivitetit të saj dhe më konkretisht gjejmë vendime për caktim ekspertësh me qëllim vlerësimin e kontributeve në natyrë, që përbën zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, miratimin e raportit të ekspertëve, etj. Ndërsa, me vendimin nr.3, datë 04.11.2001 i Asamblesë së Ortakëve është vendosur zmadhimi i kapitalit të shoqërisë dhe ndryshimi i kuotave të ortakëve në kapitalin themeltar, për ortakun N.T. 51% dhe për ortakun K.T. 49%.

Vendimi sa sipër i asamblesë së ortakëve është pretenduar si i pavlefshëm nga paditësi me qëllimin e kthimit të së drejtës të kuotave zotëruese nga 50% për secilin ortak. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me vendimin nr.2096, datë 26.07.2012, ka vendosur *konstatimin e pavlefshmërisë të pikës 2 të vendimit nr.3, datë 04.11.2001, të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë tregtare “EVITA” Sh.p.k, Korçë, sot “TONA-CO” Sh.p.k, për miratimin e ndarjes së pjesëve të kapitalit themeltar midis ortakëve themelues të shoqërisë tregtare në masën: për ortakun N.T. 51% ose 2841 pjesë me vlerë 28410000 lekë dhe për ortakun K.T. 49 % ose 2730 pjesë me vlerë 27297814 lekë. Rimarrjen e së drejtës të zotërimit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare në masën 50% të tij nga secili ortak, duke arsyetuar se vendimi nr.3, datë 04.11.2001 i asamblesë së shoqërisë, për vendimmarrjen që lidhet me ndryshimin e pjesëmarrjes së kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare midis dy ortakëve themelues nuk është i mbështetur në dispozitat e ligjit për shoqëritë tregtare. Kjo pasi, si dhe u argumentua, ky ndryshim nuk mbështetet nga zmadhimi i kapitalit në para dhe/ose në natyrë, nuk mbështetet nga transferimi i kuotave midis*

¹⁵⁰Nr. 00-2016-861 i Vendimit (98), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë datë 23.03.2016

ortakëve, por mbështetet nga një marrëveshje e heshtur ndërmjet tyre. Duke qenë një marrëdhënie juridike, ajo konstatohet se nuk është parashikuar nga ligji për shoqëritë tregtare dhe kushtet e ekzistencës së saj nuk janë rrjedhojë e asnjë dispozite materiale apo procedurale e këtij ligji. Për rrjedhojë kemi të bëjmë me një marrëveshje juridike, e cila është absolutisht e ndaluar nga ligji tregtar dhe lloji i pavlefshmërisë së saj në këtë rast individualizohet se është pavlefshmeri absolute. Në të kundërt, Gjykata e Apelit, e cila ka shqyrtuar çështjen mbi ankimin e të paditurve “Tona-Co” sh.p.k dhe N.T. mbi të njëjtat akte me vendimin nr.282, datë 14.05.2013, ka vendosur *rrëzimin e padisë* me arsyetimin se në kundërshtim me sa pranon Gjykata e Rrethit, marrëdhënia e krijuar midis ortakëve të shoqërisë N.K. e K.T për ndryshimin e kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar të shoqërisë është tërësisht një akt i shoqërisë që gjen rregullim ligjor në dispozitat e ligjit nr.7638, dt.19.11.1992, “*Për Shoqëritë tregtare*”. Gjykata e Apelit, duke e konsideruar vendimin nr.3, datë 04.11.2001, të Asamblesë së Ortakëve si një akt të shoqërisë me të cilin janë shqyrtuar çështje pas themelimit të saj bazuar në nenin 238 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992, “*Për Shoqëritë Tregtare*” ka arritur në përfundimin se padia është e parashkruar.

Kolegji vlerëson se ky përfundim i gjykatës së apelit është i drejtë ligjërisht dhe i mbështetur në aktet e administruara në gjykim. Kështu rezulton se vendimi nr.3 i Asamblesë së Ortakëve është marrë në datë 04.11.2001, ndërsa padia për konstatimin e pavlefshëm të këtij vendimi është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë më datë 05.03.2012, pothuajse pas 11 vjetësh nga marrja e tij. Kolegji Civil konstaton se dhe pas marrjes së vendimit nr.3, datë 04.11.2001, të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria ka funksionuar mbi kuotat e pranuar nga ortakët respektivisht 49% për paditësin dhe 51 % për të paditurin. Ky ndryshim është pranuar dhe në vendimin nr.7, datë 12.04.2004, të Asamblesë së Ortakëve të nënshkruar nga ortakët N.T dhe K.T. Siç u pranua dhe nga palët ndërgjyqëse në gjykim, mbi kuotat e ndryshuara është realizuar dhe ndarja e fitimit të shoqërisë për vite të tëra pa shfaqur pretendime asnjëra palë.

Në nenin 238 të ligjit nr.7638, datë 10.11.1992, “*Për shoqëritë tregtare*” është parashikuar se: “*Paditë për pavlefshmërinë e shoqërisë ose të akteve dhe çështjeve të shqyrtuara pas themelimit të saj parashkruhen për tre vjet, duke filluar nga dita kur shoqëria vihet përballë aktit të pavlefshmërisë.(...)*”. Në këto rrethana kur kërkimi për pavlefshmërinë e një akti të shoqërisë është ngritur pas 11 vjetësh nga marrja e tij dhe gjatë tërë kësaj periudhe është pranuar dhe zbatuar nga palët ndërgjyqëse, Kolegji çmon se kjo kërkesëpadi është e parashkruar. Përsa i përket shkaqeve të tjera të ngritura në rekurs, Kolegji Civil çmon se janë jashtë objektit të gjykimit të Gjykatës së Lartë. Ato lidhen thjesht me çmimin e provës sipas ligjit e bindjes juridike nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit, pretendime që, në zbatim të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, nuk përbëjnë objekt shqyrtimi nga Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji.

KAPITULLI VI

MARRËDHËNIET MES ORTAKËVE DHE AKSIONARËVE NË SHOQËRINË TREGTARE

1. Përgjegjësia personale në shoqëri dhe abuzimi me formën e saj

Në doktrinën juridike mbetet një çështje gjerësisht e diskutuar, dallimi midis përgjegjësive së themeluesve dhe/ose ortakëve të një shoqërie në raport me shoqërinë si një entitet i vetëm pas fitimit të personalitetit juridik. Vlen për t'u theksuar se pavarësisht njohjes nga Kodi ynë Civil i shoqërive tregtare si persona juridikë, vija ndarëse mes përgjegjësive së personit juridik dhe ortakëve si persona fizikë mbetet një çështje e hapur.

Koncepti i përgjegjësive së kufizuar, është një nga standardet bazë të kontratave të nënshkruara në kuadër të së drejtës tregtare¹⁵¹. Të përcaktuarit të një përgjegjësive të kufizuar si një kusht i mirëqenë në kontratat me natyrë tregtare, ka ulur në fakt kostot e kontratave në para dhe kohë, pasi nuk është më i nevojshëm diskutimi për çështjet bazike lidhur me përgjegjësinë. Pala, e cila hyn në kontratë me një subjekt tregtar të formës "sh.p.k" e ka të paracaktuar kushtin themelor se shoqëria tregtare e kësaj forme do të përgjigjet deri në vlerën e kapitalit të saj. Koncepti i përgjegjësive së kufizuar synon në thelb të bëjë një balancë mes objektivit të ortakëve për të rritur gjithnjë e më tepër nivelin e fitimeve dhe përgjegjësive të tyre kundrejt të tretëve. Megjithatë, pjesëmarrja me kuota në një shoqëri tregtare nuk do të thotë se çdo garanci e lëshuar nga një ortak personalisht do të hyjë në rrethin e përgjegjësive së kufizuar. Kufizimet e përgjegjësive sigurisht zbatohen vetëm për garancitë/kontratat që shoqëria i lidh në cilësinë e personit juridik.

Përgjegjësia e kufizuar është elementi bazë që i ka bërë shoqëritë tregtare të llojit sh.p.k. të jenë mjaft tërheqëse për investitorët. Kjo pasi në këtë rast investitorët mund të marrin riskun e investimeve në shuma të mëdha apo me risk të lartë, duke mos pasur 'frikën' e përgjegjësive së pakufizuar dhe detyrimit për t'u përgjigjur me pasuritë personale. Nëse përgjegjësia do të ishte e pakufizuar, ortakët do të detyroheshin të monitoronin më në detaje sjelljen dhe ecurinë e shoqërisë, duke u angazhuar më tepër në çështjet e administrimit. Kjo qasje do të ishte e arritshme në rastin e shoqërive me një kapital dhe aktivitet të vogël, por do të ishte e pamundur në shoqëritë me aktivitet të lartë tregtar. Në këtë mënyrë, investitorët do të limitonin nivelin e investimeve me qëllim uljen e nivelit të riskut dhe përgjegjësive dhe rrjedhimisht ekonomia nuk do të ecte me ritme të kënaqshme.¹⁵²

Kjo është pikërisht e kundërta e qasjes së shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, tek të cilat përgjegjësia e ortakëve kushtëzohet nga niveli i kuotave si dhe përgjegjësia e ortakëve përkthehet

¹⁵¹ (Easterbrook and Fischel 1989: 1444).

¹⁵² Posner (1976: 499–526); Jensen and Meckling (1976: 305–60); Landers (1975: 589–652); Manne (1967: 259–84); Halpern, Trebilcock and Turnbull (1980: 117–50); Easterbrook and Fischel (1991: 41). The arguments are nicely summarised by Blumberg (1986: 611–23).

në shumë konkrete dhe ortaku e di në çdo moment sa është shuma për të cilën do të përgjigjet në rast humbejeje¹⁵³. Për sa i përket perspektivës së kreditorëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, mendoj se ata mund të cilësohen si persona, të cilët zgjedhin të ndërmarrin një risk të lartë, pasi kanë garanci të pakta monetare¹⁵⁴. Megjithatë, duhet theksuar se kreditorët pavarësisht zgjedhjes për të hyrë në një kontratë me një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të zbatojnë mekanizma ekonomikë të cilët mundësojnë mbrojtjen e investimit të tyre. Praktika ka treguar se kreditorët e sh.p.k-ve kanë zgjedhur kryesisht këto lloje mekanizmesh për të mënjanuar riskun: Ofrimi i çmimeve më të larta për konsumatorët, aplikimi i kamatë vonesave për pagesa të pashlyera apo të vonuara si dhe diversifikimi i riskut duke investuar në shoqëri të ndryshme me qëllim uljen e probabilitetit të humbjeve¹⁵⁵. Kreditorë të cilët kanë një peshë të konsiderueshme në shoqëri, mund të caktojnë kushte edhe më strikte për të garantuar kredinë e tyre, si për shembull: nënshkrimi i marrëveshjeve të huave, kufizimi i të drejtës së shoqërisë për të shitur apo vënë si garanci asetet e saj; vënia në garanci e asetëve të shoqërisë në favor të kreditorit; të kërkuarit e garancive personale nga ana e ortakëve.

Në praktikë në fakt ka probabilitet të lartë që kreditorët të pësojnë humbje veçanërisht për shkak të mungesës së informacionit në kohë reale të gjendjes së shoqërisë debitore dhe megjithatë rastet në të cilët shoqëritë janë zhveshur nga përgjegjia e tyre e kufizuar, janë tepër të rralla.

1.1. Përgjegjësia e administratorëve/ organeve drejtuese

Në përgjithësi ligjet tregtare parashikojnë mundësinë e përgjegjësisë personale të administratorëve në raste të caktuara¹⁵⁶. Kryesisht, koncepti i përgjegjësisë personale lidhet me veprime, të cilat janë kryer drejtpërdrejtë nga administratorët ose nga veprimet e personave të tretë, të cilët kanë qenë në kontroll direkt prej tyre. Koncepti i një përgjegjësie të kufizuar nuk ekziston më kur bëhet fjalë për administratorin. Arsyeja e një qasje të tillë, duket e logjikshme pasi në thelb administratorët janë praktikisht personat, të cilët kanë një kontroll të drejtpërdrejtë dhe kanë një informacion të prekshëm dhe në kohë rele mbi ecurinë e shoqërisë, ndërkohë që ortakët nuk e kanë një informacion të tillë. Megjithatë, një vlerësim i tillë vlen sigurisht për shoqëri të cilat kanë një numër të konsiderueshëm ortakësh dhe ku raporti ortak-shoqëri është disi më i largët, pasi e njëjta gjë nuk mund të thuhet për rastet kur shoqëria ka një ortak të vetëm ose dy ortakë. Në një rast të tillë, ky diskutim do të ishte thjesht teorik, pasi kur shoqëria ka në përbërje vetëm dy ortakë, sigurisht nuk mund të flitet për mungesë informacioni apo 'distancë' në çështjet e menaxhimit të shoqërisë. Në këndvështrimin tonë, janë pikërisht këto raste, në të cilat rritet mundësia e përfitimit nga forma e shoqërisë, me qëllim arritjen e përfitimeve vetjake për disa arsye:

Së pari: Ortakët me shumë mundësi janë të angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në administrimin e shoqërisë dhe kanë informacion të plotë mbi veprimet që kryhen për llogari të shoqërisë;

Së dyti: Shoqëritë tregtare me kapital të vogël, shpeshherë nuk krijohen për të ngritur një emër të mirë të shoqërisë apo për ta bërë shoqërinë të famshme, por për të krijuar një aktivitet specifik me një objektiv të caktuar. Për rrjedhojë, dhe një abuzim me formën e shoqërisë nuk do të sillte ndonjë dëmtrim imazhi, duke nxitur kështu ortakët për të ndërmarrë veprime abusive me formën e shoqërisë. Në shoqëritë e mëdha sigurisht që ulet probabiliteti për veprime të tilla, pasi imazhi i shoqërisë ndoshta do të vlente më tepër se sa shuma që do të përfitohej në rast abuzimi me formën¹⁵⁷.

¹⁵³ Halpern et al. (1980).

¹⁵⁴ Bainbridge 2001: 501–2

¹⁵⁵ Wishart 1991: 336

¹⁵⁶ *Corporations Act 2001* (Cwlth) s. 588G (1), s. 596AB(1)), *Environment Protection Act 1970* (Vic), s. 66B(1); *Occupational Health and Safety Act 2004* (Vic), s. 144.

¹⁵⁷ Easterbrook and Fischel 1991: 55, Bainbridge 2001: 501

Së treti: në këto lloje shoqërisë nuk vlen më argumenti se duhet kufizuar përgjegjësia e ortakëve me qëllim nxitjen e investimit nga ana e tyre.¹⁵⁸

Së katërti: Kuotat nuk tregtohen në mënyrë publike dhe nuk është e domosdoshme pasja e kuotave me çmime të qëndrueshme.

Në këto raste, kreditorët mendoj se duhet të tentojnë drejt garancive më të mëdha me qëllim uljen e riskut të abuzimit.

Në nenin 16 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” përcaktohen se cilat raste do të konsiderohen si abuzimi me formën e shoqërisë. Ortakët, aksionarët e shoqërisë tregtare, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) Abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) Trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) Në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.¹⁵⁹

Pra, ligji shqiptar e përcakton në mënyrë të shprehur rrethin e subjekteve, të cilën mund të mbajnë përgjegjësi personale në rast abuzimi:

1. Ortaku (në rastin e sh.p.k.);
2. Aksionari (në rastin e sh.a.);
3. Administratorët (për sh.p.k dhe sh.a.);
4. Anëtarët e Këshillit të administrimit (në rast sh.a.).

Arsyeja pse legjislatori ka rregulluar në mënyrë të shprehur rrethin e subjekteve mendoj se është një hap pozitiv, i cili nuk lë hapësirë për interpretime. Siç u përmend dhe më lart, dhe doktrina e së drejtën ka analizuar në detaje rolin e subjekteve të veçanta në administrimin e shoqërive dhe është mëse e arsyeshme që në rast abuzimesh, ky rreth subjektësh të mund të përgjigjet personalisht për dëmet e shkaktuara ndaj shoqërisë. Për të mbështetur më tej argumentin se këta persona janë të lidhur drejtpërdrejtë me menaxhimin e shoqërisë dhe kanë informacion në kohë reale mbi gjendjen e shoqërisë, po listoj në vijim kompetencat e njohura nga ligji për secilin nga subjektet. Administratorët e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ka këto kompetenca:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

¹⁵⁸ Freedman 2000: 317, 319–20, 327–35; Easterbrook and Fischel 1991: 55; Bainbridge 2001: 500–1; Millon 2006:6.

¹⁵⁹ Neni 16 i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut¹⁶⁰.

Duke analizuar kompetencat e tyre, është e qartë se ato janë të një natyre të tillë që lejojnë një informim të plotë të administratorëve në çdo kohë, madje ligji u ka njohur atyre si detyrë të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë. Kjo provon edhe një herë se pavarësisht se administratorët funksionojnë dhe realizojnë veprimtarinë e tyre mbi bazat e politikave të shoqërisë apo vendimeve të Asamblesë, ata kanë mundësi reale për të 'tjetërsuar' informacione apo edhe për të mos krijuar në kohën e duhur sisteme alarmi për situata që kërcënojnë veprimtarinë e shoqërisë.

Ndërkohë, kompetencat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit janë¹⁶¹:

- a) Të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- c) Të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- d) Të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- e) Të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- f) Të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- g) Të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit të administrimit për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit të administrimit për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- h) Të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit të administratorëve. Raporti i këshillit të administrimit, përmendur në shkronjën "e" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- i) Të emërojë dhe të shkarkojë administratorët, të ndajë kompetencat ndërmjet tyre;
- j) Të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
- k) Të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare, të certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve apo instrumenteve të tjera të borxhit;
- l) Të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, për themelimin e shoqërive tregtare ose të grupeve të reja;

¹⁶⁰ Neni 95 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁶¹ Neni 154 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

m) Të kryejë veprimet e tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Duke marrë në konsideratë kompetencat e njohura nga ligji për Këshillin e Administrimit, vlen i njëjti argument i përmendur më sipër për administratorët, pasi legjislatori u ka njohur këtyre subjekteve një numër të madh kompetencash, të cilat në rast se do të shfrytëzoheshin me qëllim abuzimi me formën e shoqërisë, do të kishin një impakt të lartë ekonomik dhe do të çënonin interesat e shoqërisë. Për analogji me dy subjekte të e sipërpërmendura, dhe ortaku/aksionari i një shoqërie, i cili me veprimet apo me mosveprimet e tij ka abuzuar me formën e shoqërisë për arritjen e përfitimeve të paligjshme, do të përgjigjet me pasurinë e tij personale.

Neni 16 i ligjit në vijim sanksionon gjithashtu se palët e treta nuk mund të ngrënë padi për përmbushjen e detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse shoqëria provon se i treti kishte pasur dijeni për abuzimin apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Padia duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes. Elementi subjektiv i përfshirë në këtë dispozitë 'dijenia e palëve të treta' mendoj se e bën disi të vështirë çështjen e të provuarit, por megjithatë në praktikë është një përcaktim i vlefshëm pasi nëse pala e tretë do të kishte dijeni për situatat abuzive, në thelb kjo palë do të ishte palë me shoqërinë, e cila ka kryer veprimet abuzive.

Në rastin objekt konflikti gjyqësor, me cilësinë e administratorit të Shoqërisë Olimpik Petrol sh.p.k., Ortaku i shoqërisë K.M., në muajin Prill 2005, i ka shitur shtetasit K.I. përkundrejt vlerës prej 900.000 lekë, sende individualisht të përcaktuara, dy depozita nafte, sende të luajtshme. Rezultoi se pas kryerjes së këtij veprimi juridik, kundër shtetasit K.M. është bërë kallëzimi, ndaj këtij veprimi, dhe administratori i shoqërisë Ortaku i saj K.M. është dënuar me vendimin e formës së prerë nr.4, datë 12.01.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprën penale të "Shpërdorim të kompetencave të administratorit", të parashikuar neni 164 të Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me të drejtë ka arsyetuar se "...në favor të të paditurit ekziston një mënyrë origjinale e fitimit të pronësisë sipas nenit 166 të K.Coivil dhe që përbën një rrethanë substanciale që e bën padinë të rrëzueshme. Sipas kësaj dispozite personi që në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponuesi i tij...".

Nga sa më sipër për Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë rezultoi se e drejta e pronësisë gjen mbrojtje ligjore, dhe që kalimi i pronësisë të rezultojë i ligjshëm, kërkohet si parakusht që tjetërsuesi të jetë pronari i sendit që tjetërsohet, pasi në rast se ai nuk është pronar i sendit, nuk mund të kalojë një të drejtë që nuk e ka vetë. Ky është një rregull i përgjithshëm dhe legjislatori ka parashikuar raste përjashtimore që gjejnë pasqyrim në nenet 166 dhe 167 të Kodit Civil. Përjashtimi i më sipër vlen vetëm për sendet e luajtshme dhe qëllimi *ratio* i këtij parashikimi është bërë nisur nga natyra e këtyre sendeve, pjesë e qarkullimit civil, të cilat kanë qarkullim më të shpejtë, për të siguruar shpejtësi dhe efektivitet në marrëdhëniet midis subjekteve të së drejtës, pra për një qëndrueshmëri dhe stabilitet në qarkullimit civil.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vlerëson se nga interpretimi i nenit 166 të Kodit Civil, për të fituar pronësinë mbi një send të luajtshëm, ligji vendos disa parakushte pozitive dhe negative. Së pari kërkohet ekzistenca e *i)* sendit të luajtshëm, sikundër është sendi objekt material i këtij konflikti, depozitat e naftës, të pranuar nga të dyja gjykatat; *ii)* ekzistenca e veprimit juridik për kalimin e pronësisë sikurse është kontrata e shitjes; *iii)* veprimi juridik të jetë kryer kundrejt shpërblimit sikurse ka rezultuar në shumën 900 000 lekë; *iv)* tjetërsuesi të mos ishte disponuesi i sendit, pasi në rast se tjetërsuesi është pronar i sendit nuk jemi para rastit të fitimit të pronësisë me mirëbesim i sendeve të luajtshme (neni 166 i K.Civil), por jemi para rastit të fitimit të sendit me anë të kontratës (neni 164 i K.Civil); *v)* fituesi i sendit duhet të jetë në mirëbesim, ku sipas nenit 306 të K.Civil, fituesi i sendit është posedues me mirëbesim, kur poseduesi nuk ka ditur ose nuk

ishte i detyruar të dinte se posedimi i tij është i paligjshëm. Mirëbesimi prezumohet dhe mjafton të ketë qenë në kohën e fitimit të posedimit. Në rastin në gjykim, pala e paditur/blerësi K.I. në prill të vitit 2005 nuk e ka ditur rrethanën që shtetasi K.M. nuk ka qenë administrator i shoqërisë paditëse, kjo nisur edhe nga rrethanat kur me vendimin nr.19055/2, datë 18.04.2001 të Gjykatës së Tiranës rezultojnë të jetë vendosur "Depozitimin e vendimit nr.2, datë 21.02.2001 të Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë Olimpik Petrol Saranda " sh.p.k.,...", duke u publikuar për të tretët dhe vendimi civil, i cili e ka deklaruar të pavlefshëm veprimin e mësipërm është i vitit 2007. Parakushte negative që duhet të jenë të pranishme në një rast të fitimit të pronësisë sipas nenit 166 të K.Civil, janë i) pronarit nuk duhet t'i ketë humbur sendi dhe ii) sendi të mos jetë pasuri publike, pra të jetë i regjistruar në regjistra publikë. Nga hetimi ka rezultuar se paditësja Shoqëria "Olimpik Petrol" sh.p.k., nuk i ka "humbur" këto sende të luajtshme dhe se depozitat e naftës objekt i veprimit juridik të shitjes nuk hyjnë në kategorinë e sendeve pronë publike, që janë të regjistruara në Regjistra Publikë apo të jenë lënë peng, fakte të cilat do të pengonin fitimin e pronësisë nga ana e palës së paditur K.I.

Nga ana tjetër rezultoi se Gjykata e Apelit Gjirokastrë ka arsyetuar se "...Në interpretim të dispozitës më sipër, në kundërshtim me sa konkludohet nga gjykata e shkallës së parë, çmton se ndodhemi para rastit përjashtimor të parashikuar nga paragrafi i dytë i dispozitës së mësipërme (shënimi i kolegjit-referuar neni 166 të K.Civil, paragrafi i dytë me përmbajtje, megjithatë fituesi, goftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur). Depozitat e karburantit konsiderohen send i vjedhur, përderisa janë shtënë në dorë nga personi fizik K.M. në mënyrë të paligjshme dhe duke e ditur se ishin pronë e Shoqërisë "Olimpik Petrol" sh.p.k., ku ka dhe cilësinë ortaku aktualisht. Ky është një koncept të cilin doktrina e definojnë për vjedhje...Gjithashtu fakti i deklarimit fajtor dhe dënimit të K.M. për veprën penale "Shpërdorimit të kompetencave", parashikuar nga neni 164 i Kodit Penal, përforcon idenë se ky shtetas duke vepruar fizikisht (për interesa personale) dhe jo si përfaqësues i shoqërisë në veprimin juridik të shitjes së pronës së paluajtshme të shoqërisë, ka përfituar në mënyrë të paligjshme çmimin e shitjes përmes përvetësimit paraprak dhe në mënyrë të paligjshme të depozitave të karburantit – pronë e shoqërisë paditëse. Konkluzioni i gjykatës penale qëndron i pavarur nga konkluzioni i gjykatës civile se ka vend për rivendikimin e depozitave të karburantit".

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se arsyetimi i mësipërm i gjykatës së apelit është një interpretim i gabuar i ligjit, porë ky edhe në harmoni me nenin 70 të K.Pr.Penale i cili parashikon se "Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm për sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari". Ortaku i saj K.M. është dënuar me vendimin e formës së prerë nr.4 datë 12.01.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për veprën penale të "Shpërdorimit të kompetencave të administratorit", të parashikuar neni 164 të Kodit Penal. Në këtë vendim rezultojnë se "...Provohet se në muajin prill të viti 2005, i pandehuri K.M., ka shitur dy depozita naftë të shoqërisë shtetasit K.I., i cili është pronar i një pike karburanti në fshatin Gjashtë Sarandë, përkundëjt vlerës prej 900 000 lekë gjithsej. Shitja e dy depozitave të karburantit është kryer nga vetë i pandehuri K.M. që në cilësinë e administratorit ka kryer shitje në dobi të vetë dhe kundër interesave të shoqërisë dhe në kundërshtim me përmbajtjen e statutit në pjesën me titull "Transferimi tek të tretët", me përmbajtjen "Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretët që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën ¼ e pjesëve të kapitalit themeltar të shoqërisë...".

Nga sa më sipër rezultojnë se se ky shtetas nuk është dënuar për veprën penale të vjedhjes, (shtënia në dorë e pasurisë së një personi fizik, juridik apo shtetit në mënyrë të fshehtë apo të hapur, me qëllim moskthimin më të saj), kjo edhe sipas vendimit penal të formës së prerë nga ku rezultojnë cilësimi juridik i veprës për të cilën është dënuar ky shtetas që është neni 164 i Kodit Penal. Në rastin konkret shtetasi K.M. ka vepruar në cilësinë e administratorit të shoqërisë, dhe në veprimin

juridik kontratë shitje ka marrë pjesë në cilësinë e administratorit të shoqërisë, pronare e sendeve, dhe jo në emër të tij. Në ligjin “Për Shoqërisë Tregtare”, në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve juridike, parashikon edhe veprimet e kryera në abuzim, jo vetëm të administratorit por edhe të ortakëve të një shoqërie. Sa më sipër u arsyetua, nuk mund të shërbejë si bazë ligjore paragrafi i 2 i nenit 166 të K.Civil, duke shërbyer si kusht negativ për fitimin e pronësisë.

1.2. Përgjegjësia në rastin e grupimeve të shoqërive

Nëse për individët është e nevojshme ekzistenca e përgjegjësisë së kufizuar, për rastet e grupimit të shoqërive, ky qëndrim nuk vlen. Për të arritur në një konkluzion për këtë çështje, duhen marrë në konsideratë disa faktorë, por megjithatë mendoj se një rëndësi të veçantë paraqet niveli i kontrollit të shoqërisë bijë nga shoqëria mëmë. Ky qëndrim mbështetet gjithashtu dhe nga disa studiuues të së drejtës. Mund të ndodhë gjithashtu që të përdoren modele të komplikua skemash midis shoqërive me qëllim që shoqëria mëmë të shfrytëzojë përgjegjësinë dhe kapitalin e kufizuar të shoqërisë bijë me qëllim marrjen e fitimeve prej saj. Përgjegjësia e kufizuar për shoqërinë mëmë sigurisht nuk duhet të ekzistojë në rastet kur shoqëria bijë është tërësisht e kontrolluar nga shoqëria mëmë, por megjithatë, në rastin e grupimeve të shoqërive, çështja e përgjegjësisë nuk mund të jetë aq e prerë sa në rastin e administratorëve. Kjo pasi për individët janë lehtësisht të përcaktueshme rastet kur mund të ketë një abuzim me formën e shoqërisë, por ndërkohë në rastin e grupimeve përgjigja nuk mund të jetë kaq e prerë. Fakti që ekziston një probabilitet i mundshëm për abuzim me formën në rastin e shoqërive mëmë që shfrytëzojnë shoqëritë bija, nuk mund të kthehet në një spekulim. Rasti i përgjegjësisë së shoqërisë mëmë duhet të analizohet duke nxjerrë në pah se çfarë mund të kishtë bërë shoqëria mëmë për të siguruar që shoqëria bijë të kishte vepruar siç duhet dhe të kishte siguruar kapitalin në mënyrën e duhur.

Bazuar në nivelin e kontrollin, shoqëritë mëmë mund të kenë të drejtë vote në Bordin drejtues së shoqërisë bijë dhe për rrjedhojë të ndikojnë në përzgjedhjen e aktiviteteve tregtare me një risk të ulët dhe që në thelb nuk përbëjnë një abuzim me kontrollin e shoqërisë. Në këtë kontekst është e qartë se duhet të ekzistojë një lloj përgjegjësie për këto shoqëri në rast se nuk arrijnë të përcaktojnë siç duhet risqet e investimeve nga ana e shoqërive bija. Legjislacioni Amerikan, ka një përcaktim interesant mbi përgjegjësinë e shoqërive mëma. “Nën-kapitalizimi”¹⁶² konsiderohet si një nga rastet në të cilat shoqëria mëmë konsiderohet si “fajtores” në raste abuzimesh nga shoqëria bijë. “Nën-kapitalizimi” mund të ndodhë si pasojë e mungesës së një kapitali fillestar të mjaftueshëm ose zvogëlimi i aseteve kohë pas kohe, shkëmbimi i aseteve mes shoqërisë mëmë dhe asaj bijë apo si pasojë e shprëndarjes së dividendëve në mënyrë të tepruar. Kjo çështje duhet parë gjithnjë në lidhje me nivelin e sigurisë/ garancisë së ofruar nga një shoqëri. Sa më i lartë të jetë niveli i garancisë së shoqërisë, aq më pak kapitalizim do të nevojitet.

Legjislacioni shqiptar njeh dy grupime shoqërisë: Grupin kontrollues dhe atë influencues. Vlerësohet se ekziston një marrëdhënie mëmë-shoqëri e kontrolluar, kur një shoqëri tregtare sillet e vepron rregullisht, sipas orientimeve dhe udhëzimeve të një shoqërie tjetër. Ky kontroll quhet grup kontrollues¹⁶³. Kur një shoqëri, në bazë të pjesës së kapitalit të zotëruar në një shoqëri tjetër ose në bazë të një marrëveshjeje me atë shoqëri, ka të drejtë të emërojë të paktën 30 për qind të administratorëve, të anëtarëve këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës të saj, apo kur ajo zotëron të paktën 30 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme, atëherë kjo shoqëri vlerësohet si mëmë e shoqërisë tjetër, ndërsa shoqëria tjetër vlerësohet shoqëri e kontrolluar. Ky kontroll quhet grup influencues. Në rastet e grupit kontrollues, shoqëria mëmë

¹⁶² Sipas legjislacionit amerikan, koncepti “Nën-kapitalizim” nënkupton situatën kur asetet e shoqërisë nuk mund të mbulojnë detyrimet e saj.

¹⁶³ Neni 207 i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

detyrohet të mbulojë humbjet vjetore të shoqërisë së kontrolluar. Ortakët apo aksionarët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo çast mëmës t'u blejë kuotat, aksionet apo obligacionet e zotëruara prej tyre në shoqëri. Kreditorët e shoqërisë së kontrolluar kanë të drejtë t'i kërkojnë në çdo çast mëmës t'i ofrojnë garancitë e mjaftueshme për kreditë e tyre shoqërisë së kontrolluar.

Pavarësisht së në doktrinë trajtohet gjerësisht çështja e përgjegjësive në rast të grupimeve të shoqërive, në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" nuk ka një përcaktim eksplicit të rasteve të abuzimit me formën e shoqërisë në rastin e grupimeve. Duke qenë se neni 16 i përmendur më sipër hyn në kategorinë e parimeve të përgjithshme të ligjit, mendoj se i njëjti parim do të vlejë dhe në rastin e grupimeve të shoqërive, për sa kohë që nuk ka ndonjë rregullim më specifik për to. Megjithatë, garancia që ligji u njeh kreditorëve të shoqërive bija është një garanci e konsiderueshme, e cila mundëson mënjanimin e abuzimeve të mundshme.

1.3. Përgjegjësia personale e administratorit

1.3.1. Përgjegjësia Civile

Koncepti i përgjegjësive personale të administratorëve ka lindur si një domosdoshmëri me krjimin e shoqërive me qëllim mbrojtjen e interesave të shoqërive, të cilat i besojnë aspekte të rëndësishme të menaxhimit disa personave fizikë siç janë administratorët. Sipas legjislacionit shqiptar, administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, ata janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë¹⁶⁴. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët (e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar) janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme¹⁶⁵:

- a) U kthejnë ortakëve kontributet;
- b) U paguajnë ortakëve interesa apo dividendë;
- c) U shpërndajnë aktivet shoqërisë;
- d) Lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Japin kredi.

Në rastin e një shoqërie aksionare, përveç rrethanave të përmenduar më sipër, ligji parashikon se do të konsiderohet shkelje e detyrimeve ligjore, nëse administratorët kryejnë këto veprimtari¹⁶⁶:

- a) Nënshkruajnë, blejnë, pranojnë si garanci apo anulojnë aksionet e shoqërisë;
- b) Emetojnë aksione përpara kalimit të kontributit në natyrë apo shlyerjes së vlerës nominale ose me çmim më të lartë;

¹⁶⁴ Neni 98 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁶⁵ Neni 98 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁶⁶ Neni 163 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

- c) Në rast të zmadhimit të kapitalit, emetojnë aksione përpara përmbushjes së kushteve apo kur kontributi nuk është kaluar sipas kërkesave të nenit 123 të ligjit;
- d) Kryejnë pagesa në favor të anëtarëve të këshillit të administrimit apo administratorëve.

1.3.2 Përgjegjësia Penale

Koncepti i përgjegjësisë penale të administratorit sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian, merr një dimension të ri për shkak të ekzistencës së mundësisë së transferimit të shoqërive nga një vend anëtar në një tjetër. Janë të shumëta rastet e shoqërive që krijohen në një vend anëtar në të cilin rregullat e krijimit janë më të thjeshtëzuar dhe kapitali minimal i lejuar është më i vogël dhe ndërkohë tranferojnë vendin e ushtrimit të aktivitetit në një vend tjetër anëtar¹⁶⁷. Në këtë rast, duke qenë se ka një mospërputhje mes vendit të regjistrimit dhe vendit të ushtrimit të aktivitetit, ngrihet çështja e juridiksionit të gjykatës, e cila do të mund të marrë në shqyrtim përgjegjësinë e administratorit.

Interpretimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian mbi të drejtën e vendosjes, siç është përmendur dhe në Kapitullin 1 të këtij dizertacioni, ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në shumë aspekte të shoqërive tregtare, të cilat kanë zhvilluar teorinë e “Selisë Reale”. Çështja e përgjegjësisë civile të administratorëve, siç u përmend dhe më sipër, ka qenë më e elaboruar dhe më e hasur në praktikë dhe praktikat kryesore lidhen me përgjegjësinë e administratorëve në rast falimenti, mos marrjen e masave të alarmit nga ana e tyre në rast rreziku për një krizë financiare të shoqërisë etj. Çështja e përgjegjësisë penale, veçanërisht pas gjykimit të çështjeve Centros¹⁶⁸, Überseering¹⁶⁹ dhe Inspire Art¹⁷⁰, duket se u bë më aktuale me ratifikimin e të drejtës së shoqërive për vendosje në vendet anëtare të BE-së.

Me qëllim analizimin e juridiksionit të gjykatave të vendeve anëtare në rastin e përgjegjësisë penale të administratorëve do të trajtojmë një rast hipotetik në të cilin specifikohen hapat dhe analiza juridike e nevojshme e akteve, me qëllim identifikimin e juridiksionit të gjykatës.

Rast Hipotetik

Shoqëria A është krijuar dhe regjistruar sipas legjislacionit Anglez në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Kjo shoqëri e ushtron veprimtarinë e saj në Gjermani dhe ka si administrator personin X. Në vitin 2014, administratorit të shoqërisë i është hequr e drejta për të qenë drejtues në shoqëritë tregtare për shkak të një dënimi penal të dhënë në Angli. Administratori, zhvillon tashmë veprimtarinë e tij në Gjermani, shtet në të cilin ka paraqitur të dhëna të rreme mbi gjendjen financiar të shoqërisë dhe nuk ka shlyer detyrimet tatimore sipas legjislacionit gjerman. Pyetjet që shtrohen për diskutim janë:

1. A ka të drejtë administratori të ushtrojë veprimtarinë në Gjermani, ndërkohë që në Angli ekziston një vendim i cili ia mohon këtë të drejtë?
2. A ka juridiksion Gjykata Gjermane për të analizuar përgjegjësinë e administratorit për falsifikim të dokumentave të shoqërisë dhe cili do të jetë ligji i aplikueshëm?

¹⁶⁷ Ladiges, M. Criminal liability of Directors of a private limited liability company seated in Germany, Criminal Law Forum (2013) 24:87–111, faqe 2

¹⁶⁸C-212/97 Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen [1999] ECR I-1459

¹⁶⁹ C-208/00 Überseering BV v. Nordic Construction Company Baumanagement GmbH (NCC) [2000] ECR I-9919

¹⁷⁰C-167/01 Kamer van Koophandel en Fabrieken voor Amsterdam v. InspireArt Ltd [2003] ECR I-10155.

3. A ka juridiksion Gjykata Gjermane për të shqyrtuar dëmin ndaj organeve tatimore gjermane për mospagimin e taksave dhe cili është ligji i aplikueshëm?

Praktika gjermane, ka një praktikë të zhvilluar në lidhje me këto çështje dhe qëndrimi mbi përgjegjësinë penale ka qenë i unifikuar. Nëse administratori ka përdorur formën e shoqërisë për të kryer praktika jo të ligjshme, çështja do të klasifikohet si mashtrim (sipas legjislacionit gjerman)¹⁷¹ dhe fakti që shoqëria është regjistruar në një vend tjetër anëtar të BE-së, nuk e pengon aspak gjykatën gjermane të shqyrtojë çështjen. Kjo gjithashtu nuk e cënon aspak të drejtën e vendosjes të përcaktuar në Traktatin e Lisbonës, pasi ky traktat (si dhe praktika e Gjykatës së Drejtësisë së BE) i njeh gjithashtu Vendeve Anëtare të drejtën për të ndërmarre masat e nevojshme me qëllim ndalimin e shtetasve që tentojnë të kryejnë veprimtari mashtruese duke përdorur të drejtat e njohura nga traktatet apo e drejta komunitare në përgjithësi.

1.3.3. Detyrimi për të paraqitur gjendjen e falimentit

Gjykatat Gjermane¹⁷² dhe pjesa më e madhe e autorëve¹⁷³, për vite me rradhë kanë mbajtur qëndrimin se ky detyrim nuk vlen për administratorët e shoqërive të regjistruara në një vend tjetër anëtar (nga ai ku pretendohet shkelja). Aktualisht, në Gjermani ligji për shoqëritë tregtare e ka paraqitur në mënyrë të shprehur detyrimin e administratorëve për të deklaruar gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, pavarësisht vendit të regjistrimit të saj. Megjithatë qëndrimi i doktrinës tashmë nuk është më i unifikuar dhe, autorët kanë qëndrime të ndryshme mbi detyrimin e administratorit të një shoqërie të regjistruar në një vend anëtar, të deklarojë falimentin në një vend tjetër anëtar në të cilin shoqëria kryen aktivitet ekonomik¹⁷⁴.

Diskutimi kryesor teorik është nëse kjo çështje do të kategorizohet si një çështje e së drejtës tregtare apo si një aspekt i ligjit për falimentin. Mendoj se qëndrimi i autorëve të cilët e klasifikojnë këtë çështje si një aspekt i legjislacionit mbi falimentin është më i drejtë, pasi në thelb, e drejta e falimentit mund të konsiderohet si një 'nënkategori' e së drejtës tregtare që prek në thelb vetëm një nga aspektet e saj. Për rrjedhojë, dhe detyrimi i administratorit për të deklaruar gjendjen e paaftësisë paguese (falimentin) nuk mund të shikohet vetëm si një përcaktim i së drejtës tregtare, por më tepër si një detyrim i sanksionuar dhe nga e drejta e falimentit (pavarësisht shtetit në të cilin është regjistruar shoqëria tregtare). Në thelb ky detyrim i administratorëve përbën një garanci për kreditorët e shoqërisë dhe një masë parandalimi ndaj falimentit. Gjithashtu duhet të mbajmë në konsideratë se për sa kohë e drejta për të deklaruar falimentin është qartazi pjesë e legjislacionit për falimentin, e njëjta logjikë duhet të vlejë dhe për detyrimin e paraqitjes së gjendjes së kësaj paaftësie paguese¹⁷⁵.

2. Marrëdhëniet mes ortakëve

2.1. Përjashtimi i ortakut

¹⁷¹ B. Gross & A. T. Schork, 'Strafbarkeit des directors einer Private Company Limited by Shares wegen verspa' teter Insolvenzantragstellung' (2006) Neue Zeitschrift für das Recht der Insolvenz und Sanierung 10- 12

¹⁷² Landgericht (Regional Court) Gera (2004) wistra – Zeitschrift für Wirtschafts- und Steuerstrafrecht 435 dhe Amtsgericht (Local Court) Gera (2004) wistra – Zeitschrift für Wirtschafts- und Steuerstrafrecht 435 (Gjykim lidhur me një kompani nga Panamaja, e vendosur në Gjermani).

¹⁷³ Nga një studim i shkurtër i qëndrimeve të autorëve gjermane mbi këtë detyrim të administratorëve arrij në këtë konkluzionin se shumica prej tyre mbajnë qëndrim të njëjtë: C. Just, Die englische Limited in der Praxis (3rd edn), München: Verlag C.H. Beck 2008), p.342

¹⁷⁴ S. Kolmann, 'Kommentierung § 64 GmbHG' in I. Saenger & M. Inhester (eds.), GmbHG (Baden-Baden: Nomos Verlag, 2011),

¹⁷⁵ Ladiges, M. Criminal liability of Directors of a private limited liability company seated in Germany, Criminal Law Forum (2013) 24:87–111, faqe 13

Si rregull, ortakët të cilët zgjedhin të krijojnë një shoqëri apo blejnë kouta në një shoqëri ekzistuese, kanë një objektiv të përbashkët: arritjen e qëllimeve ekonomike dhe maksimizimin e fitimeve të shoqërisë. Në thelb, blerja e kuotave të shoqërisë do të thotë ushtrimi i një aktiviteti ekonomik. Parë në këtë këndvështrim, koncepti i përjashtimit të ortakut duket si një zgjidhje ekstreme për sa kohë që përbën një çënim i të drejtës për të zhvilluar një aktivitet ekonomik. Pavarësisht se '*prima facie*' përjashtimi mund të duket i padrejtë, praktika ka treguar se kjo është një qasje e drejtë, e cila ndikon pozitivisht në ecurinë e një shoqërie tregtare. Në rastin e shoqërive të personit, marrëdhënia mes ortakëve është një marrëdhënie personale, e cila ndërtohet mbi baza besimi të dyanshëm, ndërkohë që në shoqëritë e kapitalit, një element i tillë jo detyrimisht është prezent. Theksoj se rastet e përjashtimit duhet të jenë të argumentuara bindshëm pasi në thelb janë dy të drejta të cilat kundërshtojnë njëra tjetrën: E drejta e një apo disa ortakëve për të zotëruar kuota në një shoqëri të zgjedhur prej tyre dhe e drejta e disa ortakëve të tjerë për të ushtruar aktivitetin e tyre ekonomik me persona të besuar, të cilët nuk çënojnë veprimtarinë dhe imazhin e shoqërisë.

Rastet e përjashtimit të ortakëve janë të sanksionuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe në varësi të formës së shoqërisë janë si më poshtë:

- a) Në rastin e *shoqërisë kolektive dhe komandite*, përjashtimi i ortakut bëhet në rast se ai me dashje ose si pasojë e pakujdesisë së rëndë, nuk ka kryer detyrat e caktuara në statut, apo nëse kryerja e këtyre detyrave është bërë e pamundur¹⁷⁶.
- b) Në rastin e *shoqërive më përgjegjësi të kufizuar*, në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme ...por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut: me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë; me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë¹⁷⁷.

Është e dukshme se premisë kryesore për përjashtimin e një ortakut nga shoqëria është shkaktimi i dëmeve ndaj shoqërisë dhe shkelja e dispozitave ligjore e nënligjore. Legjislatori ka përcaktuar disa rrethana orientuese, të cilat mund të konsiderohen si shkak për përjashtimin e një ortakut, por megjithatë e ka lënë të hapur këtë listë arsyesh për t'u gjykuar rast pas rasti. Dispozita përmban *elementë objektivë* siç janë: shkaktimi i dëmit dhe shkelja e statutit apo e dispozitave ligjore, por lë të hapur për diskutim dhe disa *rrethana subjektive* të cilat do të duhet të gjykohen rast pas rasti për shembull: përfshirja në veprime të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut, përcaktimi i 'pakujdesisë së rëndë' etj.

Një element i rëndësishëm në rastet e përjashtimit të ortakëve është rregullimi i pasojave të largimit, veçanërisht pasojat mbi kuotat që zotëronte ortakut.

Në rastin e *shoqërisë kolektive dhe komandite*: Në rast përjashtimi...ortakët mund të zbresin nga shuma e kuotës vlerën e dëmit të mundshëm, që shoqëria ka pësuar nga mospërbushjet e ortakut.¹⁷⁸

¹⁷⁶ Neni 47-48 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁷⁷ Neni 102 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

¹⁷⁸ Neni 49 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Në rastin e *shoqërive më përgjegjësi të kufizuar*: Shoqëria ka të drejtë t'i kërkojë ortakut të përjashtuar shpërblimin e dëmit të pësuar nga veprimet, që kanë sjellë përjashtimin. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar dhe ai nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkak të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria¹⁷⁹. Të gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prerë të gjykatës për largimin ose përjashtimin dhe Statuti nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun.

2.2. Procedura për përjashtimin e ortakut-Kuorumi i nevojshëm

Një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është themeluar nga dy ortakë, I.P., që është zgjedhur dhe administrator i shoqërisë dhe ortakut tjetër, i padituri R.K., secili me nga 50%, të kapitalit të shoqërisë. Në këto rrethana shoqëria ka zhvilluar një aktivitet normal deri rreth vitit 2010, periudhë në të cilën rezultoi se mes ortakëve ka patur mosmarrëveshje lidhur me aktivitetin, drejtimin dhe vazhdimin e funksionimit të shoqërisë. Pavarësisht mosmarrëveshjeve, rezultoi se shoqëria ka vazhduar aktivitetin e saj, ndërkohë që kishte hyrë tashmë në fuqi edhe ligji nr.9901, dt.14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Pikërisht në respektim të *nenit 230* të këtij ligji, që parashikon "detyrimin e shoqërive ekzistuese që të pershtasin organizimin dhe funksionimin e tyre sipas dispozitave të këtij ligji brenda 3 viteve nga hyrja në fuqi e tij", administratori I.P., ka njoftuar me dt.16.05.2011, ortakun R.K që më dt.18.05.2011, përpara përfundimit të afatit ligjor, të mbledhin asamblenë e ortakëve për bërë përshtatjet e nevojshme në statutin e shoqërisë. Në këto kushte, dhe pas refuzimit të njërit prej ortakëve për të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve, për mundësinë e ndryshimit të statutit të shoqërisë, Asambleja e Shoqërisë, me pjesëmarrjen vetëm të ortakut I.P., më dt.18.05.2011, ka marrë vendim "t'i drejtohet gjykatës për përjashtimin e ortakut tjetër.

Nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë, rezultoi se rrëzimin e padisë kjo gjykatë e ka bërë mbi arsyetimin se Vendimi për t'iu drejtuar gjykatës për përjashtimin e ortakut, nuk është miratuar nga asambleja e përgjithshme përse kohë ortakut I.P. nuk zotëron 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës, por vetëm 1/2 e tyre. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Tiranë, duke gjetur pjesërisht të drejtë ankimin e paditësit, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë në interpretim të gabuar të ligjit ka dalë në përfundime të pabazuara. Neni 102 i ligjit nr.9901/2008, përcakton: "Në bazë të një vendimi të zakonshëm, asambleja e përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ...". Neni 86 i ligjit nr.9901/2008, përcakton: "Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakë me të drejtë vote që zotërojnë 30 % të kuotave". Neni 87 i ligjit nr.9901/2008, përcakton: "Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me 3/4 e votave të ortakëve pjesëmarrës si parashikohet në pikën 1 të nenit 86".

Mbështetur në dispozitat si më sipër, Gjykata e Apelit Tiranë, vlerëson të gabuar përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se "Asambleja nuk mund të merrte vendim për t'iu drejtuar gjykatës për përjashtimin e ortakut, pasi ortakut I.P nuk kishte 3/4 e kuotave". Me një arsyetim si më sipër, rezultoi që Gjykata e Shkallës së Parë të ketë interpretuar në mënyrë jo të saktë përqindjen e nevojshme të kuotave për vlefshmërinë e mbledhjes së Asamblesë, "kuorumin", me përqindjen e nevojshme të kuotave për vlefshmërinë e vendimeve të asamblesë. Rezultoi e qartë se vendimi

¹⁷⁹ Neni 102 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

për t'iu drejtuar gjykatës për përjashtimin e një ortaku është një vendim i zakonshëm i asamblesë së përgjithshme dhe në rastin e marrjes së vendimeve të tilla mbledhja e asamblesë është e vlefshme me një kuorum prej 30 % të kuotave të shoqërisë. Ortaku I.P. i cili zotëron 50 % të kuotave të shoqërisë "IL&BE" shpk, dhe në këto kushte ai i vetëm mund të mbledhë asamblesën për të marrë një vendim të zakonshëm. Nga ana tjetër, vlefshmëria e vendimit për kërkesën drejtuar gjykatës për përjashtimin e një ortaku, kërkon 3/4 e votave pjesëmarrëse, ndërkohë që rezultoni të ketë votuar 100% e 50%, të kuotave pjesëmarrëse në asamble.

Shoqëria tregtare "BBR" Sh.p.k., është regjistruar si person juridik në datë 20.06.2002. Kjo shoqëri është e regjistruar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ushtron aktivitet në fushën e veprimtarive radiotelevizive, funksionet e plota të një shtëpie botuese, të një studio muzikore, realizimin e fushatave promovuese ose reklamuese, prodhimin e filmave kinematografikë ose televizivë, të programeve dhe shfaqjeve radiofonike dhe televizive dhe tregtim të tyre etj. Shoqëria tregtare "BBR" shpk, zotërohet nga dy ortakë, N.H, i cili zotëron 49% të pjesëve dhe i padituri A.XH, i cili zotëron 51% të kuotave. I padituri A.XH është administrator i shoqërisë dhe njëkohësisht përfaqësuesi ligjor i saj. Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në praninë e ortakëve është parashtruar si rend dite shqyrtimi i gjendjes financiare të Shoqërisë "BBR" shpk, miratimi i raportit të ecuresë së veprimtarisë tregtare të shoqërisë dhe të tjera. Në përfundim të saj, vetëm me votat e ortakut A.XH, Asambleja e Ortakëve, ka vendosur miratimin e disa vendimeve të cilat lidhen me aspekte të rëndësishme të administrimit të shoqërisë siç janë emërimi i ekspertës kontabël, verifikimi i aseteve, miratimi i raportit të ecuresë, miratimi i marrjes hua të një shume parash si dhe të miratojë veprimet e parashikuara nga ligji, për ortakun N.H, mbi mos dorëzimin aseteve të Shoqërisë "BBR", si dhe mbi dëmet që po i shkakton shoqërisë.

Gjykata në këtë çështje ka analizuar nevojën për ndjekjen e hapave proceduralë në thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe vënien në dispozicion të materialeve të nevojshme ortakëve të shoqërisë me qëllim garantimin e një administrimi efektiv dhe garantimin e të drejtave që u lindin ortakëve nga zotërimi i kuotave. Gjykata ka mbajtur qëndrimin se nuk është hetuar nëse pala paditëse ka patur dijeni në lidhje me thirrjen e mbledhjes. Nuk është hetuar nëse i janë vënë në dispozicion palës paditëse materiali sipas rendit të dritës të kërkuar në mbledhje. Njëkohësisht nuk është hetuar nëse pas nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit të lëshuar janë ekzekutuar këto urdhra për marrjen e dokumentacioneve që ndodheshin pranë administratorit. Arsyetimi i gjykatës se nuk mundet që gjykata të ndryshojë vendimmarrjen e një shoqërie, nuk qëndron pasi ligji i ri mbi shoqëritë tregtare lejon jo vetëm ndryshim i ndonjë vendimmarrje, por edhe përjashtimin e ortakut nga shoqëria kur ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe interesat e shoqërisë, pavarësisht përqindjes së kuotave apo aksioneve që disponon, qoftë dhe në mazhorancë.

Në këto rrethana, Gjykata e Apelit e çmon të pabazuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndaj si i tillë, ai duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat si gjykatë kompetente, pasi pala e paditur para gjykatës ka provuar ekzistencën e rrethanave dhe fakteve. të cilat janë ngritur në ankim për të krijuar bindjen që vendimi duhet ndryshuar. Nisur nga analiza e rrethanave të mësipërme, ankimi i bërë në Gjykatën e Apelit si mjet mbrojtës ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë gjendet i bazuar, ndaj dhe vendimi i kësaj gjykate duhet të prishet dhe të dërgohet për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat si gjykatë kompetente.

Në çështjen me palë shoqërinë S.P¹⁸⁰ sh.p.k është themeluar më datë 28.03.1994 dhe ka ushtruar aktivitet për rreth 20 vjet. Ajo përbëhet nga tre ortakë ku secili prej tyre ka nga 33.33% të kuotave. Ortakët aktualë janë K.Ç, F.H dhe L.H. Sipas ekstraktit nga QKR datë 17.05.2013 rezultoni se

¹⁸⁰ Vendimi Nr. 107 datë 20.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

objekti i veprimtarisë së "S.P" sh.p.k është në fushën e projektimit dhe zbatimit të ndërtimeve, import eksport të lëndëve të ndërtimit, etj. Pala e paditur-kundërpaditëse L.H. ka qenë administrator i shoqërisë paditëse-të kundërpaditur "S.P" sh.p.k deri më datë 05.04.2013 kur në mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë, është vendosur shkarkimi i tij dhe emërimi i ortakut F.H. si administrator i vetëm i shoqërisë.

Më datë 19.04.2013 është mbajtur mbledhje e asamblesë së ortakëve, në të cilën ishin prezent ortakët K.Ç. dhe L.H. e i përfaqësuar nga av. F. K. ortaku F.H. Në këtë mbledhje është vendosur që të dorëzohen nga ish administratori L.H. të gjitha aktet e shoqërisë (ekonomik, financiar, juridik, vulën, etj) dhe u caktua mbledhja e ardhshme më datë 26.04.2013. Në mbledhjen e kësaj datë nga ortaku L.H. është propozuar që shoqëria të kalonte në falimentim, propozim ky që është rrëzuar nga dy ortakët e tjerë. Ortaku L.H. nuk e ka miratuar statutin, por ka kërkuar kohë të njihet me të. Megjithatë statuti është miratuar me vendim të dy ortakëve të tjerë. Në këtë mbledhje, u ra dakord nga ortakët edhe që dorëzimi i akteve të shoqërisë nga ish administratori L.H. të bëhej në Tepelenë. Me vendimin e datës 10.05.2013 asambleja e ortakëve ka vendosur konform nenit 102 të ligjit nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" që t'i drejtohet gjykatës për përjashtimin e ortakut L.H. nga shoqëria "S.P" sh.p.k. Në këtë mbledhje, ashtu si edhe në atë të datës 26.04.2013 rezultoi të kenë qenë prezent ortakët K.Ç dhe L.H., ndërsa i përfaqësuar nga avokati ka qenë ortaku i tretë F.H. Me anë të kërkesë padisë së paraqitur për gjykim, pala paditëse "S.P" sh.p.k ka kërkuar: Përjashtimi i ortakut L.H. nga shoqëria "S.P" sh.p.k, si rezultat i veprimeve të paligjshme në dëm të shoqërisë. Shuarja e gjitha të drejtave (pasurore dhe jopasurore) që i vijnë nga cilësia e ortakut në këtë shoqëri. Depozitimi i vendimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, për të pasqyruar ndryshimet përkatëse në të dhënat e subjektit shoqëria "Studio Projekt" sh.p.k.

Paditësi shoqëria "S.P" sh.p.k ka pretenduar se ortaku ka shpërdoruar rëndë besimin e ortakëve të tjerë. Ka kryer veprime fiktive financiare që lidhen me marrjen e huave të shoqërisë prej ortakëve të saj. Kësajsoj janë rritur fiktivisht borxhet e shoqërisë, duke shmangur ndarjen e dividendëve. Ka shpërdoruar pasurinë e shoqërisë "S.P" sh.p.k në favor të shoqërisë "New Studio Projekt" sh.p.k, në të cilën ishte ortak i vetëm dhe administrator L.H. Ka nënshkruar si qiradhënës dhe si qiramarrës një kontratë qiraje të mjeteve të shoqërisë "S.P" sh.p.k për qiramarrësin "New Studio Projekt" sh.p.k. Çmimet në kontratë janë më të ulëta se ato të tregut; ka vetë realizuar disa mbledhje asambleje duke falsifikuar nënshkrimet e ortakëve të tjerë, duke mos përmbushur rregullin e njoftimeve. Ka miratuar i vetëm bilance, rritur kapitalin; ka hapur në mënyrë të paligjshme tre Nipt-e për shoqërinë; ka marrë hua bankare në emër të shoqërisë "S.P" sh.p.k, duke nënshkruar edhe për ortakët. Kredia është marrë në interes të shoqërisë "New Studio Projekt" sh.p.k me bashkëkredimarrës "S.P" sh.p.k. (Për këtë është dënuar penalisht noteri P.XH. për falsifikim. Po ashtu është dënuar edhe L.H për përdorim dokumentesh të falsifikuar, por vendimi penal ende nuk ka marrë formë të prerë; ka konflikt interesi me shoqërinë "S.P" sh.p.k, për shkak të themelimit prej tij të shoqërisë "Neë Studio Projekt" sh.p.k, ku është ortak i vetëm dhe administrator, shoqëri e cila bën konkurrencë; në mënyrë të përsëritur i është shmangur detyrimin për dorëzimin e dokumenteve të shoqërisë "S.P" sh.p.k. administratorit të ri të shoqërisë. Ai krijoi incident në Tepelenë më datë 02.05.2013, duke thirrur policinë e shtetit e duke i akuzuar dy ortakët e tjerë si mashtrues që donin të uzurponin pasurinë e shoqërisë.

Gjykata ka argumentuar se Vendimi i datës 26.04.2013 është pjesërisht i pavlefshëm, për pjesën që është rrëzuar propozimi i ortakut L.H., për kalimin në falimentim të shoqërisë "S.P" sh.p.k., si dhe për pikën e dytë të rendit të ditës, ku dy ortakët K.Ç. dhe F.H. miratojnë draft statutin e ri të shoqërisë. Nga ana tjetër vendimi i datës 10.05.2013 me anën e të cilit është autorizuar shoqëria "S.P" sh.p.k. që të kërkojë në gjykatë përjashtimin e ortakut L.H., është tërësisht i pavlefshëm, për shkak të shkeljes së rregullave në lidhje me kuorumin dhe shumicën e vendimmarrjes për të pasur një vendim (të zakonshëm) të vlefshëm asambleje. Arsyet e pavlefshmërisë së vendimeve të

mësipërme, lidhen me shkeljen nga mbledhja e ortakëve të neneve 85(3), 87(1) dhe 102 të ligjit nr.9901, datë: 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe nenit 17 të statutit të shoqërisë “S.P” sh.p.k. që rregullojnë në mënyrë të posaçme (*lex specialis*) rregullat e përfaqësimit të ortakëve në mbledhjen e asamblesë dhe kuorumin e shumicën e nevojshme për të pasur vendimmarrje të vlefshme.

Konkretisht ligji nr.9901, si ligj i posaçëm, ka rregulluar në mënyrë të posaçme në nenin 85(3) të tij, mënyrën e përfaqësimit të ortakut në mbledhjet e asamblesë. Ky nen përcakton taksativisht se “*Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.*” Në rastin konkret, ortakut F.H. është përfaqësuar në mbledhjen e asamblesë nga avokati, sipas prokurës së posaçme nr.1717.rep, nr.549.kol, datë: 25.03.2013, në të cilën nuk përcaktohet dijenia e ortakut për rendin e ditës së mbledhjeve të datave 26.04.2013 dhe 10.05.2013. Gjykata çmon se, ortakut që kërkon të përfaqësohet rregullisht në mbledhjen e asamblesë, nuk duhet të mjaftohet me lëshimin e një prokure (*jo konkrete*) për përfaqësuesin e tij, por ligji tregtar kërkon domosdoshmërisht që autorizimi të jetë vetëm për një mbledhje dhe vetëm për një rend dite, të asaj mbledhje (*i cili në qoftë se nuk ezaurohet, konsiderohet se autorizimi është i vlefshëm edhe për mbledhjen pasardhëse me të njëjtin rend dite*). Parashikimi i nenit 85(3) të ligjit 9901, është një kriter formal i ligjit, i cili është i detyrueshëm për zbatim, e që nuk mund të anashkalohet nga palët.

Gjykata konstaton se, duke qenë ortakut F.H. në kushtet e përfaqësimit të parregullt në mbledhjet e asamblesë të datave 26.04.2013 e 10.05.2013, vota e përfaqësuesit të tij nuk vlen dhe prezenca e përfaqësuesit “pa autorizim të posaçëm” nuk quhet e vlefshme për efektet e kuorunit dhe shumicës për marrjen e vendimeve.

Për rrjedhojë vendimmarrja në dy mbledhjet e mësipërme është bërë nga dy ortakët K.Ç. (*që ka qenë prezent vetë*) dhe L.H. Secili nga këta ortakë ka nga 33.33% të kuotave dhe në mbledhjen e datës 26.04.2013 K.Ç. dhe L.H. kanë votuar në mënyrë të kundërt ose nuk ka votuar fare L.H. (*për rastin e draft statutit, tek pika e dytë e rendit të ditës*), e për rrjedhojë e vetmja votë e vlefshme për marrjen e vendimeve ishte ajo e ortakut K.Ç. (33.33%), çka konform nenit 17 të statutit të shoqërisë “S.P” sh.p.k nuk është i mjaftueshëm për marrjen e një vendimi të vlefshëm. Për rrjedhojë vendimet e konsideruara në mënyrë të paligjshme si të vlefshme në mbledhjen e datës 26.04.2013, në fakt janë të pavlefshme. Këtu nuk preken pjesët e tjera të vendimmarrjes, ku edhe ortakut L.H. është shënuar se ka votuar bashkë me ortakun K.Ç. (*në këtë rast vendimmarrja është e vlefshme, për shkak të pasjes së shumicës prej 66.66 % për marrjen e vendimeve*).

I njëjti arsyetim si më sipër, vlen edhe për mbledhjen e asamblesë së ortakëve të datës 10.05.2013, kur është vendosur të autorizohet shoqëria “S.P” sh.p.k. të vijojë procedurat gjyqësore për përjashtimin e ortakut L.H. Edhe ky vendim është i pavlefshëm për mungesë kuorumi të nevojshëm për marrjen e vendimit, ku e vetmja votë e vlefshme për miratimin e propozimit për përjashtim ishte e ortakut prezent K.Ç. (33.33 %) kur në fakt sipas nenit 17 të statutit duhet më shumë se 50%. Ortaku tjetër F.H. ndodhej në kushtet e përfaqësimit të pavlefshëm, sipas nenit 85(3) të ligjit nr.9901, e për këtë shkak vota e tij nuk merret për bazë.

Mospasja e një vendimi të vlefshëm konform nenit 102 të ligjit nr. 9901, bën që padisë së paditësit “S.P” sh.p.k t’i mungojë një kriter formal i domosdoshëm, çka passjell rrëzimin e saj për shkak të mosplotësisht të kriterëve formale të vendimmarrjes së vlefshme nga asambleja (*mbledhja*) e ortakëve. Gjykata në këtë rast nuk mund t’i futet më tej shqyrtimit të themelit të pretendimeve të palës paditëse, në lidhje me shkaqet për të cilat kërkohet përjashtimi i të paditurit L.H, pasi një gjë e tillë bëhet vetëm kur shoqëria ka autorizimin e duhur nga mbledhja e ortakëve, çka në rastin konkret mungon. Në zbatim të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe atij nr. 9723, datë: 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Qendra Kombëtare

e Regjistrimit duhet të çregjistrojë vendimet që konsiderohen të pavlefshme nga gjykata në këtë vendim e që anulohen për këtë shkak. Ndaj vendimit kanë bërë ankim pala paditëse Shoqëria "S.P" sh.p.k. e cila ka parashtruar shkaqet e ankimit të sipërpërmendura.

Gjykata e Apelit çmon se në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi është thelbësore një shqyrtim i hollësishëm dhe një vlerësim i drejtë i provave mbi të cilat mbështetet arsyetimi ligjor i vendimit. Gjate gjykimit është provuar se shoqëria Studio Projekt sh.p.k është themeluar më datë 28.03.1994 dhe ka ushtruar aktivitet për rreth 20 vjet. Ajo përbëhet nga tre ortakë ku secili prej tyre ka nga 33.33% të kuotave. Ortakët aktualë janë K.Ç, F.H. dhe L.H. Sipas ekstraktit nga QKR datë 17.05.2013 rezulton se objekti i veprimtarisë së "S.P" sh.p.k është në fushën e projektimit dhe zbatimit të ndërtimeve, import eksport të lëndëve të ndërtimit, etj. Pala e paditur-kundërpaditëse L.H ka qenë administrator i shoqërisë paditëse të kundërpaditur "S.P" sh.p.k deri më datë 05.04.2013 kur në mbledhjen e asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë, është vendosur shkarkimi i tij dhe emërimi i ortakut F.H. si administrator i vetëm i shoqërisë. Më datë 19.04.2013 është mbajtur mbledhje e asamblesë së ortakëve, në të cilën ishin prezent ortakët K.Ç. dhe L.H., i përfaqësuar nga avokati ortakut F.H. Në këtë mbledhje është vendosur që të dorëzohen nga ish administratori L.H. të gjitha aktet e shoqërisë (ekonomik, financiar, juridik, vulën, etj) dhe u caktua mbledhja e ardhshme më datë 26.04.2013. Në mbledhjen e datës 26.04.2013 kane qene prezent ortakët K.Ç. dhe L.H dhe ortakut F.H., i përfaqësuar nga avokati me prokurë. Në mbledhjen e kësaj date nga ortakut L.H. është propozuar që shoqëria të kalonte në falimentim, propozim ky që është rrëzuar nga dy ortakët e tjerë. Po në këtë mbledhje është vendosur t'i jepej fuqi statutit të shoqërisë "S.P" sh.p.k, i nënshkruar nga të tre ortakët, me administrator ortakun F.H. për një afat 1 vjeçar dhe selinë e shoqërisë në adresën rr. "Vaso Pasha", pall.13/1, kati i zyrave nr.4, Tiranë. Ortaku L.H. nuk e ka miratuar statutin, por ka kërkuar kohë të njihet me të. Megjithatë statuti është miratuar me vendim të dy ortakëve të tjerë. Në këtë mbledhje u ra dakord nga ortakët edhe që dorëzimi i akteve të shoqërisë nga ish administratori L.H. të bëhej në Tepelenë. Me vendimin e datës 10.05.2013 asambleja e ortakëve ka vendosur konform nenit 102 të ligjit nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" që t'i drejtohet gjykatës për përjashtimin e ortakut L.H. nga shoqëria "S.P" sh.p.k. Në këtë mbledhje, ashtu si edhe në atë të datës 26.04.2013 rezulton të kenë qenë prezent ortakët K.Ç. dhe L.H, ndërsa i përfaqësuar nga avokati ka qenë ortakut i tretë F.H..

Neni 17 i Statutit të shoqërisë "S.P" sh.p.k (i vitit 2012) përcakton se: "Asambleja merr vendime të vlefshme në rastet e parashikuara më poshtë: Në thirrjen e parë (mbledhjen e parë) në praninë e ortakëve që janë vetë prezent ose të përfaqësuar nga persona të tretë me prokurë të posaçme dhe që zotërojnë më shumë se ½ e kapitalit themeltar. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite. Për ndryshimet në statut vendos asambleja e jashtëzakonshme e shoqërisë e ortakëve, e cila merr vendime të vlefshme vetëm në rast se këto vendime do të votohen sipas nenit 86 të ligjit 9901, datë: 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"."

Neni 85 i ligjit nr.9901, datë: 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", titullohet "Përfaqësimi në asamble" dhe parashikon se:"1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e

përgjithshme.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.”

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.”. Gjate gjykimit është provuar se më datë 25.03.2013 shtetasi F.H. ortak i shoqërisë “S.P”sh.p.k. ka lëshuar prokurën e posaçme nr. 1717 rep nr. 549 kol. Nga përmbajtja e kësaj prokure të posaçme rezulton se në bazë të kësaj prokure të posaçme shtetasi F.H. ortak emëron si mbrojtës e përfaqësues të tij av.F.K. duke i dhënë të drejta të plota përfaqësimi dhe mbrojtje për: Gjithashtu, në kuadër të realizimit të mbrojtjes dhe përfaqësimit, i jep të drejtën të veprorë në mbrojtje të interesave të tij, duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme si atë të vendimmarrjes, votimit, të propozojë, paraqesë dhe nënshkruajë kërkesa të llojeve të ndryshme, të marrë pjesë në diskutime dhe të pranojë çdo vendimmarrje të asamblesë së ortakëve. Të drejtën për të hyrë në negociata dhe nënshkruajë akte juridike apo kontrata të ndryshme për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje të mundshme me mirëkuptim, të bëjë çfarëdolloj deklarate, kërkesë si dhe të kryejë çdo veprim tjetër ligjor që nuk përmendet në këtë prokurë, por që është i domosdoshëm për efekt të porosive të mësipërme. Ky përfaqësim do të vazhdojë edhe në rast se i përfaqësuarit zgjidhet administrator i shoqërisë. Në këtë rast përfaqësuesi në këtë prokurë përfiton dhe tagrat e administratorit të shoqërisë. Për veprimet e mësipërme, i jep njëkohësisht të drejtën të emërojë nëpërmjet autorizimit me shkrim persona të tjerë, që së bashku apo veç e veç të kryejnë gjithë veprimet në funksion të përfaqësimit e të mbrojtjes sipas tagrave të sipërcituara. Kjo prokurë nuk ka nevojë për konfirmim të mëtejshëm dhe është e vlefshme deri në realizimin e plotë të objektit dhe deri në çastin kur revokohet nga i përfaqësuarit. Me prokurën e posaçme nr.1717 rep, 549 kol, datë 25.03.2013, ortaku F.H. ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe konkrete natyrën dhe vëllimin e tagrave të përfaqësimit, duke i dhënë të drejtën përfaqësuesit të marrë pjesë me të drejta të plota *në të gjitha mbledhjet e zakonshme dhe jashtëzakonshme të asamblesë së ortakëve, vendimmarrjes, votimit, të propozojë, paraqesë dhe nënshkruajë kërkesa të llojeve të ndryshme, të marrë pjesë në diskutime, të pranojë çdo vendimmarrje të asamblesë së ortakëve etj.*

Prokura në këtë rast, për nga vetë natyra e saj "e posaçme", për një seri veprimesh brenda një fushe të përcaktuar, është plotësisht konkrete dhe me tagra qartësisht të shprehura për përfaqësimin e ortakut në asamblesë e përgjithshme. Është interpretim i gabuar që bën gjykata kur shprehet se "ortaku që kërkon të përfaqësohet rregullisht në mbledhjen e asamblesë, nuk duhet të mjaftohet me lëshimin e një prokure (jo konkrete) për përfaqësuesin e tij..." kur ndodhet përpara rastit të përfaqësimit me një prokurë të posaçme me tagra të specifikuar dhe konkrete. Interpretimi i gabuar i nenit 85 që bën gjykata, i referohet nocionit të "autorizimit" si një formë e aktit të delegimit të drejtave, që ka ardhur si risi e ligjit tregtar të vitit 2008 dhe jo prokurës siç rezulton të jetë lëshuar në rastin konkret nga ortaku F.H. Qëllimi i ligjvënësit duke parashikuar "autorizimin" si formë e aktit të përfaqësimit në nenin 85 të ligjit tregtar, lidhet me arsye praktike, efikasiteti dhe ekonomie për të krijuar kushte të favorshme që ortakët të mund të përfaqësohen nga një ortak apo person tjetër vetëm mbi bazën e një autorizimi të thjeshtë, të lëshuar prej tyre për çdo mbledhje asambleje, pa qenë nevoja për t'u paraqitur pranë një noteri për ta redaktuar në formën e aktit noterial, siç është prokura. Autorizimi duke qenë një akt i thjeshtë përfaqësimi, ligji ka vendosur kufizime duke i dhënë fuqi dhe vlefshmëri përdorimi vetëm për një mbledhje ose maksimalisht dhe mbledhjen vijuese me të njëjtin rend dite. Por kjo nuk do të thotë që nëse një ortak, i cili ka lëshuar një prokurë me tagra të plota përfaqësuesit të tij për ta përfaqësuar në çdo mbledhje asambleje, pavarësisht rendit të ditës, të konsiderohet i papërfaqësuar në mbledhje për arsye se duhet të lëshojë nga një prokurë të veçantë për çdo mbledhje me rend dite të ndryshëm.

Referuar tagrave të dhëna në prokurë, del qartë se ai ka qenë i mandatuar me tagra të plota përfaqësimi nga ortaku, për të gjitha mbledhjet e asamblesë së ortakëve, përfshirë dhe atë të datës 10.05.2013. Në këtë kuptim, përfaqësimi i avokatit jo vetëm që nuk vjen në kundërshtim me nenin 85 të ligjit 9901, datë 14.04.2008, por është në konformitet dhe me rregullat e nenit 17, gërma "a" të statutit të shoqërisë, i cili parashikon në mënyrë eksplicite se: "*Asambleja merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë në praninë e ortakëve që janë vetë prezent ose të përfaqësuar nga persona të tretë me prokurë të posacme ...*". Në lidhje me kërkesë padinë, vendimi i gjykatës duhet ndryshuar duke u vendosur pranimit i kërkesë padisë pasi në nenin 14 të ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare 'parashikohet'¹⁸¹;" Rezulton se me vendimin e datës 10.05.2013 asambleja e ortakëve ka vendosur konform nenit 102 të ligjit nr.9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" që t'i drejtohet gjykatës për përjashtimin e ortakut L.H. nga shoqëria "S.P" sh.p.k. Në vendimin e datës 10.05.2013 përcaktohen arsyet pse u vendos t'i kërkohej gjykatës përjashtimi i ortakut L.H. Ndër këto arsye janë se ish-administratori L.H. ka shpërdoruar rëndë besimin e ortakëve të tjerë; ka kryer veprime fiktive financiare që lidhen me marrjen e huave të shoqërisë prej ortakëve të saj, etj. Kësisoj janë rritur fiktivisht borxhet e shoqërisë, duke shmangur ndarjen e dividendëve; ka shpërdoruar pasurinë e shoqërisë "S.P" sh.p.k në favor të shoqërisë "New Studio Projekt" sh.p.k, në të cilën ishte ortak i vetëm dhe administrator L.H. Ka nënshkruar si qiramarrës dhe si qiramarrës një kontratë qiraje të mjeteve të shoqërisë "S.P" sh.p.k për qiramarrësin "New Studio Projekt" sh.p.k. Çmimet në kontratë janë më të ulëta se ato të tregut; ka vetë realizuar disa mbledhje asambleje duke falsifikuar nënshkrimet e ortakëve të tjerë, duke mos përmbushur rregullin e njoftimeve, ka miratuar i vetëm bilance, rritur kapitalin, etj; ka hapur në mënyrë të paligjshme tre Nipt-e për shoqërinë; ka marrë hua bankare në emër të shoqërisë "S.P" sh.p.k, duke nënshkruar edhe për ortakët. Kredia është marrë në interes të shoqërisë "New Studio Projekt" sh.p.k me bashkë kredimarrës "S.P" sh.p.k. (*Për këtë është dënuar penalisht noteri P.Xh. për falsifikim. Po ashtu është dënuar edhe L.H. për përdorim dokumentesh të falsifikuar, por vendimi penal ende nuk ka marrë formë të prerë.*); ka konflikt interesi me shoqërinë "S.P" sh.p.k, për shkak të themelimit prej tij të shoqërisë "New Studio Projekt" sh.p.k, ku është ortak i vetëm dhe administrator, shoqëri e cila bën konkurrencë; në mënyrë të përsëritur i është shmangur detyrimit për dorëzimin e dokumenteve të shoqërisë "S.P" sh.p.k administratorit të ri të shoqërisë. Ai krijoi incident në Tepelenë më datë 02.05.2013, duke thirrur policinë e shtetit e duke i akuzuar dy ortakët e tjerë si mashtrues që donin të uzurponin pasurinë e shoqërisë. Referuar akteve të administruara gjate gjykimit Gjykata e apelit arrin në përfundimin se kërkimi i palës paditëse për përjashtimin e ortakut L.H. nga shoqëria 'Studio Projekt sh.p.k. si rezultat i veprimeve të paligjshme në dëm të shoqërisë dhe shuarja e të gjitha të drejtave (pasurore dhe jo pasurore) që i vijnë nga cilësia e ortakut në këtë shoqëri është i bazuar në prova.

Kështu në cilësinë e ortakut dhe administratorit, i padituri kundërpaditës gjatë viteve 2004-2005 ka realizuar disa mbledhje asambleje, në bazë të akt-ekspertimit grafik të nënshkrimeve datë 04.10.2013 të ekspertit kriminalist, rezulton se i padituri ka falsifikuar nënshkrimet e ortakëve.

¹⁸¹Neni 16: Ortakët, aksionarët e shoqërisë tregtare, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
 - b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
 - c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paafësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.
2. Palët e treta nuk mund të ngrenë padi për përmbushjen e detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, nëse shoqëria provon se i treti kishte pasur dijeni për abuzimin apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Padia duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes.

Është vërtetuar se i padituri në Maj të vitit 2009, në kundërshtim ndalimet e ligjit tregtar, në konfliktit interesi dhe konkurrencë me ortakët, ka krijuar një shoqëri me të njëjtën objekt veprimtarie "New Studioprojekt Company" sh.p.k., si ortak dhe administrator i vetëm. Ka rezultuar se i padituri kundërpaditës si pronar i vetëm të shoqërisë ka dhënë me qira mjetet e rënda të saj, por duke qenë njëkohësisht edhe qiramarrës me shoqërinë "New Studioprojekt Company" sh.p.k. I padituri kundërpaditës ka marrë kredi bankare për shoqërinë "New Studioprojekt Company" sh.p.k., dhe ka futur si bashkëkredimarrës shoqërinë "Studio projekt" shpk., duke nënshkruar dhe në kontratë në emër të ortakëve. Më pas në padijeni gjithnjë duke fallsifikuar, vetëlidh edhe kontrata hipotekë mbi pronat personale në bashkëpronësi të dy ortakëve të tjerë. Me vendim nr. 393 date 04.03.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: Deklarimi fajtor i të pandehurit L.H. për kryerjen e veprës penale të fallsifikimit të dokumentave të parashikuar nga neni 186/1 i K. Penal. Nga përmbajtja e këtij vendimi ka rezultuar se L.H. nuk ka marrë miratimin e ortakëve për të krijuar shoqërinë e tij të re dhe vënien e pronave në hipotekë dhe për marrjen e kredisë.

2.3. Kompensimi i kuotës

Paditësi J.A, ka qenë ortak i shoqërisë "G" sh.p.k. dhe zotëronte 10 % të kuotave. Ai ka kërkuar të likuidohet kuota e tij prej 10% nga pala e paditur pasi gjatë muajve Qershor, Korrik 2008, i është mohuar e drejta e tij si ortak i shoqërisë, për t'u njohur me gjendjen financiare të shoqërisë nga administratori dhe njëkohsisht ortak i 90% të kuotave. Më datë 23.06.2008 është urdheruar shkarkimi i paditësit nga detyra e Drejtorit të Shkollës 12-vjeçare jopublike "N", shkarkim i cili është bërë konflikt gjyqësor dhe ka përfunduar në favor të paditësit. Në kushtet e krijuara, paditësi, duke konsideruar marrëdhëniet me administratorin dhe ortakun mazhoritar si të papajtueshme me cilësinë e bashkëortakut në një shoqëri, në datën 28.07.2008, ka njoftuar palën e paditur për largimin e tij si ortak nga shoqëria "G" sh.p.k. dhe likuidimin e kuotës së tij 10% të kapitalit të shoqërisë. Shoqëria ka pranuar largimin e ortakut, por jo likuidimin e kuotës.

Qëndrimi i Gjykatës: Gjykata e Apelit Tiranë, ka arritur në konkluzionin se neni 101 i Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", parashikon mundësinë e largimit të një ortakut, veç të tjerash, edhe për shkaqe të tjera nga ato të cituara në këtë nen, shkaqe të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ky parashikim ligjor, vjen në perputhje të plotë me parimin bazë të krijimit dhe funksionimit të një shoqërie tregtare si bashkim vullnetesh, i sanksionuar në nenin 3 të Ligjit. Procesi i krijimit dhe funksionimit të një shoqërie tregtare private me më shumë se dy ortakë, përbën në vetvete një kontratë me të drejta dhe detyrime të përbashkëta, e cila lidhet me vullnetin e palëve pjesëmarrëse në të. Në momentin që ky vullnet nuk ekziston ose është cenuar mirëbesimi mes ortakëve, ligji i njeh gjithsecilit nga ortakët, të drejtën për t'u larguar nga shoqëria për shkaqe që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë dhe të drejtën për të kërkuar likuidimin e kuotës respektive.

Në analizë të ecurisë së marrëdhënies së krijuar mes ortakëve J.A. dhe R.T., gjykata e faktit ka arritur në përfundimin se kjo marrëdhënie është cënuar dhe besimi reciprok mes tyre është thyer, që në momentin e parashtrimit të kërkesave të ligjshme të ortakut J.A. për transparencën në lidhje me veprimet financiare të administratorit të shoqërisë. Ka rezultuar që, menjëherë pas komunikimit me shkrim të këtyre kërkesave, shoqëria ka vendosur shkarkimin e këtij ortakut nga detyra e drejtorit të shkollës "N", shkollë e cila përbën dhe aktivitetin e kësaj shoqërie. Pikërisht ky veprim dhe zgjidhja e mosmarrëveshjes së marrëdhënies së punës gjyqësisht, përbëjnë shkakun e paraqitjes së kërkesës së ortakut J.A. për largimin e tij nga shoqëria. Kërkesa rezulton të jetë bërë me shkrim, duke parashtruar dhe shkaqet që, sipas këtij ortakut, e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Në vijim të këtij veprimi, ka qenë detyrim i administratorit të thërrasë Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, me objekt të përcaktuar në pikën 3 të nenit 101 të Ligjit. Pra, kjo

Asamble, ka patur detyrimin për t'u shprehur vetëm në lidhje me likuidimin e kuotës së ortakut që largohet. Ka rezultuar që ky detyrim të mos jetë përmbushur nga shoqëria dhe administratori i saj. Kështu, në datën 28.07.2008, paditësi i kundërpaditur ka njoftuar për largimin e tij dhe ka kërkuar likuidimin e kuotës së tij. Mbledhja e paracaktuar për në datën 30.07.2008 është shtyrë nga administratori për shkak të veta për në datën 31.07.2008. Në këtë Mbledhje, nuk ka rezultuar të jetë diskutuar për kërkesën e ortakut J.A. për t'u likuiduar kuota e tij 10% në shoqëri. Pas kërkesës së dytë të këtij ortakut, shoqëria i është përgjigjur me fillimin e procedurave për përjashtimin e tij nga shoqëria dhe kërkimin e dëmit moral dhe ekonomik të shkaktuar. Në këtë situatë, ortakut J.A., në referim të parashikimeve të pikës 4 të nenit 101 të ligjit, legjitimohet në padinë e tij për kërkimin e likuidimit të kuotës gjyqësisht. Në kushtet sa më sipër, gjykata e faktit ka arritur në përfundimin se padia e J.A. për likuidimin e kuotës, për shkak të largimit të tij, në parim gjen mbështetje ligjore, ndërsa kundërpadia e shoqërisë "GR&M" sh.p.k. është e pabazuar në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet të rrëzohet.

Në lidhje me likuidimin e kuotës së ortakut, në kushtet kur për përllogaritjen e saj në raport me gjendjen pasurore të shoqërisë në momentin e largimit, janë të domosdoshme njohuritë në fushën financiare, në referim të parashikimeve të nenit 224/a të Kodit të Procedurës Civile, është proceduar me thirrjen e ekspertës kontabël të regjistruar, anëtare e IEKA-s. Në lidhje me mënyrën e vlerësimit të kuotës së ortakut që largohet nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, është e nevojshme të ndalemi në kuptimin e kuotës, si një tërësi të drejtash që përbëjnë interesin ekonomik të ortakut në shoqëri. Kështu, ortakut, në raport me përqindjen e kuotave që zotëron, gëzon të drejtën e votës, të drejtën e përfitimit të dividendëve, të drejtën e transferimit të kuotës, etj. Nocioni i përdorur nga ligjvënësi në Ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" në lidhje me "likuidimin e kuotës", nuk nënkupton likuidim total apo të pjesshëm të shoqërisë, por ka të bëjë me të drejtën e ortakut që largohet për të marrë vlerën e kuotës së tij në para. Pra, në këtë moment, ortakut që largohet nuk mund të kërkojë kuotën e tij në aktivet e shoqërisë, pasi nuk gëzon asnjë të drejtë mbi to, por vetëm kompensimin nga shoqëria të vlerës së kuotës së tij.

Parashikimi i nenit 77 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, përcakton rregullat e detyrueshme për t'u zbatuar për të gjitha shpërndarjet e aktiveve nga shoqëria tek një prej ortakëve të saj, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe kompensimin për vlerën e kuotës së ortakut që largohet për shkak të arsyeshme. Duke analizuar këtë dispozitë, është më së e qartë se çdo pagesë, qoftë edhe ajo e kompensimit të vlerës së kuotës nga shoqëria, kryhet vetëm nëse aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe vetëm nëse shoqëria do të ketë aktive të qarkullueshme të mjaftueshme për të paguar detyrimet e kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

Mbështetur në analizën e mësipërme ligjore, nga gjykata i është lënë detyrë ekspertës përcaktimi i gjendjes pasurore të shoqërisë në momentin e paraqitjes së kërkesës së ortakut J.A. për largimin e tij. Në kushtet kur për periudhën 2007-2008, shoqëria ka qenë regjistruar si biznes i vogël dhe nuk ka patur detyrim ligjor për mbajtjen e bilancit, në detyrat shitesë, ekspertës iu la detyrë hartimi i këtij bilanci, mbështetur në gjithë dokumentacionin kontabël që ndodhej pranë shoqërisë për këtë periudhë. Nga bilanci shoqëria ka rezultuar me humbje. Kundërshtimet e palës paditëse në lidhje me këtë përfundim të ekspertës, pasi janë diskutuar në seancat gjyqësore të radhës, kanë rezultuar të pabazuara ligjërisht. Kështu, kjo palë ka pretenduar se vlera e aktivit "Ndërtesë" e shkollës "N", nuk duhet të merrej sipas dokumentacionit të blerjes së saj, por sipas vlerësimit të bërë nga Banka në momentin e marrjes së një kredie nga shoqëria. Ky pretendim është i pabazuar dhe ekspertja i ka dhënë përgjigje këtyre kundërshtimeve në referim të parashikimeve të neneve 59, 66 dhe 70 të Ligjit "Për Kontabilitetin". Të gjitha problemet e tjera të ngritura nga pala paditëse e kundërpaditur në lidhje me veprimet e administratorit të shoqërisë në dëm të saj, nuk janë objekt i këtij gjykimi, pasi Ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", parashikon të drejtën e ortakut për t'i goditur ato në momentin dhe mënyrën ligjore të përcaktuar. Për sa më sipër, kompensimi i vlerës së kuotës

prej 10% të paditësit të kundërpaditur, është i pamundur të realizohet në gjendjen në të cilën ndodhet kjo shoqëri, pasi aktivitetet e saj nuk janë në gjendje të mbulojnë detyrimet. Në përfundim, gjykata e faktit ka konkluduar në pranimin e pjesës së padisë, vetëm sa i takon largimit të ortakut J.A.

Rasti 2

Pala paditëse, A.Sh."D.D.2010" Sh.p.k, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi, duke thirrur si të paditur U.G., me objekt përjashtimin e ortakut U.G., marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut U.G. dhe pezullimin e vendimmarrjes së Asamblesë deri në zgjidhjen gjyqësive të çështjes, sipas nenit 102 të ligjit 9901, dt.14/04/2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*". Ka rezultuar se midis ortakëve shqiptarë të shoqërisë "D.D. 2010" sh.p.k, dhe ortakut U.G. kanë lindur mosmarrëveshje, të cilat kanë shtyrë ortakët e shoqërisë që zotërojnë X% të kapitalit themeltar, të mbledhin Asamblesë e Zakonshme të shoqërisë "D.D. 2010" sh.p.k. Kështu me vendimin nr.1, dt.15/02/2012 të Asamblesë, ata kanë kërkuar në rrugë ligjore përjashtimin e ortakut U.G. nga shoqëria për shkak se, me qëndrimet e tij i ka shkaktuar dëme të mëdha ekonomike shoqërisë. Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me padinë objekt gjykimi.

Në kuptim të nenit 102/2 të ligjit 9901, dt.14/04/2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", Gjykata e Apelit Tiranë çmon se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që justifikojnë kërkimin gjyqësiv të përjashtimit të ortakut nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Sipas këtij neni thuhet shprehimisht se "*Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:*

- a) me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkaktonte dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë;*
- b) me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj;*
- c) përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënive midis shoqërisë tregtare dhe ortakut; ose*
- c) me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë".*

Pra në kuptim të kësaj dispozite, si dhe në rrethanat e parashtruara dhe të provuara si më lart, Gjykata e Apelit Tiranë çmon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka analizuar drejt rrethanat dhe bazuar në ligj ka arritur në konkluzionin se pretendimi i palës paditëse për shkelje nga ana e ortakut U.G. të detyrimeve që burojnë nga ligji tregtar dhe aktet bazë të shoqërisë, qëndrojnë dhe kërkitimi për përjashtimin e ortakut, është i mbështetur dhe duhet pranuar. Shkeljet e konstatuara janë të tilla që e bëjnë të pamundur mbajtjen në vazhdim të cilësisë së ortakut U.G., pranë shoqërisë "D.D.2010" sh.p.k, pasi ka rezultuar se ka shkelur rëndë detyrimet që burojnë nga ligji që rregullon aktivitetin e shoqërive tregtare si dhe rregullat e përcaktuara në aktet bazë të kësaj shoqërie tregtare. Prandaj për sa më lart vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili ka vendosur pranimin e padisë është i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj dhe duhet të lihet në fuqi. Gjykata e Apelit Tiranë çmon se shkaqet e parashtruara në ankim nga përfaqësuesi i palës së paditur nuk qëndrojnë e nuk duhen marrë parasysh. Pretendimi i ngritur në ankim se gjykata e rrethit gjyqësor nuk ka respektuar parimin e kontradiktoritetit në gjykim dhe në trajtim jo të barabartë, nuk qëndron, pasi sic rezulton nga aktet procedurale, gjatë gjykimit është debatuar nga të dy palët ndërgjyqëse, si dhe u është dhënë mundësia të paraqesin të gjitha provat e mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tyre. Rrëzimi nga ana e gjykatës të kërkesës së palës së paditur për riçelje të hetimit gjyqësor është i drejtë dhe i mbështetur në nenin 304 të K.Pr.Civile, sipas të cilit, pasi i është dhënë fund hetimit gjyqësor, nuk mund të merren prova të tjera. Kur palët e shohin të nevojshme paraqitjen e tyre, kërkojnë çeljen e hetimit gjyqësor, por për këtë kërkesë vendos gjykata sipas vlerësimit të rrethanave të çështjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar drejt në këtë rast se në rast përjashtimor, kur provat janë të një rëndësie të veçantë, në lidhje edhe

me rrethanat e tjera të çështjes dhe provave të administruara, vetëm atëherë mund të vendoset riçelja e hetimit gjyqësor. Vlen të theksohet se në rastin konkret dispozita ligjore që parashikon përjashtimin e ortakut (neni 102/2 i ligjit 9901, dt.14/04/2008) është e një karakteri të jashtëzakonshëm dhe shkaqet e konstatuara janë të një rëndësie të tillë të cilat përlligjin përjashtimin e ortakut U.G.

Gjykata e Apelit Tiranë çmon se, bazuar në aktet proceduriale të dosjes gjyqësore, rezultojnë se gjatë gjykimit është debatuar akti i ekspertimit, duke i kthyer përgjigje pyetjeve të dyja palëve ndërgjyqëse. Ndryshe nga sa pretendon pala e paditur në ankim, nga akti i ekspertimit ka rezultuar qartë, se ka diferenca ekonomike që rezultojnë nga transaksionet ekonomike të kryera prej të paditurit për blerjen e pajisjes së distilerisë, për llogari të shoqërisë “D.D.2010” sh.p.k, gjithashtu ka probleme fiskale në raport me strukturat tatimore e doganore të shtetit, të cilat kanë të bëjnë me mospërputhjet e dukshme të vlerave reale dhe atyre të deklaruara në lidhje me vlerën e pajisjes së distilerisë. Tregohet qartë paligjshmëria e veprimeve të kryera prej tij, veprime në mashtrim të ekzistencës dhe zhvillimit të shoqërisë, si dhe veprime të cilat e bëjnë të pamundur mbajtjen e shoqërisë dhe cilësisë së ortakut. *Pra këto veprime tregojnë qartë se ortaku U.G. me dashje është përfshirë në një veprimtari, e cila ka penguar vazhdimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe e ka bërë të pamundur vazhdimin e marrëdhënive midis shoqërisë dhe ortakut.*

Ashtu siç drejt ka arsyetuar edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj objekt ankimi, rastet e parashikuara në ligj, të cilat përbëjnë premisë për vendimmarrjen nga Asambleja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të kërkuar gjyqësisht, përjashtimin e një ortaku, nuk janë me karakter shterues por, ligji i konsideron të një shkalle të tillë që e bëjnë të pamundur mbajtjen më të cilësisë së ortakut në një shoqëri tregtare. Gjykata e Apelit Tiranë çmon se në rastin konkret u provua se jemi përpara pranisë së disa shkaqeve të arsyeshme, me të cilat ligji tregtar lidh mundësinë e përjashtimit të ortakut nga shoqëria me përgjegjësi të kufizuar. Prandaj për shkaqet e ngritura në ankim nuk ka vend të çenohet vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2.4. Problemet ndërkufitare në përgjegjësinë e administratorëve

GJED, me vendimin e saj në çështjen Centros dhe çështjet e tjera vijuese ka ndikuar bindshëm në mundësinë e shoqërive për të ushtruar aktivitetin e tyre tregtar jashtë kufijve për sa kohë që shoqëritë mund të regjistrojnë selinë e tyre në një shtet anëtar, dhe në vijim të ushtrojnë veprimtarinë në një shtet tjetër.¹⁸² Në tërësi, GJED ka pranuar se një shoqëri e krijuar në një shtet anëtar, mund të ushtrojë veprimtari në një shtet tjetër (shteti pritës) dhe ndërkohë nuk mund të jetë subjekt i ligjit material të shtetit pritës vetëm për faktin se selia, menaxhimi kryesor dhe rezidenca e drejtuesve gjenden në këtë të fundit. Në momentin e krijimit, themeluesit e shoqërive duke zgjedhur vendin në të cilin do të krijohet shoqëria, zgjedhin në vetvete kuadrin ligjor të aplikueshëm për drejtuesit dhe përgjegjësitë e tyre¹⁸³.

Shtetet pritëse, nuk mund t'u imponojnë shoqërive të krijuara në një shtet tjetër, rregullat e tyre të brendshme mbi përgjegjësinë e administratorëve, të cilat në fakt do të mbetën subjekt i ligjit të vendit të krijimit. Në fakt duket se një zgjidhje e tillë është e arsyeshme dhe i jep hov ushtrimit të të drejtës së vendosjes, pasi nëse do të ekzistonte një përcaktim i kundërt, do të nënkuptonte se administratorët do të ishin subjekt i disa ligjeve materiale të vendeve të ndryshme dhe për rrjedhojë, ‘e drejta e vendosjes’ dhe ushtrimi i aktivitetit tregtar përtej kufijve nuk do të ishin më aq tërheqëse¹⁸⁴. Sipas GJED, shtetet anëtare janë të lira të kufizojnë të mos lejojnë aplikimin e

¹⁸²C. Gerner-Beuerle, P. Paech, E. P. Schuster (Department of Law, London School of Economics) Study on Director Duties and liability, 2013.

¹⁸³G Eckert, *Internationales Gesellschaftsrecht* (Vienna: Manz 2010) fq. 356.

¹⁸⁴C. Gerner-Beuerle, P. Paech, E. P. Schuster (Department of Law, London School of Economics) Study on Director Duties and liability, 2013.

ligjeve, të cilat lejojnë kryesisht apo në çdo rast, mundësinë e shoqërive për të ushtruar aktivitet tregtar në një shtet tjetër jashtë territorit. Në këtë kuadër, shtetet anëtare janë të lira të kufizojnë të drejtën e transferimit të selisë apo menaxhimit qendror të një shoqërie të krijuar sipas ligjit të tyre vendas. Ky përcaktim nuk vlen në rast se shoqëria që po krijohet kërkon të aplikojë ligjin material të shtetit pritës dhe në një rast të tillë, shteti i origjinës do të cilësohet si të gjithë shtetet anëtare, pavarësisht mbi përcaktimet që bën ligji i tij për të drejtën ndërkombëtare private dhe detyrohet të lejojë transferimin e selisë në një juridiksion tjetër¹⁸⁵.

Mundësia e shoqërisë për të pasur vendin e kryerjes së aktivitetit të zakonshëm në një shtet tjetër të ndryshëm nga ai i krijimit, sigurisht lidhet ngushtë me ligjin e të drejtës ndërkombëtare të zbatueshëm në juridiksionin e atij shteti. Doktrina njih dy lloje teorish: Teoria e krijimit, sipas të cilës shoqërive u lejohej të krijohen dhe të zbatojnë ligjin e vendit të origjinës pavarësisht se aktiviteti tregtar synohet të zhvillohet në një shtet tjetër si dhe “Teoria e selisë së vërtetë” sipas të cilës vendi i krijimit duhet të përputhet me atë të kryerjes së aktivitetit. Sipas studimeve të kryera së fundmi, një numër shtetesh të cilët kryesisht kanë aplikuar teorinë e “Selisë së vërtetë”, tashmë lejojnë transferimin e aktivitetit dhe menaxhimit nën një tjetër juridiksion. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë në mënyrë të vazhdueshme ka argumentuar se shtetet anëtare, pavarësisht nga legjislacioni i tyre mbi të drejtën ndërkombëtare private, duhet të pranojnë inkorporimin e shoqërive të huaja, të cilat kërkojnë të transferojnë aktivitetin e tyre së bashku me menaxhimin, në një shtet tjetër të ndryshëm nga ai i regjistrimit¹⁸⁶.

Shteti	Kriteri kryesor i lidhjes	A ndryshoi qëndrimi i shtetit pas praktikës se GJED	Rregullimi varet nga lloji i shoqërisë (nëse rregullohet nga Neni 54 TFEU)	Komente
Gjermani	Selia reale	Po	Po, dhe gjithashtu disa gjykata më të ulëta e kanë aplikuar dhe për shoqëri jashtë BE-së.	Nuk aplikohet nga gjykatat për shoqëritë të cilat përfshihen në fushën e zbatimit të nenit 54TFEU, duke qenë se shoqëritë e krijuara sipas ligjit Gjerman mund të dërgojnë selinë e tyre jashtë vendit dhe të jenë subjekt i së drejtës gjermane.
Itali	Mikse	Po	Po	Kriteri kryesor i lidhjes është vendi i parashikuar në statut. Gjithsesi, ligji tregtar aplikohet për shoqëritë të cilat kanë selinë reale

¹⁸⁵ C-210/06, *Cartesio* [2008] ECR I-9641, paragrafi 110-112.

¹⁸⁶C. Gerner-Beuerle, P. Paech, E. P. Schuster (Department of Law, London School of Economics) Study on Director Duties and liability, 2013.

				(vendin e ushtrimit të aktivitetit) në Itali, pavarësisht vendit të krijimit (regjistrimit). Kjo nuk aplikohet në shoqëritë të cilat janë subjekt i nenit 54, edhe pse këto rregulla mund të aplikohen për disa entitete (në përputhje me traktatin) në rastin e përgjegjësisë penale.
Holandë	Krijimi çregjistrimi	Nuk ka lidhje me ligjin e të drejtës ndërkombët are private	Jo	“Ligji i shoqërive të huaja” vazhdon të aplikohet, por që pas vendimit “Inspire Art”, ky ligj nuk aplikohet për shoqëritë sipas nenit 54. Përcaktimet mbi ‘konfliktin mes ligjeve’ nuk janë ndikuar nga jurisprudenca e GJED.
Angli	Krijimi çregjistrimi			Doktrina tradicionale e krijimit sipas vendeve “Common Law”
Belgjikë	Selia reale “ <i>Principal establishment</i> ”	Nuk ka ndryshim të shprehur, por aplikimi direkt i Traktatit çon në një ndryshim në rezultat.	Efektivisht po, për sa kohë që gjykatat nuk mund të aplikojnë ligjet statutore në lidhje me shoqëritë e parashikuara në nenin 54 të Traktatit.	
Francë	Mikse	Nuk ka ndryshime në ligj dhe në bazë të vendimeve të gjykatave vendase, aplikimi i	Jo (megjithatë do të jetë subjekt i interpretimit përfundimtar nga ana e gjykatave).	Kriteri kryesor i lidhjes është vendi i regjistrimit.

		ligjit Francez mbi shoqëritë e huaja mund të jetë në përputhje me Traktatin.		
Finlandë	Krijimi çregjistrimi	Jo	Jo	“Versioni Skandinav” i teorisë së krijimit

3. Aplikimi i Kodit të Punës për administratorët

Ligjet e disa Shteteve Anëtare, në disa raste aplikojnë rregulla të posaçme për punësimin e administratorëve. Ndonjëherë, kjo diferencë bëhet me qëllim zbutjen e përgjegjësisë së punonjësve të tillë. Megjithatë, nëse rregullat e përgjegjësisë së administratorit duhet të përcaktohen duke bazuar në ligjin e Shtetit Anëtar të krijimit, ligji i aplikueshëm i punës duhet të përcaktohet duke zbatuar nenin 8 të Rregullores Roma I. Neni 1 (2) (f) i Rregullores Roma I, në përgjithësi përjashton nga fushëveprimi i tij çështjet që lidhen me përgjegjësinë e drejtorëve, por ligjet mbi shoqëritë tregtare të disa shteteve anëtare, duket se lejojnë, në rrethana të caktuara, zbatimin e këtij legjislacioni në lidhje me përgjegjësinë e administratorëve¹⁸⁷. Sipas legjislacionit shqiptar, ligji shqiptar përcakton disa dispozita të cilat rregullojnë përgjegjësië civile të administratorëve, ndërkohë që rasti i përgjegjësisë penale është një dispozitë të veçantë në Kodin Penal. Në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, trajtohet koncepti i “Përgjegjësisë personale” të administratorit:

Neni 13/7: Një person, i cili është, njëkohësisht, administrator dhe ortak apo aksionar i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë. Kontratat e tjera të lidhura midis këtij personi dhe shoqërisë regjistrohen në një procesverbal, i cili bëhet në zyrën qendrore të shoqërisë. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe administratori dënohet me gjobë deri në 15,000 lekë. Kur kundërvajtja administrative e parashikuar në këtë pikë konstatohet gjatë një kontrolli të organizuar nga administrata tatimore, sanksioni ekzekutohet nga kjo administratë.

Ndërkohë, një dispozitë tjetër në kuadër të parimeve të përgjithshme të vendosura nga ligji, është neni 16, i cili përcakton se *ortakët, aksionarët e shoqërisë tregtare, administratorët dhe anëtarët e këshillit të administrimit, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:*

- i. abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;*

¹⁸⁷C. Gerner-Beuerle, P. Paech, E. P. Schuster (Department of Law, London School of Economics) Study on Director Duties and liability, 2013

- ii. *trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;*
- iii. *në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë djepi për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të njaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.*

Dispozita, në vijim sqaron dhe masën e dëmit për të cilën do të përgjigjen administratorët në varësi të llojit të shkeljes së parashikuar më sipër. Palët e treta nuk mund të ngrenë padi për përmbushjen e detyrimeve, nëse shoqëria provon se i treti kishte pasur djepi për abuzimin apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur djepi për të. Padia duhet të ngrihet brenda 3 vjetëve nga kryerja e shkeljes. Ndërkohë dispozita të tjera të ligjit, përcaktojnë detyrimet e administratorëve dhe rrethanat, në të cilat ortakët mund të kërkojnë përjashtimin e tyre.

Për sa më lart, arrijmë në konkluzionin se në legjislacionin shqiptar, dispozitat kryesore të cilat lidhen me përgjegjësinë personale të administratorit kundrejt shoqërisë për të cilën ai është kontraktuar, janë të inkuorporuara në ligjin për shoqëritë tregtare pasi ky ligj, në një formë të detajuar parashikon pothuajse të gjitha aspektet e punësimit të administratorit: mënyrën e emërimit, shkarkimit, kompetencat dhe detyrimet ndaj shoqërisë, përgjegjësitë etj. Ndërkohë, dispozitat e Kodit të Punës mendoj se janë të një natyre më të përgjithshme, të cilat mund të aplikohen mbi administratorin në drejtim të garantimit të sigurisë në punë apo kushteve të drejtave dhe detyrimeve të përgjithshme në drejtim të marrëdhënies së punës. Kjo pasi detyra e administratorit mund të konsiderohet si një marrëdhënie normale pune. Në vijim një krahasim i shkurtër i marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës dhe sipas ligjit tregtar (për administratorin e shoqërisë).

3.1. Përgjegjësia e përgjithshme civile

Brenda Bashkimit Evropian, ekziston një diferencë e konsiderueshme mbi mekanizmat ligjorë të aplikueshëm për administratorët në përgjithësi. Jo të gjitha Shtetet Anëtare mbështeten ekskluzivisht vetëm në përcaktimet e ligjeve të shoqërive tregtare në këtë drejtim. Për këtë arsye, disa rregulla të parashikuara në legjislacionin kombëtar mund të përmbajnë dispozita kontradiktore. Për shembull, nëse ligji i një Shteti Anëtar përmban dispozita lidhur me përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit të interesave të kreditorëve sipas dispozitave të Kodit Civil, rregullat e tilla mund ta ekspozojnë drejtorin në përgjegjësi si në ligjin e aplikueshëm të shoqërive, ashtu edhe në ligjin për të drejtën ndërkombëtare private. Ky problem mund të ndikojë potencialisht në të gjitha shoqëritë me veprimtari ndërkufitare.

Sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, personi që, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin ose në pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkakuar. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cenimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira¹⁸⁸. Në këtë kuadër, përcaktimi mbi shkaktimin e dëmit mbetet i përgjithshëm dhe pa bërë ndonjë specifikim të veçantë mbi rrethin e personave që përfshihen në fushën e zbatimit të tij. Ndërkohë, ligji *“Për të drejtën ndërkombëtare private”*¹⁸⁹ në kuadër të dëmit jashtëkontraktor përcakton se ligji i aplikueshëm për një detyrim jashtëkontraktor është ligji i shtetit, në të cilin ndodhi dëmi, pavarësisht nga shteti, në të cilin ngjarja që shkaktoi dëmin ndodhi dhe pavarësisht nga shteti apo shtetet në të cilin/cilat ndodhin pasojat indirekte, përveç kur nuk parashikohet ndryshe në dispozitat e ligjit në fjalë. Megjithatë, ligji parashikon gjithashtu rrethanat për përjashtimin nga rregulli i përgjithshëm, pasi kur personi përgjegjës për dëmin dhe personi që ka pësuar dëmin kanë vendqëndrimin e tyre të

¹⁸⁸Neni 608 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë

¹⁸⁹ Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011“Për të drejtën ndërkombëtare private”

përbashkët në të njëjtin shtet, në kohën kur ndodhi ngjarja, zbatohet ligji i këtij shteti. Ndërsa kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se dëmi jashtëkontraktor është dukshëm i lidhur më ngushtë me një vend të ndryshëm nga ai që përmendëm më sipër¹⁹⁰. Në vijim, edhe Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ka përcaktuar në mënyrë të detajuar rrethanat e përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit si në dipozitat e para të ligjit, të cilat kanë funksionuar si parime të përgjithshme për të gjitha llojet e shoqërive, njëkohësisht dhe për çdo formë shoqërie janë përcaktuar rastet e përgjegjësisë së administratorëve. Në vijim, paraqitet një formë e shkurtuar krahasimore mes tre ligjeve potencialisht të aplikueshme në rastin e administratorëve të shoqërive tregtare, të cilat operojnë edhe përtej kufijve. Tabela paraqet informacion mbi legjislacionin shqiptar dhe vetëm disa nene janë sjellë për ilustrim.

Shkaktimi i dëmit	Kodi Civil	Ligji “Për të drejtën ndërkombëtare private”	Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
Dispozita	Neni 608 i Kodit Civil	Neni 56 i ligjit “Për të drejtën ndërkombëtare private”	Neni 13/7; Neni 16 i Ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare
Përmbajtja	<ul style="list-style-type: none"> Përcaktohen karakteristikat e dëmit dhe elementët. Nuk ka ndonjë specifikim mbi administratorët e shoqërive 	<ul style="list-style-type: none"> <i>Si rregull:</i> Aplikohet ligji i shtetit në të cilin ka ndodhur dëmi <i>Përjashtimet:</i> Kur personi përgjegjës për dëmin dhe personi që ka pësuar dëmin kanë vendqëndrimin e tyre të përbashkët në të njëjtin shtet, në kohën kur ndodhi ngjarja, zbatohet ligji i këtij shteti; Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se dëmi jashtëkontraktor është dukshëm i lidhur më ngushtë me një vend të ndryshëm nga ai që tregohet në pikat 1 dhe 2 të këtij 	<ul style="list-style-type: none"> Përcaktohet përgjegjësia administrative në rastin e kontratave të ndaluara Përcaktohen rrethanat e përgjegjësië personale civile si dhe me ndryshimet e ligjit në vitin 2014, janë parashikuar dhe vlerat e detyrimeve për të cilat përgjigjet administratori sipas llojit të shkeljes Në Nenin 163/3 (për shoqëritë aksionare): Administratorëtqë veprojnë në kundërshtim me

¹⁹⁰Neni 56 i Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011“Për të drejtën ndërkombëtare private”

		neni, zbatohet ligji i këtij shteti.	detyrat dhe shkelin standardet e kujdesit...janë të detyruar t'i shpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga shkeljet, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar ...”
Mundësia e përjashtimit nga përgjegjësia	<ul style="list-style-type: none"> • Është e pavlefshme marrëveshja që paraprakisht përjashton ose kufizon përgjegjësinë e personit që ka kryer dëm me faj. 	Nuk përcaktohet	Nuk përcaktohet

Duke marrë në konsideratë parashikimet e legjislacionit shqiptar, nuk ka ndonej konflikt të dukshëm *'prima facie'* mes ligjeve të sipërcituar dhe rrjedhimisht nuk duket se do të shfaqen probleme të mëdha juridike në rastin e shkaktimit të dëmit jashtëkontraktor në rastin e shoqërive të huaja, të cilat kryejnë aktivitet tregtar në Shqipëri, megjithatë theksoj se ky mbetet një problem potencial, në rast se dispozitat e ligjeve të aplikueshme përmbajnë kundërshti me njëra-tjetrën.

3.2. Qëndrimi i Gjykatave Shqiptare në lidhje me problematikat e administrimit

Pas zgjidhjes së martesës, kur palët i drejtohen gjykatës për pjesëtimin e pasurisë, shfaqen problemet lidhur me mirë administrimin ose jo të veprimtarisë tregtare. Më poshtë do të trajtojmë dy raste që janë shfaqur në praktikën shqiptare gjatë administrimit të shoqërive tregtare. Shtrohen pyetjet:

Së pari, A kërkohet pëlqimi i bashkëshortit në tjetërsimin e kuotave të një shoqërie tregtare?

Së dyti, Nëse bashkëshortët ndërmjet tyre kanë bërë marrëveshje mes tyre për transferim kuotash, a është kjo marrëveshje e vlefshme, nëse nuk është bërë me akt noterial për shkak se ortakët në këtë rast janë njëkohësisht dhe bashkëshortë? (Bazuar në parashikimet e nenit 45 dhe 46 të Ligjit “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare”)

Në lidhje me pyetjen e parë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.138, datë 13.03.2012 ka marrë në shqyrtim çështjen me rrethana si më poshtë: Paditësja K.K. dhe i padituri S.K. kanë lidhur martesë ligjore më datën 27.06.2001, të cilën e kanë zgjidhur me vendimin nr.4591, datë 21.05.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vendimi ka marrë formë të prerë dhe nuk është ankimuar. Paditësja K.K. me pretendimin se pasuritë e pasqyruara në objektin e padisë janë vënë gjatë martesës së saj me të paditurin S.K. ka kërkuar pjesëtimin gjyqësor të kësaj pasurie, pavarësisht se në emër të kujt ajo figuron e regjistruar. Pavarësisht rrethit të gjerë të sendeve që përmenden në këtë vendim, për efekt studimi do të ndalemi tek kuotat që ish-bashkëshorti i saj ka pasur në dy shoqëri, 50 % në shoqërinë “O” dhe 30 % në shoqërinë ”A”. Rreth tre muaj para se

të jepej vendimi për zgjidhjen e martesës, bashkëshorti i shet kuotat që zotëron në shoqërinë “O” tek vëllai i tij. Ish- bashkëshortja paditëse kërkon shpalljen e pavlefshëm të këtij tjetërsimi me pretendimin se është kryer për të pakësuar bashkësinë ligjore.

Gjykata e Shkallës së Parë arsyeton si më poshtë: *“Për rastin konkret do të zbatohet regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore, pasi ish-bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martesor; ka veçuar nga bashkësia ligjore pasurinë vetjake; ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të kontratës nr.756 rep., datë 06.02.2008, të transferimit (shitjes) së 30% të kuotave që zotëronte i padituri S.K. në Shoqërinë “Asa-Cleaning” Sh.p.k, tek i vëllai A.K.; ka përcaktuar pasurinë që do t’i nënshtrohet pjesëtimit, duke përfshirë kuotat që i padituri zotëron në Shoqërinë “Ola 1” SHPK dhe ka përfshirë në pjesëtim kuotat që zotërohen në Shoqëritë “Asa-Cleaning” SHPK dhe automjetintip Opel, sende të luajtshme, shumat në Euro dhe USD depozita pranë Tirana Bank dhe godinën ndodhur në rrugën “Sh. Bardhoshi” me nr.pasurie 7/210, z.k. 8230, me kufizimet përkatëse”.*

Pra, personi i tretë në këtë gjykim, duke qenë kreditor i të paditurit S.K. me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, do të ushtrojë të drejtat e tij mbi pasurinë e të paditurit në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi. Nëse detyrimi i të paditurit S.K. është një detyrim edhe i bashkësisë, referuar nenit 50, 60 e 84 të Kodit të Familjes, mbi pasuritë e përbashkëta të bashkësisë, në raport me pjesën që ka secili bashkëshort si rezultat i fazës së parë të pjesëtimit, do të përcaktohen edhe detyrimet përkatëse”.

Me të njëjtin arsyetim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.451, datë 12.10.2010, ka vendosur të ndryshojë vendimin vetëm për një pjesë të tij, por duke lënë të paprekur pjesën e vendimit lidhur me tjetërsimin e kuotave. Gjykata e Lartë në fakt nuk ka arritur t’i japë një zgjidhje në themel kësaj çështjeje, por ka kthyer çështjen për rigjykim pasi ka vënë re mangësi procedurale duke qenë se personi të cilit i janë shitur kuotat, nuk është thirrur në gjykim. (Ndërkohë që vendimet e dy shkallëve të tjera kanë cënuar rëndë interesat e tij, pasi me shpalljen e pavlefshme të kontratës së shitjes së kuotave, ai nuk do të konsiderohet më ortak i shoqërisë).

Gjykata në vendimin e saj është limituar duke thënë se: *“Në datën 06.02.2008 i padituri ka transferuar me kundërshtëpërbllim pjesën e kuotave që zotëronte në Shoqërinë “Asa-Cleaning” sh.p.k dhe për rrjedhojë nuk ka më pjesë në këtë shoqëri. Gjykata, në kundërshtim me ligjin ka pranuar pavlefshmërinë e kontratës së shitjes së kuotave si pasojë e një Padie Pauliane (neni 607 i Kodit Civil) pa pasur në gjykim një padi të tillë. Gjykata analizon fakte që lidhen me persona të cilët nuk janë pjesëmarrës (subjekte procedurale) në këtë gjykim, A.K., të cilit i hiqet e drejta e pronësisë mbi një pasuri (aksione të një shoqërie) pa u thirrur si palë në gjykim. Gjykata nuk ka respektuar urdhërimet e vendimit njehsues nr.9/2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu referimi te neni 607 i K.Civil është në zbatim të gabuar të ligjit, pasi kjo dispozitë parashikon lloj të veçantë të pavlefshmërisë relative dhe jo të pavlefshmërisë absolute sikundër arsyeton gjykata.”*

Pavarësisht se çështja është kthyer në shkallë të parë dhe ende pritet një vendim, është interesante të shqyrtohet vlefshmëria e veprimit të ish-bashkëshortit në këtë rast. A do të konsiderohet shitja një veprim i simuluar me qëllim uljen e vlerës së bashkësisë, duke qenë se palët ishin në prag të zgjidhjes së martesës? Apo tjetërsimi i këtyre kuotave me shpërbllim, në vetvete përbën një vlerë të shtuar për bashkësinë? Për shkak të faktit se bashkëshortët kanë qenë nën regjimin e bashkësisë ligjore, a do të jetë bashkëshortja automatikisht zotëruese e gjysmës së kuotave që zotëronte bashkëshorti (dhe rrjedhimisht të kërkohej pëlqimi i saj si një veprim administrimi jo i zakonshëm?)

Në lidhje me pyetjen e dytë, Gjykata ka marrë në shqyrtim një tjetër çështje me rrethana si më poshtë: “Sipas ekstrakteve të QKR dhe provave të tjera administruar në gjykim, rezulton se shoqëria “Alb Security” sh.p.k. është një shoqëri tregtare e formës me përgjegjësi të kufizuar, e cila është krijuar dhe regjistruar në gjykatë, konformë ligjit të kohës, me vendimin nr.20015 datë 11.09.1998 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Me këtë vendim dhe në bazë të ligjit, ky subjekt ka fituar dhe personalitetin juridik, aftësinë për të pasur të drejta e për të marrë përsipër detyrime.

Kapitali themeltar zotërohet nga ortakët e shoqërisë, në masën 75% të kapitalit themeltar ortaku A.V. dhe 25% ortaku M.B. Në vendim janë përcaktuar gjithashtu kohëzgjatja e shoqërisë dhe administrimi i saj, i cili do të bëhej nga një administrator i vetëm, duke u emëruar si i tillë njëri prej ortakëve të shoqërisë, pikërisht e paditura M.B. Pas një marrëveshjeje shkresore mes palëve, M.B. është bërë ortakë e vetme e shoqërisë dhe A.V. pretendon shpalljen e pavlefshme të kësaj kontrate për kalimin e kuotave pasi është në kundërshtim me rregullimet ligjore. Gjykata në arsyetimin e saj ka mbajtur qëndrimin se :*“Në lidhje me marrëveshjen e vitit 2001 të sipërcituar, pala paditëse pretendon pavlefshmërinë absolute të saj, pasi ajo nuk mund të konsiderohet nga pikëpamja ligjore si një akt i vlefshëm i cili të shërbejë për transferimin e kuotave të kapitalit që A.V. zotëronte në shoqëri te ortaku tjetër B. Sipas palës paditëse ky “transaksion duhej të formalizohej dhe finalizohet me kontratën e shitjes së kuotave të bërë me akt noterial para një noteri publik...” dhe në këto kushte vjen në kundërshtim me nenin 45 të ligjit 7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” dhe nuk janë plotësuar kërkesat e nenit 663 të Kodit Civil. Në këto rrethana pala paditëse ka kërkuar zgjidhjen e pasojave të ardhura nga regjistrimi i një akti të pavlefshëm.”* Me fjalë të tjera Gjykatës i është dashur të interpretojë në këtë rast nenin 45 dhe 46 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” të vitit 1992¹⁹¹. Nga pala e paditur pretendohet se neni 46 përcakton liri forme lidhur me transferimin mes anëtarëve të familjes, ndërkohë që neni 45 parashikon se akti noterial është i nevojshëm për transferimin e kuotave.

Dhe në këndvështrimin tonë, qëndrimi i mbajtur nga gjykata dhe pretendimi i palës paditëse janë të drejta, pasi neni 46 nuk lidhet me formën e transferimit të kuotave, por thjesht përmend mundësinë e palëve për kryerjen e këtij transferimi. Ndërkohë që për vetë rëndësinë që ka veprimi juridik i transferimit të kuotave dhe parashikimit të nenit 45 se ky transferim duhet bërë me akt noterial, besojmë se do të ishte e paarsyeshme që të bëhej një përfundim i tillë vetëm për bashkëshortët. Ndërkohë sipas legjislacionit aktual për shoqëritë tregtare ligji nuk parashikon formën noteriale, por shprehet se kalimi i kuotave bëhet në formë kontraktuale me shkrim. Praktika tregon se në fakt ato noterizohen dhe kjo më së shumti vjen si një reminishencë e parashikimit të ligjit të mëparshëm lidhur me shoqëritë tregtare. Vetë “Ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” nuk e përcakton qartësisht detyrimin për noterizim, por ia lë këtë çështje për përcaktim ligjeve përkatëse. Neni 27/2 i këtij ligji parashikon se dokumentet që vërtetojnë statusin apo një fakt që do të regjistrohet në QKB duhet të jenë në origjinal, të hartuar në formën e kërkuar nga legjislacioni përkatës. Këto përcaktime evazive i lënë vend një praktike pune pranë QKB ku tentohet të zbatohet noterizimi i këtyre kontratave.

Aktualisht tash Shqipëri ende nuk ka një praktikë gjyqësore të konsoliduar në drejtim të përcaktimit të mënyrës sesi do të veprohet në rastin e një aktiviteti tregtar të bashkëshortëve kur ata vendosin të zgjidhin martesën. Shoqëritë tregtare për vetë karakteristikat që kanë si persona juridikë janë të ndryshme për nga natyra nga sendet që përbëjnë bashkësinë ligjore dhe në këtë kuptim nuk bën

¹⁹¹Neni 45 “Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial. Shoqëria ose të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t’i bëhen të ditura asaj”.Neni 46 “Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

sens t'i nënshtrohen ekskluzivisht vetëm parashikimeve të Kodit të Familjes, duke qënë se nuk mund të pjesëtosh një shoqëri tregtare në kushtet kur legjislacioni specifik që i rregullon ato, pavarësisht nëse ortakët janë bashkëshortë ose jo, nuk e njeh këtë koncept juridik. Termi pjesëtim i shoqërisë tregtare është një nocion i panjohur nga ligji tregtar dhe është gabim juridik për të tentuar të paralelizohet nocioni i pjesëtimit të pasurisë me ndarjen e një personi juridik apo nocione të tjera që në pamje të parë duken të përafërta me pjesëtimin e pasurisë. Për më tepër që edhe në doktrinën dhe teorinë në lidhje me shoqëritë tregtare nuk pranohet nga shumica e autorëve që shoqëritë tregtare të trajtohen si sende dhe ortakët si pronarë, por mendimi më i pranuar është që ortakët konsiderohen si investitorë në këto shoqëri dhe prandaj edhe administrimi i shoqërive u ngarkohet strukturave të tjera.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Themelimi i shoqërisë tregtare përbën një nga aspektet më të rëndësishme të saj, pasi në praktikë, pas themelimit të shoqërisë tregtare vijnë disa pasoja të cilat rrjedhin automatikisht nga krijimi i personalitetit të veçantë. Pasoja më kryesore është përfshirja e shoqërisë në marrëdhëniet kontraktore si një subjekt i veçantë dhe për rrjedhojë dhe marrjen përsipër të detyrimeve nga ana e saj. Tashmë, kreditë të cilat janë marrë në emër të shoqërisë i takojnë shoqërisë, dhe jo administratorit apo ortakëve apo aksionarëve. Kjo është konfirmuar për herë të parë në vendimin e Dhomës së Lordëve (Angli) në rastin e Salomonit në vitin 1897. Legjislacioni shqiptar në këtë kuadër është në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe krijon lehtësi maksimale mbi themelimin e shoqërive dhe fitimin e personalitetit juridik.

Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ofron gjithashtu lehtësi në drejtim të krijimit të degëve apo zyrave të përfaqësimit duke garantuar lehtësi në regjistrimin e tyre me anë të një aplikimi për regjistrimin fillestar dhe regjistrimet e tjera të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja bëhet nga përfaqësuesi ligjor i degës apo zyrës së përfaqësimit, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë së huaj apo nga çdo person i autorizuar.¹⁹²Degët dhe zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja regjistrohen duke depozituar aplikimin për regjistrim fillestar, të plotësuar me disa të dhëna detyruese të paracaktuara në ligj. Është e qartë se legjislacioni shqiptar ka paracaktuar një set standardesh minimale për regjistrimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit, duke lehtësuar kështu aktivitetin e tyre tregtar në Shqipëri. Theksoj se dispozitat, janë një reflektim i dukshëm i përcaktimeve të Direktivave Europiane dhe janë në përputhje me frymën e legjislacionit Evropian, i cili synon krijimin e lehtësirave në lidhje me krijimin dhe lëvizjen e kapitalit dhe maksimizimin e aktivitetit tregtar.

Me ndryshimet e bëra në vitin 2014, Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” ka prezantuar për herë të parë konceptin e pavlefshmërisë së krijimit të një shoqërie tregtare duke ecur në drejtim të përshtatjes së legjislacionit me *Acquis Communautaire*, veçanërisht Direktivën e Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968. Ligji përcakton dy regjime të ndryshme: pavlefshmërinë absolute dhe atë relative. Gjykimi mbi ekzistencën e njëres prej këtyre lloj pavlefshmërisë, do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pasojat që do të vijnë kundrejt personit juridik të krijuar (shoqërisë tregtare). Në drejtim të pavlefshmërisë së shoqërisë tregtare, Gjykata e Lartë ka elaboruar në detaje diferencat mes saj dhe pavlefshmërisë së veprimeve juridike, duke plotësuar kuptimin e dispozitave të parashikuara në ligjin e shoqërive tregtare. Si konkluzion, mbështetur dhe në argumentimin e detajuar të kësaj gjykate, parashikimet specifike për pavlefshmëritë në shoqëritë tregtare nuk janë të rastësishme. Shoqëria tregtare në thelbin e saj përfaqëson një kontratë, e cila për shkak të gjerësisë dhe kohëzgjatjes, shoqërohet me veçori specifike. Ligjvënësi këtu ka patur parasysh faktin se një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare ka filluar të kryejë aktivitet, të hyjë në marrëdhënie juridike, ose të ketë lidhur kontrata me të tretët duke përfutur të drejta e duke marrë përsipër detyrime. Nëse pavlefshmëria absolute, në kuptimin e pasojave që do të sillte do të trajtohej si në legjislacionin civil, kjo gjë do të sillte nulitetin e të gjithë veprimtarisë së shoqërisë, duke dëmtuar veç të tjerash edhe interesat e të tretëve¹⁹³.

Pavlefshmëria e themelimit të shoqërisë, e cila lidhet me rastet e shfaqjes së veseve të vullnetit të palëve që marrin pjesë për realizimin e akteve të themelimit, është rasti më i rëndë i pavlefshmërisë. Ajo mund të shkaktohet vetëm në raste veçanërisht të rënda që lidhen me mosrespektimin e rregullave bazë të themelimit të shoqërisë. Legjislacioni shqiptar, në kuadrin e zgjidhjes së pasojave, parashikon vetëm shpërndarjen e shoqërisë dhe futjen e saj në rrugën e likuidimit. Ndryshe do të trajtohej problemi për aktet që nxjerrin organet e shoqërisë gjate aktivitetit të saj, siç do të ishin vendimet e asamblese së ortakëve, apo dhe kontrata e shitjes së kuotave të kapitalit. Lidhur me to, në paragrafin 3 të nenit 231, ligjvënësi ka përdorur shprehjen

¹⁹²Neni 26 paragrafi 4 i Ligjit Nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit”

¹⁹³ Vendim Nr. 00-2010-197 (15) datë 19.01.2010 (Gjykata e Lartë)

se pavlefshmëria e tyre mund të rezultojë “nga një dispozitë urdhëruese e ligjit” në ndryshim nga paragrafi 1 ku termi i përdorur është “vetëm nga një dispozitë e veçantë e këtij ligji”¹⁹⁴.

Pavarësisht ekzistencës së praktikës gjyqësore në këtë drejtim, mendoj se një riformulim në dispozitat që lidhen me shoqëritë tregtare do të ndihmonte në shmangien e nevojës së interpretimeve ligjore në kuadër të pavlefshmërive. Aktualisht Neni 3/1 i ligjit i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” përcakton rrethanat të cilat çojnë në shpalljen e pavlefshmërisë së krijimit, por pa përcaktuar në mënyrë të shprehur se cila rrethanë është e kurueshme dhe cila jo. Edhe pse, nga një interpretim logjik dhe sistematik i dispozitave mund të analizohet një çështje e tillë, duke marrë në konsideratë se shoqëria tregtare ndërlihd interesa ekonomike shumëpalësh, mbrojtja ligjore dhe ngushtimi i hapësirave për interpretim do të ndikonte në mënyrë pozitive. Gjithashtu, vlen për t’u inkorporuar në legjislacion dhe praktika Evropiane, në kuadër të pavlefshmërisë së shoqërive. Siç u analizua në Kreun 1, praktika e GJED në këtë drejtim ka qenë e pasur dhe duke marrë në konsideratë aspiratat e Shqipërisë për anëtarësim në BE, konsideratat e GJED duhet të përfshihen në kuadrin ligjor shqiptar dhe të merren në konsideratë për analogji në interpretimet e bëra nga gjykatat shqiptare. Një gjykatë kombëtare që shqyrton një çështje që i përket fushës së veprimit të Direktivës 68/151, është e nevojshme të interpretojë ligjin e saj kombëtar në dritën e formulimit dhe qëllimit të kësaj direktive me qëllim që të përjashtojë një deklaratë të pavlefshmërisë së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në një bazë tjetër përveç atyre të renditura në nenin 11 të direktivës.

Një nga vendimet më të rëndësishme të GJED, ka qenë *Marleasing*, e cila sanksionoi se një gjykatë kombëtare që shqyrton një çështje që i përket fushës së veprimit të Direktivës 68/151, është e nevojshme të interpretojë ligjin e saj kombëtar në dritën e formulimit dhe qëllimit të kësaj direktive me qëllim që të përjashtojë një deklaratë të pavlefshmërisë së një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në një bazë tjetër përveç atyre të renditura në nenin 11 të direktivës. Gjithashtu, një gjykatë kombëtare që shqyrton një çështje që i përket fushëveprimit të Direktivës së Këshillit 68/151/KEE të 9 Marsit 1968 mbi koordinimin e masave mbrojtëse të cilat, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, u kërkohet nga shtetet anëtare të shoqërive brenda kuptimit i paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, me qëllim të marrjes së masave të tilla ekuivalente në të gjithë Komunitetin, kërkohet të interpretojë ligjin e tij kombëtar në dritën e formulimit dhe qëllimit të kësaj direktive për të parandaluar një deklaratë të pavlefshmërisë e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në një bazë tjetër përveç atyre të renditura në nenin 11 të direktivës.

Gjithashtu, një vendim tjetër i cili paraqet interes për studim mbetet *Ubbink Isolatie BV. Summons*, në të cilin Gjykata vlerëson se rregullat për pavlefshmërinë e shoqërive të përfshira në Direktivën e Parë dhe nuk zbatohen kur veprimet e përfshira janë kryer në emër të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, ekzistenca e të cilës nuk është konfirmuar pasi formalitetet e kërkuara nga ligji kombëtar për regjistrim nuk janë plotësuar.

Në lidhje me ndarjen apo bashkimin e shoqërive tregtare, pavarësisht se dispozitat ligjore janë të formuluar në përputhje me Direktivat Evropiane, gjykoj me vlerë marrjen në konsideratë të praktikës së GJED nga ana e gjykatave shqiptare, në drejtim të analizës së konkurrencës dhe pozitës dominuese në rastet e bashkimit të shoqërive. Sipas praktikës së GJED, çështja e bashkimit të shoqërive paraqet një ndjeshmëri të lartë dhe një impakt thelbësor publik pasi në rast aplikimi të një bashkimi jo të lejuar, do të cënoheshin interesat e konsumatorëve dhe do të shkeleshin parimet themelore të lëvizjes së lirë brenda BE-së. Në çështjen *Gencor*, GJED konfirmoi qëndrimin e saj se ekzistenca e një pozite dominuese rrjedh nga disa faktorë të cilët të marrë veç, nuk janë domosdoshmërisht vendimtarë. Midis këtyre faktorëve, ekzistenca e aksioneve të shumta është shumë e rëndësishme. Megjithatë, një ndarje e konsiderueshme e tregut si dëshmi e

¹⁹⁴Vendim Nr. 00-2010-197 (15) datë 19.01.2010 (Gjykata e Lartë)

ekzistencës së një pozitë dominuese nuk është një faktor konstant. Rëndësia e saj ndryshon nga tregu në treg, sipas strukturës së këtyre tregjeve, veçanërisht sa janë të shqetësuar prodhimi, furnizimi dhe kërkesa. Pra, gjykatat në praktikën e tyre nuk duhet të limitohen vetëm në një trajtim sipërfaqësor të çështjes duke marrë në konsideratë të njëjtët faktorë në tregje të ndryshme, por situata e pozitës dominuese, duhet analizuar në tregun konkret në të cilin vepron shoqëria. Më tej, në çështjen *Tetra Laval*, u arrit në përfundimin se mbi efektet e bashkimit të tipit konglomerat duhet përfshirë një ekzaminim gjithëpërfshirës të mundësisë së përshtatjes së sjelljes anti-konkurruese të aftë për të rezultuar në një përfitim maksimal, duke konfirmuar edhe njëherë nevojën për analizën e situatës së bashkimit në mënyrë gjithëpërfshirëse me qëllim evidentimin e impaktit.

Një nga çështjet kryesore të ngritura në doktrinën evropiane vitet e fundit është mundësia e shoqërive të krijuara në një nga vendet anëtare, të vendoset në një vend tjetër anëtar dhe në ç' masë kjo është e lejueshme. Tri vendimet më të rëndësishme që kanë hapur debate në lidhje me këtë çështje dhe që kanë ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e një praktike janë *Centros*¹⁹⁵, *Überseering*¹⁹⁶ dhe *Inspire Art*¹⁹⁷. Pavarësisht se gjykata ka zhvilluar një praktikë të gjerë lidhur me këtë diskutim, duket se ende nuk ka një unifikim të plotë të praktikës gjyqësore dhe shumë çështje të lidhura me të drejtën e vendosjes janë ende të paqarta. Nëse një shoqëri e krijuar dhe ka selinë qendrore në një vend anëtar të BE-së (X), sipas ligjit të një vendi tjetër anëtar të BE-së (Y), do të trajtohet si një një shoqëri që ka transferuar vendin e kryerjes së aktivitetit të zakonshëm në shtetin (Y) dhe rregullat e shtetit (Y) do të zbatohen si dhe shoqëria do të konsiderohet si subjekt i cili përfiton nga e drejta e vendosjes në kuadër të traktatit.

Praktika e GJED ka qenë mjaft e pasur lidhur me këtë çështje, duke bërë të mundur lehtësimin e lëvizjes së kapitalit brenda BE dhe lehtësimin e rregullave apo procedurave në kuadër të të drejtës së vendosjes apo brenda territorit të BE. Ndalimi i vendeve të origjinës në përcaktimin e rregullave që pengojnë të drejtën e vendosjes në një vend tjetër anëtar të Bashkimit Evropian u sanksionua përfundimisht në çështjen *Marks & Spencer*¹⁹⁸. Në këtë çështje, u argumentua nga gjykata se një masë kombëtare që lejon shoqërinë mëmë të mbulojë humbjet e shoqërive bija të inkuorpuara në të njëjtin shtet me të, por jo humbjet e shoqërive bija, të cilat janë të vendosura në një vend tjetër anëtar, përbënte në thelb një shkelje të të drejtës së vendosjes.

Në kuadër të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, si dhe në kuadër të një procesi që po shkon drejt unifikimit të legjislacionit të shoqërive tregtare brenda vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, një set Direktivash janë krijuar me qëllim lehtësimin e tregut të përbashkët dhe krijimin e një seti minimum rregullash të përbashkëta në të gjithë bashkimin. Praktika e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian ka luajtur një rol kyç në drejtim të unifikimit të praktikave Evropiane dhe veçanërisht interpretimin e shumë çështjeve praktike në lidhje me disa aspekte civile që prekin shoqëritë tregtare. Përcaktimet e traktateve mbi lirinë e vendosjes së shoqërive janë ndjekur nga një numër i madh Direktivash të cilat trajtojnë aspekte të veçanta të shoqërive.

Në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elementë të huaj, një hap cilësor do të konsideronim faktin se Rregullorja e re Bruksel I (e rishikuar) zgjeron rrethin e personave që mund t'i drejtohen gjykatave të vendeve anëtare, pasi tashmë dhe persona që nuk kanë vendbanim në një shtet anëtar, mund t'ia besojnë juridiksionin ekskluziv një gjykate të një vendi anëtar. Me hyrjen në fuqi të Rregullores së rishikuar do t'i jepet zgjidhje problematikave të

¹⁹⁵Çështja: C-212/97 *Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen* [1999] ECR I-1459

¹⁹⁶Çështja: C-208/00 *Überseering BV v. Nordic Construction Company Baumanagement GmbH (NCC)* [2000] ECR I-9919

¹⁹⁷Çështja: C-167/01 *Kamer van Koophandel en Fabrieken voor Amsterdam v. InspireArt Ltd* [2003] ECR I-10155.

¹⁹⁸Case C-446/03 *Marks & Spencer plc v HM's Inspector of Taxes* [2005] ECR I-10837 paragrafi 31

shpeshhta të hasura në praktikë lidhur me parimin e “Lis pendens”, pasi gjykata të cilës palët i kanë besuar juridiksionin ekskluziv, do të jetë ajo që do të prevalojë pavarësisht se cila është gjykata e cila është investuar e para. Në këtë pikë, mbetet akoma e papërcaktuar mënyra se si do të zgjidhet çështja në rastin e klauzolave asimetrike, por kjo duket se do të jetë një sfidë e mundshme për rregulloren. Lehtësimi i ekzekutimit të vendimeve është një nga hapat më domethënës që kjo Rregullore ka ndërmarrë. Tashmë nuk do të jetë më e nevojshme deklarimi i një vendimi si “i ekzekutueshëm”, por mjafton që ky vendim të jetë dhënë në një shtet anëtar dhe të jetë i ekzekutueshëm në shtetin anëtar ku është dhënë. Nëse këto dy kushte plotësohen, atëherë vendimi është i ekzekutueshëm në çdo shtet tjetër anëtar. Kjo shmang një procedurë burokratike, e cila shpeshherë ka sjellë problem gjatë implementimit të Bruksel I.

Një arritje e pamohueshme mbetet sqarimi që Rregullorja e rishikuar i bën çështjes së arbitrazhit. Pavarësisht se këto sqarime nuk janë inkorporuar në nene, por janë të përmendura në preambulën e Rregullores, vlen të theksohet fakti se Rregullorja i jep përparësi Konventës së New York-ut. Së fundmi, pavarësisht se shumë probleme të hasura gjatë implementimit të Rregullores së Bruksel I ende nuk janë inkorporuar në tekstin e Rregullores së rishikuar, duket se ndryshimet që janë bërë janë ndryshime cilësore dhe që pritet të sjellin një zhvillim pozitiv në kuadrin e unifikimit të së drejtës në çështjet civio-tregtare, veçanërisht në fushat e juridiksionit, njohjes dhe ekzekutimit, të cilat mbulohen nga kjo rregullore.

Një nga komponentët kryesorë të shoqërisë tregtare pas themelimit të saj, është ekzistenca e një kapitali minimal, i cili në varësi të formës së shoqërisë, ndahet në kuota apo aksione. Koncepti i kapitalit të shoqërisë është i gjithëpranuar si shuma e përgjithshme e deklaruar në bilanc si aktiv dhe korrespondon me vlerën e kontributeve fillestare të bërë nga ortakët e shoqërisë në momentin e krijimit të saj, si dhe me asetet neto të shoqërisë të cilat janë të destinuara të përdoren për zhvillimin e aktivitetit tregtar¹⁹⁹. Kapitali përbën një nga garancitë kryesore të kreditorëve në marrëdhëniet kontraktore me shoqëritë dhe ideja e vendosjes së kapitalit minimal kulmoi me miratimin e Direktivës së dytë mbi kapitalin²⁰⁰. Ekzistenca e rregullave për mbrojtjen e interesave ekonomike të kreditorëve është një zgjidhje e dmosdoshme për shkak të mungesës së tregjeve ideale në të cilat transparenca është maksimale dhe ku sjelljet oportuniste nuk janë prezente. Në kushtet e tregjeve ku ekziston mundësia e asimetrisë së informacionit, doktrina e kapitalit ligjor duhet të shikohet e ndërthurur me mekanizmat e mbrojtjes së kreditorëve. Niveli i mbrojtjes së ofruar kundrejt kreditorëve, varion nga një shtet në tjetrin, megjithatë në një vështrim të përgjithshëm, shtete e BE-së janë të orientuara më tepër drejt mbrojtjes së interesave të kreditorëve, ndërkohë që në SHBA vihet re një qasje, e cila ofron më tepër fleksibilitet për ortakët dhe aksionerët e shoqërive në krahasim me kreditorët.

Lëvizja e kapitalit përfshin në fushën e veprimit dhe investimin direkt në formën e pjesëmarrjes në një shoqëri nëpërmjet zotërimit të aksioneve, qoftë duke marrë pjesë në menaxhimin dhe kontrollin e shoqërisë (investim direkt) apo për qëllime investimi pa pasur për qëllim pjesëmarrjen në aspekte të menaxhimit apo kontrollit të shoqërisë (investime në portofol)²⁰¹. Aneksi i Direktivës si dhe shënimet sqaruese mbi të, parashikojnë se dhe investimi direkt, në formën e pjesëmarrjes në një shoqëri nëpërmjet blerjes së letrave me vlerë, përbën lëvizje të kapitalit. Ky qëndrim, u konfirmua dhe nga GJED në çështjen C-367/98 - Commission v Portugal²⁰², paragrafi 38. Edhe pse neni 56 nuk e përkufizon termin “lëvizje e kapitalit”, investimet

¹⁹⁹ Miola, M, Legal Capital and Limited Liability Companies: the European Perspective ECFR 2005, 413–486

²⁰⁰ Escher – Weingart, Reform durch Deregulierung im Kapitalgesellschaftsrecht (2001) 59

²⁰¹ Ky qëndrim i GJED është sanksionuar në çështjet: C-222/97 Trummer and Mayer [1999] ECR I-1661, paragrafi 21; Commission v France, paragrafi 36 and 37, Commission v United Kingdom, paragrafi 39, 40) si dhe në çështjen C-282/04 - Commission v Netherlands, § 19.

²⁰² C-367/98 - Commission v Portugal, paragrafi 38.

direkte ndërkufitare përfshihen gjithashtu brenda këtij koncepti. Kjo karakterizohet veçanërisht nga mundësia për të marrë pjesë efektivisht në menaxhimin dhe kontrollin e një shoqërie.

Masat të cilat kufizojnë lëvizjen e aksioneve apo kufizojnë në mënyrë direkte apo indirekte pjesëmarrjen efektive në menaxhimin apo kontrollin e shoqërisë (për shembull duke vendosur një sistem miratimi paraprak), përbëjnë kufizim të së drejtës së lëvizjes së kapitalit. Masat shtrënguese nuk do të analizohen në kuadër të shtetësisë së investitorit, por në kuadër të mundësisë së tij efektive për të blerë aksione dhe për të përfituar nga të drejtat që lidhen me to, pra pavarësisht se një masë shtrënguese mund të jetë e njëjtë si për shtetasit rezidentë si për ata jo rezidentë, sërisht ajo duhet të analizohet në kuadër të efekteve që sjell. Në çështjen *Komisioni kundër Spanjës*, GJED analizoi nëse rregullat e vendosura në Spanjë në ligjin 51995 dhe disa Dekrete Mbretëore përbënin apo jo kufizim të lirisë së kapitalit, pasi përcaktonte miratim paraprak të disa vendimeve lidhur me shoqëritë tregtare. Edhe pse rregullat në fjalë nuk shkaktojnë trajtim të pabarabartë, ato pengojnë blerjen e aksioneve në shoqërinë në fjalë dhe pengojnë investitorët në Shtetet e tjera Anëtare për të investuar në këto shoqëri²⁰³. I njëjti qëndrim është mbajtur dhe në rastin e Mbretërisë së Bashkuar ku u gjykua se duke vendosur dispozitat që kufizojnë mundësinë e marrjes së aksioneve me të drejtë vote, si dhe procedurë që kërkon pëlqimin për shitjen e asetëve të shoqërisë, kontrollin e filialeve të saj dhe mbylljen e saj, Mbretëria e Bashkuar nuk ka përmbushur detyrimet e saj sipas nenit 56 të KE²⁰⁴.

GJED, në praktikën e saj ka analizuar dhe masat shtrënguese të ndërmarra nga Shtetet Anëtare me qëllim nxitjen e investimeve në tregun e brendshëm dhe kufizimin e investimeve në shoqëri të krijuara në një Shtet tjetër Anëtar. Një nga llojet më të ndeshura të këtij kufizimi, mund të konsiderohet dhe vendosja e disa procedurave të miratimit paraprak, sipas të cilave shoqëria duhet të autorizohet nga shteti para marrjes së vendimeve lidhur me disa aspekte të rëndësishme të menaxhimit të shoqërisë dhe ushtrimit të të drejtave që lindin nga zotërimi i kuotave dhe aksioneve. Një përfundim i vlefshëm nga praktika e GJED është analiza që kjo e fundit i ka bërë masave shtrënguese të imponuara nga shtetet anëtare të BE-së me qëllim kufizimin e aktivitetit tregtar jashtë territorit dhe nxitjen e ushtrimit të aktivitetit vendas.

Brenda Bashkimit Evropian, ekziston një diferencë e konsiderueshme mbi mekanizmat ligjorë të aplikueshëm për administratorët në përgjithësi. Jo të gjitha Shtetet Anëtare mbështeten ekskluzivisht vetëm në përcaktimet e ligjeve të shoqërive tregtare në këtë drejtim. Për këtë arsye, disa rregulla të parashikuara në legjislacionin kombëtar mund të përmbajnë dispozita kontradiktore. Për shembull, nëse ligji i një Shteti Anëtar përmban dispozita lidhur me përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit të interesave të kreditorëve, sipas dispozitave të Kodit Civil, rregullat e tilla mund ta ekspozojnë drejtorin në përgjegjësi si në ligjin e aplikueshëm të shoqërive, ashtu edhe në ligjin për të drejtën ndërkombëtare private. Ky problem mund të ndikojë potencialisht në të gjitha shoqëritë me veprimtari ndërkufitare.

Aktualisht në Shqipëri ende nuk ka një praktikë gjyqësore të konsoliduar në drejtim të përcaktimit të mënyrës sesi do të veprohet në rastin e një aktiviteti tregtar të bashkëshortëve kur ata vendosin të zgjidhin martesën. Shoqëritë tregtare për vetë karakteristikat që kanë si persona juridikë janë të ndryshme për nga natyra nga sendet që përbëjnë bashkësinë ligjore dhe në këtë kuptim nuk bën sens t'i nënshtrohen ekskluzivisht vetëm parashikimeve të Kodit të Familjes, duke qënë se nuk mund të pjesëtosh një shoqëri tregtare në kushtet kur legjislacioni specifik që i rregullon ato, pavarësisht nëse ortakët janë bashkëshortë ose jo, nuk e njeh këtë koncept juridik.

²⁰³C-163/94, C-165/94 dhe C-250/94 *Sanz de Lera* dhe të tjerët [] ECR I-4821, paragrafi 25, dhe Rasti C-302/97 *Konle* [1999] ECR I-3099, paragrafi 44) C-367/98 - *Komisioni kundër Portugalisë*, § 39, 42-43 dhe 45

²⁰⁴C-98/01 – *Commission vs United Kingdom*, paragrafi 50 dhe C-174/04 - *Commission v Italy*, paragrafi 29-31

Pajtohem me mendimin se termi pjesëtim i shoqërisë tregtare është një nocion i panjohur nga ligji tregtar dhe është gabim juridik përpjekja për të tentuar të paralelizohet nocioni i pjesëtimit të pasurisë me ndarjen e një personi juridik apo nocione të tjera që në pamje të parë duken të përafërta me pjesëtimin e pasurisë. Për më tepër që edhe në doktrinën dhe teorinë në lidhje me shoqëritë tregtare nuk pranohet nga shumica e autorëve që shoqëritë tregtare të trajtohen si sende dhe ortakët si pronarë, por mendimi më i pranuar është që ortakët konsiderohen si investitorë në këto shoqëri dhe prandaj edhe administrimi i shoqërive u ngarkohet strukturave të tjera.

BIBLIOGRAFI

LIBRA DHE ARTIKUJ

1. Troberg, in: v.d.Groeben/Thiesing/Ehlermann, *EU-/EG-Vertrag*, 5th ed. (Baden-Baden: Nomos 1997)
2. Schon, "Europäische Kapitalverkehrsfreiheit und nationales Steuerrecht", in: *Gedachtnisschrift Knobbe-Keuk* (Koln: O. Schmidt 1997) 743, at pp. 750 et seq.
3. Emmerich/ Habersack, *Aktienkonzernrecht* (1998)
4. Nuni, A., "E drejta Civile- Pjesa e Përgjithshme" Tiranë 2001
5. Schon, "The Concept of the Shareholder in European Corporate Law", 1 *EBOR*(2000)
6. Haritz/ Wisniewski, "Das Ende des Umwandlungsmodells, Erste Anmerkungen zu umwandlungssteuerrechtlichen Aspekten der geplanten Unternehmenssteuerreform", *GmbH-Rundschau* [2000]
7. Arcelia Quintana Adriano. E, The Natural Person, Legal Entity or Juridical Person and Juridical Personality, December 2015
8. Farrar, J. 1998, 'Legal Issues Involving Corporate Groups',
9. Vernengo J.R., 'Hans Kelsen – The Pure Law Theory' 178, 2000
10. Veil of Confusion Surrounding the Doctrine of Piercing the Corporate Veil', *Oregon Law Review*, 76, 4: 853–908.
11. Miola, M., Legal Capital and Limited Liability Companies: the European Perspective ECFR 2005, 413–486
12. Escher – Weingart, Reform durch Deregulierung im Kapitalgesellschaftsrecht (2001) 59
13. Kübler, Aktie, Unternehmensfinanzierung und Kapitalmarkt (1989)
14. European Union Law: Cases and Material, Damian Chalmers, Gareth Davies, dhe Giorgio Monti
15. Le capital social dans le droit américain des sociétés, in Couret-Le Nabasque (n 1) 153
16. For a comparative cospectus of capital maintenance and distribution regimes, Rickford (n 3) 998
17. *Company and Securities Law Journal*, 16, 3: 184–206.
18. Freedman, J. 2000, 'Limited Liability: Large Company Theory and Small Firms', *Modern Law Review*, 63, 3: 317–54.
19. Gelb, H. 1982, 'Piercing the Corporate Veil', *Chicago Kent Law Review*, 59, 1: 1–22.
20. Herzig, "Körperschaftsteuersystem und Europäischer Binnenmarkt", in: Schon (ed.), *Gedachtnisschrift Knobbe-Keuk* (Koln: O. Schmidt 1997)
21. Brambusch, J., & Grassegger, H. (2010, January 22). *Das Geschäft mit falscher Biowolle*. Retrieved May 25, 2011, from Financial Times Deutschland: Carr, A. S., & Smeltzer, L. R. (1999).
22. Carroll, A. B. (1999). Corporate Social Responsibility: Evolution of a Definitional Construct. *Business Society*, 38(3), 268-295.

23. Carter, C. R., & Jennings, M. M. (2002). Social responsibility and supply chain relationships. *Transportation Research Part E: Logistics and Transportation Review*, 38(1), 37-52.
24. Egels-Zandén, N., & Kallifatides, M. (2010). Multiparadigm Inquiry into Corporate Responsibility: An ABB Corporate Aid Project under the Global Compact Banner. In P. Dobers, *Corporate Social Responsibility - Challenges and Practices* (pp. 163-197). Stockholm: Santérus Academic Press
25. D. Ormerod, Smith and Hogan's Criminal Law(13th edn., Oxford: Oxford University Press, 2011)
26. Harris, J. 2007, 'Corporate Group Insolvencies: Charting the Past, Present and Future of "Pooling" Arrangements', *Insolvency Law Journal*, 15, 2: 78–99.
27. Gordon, J. and Kornhauser, L. 1985, 'Efficient Markets, Costly Information and Securities Research', *New York University Law Review*, 60, 5: 761–849.
28. Ransiek & S. Hu"ls, 'Strafrecht zur Regulierung der Wirtschaft' (2009)Zeitschrift fu"r Unternehmens- und Gesellschaftsrecht
29. Scott, R.E. 1990, 'A Relational Theory of Default Rules for Commercial Contracts', *Journal of Legal Studies*, 19, 2:597–616
30. Spender, P. 2005, 'Weapons of Mass Dispassion: James Hardie and Corporate Law', *Griffith Law Review*, 14: 280.
31. A. T. Schork, 'Strafbarkeit des directors einer Private Company Limited by Shares wegen verspa"teter Insolvenzantragstellung' (2006)
32. J. C. Joerden & A. J. Szwarc (eds.), 'Europaisierung des Strafrechts in Polen und Deutschland – rechtsstaatliche Grundlagen' (Berlin: Duncker & Humblot, 2007)
33. H. Eidenmu"ller, 'Mobilita"t und Restrukturierung von Unternehmen im Binnenmarkt' (2004)
34. Just, Die englische Limited in der Praxis (3rd edn., Muenchen: Verlag C.H. Beck 2008)
35. P.Mankowski&S.Boc, 'Fremdrechtsanwendung im Strafrecht durch Zivilrechtsakzessorietat bei Sachverhalten mit Auslandsbezug fur Blanketttatbestande und Tatbesta"nde mit normativem Tatbestandsmerkmal'
36. Landers, J., 1975, 'A Unified Approach to Parent, Subsidiary and Affiliate Questions in Bankruptcy', *University of Chicago Law Review*, 42, 4: 589–652.
37. H. Radtke, 'Untreue (§ 266 StGB) zu Lasten von ausla"ndischen Gesellschaften mit faktischem Sitz in Deutschland?' (2008)
38. Milman, D. 1999, 'Groups of Companies: The Path Towards Discrete Regulation' in D. Milman (ed.), *Regulating Enterprise: Law and Business Organisations in the UK*, Hart, Oxford
39. Neyers, J. 2000, 'Canadian Corporate Law, Veil-Piercing, and the Private Law Model Corporation', *University of Toronto Law Journal*, 50, 2: 173–240.
40. V. G. Heinz, Die englische Limited (2nd edn., Baden-Baden: Nomos Verlag, 2006)
41. Halpern, P. and Trebilcock, M. and Turnbull, S. 1980, 'An Economic Analysis of Limited Liability in Corporation Law', *University of Toronto Law Journal*, 30, 2: 117–50.
42. Hansmann, H. and Kraakman, R. 1991, 'Toward Unlimited Shareholder Liability for Corporate Torts', *Yale Law Journal*, 100, 7: 1879–934.
43. Widen, W. 2007, 'Corporate Form and Substantive Consolidation', *George Washington Law Review*, 75, 2: 237–328.
44. Strasser, K.A. 2004, 'Piercing the Veil in Corporate Groups', *Connecticut Law Review*, 37, 3: 637–66.
45. Adolff, J., 'Turn of the Tide?: The "Golden Share" Judgments of the European Court of Justice and the Liberalization of the European Capital Markets', *German Law Journal*, Vol.3, Number 8, August 2002.

46. Apostolov, A., Communication concerning State control over privatized companies, Bulgarian Privatisation Agency, 2002, Sofia.
47. McHarg, A. (1998), "Government Intervention in Privatised Industries: The Potential and Limitations of the Golden Share", *Utility Law Review*, 9, 198-201.
48. McCurry, P. (2001), "Golden shares Fail to Glisten", *Privatisation International*, January, 41-3.
49. Mohamed, S., Field of Free Movement of Capital, Recent Case Law in the Field of Free movement of Capital, *European Business Law Review*, September/October 2001, pp.263-269.
50. Nugraha, S., Privatisation of State Enterprises in the 20th century a step forwards or backwards? A comparative analysis of privatisation schemes in selected welfare states, RuG, Groningen, 2002.
51. Oliver, P. and Roth, W., The Internal Market and The Four Freedoms, *Common Market Law Review* 41, Kluwer Law International 2004, Netherlands, pp.407-441.
52. Parker, D., Privatisation in the European Union, Theory and Policy Perspectives, Routledge, London, 1998.
53. Peter Zumbansen, Daniel Saam, The ECJ, Volkswagen and European Corporate Law: Reshaping the European Varieties of Capitalism, *Comparative Research and Law and Political Economy*, Vol 03, o6, (2007).
54. Putek, C., "Limited but Not Lost: A Comment on the ECJ's Golden Share decisions" *72 Fordham Law Review* (2004) 2219, 2250.
55. Ramamurti, R., Why Are Developing Countries Privatizing? *Journal of International Business Studies*, Second Quarter, 1992, pp.225-245.
56. Report of the High Level Group of Company Law Experts on a Modern Regulatory Framework for Company Law in Europe, 4 November 2002, Brussels.
57. Rutabanzibwa, Audax Peter, "What is golden in the golden share?: Company law implications of privatization", *The Company Lawyer*, 1996, Vol 17, No 2.
58. Staikouras, P., Structural Reform Policy: Privatisation and Beyond – The Case of Greece, *European Journal of Law and Economics*, 17, Kluwer Academic Publishers, The Netherlands, 2004, pp. 378-398.
59. Szyszczak E., Golden shares and Market Governance, *Legal Issues of Economic Integration*, Kluwer Law International, Netherlands 2002, volume 29 (3), pp.255-284.
60. Shaughnessy, H., Privatisation and Economic Development in Eastern Europe and The CIS, Investment, Acquisition and Managerial Issues, John Wiley & Sons Ltd, West Sussex, England, 1994.
61. Simeonov, Kaloian. Negotiations between Bulgaria and European Union concerning Chapter 4 "Free movement of capital", *Bulletin Europe*, 2002, volume 3.
62. Yergin Daniel A. and Stainlaw Joseph, *The Commanding Heights, The Battle Between Government and the Marketplace That Is Remaking the Modern World*, Simon & Schuster, New York, 1998.
63. Zach. C., Privatisation – A world privatization guide, *International Financial Law Review*, Euromoney publications, London, 1994.
64. Single Market news, The Newsletter of the Internal Market DG, European Commission, №33, April 2004.
65. Slot, P., Case Law, Case C-205/99, *Asociacion Profesional de Emresas Navieras de Lineas Regulares (Analir) and Others v. Administracion General del Estado*, Judgment of the Full Court of 20 February 2001, [2001] ECR I-1271, *Common Market Law Review* 40, Kluwer Law International, Netherlands, 2003, pp.159-168.

66. Baldassarri, M., Paganetto, L. and Phelps, E., *Privatization Processes in Eastern Europe, Theoretical Foundations and Empirical Results*, The Macmillan Press Ltd, London, 1993
67. Behrens, P., *Public Services and the Internal Market – An Analysis of the Commission's Communication on Services of General Interest in Europe*, *European Business Organization Law Review* 2, T.M.C. Asser Press, 2001, pp.469-492
68. Bulgarian newspaper "Dnevnik" – <http://www.dnevnik.bg/>
69. European Commission Staff Working Document, *Special rights in privatised companies in the enlarged Union – a decade full of developments*, Brussels, 22.07.2005.
70. Fleisher, H., Case C-367/98, *Commission of the European Communities v. Portuguese Republic (Golden shares)*; C-483/99, *Commission of the European Communities v. French Republic (Golden shares)*; and C-503/99; *Commission of the European Communities v. Kingdom of Belgium (Golden shares)*. Judgments of the Full Court of 4 June 2002, *Common Market Law Review* 40, Kluwer Law International 2003, Netherlands, pp.493-501.
71. Geradin D., *The liberalization of State Monopolies in the European Union and Beyond*, 2000 Kluwer Law International, The Hague, The Netherlands, 2000.
72. Graham and Prosser, *Privatizing Public Enterprises-Constitutions, the State, and Regulation in Comparative Perspective*, Clarendon Press, Oxford, 1991.
73. Graham, C. and Prosser T., *Golden shares: Industrial Policy by Stealth*, Public Law, 1988.
74. Grundman, S., and Moslein, F., *Golden Shares - State Control in Privatised Companies: Comparative Law, European Law and Policy Aspects*, *European Banking Financial Law Journal (EUREDIA)*, 1, 2004, pp.1-37.
75. R. M. Beltzer, 'The Transfer of Undertakings and the Importance of Taking Over Personnel – A Vicious Circle' (2007)
76. High Level Group of Company Law, Experts, *Report on Issues Related to Takeover Bids*, (10 January 2002), p.34 and pp.74-75 (Annex 4).
77. Horozov, G., *Privatisatzionniat dogovor – sashnost, osobenosti, pravno dejstvie*, Sibi, Sofia, 2000.
78. Horozov, G., *Sledprivatisatzionnen control – sashnost, dejstvie, posleditzi*, Sibi, Sofia, 2002.
79. P. Davies and M. Freedland, *Towards a Flexible Labour Market* (Oxford: OUP, 2007)
80. http://europa.eu.int/comm/enlargement/docs/newsletter/latest_weekly.htm#B, *Enlargement weekly* 21 June 2004.
81. Kronenberger, V. "The rise of the "golden" age of free movement of capital: A comment on the golden shares judgments of the Court of Justice of the European Communities", *European Business Law Review*, 4, (2003).
82. Lageweg, M., *Privatisation in Bulgaria, Czechoslovakia, Hungary and Poland*, Free University Amsterdam, Economic Faculty, Zoetermeer, November 1992.
83. Marcanio, A. and Josselin, J., *the Economics of Harmonizing European Law*, Edward.
84. Eidenmüller, *Effizienz als Rechtsprinzip*, 2nd Ed. 1998, pp. 106 ff.; Kirchner/Painter/Kaal, *ECFR* 2005, 159, 169
85. Blum, F. and Logue, A., *State Monopolies Under EC Law*, John Wiley & Sons Ltd, England, 1998, pp.7-17
86. Boardman, A.E. and Laurin, C. (2000), "Factors Affecting Stock Price Performance of Share-issued Privatizations", *Applied Economics*, 32, 1451 – 64 and Gompers et al (2001), "Corporate Governance and Equity Prices", NBER Working Paper.
87. Camara, P., "The end of the "Golden" Age of Privatisations? The recent ECJ Decisions on Golden Shares", *European Business Organization Law Review*, 3, (2002), p.506, pp.503-513.
88. Castro, J., Uhlenbruck, K., *Characteristics of Privatization: Evidence from developed, less-developed, and former communist countries*, *Journal of International Business Studies*, First Quarter, 1997, pp.123-141.

89. *Lorenzo Amatori and Other v Telecom Italia SpA, Shared Service Center Srl* Case C-458/12, 'nyr'. [2014]
90. Consolidated Version of the Treaty Establishing the European Community as amended in accordance with the Treaty of Nice Consolidated Version (OJ 2002 C325/1-184).
91. Dashwood, A., *The Relationship Between The Member States and The European Union/European Community*, Common Market Law Review 41, Kluwer International, Netherlands, 2004, pp.355-381.
92. Davies, G., *European Union Internal Market Law*, 2nd edition, Cavendish Publishing Limited, The Glass House, London, 2003.
93. Devroe W., *Privatizations and Community Law: Neutrality Versus Policy*, Common Market Law Review, Kluwer Law International 1997, Netherlands, volume 34, pp. 267-306 .
94. N. Countouris and W. Njoya, 'Transfer of Undertakings' in M. Schlachter (ed), *EU Labour Law: A Commentary* (Alphen aan de Rijn: Wolters Kluwer, 2015)
95. P. Davies, 'Transfers—The UK Will Have to Make Up Its Own Mind' (2002) 30(2) ILJ 231–5.
96. *European Union Law*, 3rd edn (Cambridge: Cambridge University Press, 2014).

LEGJISLACION

1. Ligj Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
2. Ligj Nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
3. Ligj Nr. 110/2012 “Për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare”;
4. Direktiva 2006/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2006 për krijimin dhe funksionimin e sipërmarrjes së institucioneve të kreditit e amenduar;
5. Direktiva 2006/49/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 14 qershor 2006 për mjaftueshmërinë e kapitalit të firmave të investimit dhe institucioneve të kreditit e amenduar;
6. Direktiva 2007/44/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 shtator 2007 që ndryshon Direktivën e Këshillit, 92/49/KEE dhe Direktivat 2002/83/KE, 2004/39/KE, 2005/68/KE dhe 2006/48/KE në lidhje me rregullat procedurale dhe kriteret e vlerësimit për vlerësimin prudencial të blerjeve dhe rritjes së pjesëmarrjes në sektorin financiar ;
7. Direktiva 2009/111/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 që ndryshon Direktivat 2006/48/KE, 2006/49/KE dhe 2007/64/KE në lidhje me bankat që kanë lidhje me institucione qendrore, disa çështje për fondet e veta, ekspozimet e mëdha, masat mbikëqyrëse, dhe administrimin e krizave (Direktiva për Kërkesat për Kapital II) ;
8. Direktiva 2010/76/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 24 nëntor 2010 që ndryshon Direktivat 2006/48/KE dhe 2006/49/KE në lidhje me kërkesat për kapital për portofolin e librit të tregtueshëm dhe rishikimin mbikëqyrës të politikave të remunerimit;
9. Direktiva 2002/47/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 6 qershor 2002 mbi marrëveshjetë të kolateralit financiar;
10. Direktiva 2001/24/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 prill 2001 për iorganizimin dhe likuidimin e institucioneve të kreditit;
11. Direktiva 2008/48/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 prill 2008 për marrëveshjetë e kredisë për konsumatorët që shfuqizon Direktivën 87/102/KEE;
12. Direktiva 2002/65/KE E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 shtator 2002 lidhur me marketingun në distancë të shërbimeve financiare për konsumatorin që ndryshon Direktivën e Këshillit, Direktiva 90/619/KEE dhe Direktivat 97/7/KE dhe 98/27/KE;
13. Direktiva 1986/635/KEE e Këshillit e datës 8 dhjetor 1986 për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të bankave dhe institucioneve të tjera financiare ;

14. Direktiva e Këshillit 1989/117/KEE e datës 13 shkurt 1989 për detyrimin e degëve të vendosura në një Shtet Anëtar të institucioneve të kreditit dhe institucioneve financiare që i kanë selitë qendrore jashtë atij Shteti Anëtar në lidhje me publikimin edokumenteve të llogarive vjetore ;
15. Direktiva 2001/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 Shtator 2001 që ndryshon direktivat 78/660/KEE, 83/349/KEE dhe 86/635/KEE në lidhje me rregullat e vlerësimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të disa lloj shoqërive sidhe bankave dhe institucioneve të tjera financiare ;
16. Direktiva 2003/51/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 18 Qershor 2003 që ndryshon direktivat 78/660/KEE, 83/349/KEE, 86/635/KEE dhe 91/674/KEE në lidhje me rregullat e vlerësimit për llogaritë vjetore dhe të konsoliduara të disa llojshoqërive si dhe bankave dhe institucioneve të tjera financiare, si dhe sipërmarrjeve në fushën e sigurimeve ;
17. Direktiva 2009/110/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit datë 16 shtator 2009 mbi marrjen, ndjekjen dhe mbikëqyrjen e kujdesshme të biznesit të institucioneve të parashë elektronike, ndryshimit Direktivat 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dheshfuqizimi i Direktivës 2000/46/KE;
18. Direktiva 2007/64/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 Nëntor 2007 nëshërbimet e pagesave në tregun e brendshëm që ndryshon Direktivat 97/7/ KE, 2002/65/ KE, 2005/60/ KE dhe 2006/48/ KE dhe shfuqizon Direktivën 97/5/ KE;
19. Direktiva 94/19/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit 30 maj 1994 për skemat edepozitave të garancisë;
20. Direktiva e parë e Këshillit 73/239/KEE, datë 24 Korrik 1973, për bashkërendimin eakteve ligjore, nënligjore dhe administrative që kanë të bëjnë me fillimin dhe ndjekjen veprimtarisë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim të sigurimit të jetës;
21. Direktiva e Këshillit 73/240/KEE, datë 24 Korrik 1973, që heq kufizimet mbi lirinë evendosjes në veprimtarinë tregtare të sigurimit të drejtpërdrejtë me përjashtim tësigurimit të jetës;
22. Direktiva 87/344/KEE, datë 22 Qershor 1987, mbi koordinimin e ligjeve, rregullorevedhe dispozitave administrative që lidhen me sigurimin e shpenzimeve ligjore;
23. Direktiva e dytë e Këshillit 88/357/KEE, datë 22 Qershor 1988, për bashkërendimin eakteve ligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejtame përjashtim të sigurimit të jetës, ku parashikohen dispozitat për mundësimin eushtrimit të efektshëm të lirisë për të ofruar shërbime dhe ku ndryshohet Direktiva 73/239/KEE;
24. Direktiva e Këshillit 92/49/KEE, datë 18 Qershor 1992, për bashkërendimin e akteveligjore, nënligjore dhe administrative në lidhje me sigurimet e drejtpërdrejta me përjashtim të sigurimit të jetës, dhe për ndryshimin e Direktivës 73/239/KEE dhe Direktivës 88/357/KEE (Direktiva e tretë për sigurimet jo- jetë);
25. Direktiva 2002/13/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 Mars 2002, përndryshimin e Direktivës së Këshillit 73/239/KEE në lidhje me kërkesat për nivelin eafhtësisë paguese për ndërmarrjet e sigurimeve jo- jetë;
26. Direktiva e Këshillit 91/674/KEE, datë 19 Dhjetor 1991 për llogaritë vjetore dhe llogaritë e konsoliduara të ndërmarrjeve të sigurimeve;
27. Direktiva 98/78/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 27 Tetor 1998, përmbikëqyrjen shtesë të ndërmarrjeve të sigurimeve në grupin e sigurimeve;
28. Direktiva 2002/92/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 9 Dhjetor 2002, për ndërmjetësimin në sigurime;
29. Direktiva 2005/68/KE datë 16 Nëntor 2005, dhe amenduar Direktivat e Këshillit 73/239/KEE, 92/49/KEE si dhe Direktivat 98/78/KE dhe 2002/83/KE Mbirisigurimin;

30. Direktiva 2001/17/KE për riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve të sigurimeve;
31. Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbitregjet e instrumenteve financiarë” që ka ndryshuar Direktivën 85/611/KE dhe 93/6/KEE dhe Direktivën 2000/12/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe ka shfuqizuar Direktivën 93/22/KEE;
32. Direktiva 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 Janar 2003 “Përtrajtimin e informacionit të brendshëm dhe manipulimin e tregut”;
33. Direktiva 2003/71/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 4 Nëntorit 2003 “Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë i janë ofruar publikut ose janë pranuar për t’u tregtuar” që amendon Direktivën;
34. Direktiva 2010/73/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 24 Nëntor 2010 që kandyshuar Direktivën 2003/71/KE “Mbi publikimin e prospektusit, kur letrat me vlerë janë ofruar publikut ose janë pranuar për t’u tregtuar” dhe Direktivën 2004/109/KE “Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rrethemetuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t’u tregtuar në tregjet e rregullta”;
35. Direktiva 2004/109/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 15 Dhjetorit 2004 “Mbi harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rrethlëshuesve të letrave, të cilat janë pranuar për t’u tregtuar në tregjet e rregullta dhe qëka ndryshuar Direktivën 2001/34/KE;
36. Direktiva 2001/34/KE e Parlament Evropian dhe e Këshillit të 28 Maj 2001 “Mbipranimin e titujve në listimin e bursave zyrtare të titujve dhe informacioni që duhet publikuar për këto tituj”;
37. Direktiva 2003/41/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 3 Qershorit 2003 “Mbi aktivitetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensioneve profesionale”;
38. Direktiva 2009/65/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 13 Korrikut 2009 “Përkoordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative lidhur mesipërmarrjet për investimet kolektive në letrat me vlerë të transferueshme (UCITS)”;
39. Direktiva e Këshillit 78/473/KEE e 20 Maj 1978 mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me bashkësigurimin komunitar;
40. Rregullorja (KE) Nr. 583/ 2010 e datës 1 Korrik 2010 që ka implementuar Direktivën 2009/65/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me informacionin kyç të investitorit dhe kushtet që duhet të plotësohen kur sigurohet informacioni kyç të investitorit ose prospektit të aksesueshëm gjatë një periudhe të përshtatshme, endryshme nga ajo në letër dhe në formë elektronike;
41. Rregullorja (KE) Nr 1606/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 19 korrik 2002 për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;
42. Direktiva 2014/65/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbitregjet e instrumenteve financiarë” që ka ndryshuar Direktivën 2002/92/KE dhe Direktivën 2011/161/KE (MiFID II).
43. Direktiva 2003/6/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 28 Janar 2003 “Përtregtimin e brendshëm dhe manipulimin e tregut”;
44. Direktiva 2014/51/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 Prill 2014 kandyshuar Direktivën 2003/71/KE dhe Direktivën 2009/138/KE dhe Rregulloren (KE) Nr. 1060/2009, (BE) Nr. 1094/2010 dhe (BE) Nr. 1095/2010 në lidhje me kompetencat e Autoritetit Mbikëqyrës Evropian EIOPA (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale) dhe Autoritetit Mbikëqyrës Evropian ESMA (Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjeve).
45. Rregullorja (BE) Nr. 600/ 2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi tregjet e instrumenteve financiarë” është publikuar në fletoren zyrtare të BE-së.

46. Rregullorja (BE) Nr. 596/2014 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 16 Prill 2014 mbi manipulimin e tregut (Rregullore mbi manipulimin e tregut).
47. Direktiva 2014/49/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Prill 2014 përsëritet e garantimit të depozitave;
48. Direktiva 2014/59/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 Maj 2015 mbi krijimin e një kuadri për rimëkëmbjen dhe zgjidhjen e institucioneve të kreditimit dhe shoqërive të investimit e cila ndryshon Direktivën 82/891/KEE, Direktivën 2001/24/KE, Direktivën 2002/47/KE, Direktivën 2004/25/KE, Direktivën 2005/56/KE, Direktivën 2007/36/KE, Direktivën 2011/35/BE, Direktivën 2012/30/BE dhe Direktivën 2013/36/BE, Rregulloren e (BE) Nr. 1093/2010 dhe (BE) Nr. 648/2012 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit.
49. Stabilisation and Association Agreement between the European Communities and their Member States, of the one part, and the Republic of Albania, of the other part.

VENDIME GJKATASH

1. Case C-307/97 *Compagnie de Saint-Gobain, Zweigniederlassung Deutschland v. Finanzamt Aachen-Innenstadt*, [1999] ECR I-6161
2. Case 270/83 *Commission v. France*, [1986] ECR 273
3. Case C-330/91 *Commerzbank AG* [1993] 4017, 4043
4. C-152/84 *Marshall v Southampton dhe South-West Hampshire Area Health Authority* [1986] ECR 723.
5. C-14/83, *Von Colson dhe Kamann kundër Land Nordrhein-Westfalen* [1984] ECR 1891
6. Advocate General *Lenz*, in Case C-250/95 *Futura Singer*, [1997] ECR I-2471
7. Case C-311/97 *Royal Bank of Scotland*, [1999] ECR I-2651 at p. 1-2672
8. Case C-114/97 *Commission v. Spain*, [1998] ECR I-6717
9. Case C-212/97 *Centros Ltd v. Erhvervs- og Selskabsstyrelsen*, [1999] ECR I-1459.
10. Case C-251/98 *Baars* [1999] ECR I-2787, the opinion of Advocate General
11. Case 205/84 *Commission v. Germany*, [1986] ECR 3755
12. Case C-76/90 *Sager v. Demmeyer Ltd.*, [1991] ECR I-4221,
13. C-194/06 - *Orange European Smallcap Fund*
14. German Federal Constitutional Court, Case 1 BvR 1613/94, 100
15. Case C-98/01 *Commission v United Kingdom* [2003] ECR I-4641
16. Case C-367/98 *Commission v Portugal* [2002] ECR I-4731
17. C-452/01 - *Ospelt and Schlössle Weissenberg*
18. C-515/99 - *Reisch and Others*
19. Case C-174/04 *Commission v Italy* [2005] ECR I-4933
20. C-279/93 - *Finanzamt Köln-Altstadt v Schumacker*
21. Case C-503/99 *Commission v Belgium* [2002] ECR I-4809
22. Case C-167/01 *Kamer van Koophandel en Fabrieken voor Amsterdam v. Inspire Art Ltd* [2003] ECR I-10155.
23. C-222/97 - *Trummer and Mayer*, § 21.
24. C-358/93 - *Bordessa and Others*, § 13.
25. C-163/94 - *Sanz de Lera and Others*, § 33.
26. *Luisi and Carbone v Ministero del Tesoro*
27. C-386/04 - *Centro di Musicologia Walter Stauffer*
28. C-439/97 – *Sandoz*
29. C-67/08 – *Block*
30. C-560/13 - *Wagner-Raith*
31. C-446/04 - *Test Claimants in the FII Group Litigation*

32. C-190/12 - Emerging Markets Series of DFA Investment Trust Company
33. C-163/94 - Sanz de Lera and Others
34. C-513/03 - van Hilten-van der Heijden
35. C-358/93 - Bordessa and Others
36. T-315/01 - Kadi v Council and Commission
37. C-279/93 - Finanzamt Köln-Altstadt v Schumacker
38. C-302/97 – Konle
39. Vendim i GJK Nr. 10, datë 19.03.2008
40. Vendim i GJK Nr.6, datë 04.03.2010
41. Vendim i GJK Nr. 2, datë 16.01.2013
42. Vendim i GJK Nr.1, datë 25.012010
43. Vendim i GJK Nr. 24, datë 24.07,2009
44. Vendim i GJK Nr. 12, datë 17.03.2014
45. Vendim i GJK Nr. 31, datë 10.07.2013
46. Vendim i GJK Nr. 26, datë 25.03.2009
47. Vendim i GJK Nr.36, datë 10.11.2010
48. Vendim i GJK Nr.14, datë 21.03.2014
49. Vendim i GJK Nr. 22,datë 08.02.2013
50. Vendim i GJKNr.32,datë 28.12.2009
51. Vendim Nr. 1449,datë 27.10.2005, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
52. Vendim Nr.340,datë 04.10.2009, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
53. Vendim Nr.60,datë 09.02.2010,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
54. Vnedim Nr.337,datë 26,06.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
55. Vendim Nr.468,datë 24.10.2012,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
56. Vendim Nr.53,datë 03.02.2011,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
57. Vendim Nr.81,datë 16.02.2012,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
58. Vendim Nr.239,datë 04.04.2013,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
59. Vendim Nr.142,datë 31.03.2011,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
60. Vendim Nr.82,datë 22.02.2011,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
61. Vendim Nr.1067,datë 26.09.2007,Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
62. Vendim Nr.00-2012-869,datë 12.04.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
63. Vendim Nr.00-2012-2416,datë 16.11.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë
64. Vendim Nr.2703 datë 12.12.2011 Gjykata e Apelit Tiranë
65. Vendim Nr.2104 datë 17.09.2012 Gjykata e Apelit Tiranë

66. Vendim Nr.2031 datë 07.09.2012 Gjykata e Apelit Tiranë
67. Vendim Nr.2441 datë 17.10.2012 Gjykata e Apelit Tiranë
68. Vendim Nr.1656 datë 18.07.2013 Gjykata e Apelit Tiranë
69. Vendim Nr.662 datë 19.03.2013 Gjykata e Apelit Tiranë
70. Vendim Nr.4971 datë 16.05.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
71. Vendim Nr.6314 datë 19.06.2012 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
72. Vendim Nr.5176 datë 23.06.2010 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
73. Vendim Nr.2256 datë 24.03.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
74. Vendim Nr.10308 datë 16.12.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
75. Vendim Nr.623 datë 30.01.2009 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
76. Vendim Nr.6924 datë 19.06.2013 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
77. Vendim Nr.4764 datë 02.05.2013 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
78. Vendim Nr.7718 datë 18.10.2010 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
79. Vendim Nr.7952 datë 14.10.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
80. Vendim Nr.4848 datë 14.05.2012 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
81. Vendim Nr.6314 datë 19.06.2012 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
82. Vendim Nr.9754 datë 01.10.2013 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
83. Vendim Nr.12508 datë 18.12.2012 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
84. Vendim Nr.3616 datë 18.03.2014 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
85. Vendim Nr.3567 datë 03.05.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
86. Vendim Nr.10036 datë 08.10.2013 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
87. Vendim Nr.1577 datë 19.02.2013 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
88. Vendim Nr.6461 datë 20.07.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
89. Vendim Nr.3417 datë 21.03.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
90. Vendim Nr.9745 datë 23.11.2009 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
91. Vendim Nr.10373 datë 11.12.2009 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
92. Vendim Nr.4751 datë 02.06.2009 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
93. Vendim Nr.390 datë 28.01.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
94. Vendim nr.2577 date 20.03.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
95. Vendim nr.3082 date 26.06.20011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
96. Vendim nr.6062 date 06.07.2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
97. Vendim nr.172 date 19.01.2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

98. Vendim nr.5325 date 25.05.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane
99. Vendim nr.3699 date 23.04.2008 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
100. Vendim nr.3035 date 18.04.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
101. Vendim nr.5068 date 13.06.2011 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
102. Vendim nr.8250 date 21.07.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
103. Vendim Nr.4280 datë 23.05.2011 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
104. Vendim Nr.68 datë 14.01.2014 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
105. Vendim Nr.10509 datë 03.11.2014 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
106. Vendim Nr.6725 datë 28.06.2012 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
107. Vendim Nr.2747 datë 26.02.2014 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë
108. Vendim Nr.9734 datë 01.10.2013 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë
109. Vendim Nr. 5880 datë 27.05.2013 Gjykata e Rrethit GjyqësorTiranë